

# BIBLIOTHECAE 6

Organ i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë



BIBLIOTEKONOMI

PROJEKTE TË REJA

DOKUMENTE

LEXIME TË REKOMANDUARA

HISTORI E LIBRIT DHE E SHTYPIT

2005

# BIBLIOTHECAE

*Organ i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë*

Nr. 6 Viti 2005

*Drejtor*

**Prof. as. dr. AUREL PLASARI**

*Kryeredaktore*

**ETLEVA DOMI**

*Redaksia:*

**Ramazan Vozga (sekretar)**

**Farfuri Xhaja**

**Maksim Gjinaj**

**Tefta Buzo**

*Këshilli botues:*

**Aida Veliaj**

**Dr. Ardian Klosi**

**Prof. as. dr. Kaliopi Naska**

**Prof. Koli Xoxi**

**Dr. Kujtim Bevapi**

**Prof. Nasho Jorgaqi**

**Sherif Delvina**

*Përpunimi grafik*

**Elzana Agolli**

© Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

*Adresa:*


**Biblioteka Kombëtare**

**Sheshi "Skënderbeu", Tiranë**

**Tel. & Fax: +355 4 257670**

**www.bksh.al**

2005





- Biblioteka e Babelit 8  
**Jorge Luis Borges**
- 

### HISTORI E LIBRIT DHE E SHTYPIT

- Jeta mbas vdekjes e Dhimitër Bedullit 17  
**Prof. as.dr. Aurel PLASARI**  
*Biblioteka Kombëtare*
  - Filip Fishta, gjurmuesi i historisë shqiptare në arkivat dhe bibliotekat e Europës 23  
**Gjovalin ÇUNI**  
*Biblioteka "Marin Barleti", Shkodër*
  - Librat e mi 34
  - Spanët, Bokalët dhe Marulët sipas botimeve albanologjike 42  
**Afërdita SHARXHI**  
*Biblioteka Kombëtare*
- 

### VEPRIMTARË TË ALBANOLOGJISË

- Antonio BALDACCI (1867-1950) 51
- Marcin BIELSKI (1495-1575) 51
- Jacques BOURCART (1891-1965) 52
- Vincenzo CORONELLI (1650-1718) 53
- Jacob Philipp FALLMERYER (1790 – 1861) 55
- Margaret HASLUCK (1885-1948) 56



■ Nicolae IORGA (1871-1940)	57
■ Theodor IPPEN (1861-1935)	58
■ William Martin LEAKE (1777-1860)	59
■ Gustav MEYER (1850-1900)	60
■ François POUQUEVILLE (1770-1838)	61
■ Mario ROQUES (1875-1961)	61
■ Gustav WEIGAND (1860-1930)	62

---

## **BOTIME**

■ Digjitalizimi, e ardhmja e bibliotekomisë moderne <b>Eni KAÇI</b> <i>Biblioteka Kombëtare</i>	65
---	----

---

## **BIBLIOTEKONOMI**

■ Rregullat e katalogimit dhe Kërkesat Funktionale për Regjistrimet Bibliografike <b>Farfuri XHAJA</b> <i>Biblioteka Kombëtare</i>	71
■ Bibliotekat publike shqiptare në Shoqërinë e Informacionit <b>Etleva DOMI</b> <i>Biblioteka Kombëtare</i>	89
■ Biblioteka e Universitetit të Tiranës: histori dhe perspektivë <b>Kledi SHEGANI</b> <i>Biblioteka e Universitetit të Tiranës</i>	94

- Biblioteka dhe shërbimet e informacionit parlamentar **99**  
**Zana BUFI**  
*Biblioteka e Kuvendit*
  
- Biblioteka Aleksandrina **105**  
**Mirlona BUZO**  
*Biblioteka Kombëtare*
  
- Bibliotekat publike në Spanjë **114**  
**Odetta MEMA**  
*Biblioteka Kombëtare*
  
- Direktiva të Këshillit të Europës/EBLIDA për legjisllacionin dhe politikat bibliotekare në Europë **120**
  
- Udhëzues të projektit CALIMERA-Digjitalizimi **130**

---

#### BIBLIOTEKA TË REJA-KULTURA TË REJA

- Biblioteka e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike **149**  
**Besa KASAPI**  
*Universiteti Politeknik*

---

#### PROJEKTE TË REJA

- Konvertimi retrospektiv i skedarëve tradicionalë **155**

---

## DOKUMENTE

- Manifesti i Aleksandrisë për bibliotekat 159
  - Rezoluta e Luksemburgut e CENL-së për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore europiane 161
  - Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s z. M. Koïchiro Matsuura me rastin e Ditës Botërore të Aftësimin në Informacion 8 shtator 2005 163
- 

## NGJARJE

- Dita Botërore e Librit në Bibliotekën Kombëtare 167
  - Në përkujtim të shkrimtarit dhe përkthyesit Mustafa Greblleshi 168
  - Promovohet libri me kujtime "Endur në tisin e kohës" i Vedat Kokonës 169
- 

## VEPRIMTARI

- Java e Bibliotekës në Kosovë 171
- 

## LEXIME TË REKOMANDUARA

- Recensione 173
- Hyrje të reja 181
- Website 190

## TERMINOLOGJI

- Në ndihmë të terminologjisë së shpjeguar të bibliotekomisë **Farfuri XHAJA** 192  
*Biblioteka Kombëtare*
-



*Jorge Luis Borges (1899-1986) poet, eseist dhe tregimtar argjentinaz. Që nga viti 1937 punoi si katalogues në bibliotekën publike të Buenos Airesit. Procesi i katalogimit frymëzoi një nga tregimet më të famshme të Borgesit "Biblioteka e Babelit" (1941), në të cilin biblioteka, e strukturuar në mënyrë të përsosur, përfaqëson Universin. Më 1955 Borges u bë drejtor i Bibliotekës Kombëtare të vendit të vet. Me atë rast ai pati thënë se fati ishte tallur me të dhe i kishte dhënë njëherazi libra pa fund dhe errësirë, duke aluduar për verbërinë thujtje të plotë që e kishte kapluar.*



# Biblioteka e Babelit

*Jorge Luis Borges*

**“By this art you may contemplate  
the variation of the 23 letters...”**

*The Anatomy of Melancholy*  
part 2, sect. II, mem. IV.

Universi (që të tjerë e quajnë Bibliotekë) përbëhet nga një numër i pacaktuar, dhe ndoshta i pafund, galerish gjashtëkëndëshe, me puse të gjera ajrimi, në qendër, të rrethuar me parmakë shumë të ulët.

Prej secilit nga këta gjashtëkëndësha shihen katet e poshtme dhe të sipërme, pa mbarim. Shpërndarja e galerive është e pandryshueshme. Njëzet raftet e gjatë, nga pesë për anë, mbulojnë krejt muret me përrjashtim të dy prej tyre; lartësia e tyre, që është sa ajo e vetë kateve, nuk e kalon aspak shtatin e një bibliotekari me fizik normal. Secila prej faqeve të lira bie në një korridor të ngushtë, i cili del në një tjetër galeri identike me të parën dhe me gjithë të tjerat. Në të djathtë dhe në të majtë të korridorit ka dy kthinëza fare të vogla. Njëra sa për të fjetur në këmbë, tjetra sa për të kryer nevojat. Aty pranë, kalon një shkallë spirale që ulet e ngrihet sa të ha syri. Në korridor ka një pasqyrë që dyfishon me besnikëri pamjet. Njerëzit nga kjo nxjerrin përfundimin se Biblioteka

nuk është e pafund; po të ishte ashtu me të vërtetë, përse duhej ky dyfishim i rremë. Unë për vete parapëlqej të ëndërroj se këto sipërfaqe të lëmuara janë atje për të paraqitur pafundësinë dhe për ta premtuar atë... Ca si fruta sferike të quajtura llamba sigurojnë ndriçimin. Nga dy për çdo gjashtëkëndësh dhe të vendosura horizontalisht, këto globe lëshojnë një dritë të pamjaftueshme, të pareshtur.

Si të gjithë njerëzit e Bibliotekës, unë kam udhëtuar në të ri; kam bërë pelegrinazhe në kërkim të një libri dhe ndoshta të katalogut të katalogëve; tani që sytë e mi mezi deshifrojnë çka shkruaj, po bëhem gati të vdes diku afër gjashtëkëndëshit ku linda. Kur të vdes, nuk do të mungojnë duar të përshpirtshme që të më hedhin nga parmaku e poshtë: varri im do të jetë ajri i humnershëm; trupi im do të zhytet thellë për një kohë të gjatë, do të kalbëzohet, do të shpërbëhet në erën që përftohet nga rënia, e cila është e pafund. Sepse unë e thashë se Biblioteka është e pambarue-

shme. Për idealistët, sallat gjashtëkëndëshe janë një formë e domosdoshme e hapësirës absolute, ose të paktën e intuitës sonë për hapësirën; ata mendojnë se një sallë trekëndëshe apo pesëkëndëshe do të ishte e pamendueshme. Sa për mistikët, ata pretendojnë se ekstaza u zbulon një dhomë rrethore me një libër të madh gjithashtu rrethor me shpinë të vijueshme, që i bie përqark plotësisht mureve, por dëshmia e tyre është e dyshimtë, fjalët e tyre të errëta: ky libër ciklik, është Zoti... Po mjaftohem tani për tani me përsëritjen e sentencës klasike: Biblioteka është një sferë, qendra e vërtetë e të cilës është një gjashtëkëndësh i çfarëdoshëm dhe perimetri i saj është i paarritshëm.

Çdo njëri nga muret e secilit gjashtëkëndësh mban pesë rafte, çdo raft ka tridhjetë e dy libra, të gjithë me të njëjtin format, çdo libër ka katërqind e dhjetë faqe; çdo faqe dyzet rreshta dhe çdo rresht afërsisht tetëdhjetë shkronja të zeza. Ka gjithashtu shkronja në shpinë të çdo libri; këto shkronja as tregojnë as paralajmërojnë atë çka do të thonë faqet: mospërputhje që, e di edhe vetë, nganjëherë duket misterioze. Para se të përmbledh zgjidhjen (zbulimi i së cilës, pavarësisht nga shfaqjet e saj tragjike, është ndoshta fakti kryesor i ngjarjes) dua t'ju kujtoj nja dy aksioma.

Aksioma e parë: Biblioteka ekziston *ab aeterno*.

Në këtë të vërtetë, rrjedhoja e menjë-

hershme e të cilës është përjetësia e ardhshme e botës, nuk mund të dyshojë asnjë njeri me mend. Qëllon që njeriu, bibliotekari jo i përkryer, të jetë vepër e rastësisë ose e demiurgëve dashakeqës; universi me pajisjen e vet elegante me raftë, me vëllime enigmatike, me shkallët e palodhshme për udhëtarin dhe me nevojtoresh për bibliotekarin që rri ndenjtur, s'mund të jetë veçse vepër e Zotit. Për të matur largësinë që ndan hyjnoren nga njerëzorja, mjafton të krahasosh këto simbole të vjetëruara e të paqarta që dora ime e gabueshme shkarravit e shkarravit mbi kapakun e një libri me shkronjat organike të pjesës së brensdshme: të përpikta, të brishta, në një mellan të zi, me një simetri të paimitueshme.

Aksioma e dytë: *numri i simboleve ortografike është njëzet e pesë!*

Qe ky shënim që lejoi, para nja treqind vjetësh, të formulohej një teori e përgjithshme e Bibliotekës dhe të zgjidhte në mënyrë të kënaqshme problemin që s'kish mundur ta deshifronte asnjë hamendje: natyra e paformë dhe kaotike e pothuaj të gjithë librave. Njëri prej këtyre, të cilin im at e zbuloi në një gjashtëkëndësh të rrethit pesëmbëdhjetë-nëntëdhjetë e katër, përmbante vetëm tri shkronja MCV të përsëritura mbrapshtisht nga rreshti i parë tek i fundit. Një tjetër (që e shohin shumë në zonën time) është një labirint i vërtetë shkronjash, por në faqen e parafundit gjendet kjo frazë: *O kohë, piramidat e*

<sup>1</sup> Dorëshkrimi origjinal i këtij teksti nuk përmban as shifra as shkronja të mëdha. Pikësimi ishte kufizuar me presje e pikë. Këto dy shenja, hapësira dhe njëzet e dy shkronjat e alfabetit janë njëzet e pesë simbolet e mjaftueshme të numëruara nga i panjohuri (shënim i botuesit).

*tua!* S'ka sesi ta injorosh më këtë gjë: për një rresht të arsyeshëm, për një informacion të saktë ka lega e lega të tëra kakofonish të çmendura, shkarravinash pa kuptim e fjalësh pa lidhje. (Njoh një vend barbar ku bibliotekarët kanë hequr dorë nga zakoni për t'u gjetur një kuptim të çfarëdoshëm librave, si një zakon bestyt e të kotë, dhe e krahasojmë me zakonin për të shpjeguar ëndrrat dhe vijëzimet kaotike të dorës... Ata pranojnë se shpikësit e shkrimit kanë imituar njëzet e pesë simbolet natyrore, por pohojnë se ky zbatim është i rastësishëm dhe se librat vetë nuk thonë asgjë. Ky opinion, sikundër do ta shohim, nuk është plotësisht i rremë).

Për shumë kohë u mendua se këto libra të padepërtueshëm u përgjigjeshin gjuhëve të harruara e të largëta. Është e vërtetë se njerëzit më të lashtë, bibliotekarët e parë përdorin një gjuhë krejt të ndryshme nga ajo që flasim ne tani; është e vërtetë se disa dhjetëra milje në të djathtë gjuha bëhej dialektore dhe nëntëdhjetë kate më lart, e pakuptueshme. E gjithë kjo, e përsëris, është e saktë, por katërqind e dhjetë faqe me MCV të pandryshueshme nuk mund t'i korrespondonin asnjë gjuhe, qoftë edhe dialektore apo rudimentare. Disa lanë të kuptohej se çdo shkronjë mund të ndikonte te shkronja pasardhëse dhe se vlera e MCV-së në rreshtin e tretë të faqes 71 nuk është e njëjtë me vlerën e këtij grupi në aksh rresht të një tjetër

faqeje, por ky propozim i paqartë nuk pati aspak sukses. Të tjerë thanë se qe fjala për kriptografi; është kjo hipotezë që më në fund triumfoi dhe u pranua botërisht, megjithëse me një kuptim të ndryshëm nga ai primitiv.

Pesëqind vjet më parë, shefi i gjashtëkëndëshit të sipërm<sup>2</sup> vuri dorën mbi një libër po aq të ngatërruar sa të tjerët, por që kishte dy faqe, apo pothuaj dy, me rreshta homogjenë e, me sa duket, të lexueshëm. Ai ia tregoi zbulimin e tij një deshifruesi shëtitës, i cili tha se ato ishin hartuar në portugalisht; të tjerë pretenduan se ishte jidish. Më pak se një shekull më vonë, u përcaktua gjuha e saktë: bëhej fjalë për një dialekt lituanes të garantitit me intonacione të arabishtes klasike. Përmbajtja gjithashtu u deshifrua: ishin nocione të analizës kombinuese të ilustruar me shembuj të ndryshore me përsëritje konstante. Këta shembuj i lejuan një bibliotekari gjenial të zbulonte ligjin themelor të Bibliotekës. Ky mendimtar vuri re se të gjithë librat, sado të ndryshëm qofshin, përmbajnë elemente të barabarta: hapësirën, pikën, presjen, njëzet e dy shkronjat e alfabetit. Ai përmendi një fakt që e konfirmuan të gjithë udhëtarët: *nuk ka në gjithë atë Bibliotekë dy libra njëlloj*. Nga këto premisa të pakundërshtueshme ai nxori përfundimin se Biblioteka është e plotë dhe se raftet e saj ruajnë të gjitha kombinimet e mundshme të njëzet e ca simboleve ortografike (numër, ndonëse shumë i madh, jo i pafund),

<sup>2</sup> Dikur kishte nga një njeri për çdo tre gjashtëkëndësha. Vetëvrasja dhe sëmundjet e mushkërive e kanë prishur këtë raport. Kujtimi i një melankolie të papërkrueshme: më ka qëlluar të udhëtoj për net të tëra përmes korridoreve e shkallëve të lëmuara pa takuar asnjë bibliotekar.



domethënë gjithë ç'është e mundur të shprehet, në të gjitha gjuhët, gjithçka: historia e hollësishme e të ardhmes, autobiografitë e kryeengjërve, katalogu besnik i Bibliotekës, me mijëra katalogë të rremë, paraqitja e pavërtetësisë së këtyre katalogëve, paraqitja e pavërtetësisë së katalogut të vërtetë, ungjilli gnostik i Bazilidës, komenti i këtij ungjilli, komenti i komentimit të këtij ungjilli, tregimi i vërtetë i vdekjes tënde, përkthimi i çdo libri në të gjitha gjuhët, ndërftimet e çdo libri në të gjitha librat.

Kur u shpall se Biblioteka i kishte të gjithë librat, reagimi i parë qe një lumturi e çmendur. Të gjithë njerëzit ndiheshin zotër të një thesari të paprekur e të fshehtë. Nuk kishte problem vetjak apo botëror që të mos e gjente zgjidhjen të shprehur diku: në ndonjë gjashtëkëndësh. Gjithçka ishte e justifikuar, gjithësia befaz kishte fituar përmasat e pakufizuara të shpresës. Në atë kohë u fol shumë për Justifikimet: libra apologjie e profecie që justifikonin përgjithmonë veprimet e çdo njeriu dhe ruanin për të ardhmen të fshehta të mrekullueshme. Me mijëra të paduruar braktisën gjashtëkëndëshin e ëmbël të lindjes dhe iu turrën shkallëve, të shtyrë nga qëllimi i rremë për të gjetur Justifikimin e tyre. Këta pelegrinë grindeshin nëpër korridoret e ngushta, lëshonin mallkime të pakuptueshme, kacafyteshin midis tyre në shkallët hyjnore, flaknin në fund të tuneleve librat mashtrues, vdisnin të rrokullisur poshtë nga njerëzit e zonave të thella. Të tjerë, shkalluan nga mendtë... Nuk mund të mohosh ekzistencën e Justifikimeve (unë vetë njoh dy syresh që kanë të bëjnë me personazhe të ardhshme, personazhe

ndoshta joimagjinare), por shkencëtarëve nuk u shkente mendja se mundësia që njeriu të gjejë justifikimin e vet, apo ndoshta edhe ndonjë variant të rremë të tij, është pothuaj zero.

Aso kohe shpresohej gjithashtu të hidhej dritë mbi misteret themelore të njerëzimit: origjinën e Bibliotekës dhe të Kohës. Nuk është e pabesueshme që këto mistere të rëndësishme të shpjegohen vetëm nëpërmjet fjalëve njerëzore: nëse gjuha e filozofëve nuk do të mjaftonte, Biblioteka shumëformëshe do të kishte krijuar një gjuhë të padëgjuar, që do të duhej posaçërisht për to, me gjithë fjalorët e gramatikat e saj. U bënë katër shekuj që njerëzit, me këtë shpresë, shtrydhën gjashtëkëndëshat...

Ka kërkues zyrtarë, *inkuizitorë*. Unë i kam parë tek ushtrojnë funksionin e tyre: ata mbërrijnë gjithmonë të rraskapitur; flasin për një shkallë pa shkallare ku desh thyen qafën, flasin me bibliotekarin për galeritë dhe korridoret; nganjëherë marrin librin që kanë më pranë dhe i hedhin një sy për të gjetur fjalë të ndyra. Me sa duket asnjë prej tyre nuk shpreson të gjejë gjë.

Dalldia e shpresës u pasua, si zakonisht, nga një ligështim shumë i madh. Siguria që ndonjë raft i ndonjë gjashtëkëndëshi ndrynte brenda tij libra të çmuar dhe që këta ishin të paarritshëm dukej pothuaj e padurueshme. Një sekt blasfemues propozoi të ndërpriteshin kërkimet dhe të përziehen shkronja e simbole derisa të arrinin të rindërtonin, po t'i ndihte fati, këta libra kanonikë. Autoritetet u detyruan të nxirrnin urdhra të rreptë. Sekti u zhduk; por në fëmijëri kam parë pleq që fshihehin për një kohë të gjatë në nevojtoje me disqe



të vegjël metalikë në fund të një koni të ndaluar dhe imitonin keq nëmujën hyjnore.

Të tjerë, përkundrazi, menduan se thelbësore ishte të zhduknin veprat e panevojshme. Ata pushtonin gjashtëkëndëshat duke paraqitur fletë-leje, nganjëherë autentike, shfletonin me mërzi një vëllim dhe dënonin raftet të tërë: pikërisht tërbimit të tyre spastrues, asketik ia detyrojmë humbjen e pamend të miliona vëllimeve. Emri i tyre, kuptohet, urrehet në kulm, por ata që qajnë “thesaret” e shfarosura nga furia e tyre harrojnë dy fakte shumë të njohura. *Së pari*, Biblioteka është aq e madhe sa çdo gjymtim me origjinë njerëzore nuk mund të jetë veçse i papërfillshëm. *Së dyti*, nëse çdo ekzemplar është unik dhe i pazëvendësueshëm, ka gjithmonë, meqë biblioteka është e plotë, me qindra-mijëra faksimile pothuaj të përkryera që nuk ndryshojnë nga libri i saktë veçse nga një shkronjë a një presje. Ndryshe nga opinioni i përgjithshëm, unë mendoj se pasojat e dëmtimeve të bëra nga Spastruesit janë zmadhuar nga tmerrri që kishte ngjallur fanatizmi i tyre. Ata i kishte kapluar jermi për të shtënë në dorë librat fantastikë të gjashtëkëndëshit të Kuq gjak: libra me format të zvogëluar, të gjithëpushtetshëm, të ilustruar e magjikë. Një besëtytni tjetër e këtyre kohërave ka arritur deri te ne: ajo e Njeriut të Librit. Mbi ndonjë raft të

ndonjë gjashtëkëndëshi, mendohej se duhej të ekzistonte një libër që është çelësi dhe përmbledhja e përkryer e të gjithë librave: është një bibliotekar që e ka lexuar këtë libër dhe ai ngjan si perëndi. Në gjuhën e kësaj zone ruhen ende gjurmë të kultit blatur këtij funksionari të hershëm. Në kërkim të tij u organizuan shumë pelegrinazhe, që për një shekull rrahën më kot horizonte nga më të ndryshmet. Si ta lokalizojë gjashtëkëndëshin e përndëruar e të fshehtë që e mbronte? U propozua një metodë prapavajtëse: për të lokalizuar librin A, shihej më parë libri B që do të tregonte vendin e A-së, për të lokalizuar librin B, shihej më parë libri C dhe kështu me radhë deri në pafundësi... Në këto soj aventurash shkrija dhe unë vetë forcat e mia dhe harxhova më kot vitet. Është e sigurt që në ndonjë raft të gjithësisë ky libër i plotë duhet të ekzistojë;<sup>3</sup> lus perënditë e harruara që një njeri - qoftë edhe i vetëm, para mijëra vjetësh! - ta ketë pasur ndër duar dhe ta ketë lexuar. Po qe se nderi, urtësia dhe gëzimi nuk janë për mua, qofshin për të tjerë. Rroftë e qoftë parajsa edhe nëse vendi im është në ferr! Le të poshtërohemi e të bëhem hi, mjaft që Biblioteka Jote e stërmadhe të gjejë kuptim te një qenie, te një çast.

Të pafetë pohojnë se absurditeti është rregull në Bibliotekë dhe se pjesët me kuptim, ose vetëm me një farë lidhje, për-

<sup>3</sup> E përsëris, mjafton ta imagjinosh një libër që ai të ekzistojë. Vetëm ajo që është e pamundur përjashtohet. Për shembull: asnjë libër nuk është gjithashtu shkallë, megjithëse padyshim ka libra që e diskutojnë, që e mohojnë dhe që e tregojnë këtë mundësi, dhe të tjerë struktura e të cilëve ka një farë lidhje me strukturën e një shkalle.

bëjnë një përjashtim gati të mbinatyrshtëm. Ata flasin, e di, për “këtë bibliotekë të ethshme vëllimet e pasigurta të së cilës rrezikojnë pareshtur të shndërrohen në të tjera vëllime dhe pohojnë, mohojnë dhe ngatërrojnë gjithçka si një perëndi në jerm”. Këto fjalë, që jo vetëm tregojnë sheshit rrëmujën, por edhe e ilustrojnë atë, provojnë mirëfilli një shije të neveritshme dhe një injorancë të pandreqshme. Në fakt, Biblioteka i përmban të gjitha strukturat verbale, të gjitha ndryshimet që lejojnë njëzet e pesë simbolet ortografike, por as edhe një absurditet absolut. Është e kotë të vësh re se vëllimet më të mira nëpër gjashtëkëndëshat që drejtojnë unë kanë për titull “Rrufe kokëmbuluar”, “Ngërç allçie” dhe “Axaxaxas mlö”. Këto fjali, pa lidhje në pamje të parë, kanë padyshim një shpjegim kriptografik ose alegorik; një shpjegim i tillë është verbal, dhe, *ex hypothesi*, figuron që më parë në Bibliotekë. Nuk mund të kombinoj një varg të çfarëdoshëm shkronjash, për shembull: *dhcmlrchtjdj*, që Biblioteka hyjnore mos ta ketë parashikuar tashmë dhe që të mos ketë një kuptim të tmerrshëm në një nga gjuhët e saj të fshehta. Askush nuk mund të artikulojë një rrokje që të mos jetë plot dhembshuri e tmerr që të mos jetë diku emri i fuqishëm i një hyu. Të flasësh, do të thotë të biesh në tautologji. Kjo letër e panevojshme dhe fjalëshumë që po shkruaj ekziston tashmë në një nga tridhjetë vëllimet e pesë rafteve të njërit prej gjashtëkëndëshave të panumërt - dhe përgënjeshtrimi i saj gjithashtu. (Një numër *n* gjuhësh të mundshme përdor të njëjtin

fjalor; në këtë apo atë leksik, simboli *Bibliotekë* do të marrë përkufizimin e saktë *sistem universal dhe i përhershëm gale-ri-sh* gjashtëkëndëshe, por *Bibliotekë* do të thotë *kallëp* ose *piramidë* ose çfarëdo gjëje tjetër, po që se shtatë fjalët e përkufizimit kanë një tjetër kuptim). Ti, që më lexon, a je i sigurt se e kupton gjuhën time?

Të shkruarit metodik, për fat të mirë, më heq mendjen nga gjendja aktuale e njerëzimit. Siguria që gjithçka është shkruar na kthen në hiç ose në fantazma... Njoh zona ku të rinjtë përkulen para librave dhe lënë në faqet e tyre të puthura barbare pa deshifruar dot asnjë shkronjë të vetme. Epidemitë, përçarjet heretike, pelegrinazhet që degjenerojnë në mënyrë të pashmangshme në hajdutëri, kanë shfarosur popullsinë. Më duket se i kam përmendur vetëvrasjet, çdo vit edhe më të shpeshta. Ndoshta jam gabuar nga pleqëria dhe frika, por e parandiej se fara njerëzore - e vetnja që ekziston - gati po shuhet, ndërsa Biblioteka do të jetojë ngaherë: e ndriçuar, e vetmuar, e pafund, krejt e palëvizshme, e armatosur me vëllime të çmuara, e padobishme, e paprishur, e fshehtë. Sapo shkrova e *pafund*. Nuk e ndërftua këtë mbiemër ngaqë më rrëmbeu retorika; them se është me vend të mendosh se bota është e pafund. Ta mendosh të kufizuar do të thotë të postuloj se në ndonjë vend të thellë korridoret, shkallët, gjashtëkëndëshat mund të zhduken - gjë që është e paimagjinueshme, absurde. Ta përfytyrosh pa kufi do të thotë të harrosh se numri i librave të mundshëm s'është aspak pa kufi. Problem i lashtë

për të cilin unë propozoj këtë zgjidhje: *Biblioteka është e pakufizuar dhe periodike*. Po të kishte një udhëtar të përjetshëm që do ta përshkonte në një drejtim të çfarëdoshëm, shekujt, më në

fund, do t'i mësonin se të njëjtat vëllime përsëriten gjithmonë në të njëjtin çrregullim - që i përsëritur, do të bëhej një rregull: Rregulli. Vetmia ime ngushëllohet me këtë shpresë të hijshme<sup>4</sup>.

1941, Mar del Plata

*Përkthyer nga Saverina Pasho*

---

<sup>4</sup> Letizia Alvarez de Toledo vuri re se kjo Bibliotekë e madhe ishte e panevojshme: do të mjaftonte, në fund të fundit, *një vëllim i vetëm, me format të zakonshëm, i shtypur me shkronja nëntëshe ose dhjetëshe* që të përmbante një numër të pafund fletësh të holla sa s'bëhet. (Kavalieri, në fillim të shekullit XVII, shihte në çdo trup të ngurtë mbivendosjen e një numri të pafund planesh). Përdorimi i këtij vade-mekumi të mëndafshtë s'do të ishte i lehtë: çdo fletë e dukshme do të ndahej në fletë të tjera; e pamendueshmja faqe e mesit nuk do të kishte anë të prapme.

- 
- Jeta mbas vdekjes e Dhimitër Bedulit 17
  - Filip Fishta, gjurmuesi i historisë shqiptare në arkivat dhe bibliotekat e Europës 23
  - Librat e mi 34
  - Spanët, Bokalët dhe Marulët sipas botimeve albanologjike 42
-



# Jeta mbas vdekjes e Dhimitër Bedulit

*Prof. as. dr. Aurel PLASARI*

Biblioteka Kombëtare

**N**jë teolog i mirë lindet për së dyti mbasi vdes; Dhimitër Beduli, ndoshta, është ndër të rrallat raste të atyre që lindin për së treti. Këtë e dëfton bibliografia e veprës së tij, e cila sa vjen dhe rritet.

Ndërsa prej veprimtarisë së tij të hershme (1934-1967), pos bashkëpunimeve të shumta në organe si *Predikimi* apo *Jeta kristiane*, njiheshin tanimë punimet: *Engolpion i çdo orthodhoksi* (1936), *Jeta dhe çudirat e Shën Mitër Mirovllit* (1936), *Disa këshilla morale krishterore* (1939), *Ngjallja e Krishtit* (1940), *Shën Prokopi* (1942), *Mësime fetare, I, II, III dhe IV* (1938-1940), *Mbi përdorimin e gjuhës shqipe në Kishë* (1961), *Të dhëna për periudhën e Skënderbeut nga një veperë agjiografike e shek. XVI* (1969) etj., mbas 1990-s do të shtoheshin punimet: *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944* (1992), *Një vështrim mbi kishat dhe manastiret e Pogonit* (1996), ashtu si edhe mbas vdekjes së tij: *Kungata hyjnore* (1997), *Kodiku i kishës së Shën Prokopit* (1997), *Gjuha shqipe në Kishë* (1997), *Leksi-one* (1998) etj.

Në këtë vëllim, që po botohet mbas vdekjes së dijetarit, përmbledhen disa nga punimet e tij të fushave të kulturës kish-tare, posaçërisht të traditës bizantine dhe mbasbizantine në Shqipëri. Të shkruara në periudha të ndryshme të jetës së autorit, këto punime janë përzgjedhur nga botimet e tij të hershme ose të pjesshme, nga dorëshkrimet e lëna pa botuar, nga bashkëpunimet me Institutin e Studimeve Shqiptare, mandej me Institutin e Shkencave, më mbas me Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë, me Fakultetin e Historisë e të Filologjisë etj. Ato përfaqësojnë, sikurse shpresojnë përgatitës dhe botues, pjesën më substanciale të kërkimeve shkencore të Dhimitër Bedulit dhe, njëherësh, atë më pak të njohur të bashkëndihmës së tij në kulturën tonë.

Dhimitër Beduli qe lindur më 1914 në fshatin Skore të Pogonit, Gjirokastër, fshat që, sikurse tregon vetë dijetari, së toku me pesë fshatrat e tjerë të kësaj krahine, Poliçan, Sopik, Çatistë, Mavrogjer dhe Hllomo, flisnin greqishten si gjuhë amtare. I ardhur në jetë në shtetin e ri shqiptar, Beduli çunak do të formohej me modelin e ri të edukimit, fjala vjen duke kënduar së toku me bashkëmoshatarët në gjuhën e mëmës këngën: *Simera aspros uranos, simera aspri mera, /simera eortazome allvaniqi simea...* ("Sot është qiell i bardhë, sot është ditë e bardhë, / sot festojmë flamurin shqiptar..."). Në vitin 1930 mbaronte shkollimin e mesëm (gjimnaz) në Athinë dhe kthente në atdhe, prej nga do të vinte për studimet e larta për teologji në Kishineu, Besarabi, të Rumanisë nga 1930 më 1934, duke u specializuar në fushën e muzikës bizantine.

I kthyer në atdhe mbas studimeve universitare, u vu të jepte mësim në seminarin kombëtar ortodoks "Apostull Pavli", Tiranë, kur shërbeu prej 1935-s deri më 1944 si drejtor i tij. Po në atë periudhë, që mund të quhet e lulëzimit të parë të veprimtarisë së tij, drejtoi njëkohësisht revistën *Predikimi* (1935-1939) dhe mandej revistën *Jeta kristiane* (1940-1944); prej 1935-s krijoi dhe drejtoi korin e ri mikst të kishës katedrale të Ungjillëzimit në Tiranë, si dhe ndërmori një numër nismash të tjera, duke iu vënë njëherësh edhe përkthimeve, botimeve etj. Më 1945, ndërsa seminary "Apostull Pavli" do të mbyllej duke "u fikur", ai do të ishte ndër nismëtarët e organizimit të "Lidhjes së Teologëve dhe Seminaristëve të Shqipërisë", një organizim i cili do të rrekej të shpëtonte të shpëtueshmen në rrethanat e reja aspak

të mbrohta për lirinë e besimit dhe të mendimit në Shqipërinë e mbas 45-s.

Mbaskësaj jeta e tij “e jashtme” do të ndryshonte: teologu në zë do të shfaqej si “referent statistike” në Drejtorinë Qendrore të Oficinave, Durrës (1946-1948); si “referent plani” në Uzinën Mekanike, Tiranë; madje si “shef plani” i po asaj uzine (1948-1978). Por do të ishte jeta e tij e brendshme ajo që nuk do të ndryshonte, pavarësisht kontingjencave të mbrapshta. Përkundrazi, pikërisht ato kontingjenca do t’ia këndellnin fuqitë për t’i qëndruar sprovvës së madhe. “*Edhe në ecsha në luginën e hijes së vdekjes, nga asnjë e keqe s’do të kem frikë, se Ti me mua je*”: ishte një nga psalmet që atij ia kishte ënda ta përsëriste. I mbyllur në shtëpinë e tij në orët “e lira”, duke dhënë e marrë me librat që i pakësoheshin nga konfiskime të njëmbasnjëshme, si dhe duke këmbyer dendur letra me sivëllezërit e tij, koha e vjedhur nga prehja ose nga gjumi i natës konvertohej në punë: hulumtime, studime, bashkëpunime shkencore. Shpirti i tij vijonte të ishte ai që kishte qenë. Ballafaqimi ndodhte gati-gati si në Mesjetë: mes qetësisë së manastirit dhe zallahisë së panairit. Ndërsa aty brenda, i veçuar prej botës, mjeshtri “ripërtypte” *logosin*, jashtë spektakli qytetar-socialist ziente me sloganet e tij, mbledhjet, aksionet, agjitpropin zhurmëmadh. Qysh më 1942, në një artikull të *Jeta kristiane*, ai lexuesit e vet i pati paranjoftuar: “*Nuk është nevoja të jem i pasur, i lumtur dhe plot me nderimet e kësaj bote. Më mjafton që jam njeri i pajisur prej Zotit me dhuratën më të vlefshme, me arsyen, dhe si i tillë duhet t’i shërbej Atij që më krijoi e më solli në këtë jetë. Perëndia, pra,*




*më dha arsyen për këtë qëllim: të jem i tëri në shërbim të dëshirave të Tij, të veproj për Atë*”.

Jeta e tij e dytë do të niste në shkurtin e 1991-shit, kur do të shfaqej, së toku me bashkëpunimet e tjerë, në rihapjen e kishës katedrale të Ungjillëzimit, në Tiranë, në datën historike 31 Mars: atë ditë do të mbante fjalën e hapjes. Vetëm pak muaj më vonë, mbrëmanet, i kthyer në shtëpi nga mesha solemne për prirjen e Eksarkut, do të përthërriste në shënimet e veta: “*O Irinë [Banushi], o Theofan [Popa]! Sot qava. Ëndrrën tonë që, kur të hapej Kisha, ta hapnim duke kënduar “Krishti u ngjall”, e plotësoi sot Eksarku, i ndriçuar prej Zotit... Dhe unë qava nga gëzimi, duke ju kujtuar juve, o shpirttra të ndritur, o Irinë, o Theofan! Ëndrra*

jonë u plotësua. E kisha si peshë në shpirt. Tani u lehtësova". Në Konferencën e Parë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, më 1992, do të zgjidhej anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të saj, ndërsa më 1993 Sekretar i përgjithshëm i atij Këshilli. Po më 1993 do të emërohej Kryetar i Komisionit të përkthimeve dhe shqyrtimit të veprave kishtarë. Rihapja e Seminarit do ta kthente, ashtu si gati 50 vjet të shkuar, në pupitrin e pedagogut. Do të ishin, për teologun tanimë të rënduar sëmundjesh, vite të ethshme të një veprimtarie me intensitet të pabesueshëm për moshën e tij.

Befasues do të ishte edhe për mua, ndoshta një ndër dhjetëra ose qindra të tjerë të kaluar nëpër "ateizmin zyrtar", identifikimi i tij. Ai ishte trajtuesi i *Himnit Akathist*, të tillë siç e mbaja mend nga vogëlia, kur mëma më merrte përdore dhe venim në "kishën tonë", dhe që lypsej kënduar vetëm më këmbë. Ai do të më lidhej më këngën "O Zot, thirra", të përkthyer po prej tij dhe së cilës në atë moshë mezi ia merrja vesh fjalët e rralla, ose me "Meshën e Shën Joan Gojartit" me tre zëra etj. Po ashtu edhe me libërthin me titull të pakuptueshëm atëherë *Engolpion i çdo orthodhoksi*, për të cilin tani do të mësoja që ishte vepër e Bedulit të urtë, dhe që do të më kthente oreçast te kremtet "me kisha". Dhe ja ku ishte Beduli dijetar, autor i studimit të Kodikut të Shën Prokopit (*Bashkësia ortodokse e Tiranës*), që do të më lëvizte tani çelësin magjik të kuptimit të dokeve të pritjes e të përcjelljes, kur venim përdore gjithnjë me mëmën të "të vetët": në ditët e Emrit, në Krishtlindjet, në Pashkët e Mëdha, në



Nga fondi arkivor i Bibliotekës Kombëtare

dasmat me kurora që shpesh viheshin nëpër shtëpi, në Rrëshajët e deri te "të shtunat e të vdekurve" me grurë të zier, arra e rrushka të thata. Në kishën katedrale të Ungjillëzimit, ku e pati ofruar veten për 50 vjet si psalt i parë, tanimë të rihapur, dijetari modest do të vijonte të psallte me zërin e ëmbël rinor deri me 25 dhjetor 1995 për të ndërruar jetë, i sëmurë rëndë, më 16 janar 1996.

"*Sot, kur mësova se prëndia e mori pranë Vetes, provova ndjesinë se u dogj një bibliotekë e gjallë*", thoshte në fjalën përkujtimore në ceremoninë e përmortshme për të Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Duke pasur mundësi tanimë të njoh,



me sa kam mundur, punimet tij të fushave të ndryshme të dijës, përkthimet e tij dhe, falë gatishmërisë së të birit z. Kristofor Beduli, edhe pjesë të dorëshkrimeve të tij, të skedave, të shënimeve apo të letër-këmbimit, si dhe vlera të rralla të bibliotekës së tij, jam në gjendje ta pohoj përjetimin e ndjesisë së djegies së asaj “biblioteke të gjallë”. Tani, kur teologu i madh është lindur për së treti, mund të themi: Një dijetar i mirë kaloi pranë nesh... ndërsa ne nuk e ditëm.

Punimet e Dhimitër Bedulit që këtu po botohen, posaçërisht ato që kanë të bëjnë me hulumtimin e traditës bizantine e mbasbizantine në Shqipëri, të monumenteve të saj, si kodikë, kisha, manastire në vendin tonë etj., i përkasin historisë së kulturës si shkencë humaniste *par excellence*. Pa e kuptuar studimin e historisë së kulturës si një “perandori mandarinësh”, sikurse e quante Nikolla Jorga, që japin e marrin mes tyre nga zyra në zyrë nëpërmjet zhargonit të një esnafi të çinteresuar për nevojat e lexuesve jashtë, prej të cilëve i ndan “muri i madh”, Beduli i përket një shkollë studimore të përkundërt, themeluar nga Jorga pikërisht në rastin e “studimeve bizantine”: asaj të shembjes së murit dhe prirjes për t’iu afruar, më shumë se “esnafit”, lexuesve për të cilët tradita është sa histori e kaluar, aq edhe realitet ende sot e gjithë ditën. Dijetarë si ai as nuk ndiejnë nevojën të duken “të modës”, as nuk kanë frikë se mos ngajnë *démodés*. Mund të bëhet ky edhe shkas që një studiues i këtitillë, i parapëlqyer për t’u mbuluar me heshtje prej “esnafit”, ta ketë jetën e vet jo aq mes tij, se sa në mesin e lexuesve të

dashuruar mbas historisë së kulturës së tyre.

Pavarësisht kalimit të viteve dhe dhjetëvjeçarëve, pavarësisht të dhënave të reja dalë tanimë në dritë, si dhe qortimeve, përsaktësimeve etj., që edhe punimeve të tij, si atyre të çdo dijetari, mund t’u bëhen, pjesa më e mirë syresh mbeten me vlerë të mirëfilltë referative. Jo aq nxënës i Descartes-it në kërkimin shkencor, se sa i Etërve të Kishës, Beduli hulumtues ngjan i vetëdijshëm që lëviz brenda një historie, një tradite kërkimore-shkencore, prej se cilës ka mjaft për të nxënë. Te një “nxënës” i tillë sensi i vijimësisë është thujse kudo i ndjeshëm si kriter përçues i një metodologjie jo thjeshtë-vetëm të kërkimit shkencor, por edhe të veprimtarisë intelektuale në përgjithësi. Të mos ngrihesh mbi tematikat e trajtuara duke e mbajtur veten për kulm të mendimit, por ta kuptosh veten dhe mendimin tënd brendapërbrenda një tematike të rrahur prej shumë të tjerësh para teje, qoftë për vlerësuar vijimësinë, qoftë për të vënë në pah dallimet: ky është një nga mësimet intelektuale që mund të nxirret prej modelit kërkimor-shkencor të Bedulit. Kjo, me sa duket, ia jep edhe stilit të tij tonin e qetë të të argumentuarit, thujse asnjëherë të shenjuar ideologjikisht. Ndoshta edhe kjo nevojë - e ruajtjes së parimit të vijimësisë në kërkimin shkencor dhe e mospërdhunimit të këtij parimi - që një nga shkasat e përgatitjes së përmbledhjes “Kishë dhe kulturë”.

Çfarë të shpresohet, më në fund, me këtë botim të saj? Që me punimet e zgjedhura të përmbledhura këtu të ndikojë për njohjen e “dijetarit të mirë”, që sapo

kaloi pranë nesh, në rrafsh kombëtar dhe, më së tij të vyer në ato fusha studimi ku ndoshta, edhe më përtej falë bashkëndih- shokët i pati të paktë.

## THE LIFE BEYOND DEATH OF DHIMITËR BEDULI

*Dhimitër Beduli is, perhaps, one of the rare occasions of the people who are brought to life for the third time. The bibliography of his works, which gets more and more bigger, is a good example of this.*

*In the book "Church and Culture" a posthumously publication of the scholar, are included some of his works in the fields of the culture of the religion, especially regarding the byzantine and postbyzantine tradition in Albania. The abovementioned works were written in various periods during the life of the author and have been selected from earlier and partial publications, as well as from unpublished manuscripts. The studies of the author, especially those which have to do with researches of the byzantine and postbyzantine tradition in Albania, and the monuments of this culture, such as codices, churches, monasteries in our country etc., belongs to the history of culture as a humanitarian science par excellence.*

*Despite the passing of the years and decades, despite of the new data coming into light, as well as corrections and precisements etc., that might be done to his works, a normal procedure that every scholar goes through, the bulk of his works still remains a valuable source of references. What we really do hope with the publication of this book? That the selected works included here to influence in making wellknown publicly "the good scholar", the one who passed close to us, in national level and, who knows, even beyond, thanks to his contribution in a field where he didn't have rivals.*

# Filip Fishta, gjurmuesi i historisë shqiptare në arkivat dhe bibliotekat e Europës

**Gjovalin ÇUNI**

Biblioteka "Marin Barleti",  
Shkodër

## Jeta dhe personaliteti shkencor

Filip Fishta u lind në Shkodër më 28 prill 1904. Po në këtë qytet ndoqi mësimet fillore në Kolegjën Saveriane të drejtuar nga Etërit Jezuitë. Studimet e mesme dhe të larta i kreu në Jugosllavi. Mbaroi Universitetin e Beogradit duke patur si profesor balkanologun e shquar Henrik Bariç, njërin nga drejtuesit e Institutit të Gjuhëve Sllave dhe Orientale (1923) dhe të përmbledhjes së studimeve "Arhiv za arbanSKU starinu, jezik i etnologiju", i cilësuar nga njohësit e albanologjisë: "...botim plot interes për sendet shqiptare, sadoqë pjesa më e madhe është shkruar serbisht, në një gjuhë pak të arrijtshme".<sup>1</sup>

Veprimtarinë e tij botuese e filloi me disa poezi të shkurtra te "Kalendar i Vep-

rës Pijore" (1924-1925). Ashtu siç thekson me të drejtë doc. Dr. Zeqirja Neziri, Filip Fishta: "...bën pjesë në mesin e studiuesve shqiptarë të letërsisë, i cili veprimtarinë e tij e dha para Luftës së Dytë Botërore. Duke studiuar ndonëse jo plotësisht veprat e tij ky autor arrin në konkluzionin... "se emri i Filip Fishtës, nuk është aq anësor".<sup>2</sup>

Dëshirojmë të theksojmë se Filip Fishta mund të bënte pjesë edhe në radhët e akademikëve të shquar të pasluftës, por planifikimet komuniste për të zhdukur inteligjencën shqiptare, aq më tepër atë shkodrane, kishin përfshirë edhe atë. Që në nëntor të viti 1942, Enver Hoxha në një artikull të "Zërit të Popullit", me titull: "Armiqtë përpiqen për një modus vivendi" shkruante: "...Filip Fishta, studentë të degjeneruar që ndjekin në Romë univer-

<sup>1</sup> Diturija, 1 mars 1927, nr.5:164

<sup>2</sup> Zeqirja Neziri "Filip Fishta dhe historia e letërsisë", Rilindja, 4 prill 1996: 9



sitetet e “Via Venetos”, po bisedojnë kokë më kokë dhe po formojnë një grup të rinjsh nacionalistë”<sup>3</sup>. Për diktatorin nuk kishte rëndësi se Filip Fishta nuk kishte studiuar në universitetet italiane. Që në atë kohë siç duket ai...” iu bashkue atyre studiuesve modestë “anonimë”, të historisë së letërsisë shqiptare emnat e cilëve shumë rrallë ose asnjëherë nuk u përmendën”.<sup>4</sup>

Filip Fishta ishte një njeri me talent të jashtëzakonshëm. “Malli i shtampës”, karakteristikë e njerëzve diturakë, e shtyu atë të merrej me shumë fusha të filologjisë. Studimet e tij përfshijnë gjuhësinë, letërsinë, folklorin, historinë, arsimin, arkeologjikën, biografinë, bibliografinë, bibliotekat etj. Në punën e tij shkencore e ndihmoi shumë edhe zotërimi i gjuhëve lindore si dhe i gjuhëve të vdekura greqishte e vjetër dhe latinishte.

Veprimtaria e tij shkencore është zhvilluar brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ka punuar si lektor në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare të Universitetit të Beogradit<sup>5</sup> dhe “Lektor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe” në “École Nationale des Langues Orientales Vivantes”, në Paris (hapur në Universitetin e Sorbonës në vitin 1921) nën drejtimin e prof. Mario Roques”<sup>6</sup>. Filip Fishta u shtohet mësuesve të tjerë të shqipes në këtë shkollë, mes të cilëve përmenden Dhimitër Berati dhe Stavri Stavro. Ai duhet të ketë dhënë ndihmesën e tij në Qendrën e Studimeve Shqi-

ptare (Centre d’Études Albanais), që kishite detyrë mbledhjen e informacioneve rreth Shqipërisë, bazuar në kontributin e studentëve shqiptarë “...pra prej punimit të kompatriotëve t’anë dhe nga intiligjenca e tyre”. Qëndrimi pranë Mario Roques do ta shtynte atë në të ardhmen t’i kushtonte një pjesë të madhe të veprimtarisë së tij thellimit dhe analizës shkencore të dokumenteve albanologjike të zbuluar nga albanologë të dëgjuar në bibliotekat dhe arkivat e ndryshme të Europës.

Gjatë kohës kur punonte jashtë Shqipërisë, studimi më i arritur i tij, që dhe në ditët tona ngjall diskutime mes studiuesve të letërsisë shqipe, lidhet me “konceptet e periodizimit të letërsisë shqiptare”. Studimi është botuar gjatë viteve 1931-1932 në gjuhën serbe në disa numra të revistës “Misao” të Beogradit me titull “Istorija albanske knizhevnosti” (“Historia e letërsisë shqiptare”). Pa dashur të ndalemi në këtë artikull, tanimë të analizuar hollësisht nga Zeqirja Neziri<sup>8</sup>, nuk mund të mos përmendim parathënien ku fuqishëm ndihet krenaria për kombin të cilit i përket. Botimin e këtij shkrimi ai e quan “... nisjativë për botimin e një pasqyre të historisë letrare shqiptare si një përpjekje për ta informuar opinionin lexues sllavo-jugor me civilizimin shqiptar, me prodhimin kulturor e letrar gojor e të shkruar shqiptar”.<sup>9</sup>

Bazuar në të dhënat e Willy Kamsit, deri më tani i vetmi jetëshkrues i tij,

<sup>3</sup> Enver Hoxha. Vepra 1, Tiranë, 1983:151

<sup>4</sup> Zeqirja Neziri. “Filip Fishta dhe historia e letërsisë”, Rilindja, 4 prill 1996: 9

<sup>5</sup> Zeqirja Neziri. Filip Fishta dhe historia e letërsisë”, Rilindja, 4 prill 1996: .

<sup>6</sup> Willy Kamsi: Filip Fishta “Kosova për historinë e letërsisë kombëtare”, Prishtinë, 2002:9

<sup>8</sup> Zeqirja Neziri. “Filip Fishta dhe historia e letërsisë”, Rilindja, 4 prill 1996: 9

<sup>9</sup> Po aty



mësojmë se pas kthimit në atdhe, ai emërohet mësues në gjimnazin shtetëror në Tiranë.

“Tue mungue një tekst, harton dhe shtypë vetë me ciklostil tue ua shpërnda nxanësve, “Histori e letërsisë shqiptare”;... me vitin 1935, mbërrijti me botue dy ndër tri vëllimet që kishte ndër mend, të “Antologi shqipe” për shkollët e mesme”.<sup>10</sup>

Në vitin 1941 Filip Fishta është mes autorëve që krijuan tekstin: “Shkrimtarët Shqiptarë” (vol. 2) me pjesëmarrjen e mjaft autorëve në redaktimin e Ernest Koliqit dhe Namik Resulit duke punuar në të dy vëllimet zërat: Nikollë Kazazi, Muhamet Çami, Pjetër Zarisht, Leonardo de Martino dhe Naim Frashëri.<sup>11</sup>

Filip Fishta bëri një punë të lavdërueshme në mbledhjen e folklorit shqiptar. Veprimtaria e tij në këtë fushë duhet vlerësuar në shumë drejtime. Studimin e folklorit Fishta e sheh jo vetëm si një veçansi shpirtërore të popullit tonë, por edhe si një mundësi për të njohur gjuhën dhe zhvillimin gjuhësor të një populli. Në këtë ide ai mbështetet edhe te studiuesit e mëparshëm të së njëjtës lëndë. F. Fishta shkruante:... “folklori... asht cejha e pash-terrshme e gjuhsis dhe e letratyrës kombtare”.<sup>12</sup>

Duke parë dëshirën e mjaft studiuesve në mbledhjen e pasurisë gojore, e cila shpeshherë rezultonte jo e dobishme dhe kontradiktore, ai gjatë viteve 1933-1936, në faqet e revistës “Leka”, boton këngët e



mbledhura si dhe folklor të Kosovës me titull: “Drejtime për mbledhje të folklores”. Ky artikull ngelet si shembull metodik i mbledhjes dhe i klasifikimit të folklorit. Në vitin 1937 së bashku me Karl Gurakuqin zgjedh dhe komenton “Kangë trimnije dhe kreshnikësh”, që do të përbënin vëllimin e parë të “Visaret e Kombit”. Më vonë, në vitin 1944, përgatit botimin: “Kosova për historinë e letërsisë kombëtare”, vepër kjo mbledhur gjatë shumë viteve nga mësuesi kosovar Myrteza Reka, që do të shënonte vëllimin X të “Visareve të Kombit”.<sup>13</sup>

Deri në vitin 1944, ashtu siç del nga të dhënat e W. Kamsit, ai ka bashkëpunuar

<sup>10</sup> Willy Kamsi: Filip Fishta “Kosova për historinë e letërsisë kombëtare”, Prishtinë, 2002

<sup>11</sup> Shih në: Shkrimtarët shqiptarë, vol. 1-2, Tiranë, 1941

<sup>12</sup> F. Fishta. Kosova për historinë e letërsisë kombëtare, Prishtinë, 2002: 92

<sup>13</sup> Libri në fjalë u botua i plotë në vitin 2002, në kujdesin e W. Kamsit nga shtëpia botuese “Shpresa” e Prishtinës.

thujas me të gjitha revistat e njohura të kohës brenda dhe jashtë Shkodrës, nga të cilat veçohen: “Kalendari i Veprës Pijore”, “Hylli i Dritës”, “Leka”, “Përpjekja shqiptare”, “Shkëndija”, “Tomori i vogël”, “Drini”.

Studimet e kryera në këto revista, pjesa më e madhe e të cilave ishte fryt i kërkimeve disavjeçare në bibliotekat më të njohura të Europës, si ajo e Vatikanit, Biblioteka Kombëtare e Parisit, Biblioteka Kombëtare e Romës, ajo e Beogradit etj., ngjallën interesim shkencor të filologëve të kohës dhe shpeshherë u shoqëruan edhe me diskutime. Mes studimeve të kësaj periudhe shënojmë: “Nder gjurmë të Propagandës Fide” në Ballkan, (Gjurmime në Arkivin e Vatikanit, 1932), “Njoftime mbi Arqipeshkvijt e Shkupit” (1934), “Çashtja e dy shtypshkrojeve të shekullit XVI në Skenderi: (1563) n’Epidamnus (1584)” (1934-1935), “Dorëshkrime të Bibliotekës Nacionale të Parisit” (Traktati i Galvanusit..., Vjeti 1300, kush-tue princave dhe baronave Shqiptarë... ) (1938).

Studiues të letërsisë shqiptare e vlerësojnë Fishtën si kritik<sup>14</sup> dhe polemist mjaft të Zotin. Mes artikujve të shumtë mund të veçojmë: “Dy pasqyra letrare” (Ese kritike vrojtore së prof. Pavolinit “Letteratura” e veprës së prof. Papas Gaetano Petrotta “Popolo, Lingua e Letteratura Albanese”. Palermo, 1931), përfshirjen në polemikën e “Hyllit të Dritës” me Mjedën, kritikën e pikëpamjeve të Atë F. Cordinjanos rreth kombit shqiptar në fletët e “Shkëndisë” (1941).

Figura e Fishtës në këto vite nuk do të ishte e plotë nëse nuk shënohet edhe veprimtaria e tij si përkthyes, punimet bibliografike si dhe kontributi i dhënë në fushën e bibliotekonomisë shqiptare.

“Bibliografia – kjo shkencë kujdesie dhe durimi – nuk është e akoma e njohur në botën shqiptare. Gjer më sot vetëm prof. Filip Fishta ka dhënë një provë të lavdërueshme e të çmueshme me bibliografine e At Gjergj Fishtës”.<sup>15</sup> I kësaj periudhe është edhe studimi me vlerë i pasurive të literaturës orientale që ndodhej në Bibliotekën e Myftinis së Tabakëve në Shkodër. Filip Fishta deri në vitin 1944 drejtoi Bibliotekën e “Institutit të Studimeve Shqiptare” (1940).

Në vitin 1942, së bashku me Henrik Lacën, boton “Fjaluer latin-shqip”, i cili: “bje të jetë i treti fjalor i latinishtes i botuem në gjuhën shqipe, mbas atij të Frangut të Bardhë e të At Adon Aldegherit. Ky fjalor që përgatitë tue pasë parasysh Georgesin, Campanini - Carboni-n e Aldegheri-t”.<sup>16</sup>

Vitet e komunizmit, ashtu si për shumicën e intelektualëve nacionalistë, ishin vitet e zhvlerësimit. Menjëherë pas çlirimit ai pranon burgjet komuniste. Akuzat kryesore, që rëndonin mbi të, ishin shkrimet e botuara gjatë vitit 1944 në disa numra të revistës “Drini”: “Kosova në historinë e letërsisë kombëtare”. Mbas daljes nga burgu ai punon si bibliotekar në Bibliotekën e qytetit të Shkodrës si dhe më pas në Tiranë në Bibliotekën Kombëtare dhe në atë të Institutit të Gjuhësisë, si nëpunës i jashtëm. “...mbas botimit të vëllimit I (1968) të veprave të Enver Hoxhës, për

<sup>14</sup> Shih në: Robert Elsie. “Historia e letërsisë shqipe”, Tiranë

<sup>15</sup> “Bibliografi Albanese” 1941, Shkëndija, 1943

<sup>16</sup> W. Kamsi: Filip Fishta “Kosova për Historinë e Letërsisë Kombëtare”, Prishtinë, 2002: 10

një shënim aty qe pushue përfundimisht nga ajo punë".<sup>17</sup>

Gjatë më tepër se 30 viteve diktaturë, si shkroi vetëm pak artikuj, duke patur përkrahjen e prof. Henrik Lacës e Pashko Gecit në vitin 1966 boton të katërtin "Fjalor latinisht-shqip" (Ribotim, 2004). Artikujt e tij të fundit janë: "Mbi mbledhjen dhe radhitjen metodike të proverbave dhe shprehjeve figurative në gjuhën tonë" (1962), nekrologjia e Mario Roques-it (1962), "Kontribut për historinë e bibliotekave të Shkodrës" (1956). Vdiq papritmas në Tiranë më 11 mars 1976 i vetmuar. La pas vetes vetëm shkrimet e tij. Dashuria për librin e kishte bërë të harronte dashuritë e tjera, ngrohtësinë dhe telashtet që krijon familja. Të njëjtat ndjenja që ai vetë kishte shprehur për prof. Mario Roques, të cilin e pat udhërrëfyes në jetën shkencore, vlejné edhe për atë, me të vetmin ndryshim se profesori kësaj radhe ishte ai vetë dhe salikimet i munguan. "...u varros në heshtje, përcjellë vetëm nga ndonji mik i ngushtë dhe nga disa nxënës të tij..., ka qënë krejt i thjeshtë dhe konfidencial".<sup>18</sup>

## Vëzhgim mbi disa studime nga bibliotekat dhe arkivat europiane.

"Historia shqiptare mbetet akoma për t'u shkruar. Po që të shkruhet, diç duhet

bërë më parë: të gjurmohen arkivat, kudo që ndodhen, dhe të gjënden dokumentat që flasin mbi Vendlin tonë"<sup>19</sup>, - kjo ishte motoja e shtresës së re të intelektualëve shqiptare që përpqeshin të vinin bazat e një historie të paanshme të një kombi.

Pas një pune të gjatë, arritën të dalin në pah nga studiues vendas dhe të huaj dokumente të rëndësishme për historinë e Shqipërisë.<sup>20</sup> Protagonist i gjetjes së gjurmëve të vjetra në vitet '30-'40 u bë brezi i ri i studiuesve i shkolluar në universitetet europiane.

Nga një varg studimesh të kryera në bibliotekat e arkivat e Europës po analizojmë tre prej tyre.

### "Njoftime historike mbi Arqipeshkvijt e Shkupit"

Studimi në fjalë është kryer bazuar në dokumentet e Propaganda Fides si dhe në studimin e një bibliografie të pasur autorësh vendas dhe të huaj, mes të cilëve edhe akademiku Tihomir R. Gjorgjeviç. Ndonëse studimi i takon historisë kishtarë, në të gjenden edhe mjaft fakte që i takojnë historisë kombëtare.

Autori, jo pa krenari, njofton se: "Bri kombësive të tjera në ket ndeje randsiplohtë shohim edhe bashkatdhetarët tanë".<sup>21</sup>

Fishta, ashtu si edhe autorë të tjerë të kohës, i bën një paraqitje deskriptive gjithë

<sup>17</sup> Po aty:10

<sup>18</sup> Filip Fishta. Mario Rok për filologjinë... BUSHT. Seria Shk. Shoq. XVI/1962, n.3 :210-213.

<sup>19</sup> Shkëndija, 1942, nr.1: 34

<sup>20</sup> "Acta e diplomata..." (Shufilaj, Jireček, Thaloci: 1913,1918), Contributi alla Cronologia albanese" (Atë Zef Valentini: 1942), "Illyricum sacrum" (Coleti), "Saggio di un Registro Strorico dell' Albanie (atë Z. Valentini, atë F. Kordinjano: 1940). "Burime të historisë shqiptare" (M. Frashëri: 1928).

<sup>21</sup> Filip Fishta: Njoftime historike mbi Arqipeshkvijt e Shkupit. Hylli i dritës, nr.8, vjeti, 1932: 428



rendit të arqipeshkvijve të Shkupit duke filluar që nga të dhënat e Koletit tek “Illyricum Sacrum” (Paregorius 343) deri te Lazër Mjeda (1913-1921).

Nga rendi i arqipeshkvijve shqiptarë autori ndalet tek ata që zënë vend të rëndësishëm në historinë e letërsisë dhe të kombit, duke nxjerrë në pah vlerat e Bogdanëve, të Mhill Sumës, të Kazazit, Mazrrekëve etj. Ndonëse tanimë një pjesë e veprës së tyre njihet nga studiuesit shqiptarë, në studimin e tij të tërheqin vëmendjen disa fakte që duhen vlerësuar edhe në ditët e sotme, duke u bërë baza të studimeve të mëtejshme.

Prej familjes Mazrreku ai ndalet te Matia Mazrreku, nga i cili... “ kemi trashiguar një leksion të vogël italisht-shqip shkruem prej dorës së këtij të fundit”.<sup>22</sup> Duke u ndalur në veprimtarinë e Andrea Bogdanit, i emëruar Arqipeshkëv i Shkupit (6 mars 1656), ai shënon faktin që duhet marrë në konsideratë nga studiuesit e sotëm.

Studiuesit e historisë së letërsisë, ndonëse përmendin “Gramatikën...” e Andrea Bogdanit dhe fatin e saj, pak ose aspak përmendin ndihmën dhe ndikimin që ai ka patur në hartimin e veprës “Cuneus Prophetarum” (“Çeta e Profetëve”) të Pjetër Bogdanit (1685) “Ky zot fort i urtë (d.m.th. Ndre Bogdani) më dha zemër me votë paret ndë ket vepër ende tue më ndihmuem pakuer fort ndë shumë fjalë t’arbëneshja, të tizat i kish udob e nëpër duer, tue pasun bam ende aj nji Gramatikë fort të goditshme latin e shqyp”.<sup>23</sup>

Për kohën, botimi i veprës së P. Bogdanit në vitin 1685 në Padova dhe dy ribotimet e tjera të veprës më 1691 e 1702 në Venedik nën titullin “L’infallibile verita”, siç thotë vetë F. Fishta: “...shkaktuan një pëshënjellim të vogël ndërmjet atyne qi e kujtuen se u ban njimend tri botime të veprës unji e atyne qi e vun në dyshim ket gja, ndër të cilët po bijmë M. Roques dhe P.G. Petrota”.<sup>24</sup> F. Fishta në studimin e tij sqaron se shkaku i ndërrimit të emrit të veprës mund të jetë bërë për arsye tregtare dhe ndonjë ndryshim i vogël në paratitje bën që libri: “... të duket si nji botim i ri, ba te nji edituer tjetër në Venedik”.<sup>25</sup> Duke ngelur në këtë argument duhet nënvizuar se botimet patën shpjegimet e tyre në gjuhën italiane dhe sllave, gjë që nuk shënohet te disa studiues të historisë së letërsisë shqipe. Bazuar në disa dokumente origjinalë, F. Fishta saktëson edhe datën e saktë të vdekjes së P. Bogdanit, dhjetor i vitit 1689, Prishtinë. Në vëzhgimet e tjera autori flet edhe për të tjerë arqipeshkvij të Shkupit që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në historinë kombëtare.

### **“Dorëshkrime të Bibliotekës Nacionale të Parisit”**

Studimet në Bibliotekën Nacionale të Parisit u bënë në vitin 1938 gjatë kohës që autori bën një udhëtim në Paris. Ashtu siç thekson vetë autori, kërkimet në këtë bibliotekë, më të rëndësishmen në Europë

<sup>22</sup> Po aty: 428

<sup>23</sup> Po aty: 435

<sup>24</sup> Po aty: 438

<sup>25</sup> Po aty: 439



pas British Museum, u nxitën nga se kjo bibliotekë: "...ruen me kujdes sa sende të çmushme për Historin e Shqipërisë e gjuhësinë".<sup>26</sup> Mes të tjerave, në këtë bibliotekë F. Konica zbuloi "Fjalorin Greqisht-Shqip" të Marko Boçarit, të cilin e botoi në revistën "Albania" më 1908 dhe më vonë në "Kalendarin Kombjar" të drejtuar nga Lumo Skëndo. I njëjti njoftonte edhe për ekzistencën në Bibliotekën Mazarine Paris të veprës së Budit "Specvlm Confessionis" ("Pasqyra e të refyëmit", 1621).

Shkak për kërkimet u bë vepra e Golubovich-it "Bibliotheca bio-bibliografica...", e cila shënonte edhe një dorëshkrim të rëndësishëm të vitit 1300, të quajtur "Traktati i Galvanus-it de Levanto Januensis (Vjeti 1300), kushtue princaveit e baronaveit Shqiptarë me shtymjen e Dominicus-it Albanensis, i Urdhmit të Frenëve të Vogjël".<sup>27</sup> Për të arritur te dokumenti, Filip Fishta ndoqi rrugën analitike të studimit të veprës së këtij autori, nisur nga vlerësimet që të tjerët i kishin bërë punës së Galvanusit de Levanto.

"Kohler-i asht i vetmi në radhën e këtyne vehtjeve të ndryshme në lidhni me auktorin e dorëshkrimit, kujton në një oroe mjaft të hapët Fra Dedën Shqiptar (Fra Dominicus-in Albanensis)".<sup>28</sup>

Vepra, ashtu siç thekson edhe vetë F. Fishta, nuk është shumë e njohur: "Shumica e vetjeve, të cillëve Galvano de Levanto ua kushton traktet e veta, mjerisht kanë lënë gjurmë fare të pakta në histori".<sup>29</sup> Një pjesë e dorëshkrimit, që i kushtohet princërve shqiptarë, ndodhet në fletën 45 me titull "Neophyta doctrina...". Në këtë fletë autori i dorëshkrimit, ashtu siç shkruan ai vetë, jep të dhëna rreth familjeve më të shquara mesjetare të kohës, si: Matrangajt, Skurejt, Jonimët, Blinishtët etj., nxitur nga Fra Deda Shqiptar, për të cilin ai shkruan: "...nipote e consanguineo dei principi albanesi di recente entrati nel seno della Chiesa cattolica. Fra Domenico era dell'Albania venuto a Genova, e probabilmente egli stesso portò ai suoi compatrioti principi il trattato di Galvano".<sup>30</sup>

Filip Fishta është i vetëdijshëm se studimet me të dhëna më të detajuara rreth këtyre familjeve janë më të plota në veprat të tjera historike, por nënvizon duke folur për dokumentin e zbuluar: "Njohja dhe paraqitja objektive e tyre nuk duhet lanë jashtë n'at rasë kuer e shohim të nevojshme t'a kemi sa ma të kjashtë fytyrën e kësaj jete shqiptare".<sup>31</sup>

Duke analizuar familjet mesjetare, ai është i një mendimi me Shufflain se ato

<sup>26</sup> Dorëshkrime të Bibliotekës Nacionale të Parisit. Hylli i dritës, nr. 9, vjeti, 1938, 473

<sup>27</sup> Po aty: 473

<sup>28</sup> Po aty: 474. Vepra në fjalë, e ruajtur në formë dorëshkrimi, i takonte koleksionit të Sir Thomas Phillips dhe ishte blerë nga Biblioteka Nacionale Franceze në vitin 1898. Meqenëse nuk e kam ndeshë kund të përshkruem këtë dorëshkrim po bëjmë një përshkrim të shkurtë duke e nxjerrë në dritë nga faqet e "Hyllit të dritës", bazuar në përshkrimin e Filip Fishtës. Formati 195 x 130. Faqe dorëshkrim 68. Mbi kopertinë të mbulojë ka këtë shënim: Galvanus-i de Levanto. Bibl. Nac. Lat. 3181.

<sup>29</sup> Po aty.

<sup>30</sup> Filip Fishta. Dorëshkrime të Bibliotekës Nacionale të Parisit. Hylli i dritës, 1938, nr: 9: 477

<sup>31</sup> Po aty, nr.11: 43

lindën mbi bazat e shthurjeve të mëdha fisnore, të cilat në shekullin XIV na dhanë dinastët mes të cilëve Dukagjinët, Topiajt, Aranitët etj.

Në analizat e mëtejshme historike Fishta përpiket të përcjellë të lexuesi një jetë të zhvilluar mesjetare me të tëra karakteristikat e shtëpive të njohura të kohës me të cilat u ballafaquan, por edhe ditën të bashkëpunonin.

Qytetërimi u ruajt edhe pas rënies së Shqipërisë në dorë të turkut duke u pasqyruar në brigjet e tjera të Adriatikut. Tek analiza që F. Fishta i bën Matrangajve të Piana dei Greci, krahas figurave të njohura, të tërheqin vëmendjen figurat më pak të “dëgjuaara”, si: Lukë Matranga Junior (i gjysmës së shek. XVIII), autor i një vepre rreth Guzetës dhe i disa biografive; Papa Filip Matranga “...në zotnimin e të cillit thuhet se ká kênë fjalori i Françesk Maria Da Lecce-s, shkruie me dorë të tij në 1702 në Mat. Gjurmët e këtij fjalorime përjashtimin e disá pjesëve të zgjedhuna qi shenjoi Dhimitër Camarda, sot nder duer të Pálit Schirò-kan humbë”<sup>32</sup>; Dom Pjetër Matranga që në gusht të vitit 1830 zbuloi në Rromë “Odet e shën Sofronit” dhe: “...u emnuie si shkrimtar i gjuhës greqishte në Bibliothekën e Vatikanit”<sup>33</sup> dhe anëtar i Akademisë romane e deri te Francesko Matranga, drejtori i parë i të përkohshmes “Cronache Italo-Albanesi” (1926).<sup>34</sup>

Indirekt duke folur për veprat e Marin Barletit “Jeta dhe bëmat e Gjergj

Kastriotit”, Venedik (1504) njihemi edhe me një shënim mjaft interesant mbi përpjekjet e Karl Gurakuqit për përkthim e kësaj vepre.

“Kjo veper e përkthieme nder gjuhë të ndryshme t’Europës, nisi të përkëthehej në gjuhë t’onë nga prof. K[arl] Gurakuqi, si më njohtoi zoti Sotir Kolea...”<sup>35</sup> Ndimën që duhet t’i jepte përkthyesit të kësaj vepre ai e cilëson “detyrë kombëtare”. Një vend të rëndësishëm në analizën e tij zë edhe familja Blinishti.

Në trajtesat historiko-fetare të përfshira në studimin e Fishtës, krahas organizimit dhe simbiozës fetare mes dy Kishave në Shqipëri, synohet më tepër të jepen kontributet kulturore të realizuara gjatë viteve. Për Kishën Perëndimore veçon botimet e realizuara nga Kongregacioni “De Propaganda Fide”, duke theksuar se me mjetet e këtij Kongregacioni janë shtypur veprat më të rëndësishme shqiptare jashtë dhe në Shqipëri. Influenca e Kishës Lindore kalon përmes veprës së Akademisë së Voskopojës gjatë shekullit XVII. Nga kjo rrymë kulturore ai veçon Theodor Haxhi Filipin, Naum Veqilharxhin, Arqipeshkvin Eubes Gregori. Nuk lë pa përmendur edhe punimet e Konstandin Kristoforidhit, përkthyes të veprave të Shoqërisë Biblike Anglikane: “... punimet e të cilit, me shtymjen qi i dhanë anëtarët e Komisisë Letrare Shqipe të Shkodrës, shërbyen dhe do të vyejnë si guer themeli i perpjekjes kah një gjuhë letrare të njaj letratyre ende të vorfën”<sup>36</sup>

<sup>32</sup> Po aty, 9 : 479

<sup>33</sup> Po aty: 479

<sup>34</sup> Po aty: 479

<sup>35</sup> Po aty: 544

Nuk duhen lënë pas dore edhe zbulimet e dorëshkrimeve të tjera të bëra nga F. Fishta në Bibliotekën Nacionale të Parisit, në të cilat pasqyrohet interesimi i studiuesve të kohës, por edhe nevoja praktike për njohjen e gjuhës shqipe. Sipas njoftimeve të tij, në Paris ruhet dorëshkrimi i Fallot & Ackermann: "Glossaire Grec-Romaïque-Albanais", një ripunim i veprës së Akademisë së Voskopojes me autor Dhanilin, "të cillen W Martin Leake-u, pëfaqësuesi diplomatik i Anglis në Kuriin e Ali Pashës e ribotoi ndër fletët e veprës "Researches in Greece" (London 1814), si dhe dorëshkrimin tjetër të të njëjtëve autorë: "Glossaire latin albanais" që "nuk asht tjetër veç një ripunim dhe shkurtim i fjalorit të Frang Bardh-it "Dictionarium latino epiroticum" etj. (vj. 1635) përcjellë me disa oroe kritike të këtij fjalori".<sup>37</sup>

Filip Fishta bën thirrje që të analizohet çdo gjë e zbuluar. Sipas tij lënda e zhvilluar nga Buzuku, Matranga, Budi, Bardhi, Bogdani ka "nji drejtim mâ shekullâr".<sup>38</sup> Parathëniet dhe pasthëniet janë një pasqyrë e zhvillimeve historike shqiptare të kohës. "Ato vepra të vorfna, monumenta të vërtetë gjuhësorë, vjefhtën të hjedhin shkëndiat e para të jetës mendore në Shqipni qyshë në të pesëmbdhetin shekull...".<sup>39</sup>

Studimi i Filip Fishtës synonte të sillte një hap përpara në trajtimin e historisë sonë kombëtare bazuar në dokumente origjinale.

## "Gjurmimet e njij mueji në Rromë"

Studimi në fjalë ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë lidhet me Pjetër Budin dhe veprat tij, Kuvendin e Arbërit, pseudo-publikimet e veprës apologjike të Bogdanit (1691 e 1702) në Bibliotekën Nacionale të Romës, vendbotimin e Triodit të Stefanit të Shkodrës, ndërsa pjesa e dytë ka të bëjë me historinë kishtarë, vizitën baritore të Marin Bizzit në edicionin e dr. Franjo Raçkit, plotësimet dhe shënimet e botimit bazuar në dorëshkrimet origjinale të dorëshkrimit që gjendet ne Bibliotekën e Vatikanit.

Meqenëse relacionet e Bizzit tanimë janë të botuara dhe të komentuara po përqendrohëm në të rejat që sollën për kohën, vrojtimet rreth veprave të Budit e Bogdanit.

Në studimin e tij bëhet i njohur fakti i fotografimit dy herë të ksomblave të veprës "Pasqyra e të rrëfyemit" të Pjetër Budit të zbuluara nga M. Roques<sup>40</sup> nga F. Fishta në dy bibliotekat që i zotëronin, në atë te Parisit në vitin 1930, porositur nga dom Ndre Mjeda me ndihmën financiare të Imzot Lazër Mjedës, si dhe fotografimi i dytë i kryer në Bibliotekën e Vatikanit me porosi të Ministrisë së Arsimit. Fotografimi i dytë i realizuar në "fotografi pozitive", ashtu siç thekson vetë autori, ishte më i mirë se "fotografimi me negative", i cili nuk ishte i përshtatshëm për

<sup>36</sup> Po aty: nr.1, 1939: 45

<sup>37</sup> Po aty: 45

<sup>38</sup> Po aty: 46

<sup>39</sup> Po aty: 46

<sup>40</sup> Filip Fishta. Mario Rok për filologjinë, kërkimet arkivale dhe historike të vëndit tonë BUSHT, SSSH. XV/1961, nr. 3: 219. (M. Rok zbuloi veprat e P. Budit)



botim. Ndonëse në ditët tona jemi familjarizuar tanimë me këto vepra, revista “Leka” përmes pendës së dom Ndre Mjedës, Filip Fishtë, që e shkroi me dorë veprën dhe bëri fotografimin saj, e cilësonte “t’flaktin atdhetar”.<sup>41</sup>

“Mbas dërgesës s’ime nga Parisi - mbarë vepra e përkthrueme me dorë prej meje dhe ma vonë e fotografueme ... ndër kopje negative - Mjeda ribotoi në *Lekën* përveç fac-similes së titullit të librit ..., edhe dhetë faqet e parathanëjes së veprës në fjalë këthye me orthografin e soçme të shqipes”<sup>42</sup>. Siç del nga arsyetimet e F. Fishtës qëllimi i fotografimit të dytë ishte rifillimi i punës për botimin e plotë të veprës së Budit. Autori njofton se në bibliotekën e Vatikanit ndodhen edhe vepra të tjera. Me mjaft interes në studimin e veprës së dytë të P. Budit është pohimi se kjo vepër, e titulluar “Rituale romanum et Speculum Confessionis” (1621), përmban 3 vepra. Përkthimi i këtyre veprave më vonë nga Dhimitër Shuteriqi e Robert Elsie flet për Ritualin dhe Specvlm si vepra kryesore dhe për një vepër ndërmjetëse dhe lidhëse mes tyre të përbërë prej 16 faqesh e cila emërtohet nga autorët “Kush thotë meshë këto kafshë i duhen me shërbyem”. Në të dhënat e Fishtës vepra në fjalë përkthruhet si e tillë, por vepërza ndërmjetëse njihet me një titull të ndryshëm nga të parët: “Diftojsi i Meshës Rromake”. Për fat të keq Dh. Shuteriqi përmend shumë autorë që e kanë studiuar apo dhe njohur këtë

libër, përmend edhe artikullin e dom Ndre Mjedës të “Leka”, por nuk jep asnjë njoftim mbi Filip Fishtë si fotografuesin e parë të veprës.<sup>43</sup> Një kopje e fotografuar e kësaj vepre ndodhet në Bibliotekën Kombëtare. A mos vallë është kopja e Filip Fishtës?

Në studimin e “Rituale Romanum” Filip Fishta arrin në konkluzionin se “ndodhemi jo vetëm përpara njëj përkthimi të thjeshtë, por edhe në punimin e njëj shkrintari t’onë i cili din t’ia përshtasi landën e shkrueme botës shqiptare, tue marrë në shqyrtim zakonet e këqija të vendit t’interesantshme edhe për folklorën t’onë”.<sup>44</sup>

Filip Fishta fotografoi edhe të parin botim të “Doktrinës Kristiane” shtypur në Romë te B. Zaneti në vitin 1618 me idenë fikse se parathëniet e veprave kanë njohuri historike.

Kuvendit të Arbërit zë një vend të rëndësishëm në këtë studim. Tanimë kjo ngjarje i është nënshtruar një analize të gjithanshme nga mjaft autorë. Fishta në studim i rikthehet edhe një herë faktit se vepra e Bogdanit është një botim i vetëm pavarësisht nga viti dhe vendi i botimit.

Autori na njeht me një tjetër studiet veprës së Bogdanit dr. Guljielm Dedën, përgëzon A. Mark Harapin për ribotimin e “Çetës së Profetëve” dhe kritikon N. Resulin për mosvlerësimin e duhur.

Studimi në fund të pjesës së parë i rikthehet edhe një herë problemit të një shtypshkronje të vjetër të Shkodrës të trajtuar edhe më parë duke mohuar ekzistencën e saj.

<sup>41</sup> Nd. Mjeda. Për një libër të panjohun të Imzot Pjetër Budit. LEKA, 1932, nr.7-8:498.

<sup>42</sup> F. Fishta: Gjurmimet e njëj mueji në Rromë. Hylli i Dritës:499

<sup>43</sup> Dh. Shuteriqi. Shkrimet shqipe në vitet 1332-1350. Tiranë, 1996:62

<sup>44</sup> Po aty: 499



## FILIP FISHTA, THE SCHOLAR OF THE ALBANIAN HISTORY THROUGH THE ARCHIVES AND THE LIBRARIES OF EUROPE

*Filip Fishta, the scholar and the researcher of the early heritage of the Albanian literature, has a rich contribution, but, unfortunately, still unknown, due to the historical circumstances. The article is a good insight regarding the researches of the abovementioned author during his work looking for Albanian manuscripts in the libraries of Paris and Rome.*

*The author of the article conveys to us the contribution of F. Fishta in discovering the works of the French scholar Mario Roques and in particular his studies "Historical Announcements on the Archbishops of Skopje", "Manuscripts in the National Library of Paris", "One month researches in Rome", all published in newspapers during the '30-s. You can find an abundant information in the works of Fishta regarding the publications and republications of the books of Budi and Bogdani.*

## Librat e mi



Kisha një pasion që fillimet i pati në Salzburg dhe më ndoqi i pashuar deri në këto ditë të fundit të jetës. Ai u bë vetë mënyra dhe forma e ekzistencës sime: dashuria për librin. Kam lexuar pambarrimisht shumë, duke filluar që nga ajo moshë pangopësie kur dëshirat bëhen ves. Kisha plot shokë, që ashtu si unë nuk kanë dashur të prehen në gjirin e një jete të qetë e pa tallaze, duke kërkuar të bëjnë një jetë të frymëzuar ku të vlonte pasioni. Dëshironin ta ndjenin jetën duke zbuluar me ngut anë të saj pak të njohura për ne, për shembull vajzat. Ose të provonin lodra që të jepnin mundësi të pakufizuara tendosjeje nervore, por nganjëherë dhe fitime, si kumari. Ndërsa unë me entuziazmin tim gllabërues përpija librat që asnjëherë s'arritën të ma shuajnë etjen. Dhe sot që shikoj se si flashken me moshën shumica e pasioneve, ndërsa ky për librin, përkundrazi, mendoj se kam qenë

më fatkeqi dhe më fatlumi, që pata një të tillë ves i cili, në fund të fundit, është më fisniku. Isha një dashurues maniak librash. Blija vepra të mira, por me lidhje të dobët, sepse kisha leverdi. Parimi im i pandryshuar gjithmonë ka qenë: sa më shumë libra me më pak para. Nuk mund të mburrem se në bibliotekën time kam edicione të rralla për nga paraqitja, siç mund të mburret një bibliofil i vërtetë, por them se kam libra vërtet me vlerë për nga përmbajtja. Më kujtohet biseda që kam bërë dikur, nga vitet '80 me ambasadorin italian Karlo Xhentile, një humanist në kuptimin më të mirë të fjalës. Ai më pati treguar në ambasadë bibliotekën e tij, që e kish sjellë nga Italia, me libra të zgjedhura, vërtet të mrekullueshme si nga përmbajtja ashtu dhe nga veshja. Kur i thashë se shumë nga librat që kishte ai, i kisha blerë në Vjenë vite përpara në kohën e studentërisë, në botimet e tipit "Biblioteca

Universale”, “Biblioteca classica economica italiana” ose të “Reclams universalbibliothek”, gjermanisht etj., etj. ai i habitur shprehu dëshirën për të parë bibliotekën time. “Veç të tjerash do të desha të dija se cili do të kishte qenë ushqimi i një intelektual shqiptar”, më tha. “Vizita të tilla kam bërë në Çeki, Hungari, ku kam pasur rastin të njihem me bibliotekën e filozofit të shquar Georg Lukash” etj. U tmerrova se sa të varfër do të dukeshin librat e mi nga pamja përpara bibliotekës-së tij plot shkëlqim. Edhe sot e kujtoj me keqardhje që s’ia përbusha dëshirën Xhentiles, atij fisniku të vërtetë që bëri aq shumë për të krijuar marrëdhënie të ngrohta midis dy akademive tona, sepse një takim i tillë privat atëherë do të ishte si lulja e një pranvere të parakohshme.

Po le të kthehemi në Vjenë, në kohën e studentërisë kur pasioni për librat bëri që unë të kisha një bibliotekë të mirë me mbi 10 000 vëllime përpara se të kthehesha përfundimisht në Shqipëri. Këto libra ishin në pjesën më të mirë fryt i një gjahu sistematik nëpër antikuariate, ku bëja vizita të rregullta një herë në dy javë. Një paradis për mua ishte rruga “Wollzeile”, ku antikariatet ishin pranë njëri-tjetrit. Akoma dhe sot shoh në ëndërr sikur kaloj nëpër rrugicat e kësaj lagjeje të brendshme të Vjenës dhe shëtis me mallin e pushuar të rinisë.

Ishte koha e krizës së madhe në prag të Luftës së Dytë Botërore dhe shumë njerëz shisnin librat e bibliotekave të tyre për të plotësuar nevojat familjare. Kur shfletoj sot libra të bibliotekës sime dhe shoh emrat e ish-pronarëve të tyre (Th. Ipen, M. Lamberc etj.) provoj se sa

kënaqësi kam ndjerë në atë kohë kur kam shtënë në dorë librat e tyre, libra të rrallë e me vlerë. Po ky pasion sillte me vete pasojën fatkeqe që të mbetesh pa para e të detyrohesh herë pas here që të merrja hua nga shokët e miqtë për të blerë më lirë librat që shiteshin me okazion në treg. Megjithatë unë s’isha më prishësi. Nuk ishin të rralla rastet kur vinin shokët të më kërkonin hua.

Me përjashtim të ndonjë rasti konfliktesh, marrëdhëniet midis studentëve shqiptarë të Vjenës kanë qenë më se vëllazërore, gjë që ishte shumë e nevojshme, se pa ndihmën e njëri-tjetrit s’mund të kaloheshin vështirësi të mëdha të herëpashershme të jetesës aty. Më të vështira kanë qenë situatat kur vonohej ardhja e bursave nga Shqipëria, sepse në kohën e Zogut ishte e zakonshme vonesa e pagave deri në disa muaj. Por bursistët e Vjenës, për aq kohë sa s’u kishin ardhur paratë do të gjendeshin si peshku në zall në këtë vend të huaj, sikur të mos kishin ndihmën e shokëve të tyre që kishin kursyer ose që kishin burime të tjera të ardhurash, për shembull siç ishim nganjëherë ne privatistët, vëllezërit Buda. Po për fat të keq kishte dhe nga ata, që s’më vjen mirë të pohoj, mbesnin keq që javën e parë, mbasi kishin marrë bursën e muajit, sepse i zinte mëngjesi në tryezat e bixhozit të kafeneve... Po sido që venin punët, një nga gjërat më të bukura të rinisë sonë ishte ai solidariteti i shkëlqyer për të ndihmuar shoqi-shoqin me ç’të mundnim.

S’e harroj edhe sot e kujtoj. Ishte një nga ato raste kur më ishte mbaruar çdo rezervë ushqimore dhe e pata shpenzuar edhe groshin e fundit. Isha i lumtur se kisha blerë serinë e plotë të veprave të



Tomas Mani, por po bëheshin më shumë se njëzetekatër orë që s'kisha futur gjë në gojë, i rënë përmbys mbi librat pa dalë fare nga shtëpia. Qeshë i vendosur ta kaloja kohën kështu duke shpresuar se ndërkohë do të më vinin paratë nga Shqipëria. Me këtë blerje kisha arritur të përbushja ëndrrën time të madhe për të pasur edhe libra të tjera me vlerë të llojit intelligenzen -roman<sup>1</sup>, që kanë qenë dobësia ime. Pak përpara kisha blerë pothuajse të gjitha romanet e Haksilit, që janë të këtij karakteri, ndërsa tani shijoja ushqimin më të mrekullueshëm që kisha përfytyruar: po jetoja me personazhet e Mani. Letërsia gjermane ka edhe vepra që dallohen për nga mënyra me të cilën shkrimtari ndjek hap pas hapi zhvillimin shpirtëror të heroit, që i quajmë libra të tipit *bildungsroman*. Dhe të tilla, vërtet interesante, s'ka pak kjo letërsi. Por veprat e Mani i kam lexuar dhe rilexuar gjithmonë me dëshirë e kënaqësi, sepse, përveç të tjerash, ato kanë një të tillë thellësi mendimi, që i bën të mbeten kurdoherë tërheqëse, të pavjetëruara.

Erdhi koha që s'mund të shkoja më as në Universitet, sepse duheshin kursyer energjitë. Po hyja në ditën e katërt të agjërimit, i mbyllur me dëshirë në burgun e leximeve, duke rënë për të fjetur pak, në kohën kur të tjerët zgjoheshin, sepse i gdhija netët.

Po sado i madh, ushqimi im shpirtëror nuk e mundte dot shqetësimin fizik të urisë

që sa vinte e shtoej. Duke mos pasur ushqim, merret me mend se edhe zemra dhe çdo organ tjetër s'punonin në rregull. Mbaj mend si tani se kur uria kishte arritur kulmin, një erë e mirë që vinte nga dollari më kujtoi se ndofta ende do të kishte mbetur diçka e ngrënshme aty, që s'do ta kisha vënë re më parë. Kërkova andej-këndej dhe nga era gjeta një kallëp sapun tualeti që ia ngula sytë me vëmendje. Kisha arritur në një gjendje të tillë që po mendoja se a do të mund të shpëtoja nga uria po t'ia ngulja dhëmbët, kur dëgjova disa hapa që u ndalën përpara derës sime. Dikush trokiti me vrull. E hapa dhe ç'të shihja?! Naim Vreton!<sup>2</sup> U derdha në krahët e shokut tonë në vuajtje, që gjithë jetës mbeti siç ishte student. Njeri i vërtetë me një zemër të madhe, të bardhë, plot dashuri për shokët dhe njerëzit, me një sinqeritet të ndritur, që s'iu flashk dhe s'iu zbeh kurrë nga vitet e gjata të një jete që kurdoherë u përpoq ta bënte të bukur. Dhe të dy së bashku u ulëm në tryezë duke ngrënë gjithçka kish sjellë ai me vete. Kështu brenda pak kohe i vura në vend kaloritë e humbura gjatë këtyre ditëve. Që atëherë mësova të agjëroja, jo për qëllime fetare, po sipas rastit dhe nevojës.

Një tjetër mënyrë për të siguruar para që të dilja nga situata e vështirë ishte të lënët peng. Kjo metodë ishte e frytshme përkohësisht po të kishe sende me vlerë, si për shembull ndonjë kostum të mirë, apo bizhu, stoli të arta etj., sende që unë s'i kisha.

<sup>1</sup> Roman që ka si personazhe intelektualë, përgjithësisht shkrimtarë dhe artistë, të cilët diskutojnë mes tyre.

<sup>2</sup> Dr. Naim Vreto (1905-1995); studimet e ulëta dhe të larta i kreu në Vjenë. Të mesmen në Frajshtad. Ka dhënë kontribut me vlerë, deri në vitet e fundit të jetës së tij të gjatë, për mbarëvajtjen e blegtorisë shqiptare.



Doroteum<sup>3</sup> quhej pengëtorja - institucioni shtetëror ku zakonisht të varfërit linin pasuritë e tyre të fundit. Prej saj kishte marrë emrin edhe rruga, që quhej Doroteaggasse. Aty unë kam pasur mundësi të blija libra shumë të vlefshëm, që shiteshin në ankand kur i zoti nuk vinte t'i shpengonte. Te Teze Dorotea, siç e quanim ne studentët, nuk kam blerë vetëm libra, por kam lënë peng dhe thesare të zemrës kur isha ngushtë: përsëri librat. Me gjithë emrin e saj të bukur (italisht këtij institucioni thonë Mali i Mëshirës), rruga për atje ishte një kalvar. Në krahasim me sendet e çmuara që pranoheshin te Tezja, librat ishin gjërat që kishin më pak vlerë. Unë duhet të çoja një valixhe të rëndë me libra që të vlerësoheshin diçka. Më dilte shpirti nga hundët derisa arrija atje. Nuk ishte shaka të ngarkoheshe me një valixhe plot, rreth 50-60 kg. libra, aq më tepër që në rrugën e vjetër të Tezes nuk kishte tramvaj. Bëja shumë ndalesa; qëndroja për t'i dhënë zemrës mundësi të pushonte. Kur arrija t'ia dorëzoja thesarin tim nëpunësit të Tezes, të rrahurat e zemrës gati më merrnin frymën. Dhe pas gjysmë ore mundimesh sflitëse, me duart që më dridheshin e djersët që më shkonin çurg, merrja një shumë fare të vogël të hollash (të cilën përsëri duhej ta ktheja, nëse doja

t'i shpëtoja librat e mi) sa për të kaluar vetëm pak ditë.

Shokët e mi, me të ardhurat që kishin nga bursat arrinin të kishin edhe roba të bukura, të shkonin në ballo për të kërcyer, apo për t'u dëfryer, ndërsa unë isha i kënaqur me jetën e Diogjenit që bëja. Nuk i vija fare rëndësi lustrës së jashtme, veshjes.

Mbjaj mend një herë, kur kishte ardhur Persja<sup>4</sup> në Vjenë për të bërë një operacion. E gdhiva në spital, sepse ajo kishte nevojë për ndihmë. Nga ora pesë e mëngjesit po kthehesha në pensionin tim dhe prej këndeje do të shkoja në Universitet. Ndërkaq dëgjova se më thirri dikush:

- Ej, zi, zi!<sup>5</sup>

Kthej kokën dhe dalloj një polic që më bën me shenjë të ndaloj. Më sheh nga poshtë lart dhe më kërkon kartën e identitetit.

- Po vij nga spitali, - i them duke i zgjatur dokumentin.

- Ah, edhe ju qenkeni intelektual?! - m'u drejtua ai i habitur duke mbyllur pasaportën time. Natyrisht që veten e vet s'e diskutonte.

- Pse s'më besoni? - e pyeta.

- Pamja juaj më bëri të dyshoj, - u përgjigji ai.

Atëherë hodha sytë dhe pashë me vëmendje veshjen time. Vërtet këpucët i

<sup>3</sup> Nga dorote-dhuratë e zotit (greq.)

<sup>4</sup> Gruaja e vëllait të Aleksit, Stasit, Anastas (ose Stas) Buda (1905-1955). Mësimet fillore i kreu në Leçe. Vazhdoi disa vjet në gjimnazin federal të Salzburgut dhe në Akademinë tregtare të Insbrukut, por i ndërpreu studimet për t'i ardhur në ndihmë të atit në mbarëvajtjen e farmacisë, ku punoi deri në mbarim të luftës. Në vitin 1948 u dënua me burg dhe punë të detyruar për mospagim të tatimeve. Gjatë viteve 1949-1953 punoi si farmacist në Elbasan, ndërsa vitet e fundit në Depon Qendrore të Barnave dhe në farmacinë nr. 3, në Tiranë.

<sup>5</sup> Ju (gjerm.).

kisha fare të ngrëna dhe pantallonat të rrjepura. Ndërkaq polici më tha:

- Më falni, shkoni!

Kështu më ka ndodhur dhe herë të tjera... Por nuk jam penduar aspak, përkundrazi mallëngjehem, sa më dalin lot nga sytë kur hyj sot në bibliotekën time dhe shoh e përkëdhel me dorë librat e mi më të dashur, një pjesë e të cilëve është blerë me këto sakrificë, disa herë duke hequr nga goja edhe kafshatën, ose duke hequr dorë nga dëfrimet e moshës së rinisë.

Një ditë, duke më shëtitur nëpër shtëpi me karrocën që e përdor prej disa vjetësh qëkur më ka mbërthyer në vend paraliza e rëndë, më çuan në studion time. Ajo ndodhet në dhomën më të madhe të katit të parë, me mure të lartë, të mbushur nga tavani në dysheme me rafte librash, të gjithë të vënë shtrënguar në dy radhë. Me të hyrë u mallëngjeva se mendova që ky do të ishte stacioni im i fundit... dhe se ende mund të kem ndonjë libër, që me atë optimizëm kriminal, siç thotë Shopenhaueri, e kam lënë për ta lexuar “më vonë”, duke harruar se jeta e njeriut përbëhet nga shumë të tilla “më vonë”. Edhe se jo i ngopur, jam i kënaqur që i kam lexuar këto libra dhe që edhe sot e kam para sysh çdo vepër e autor të bibliotekës sime që prej kohësh i ka kaluar 20 000 vëllimet.

Gëtja thotë se koha është e çuditshme, një tirane tekanjoze që fjalën dhe veprën e çdo shkrimtari e shikon ndryshe. Por mendoj se kurdoherë vetitë themelore të shkrimtarëve dhe të veprave të tyre mbeten. Qëndrojnë përkrah vëllimet e veprave të gjermanëve të mëdhenj,

madhështia sipërore më e urtë dhe më tokësore e Gëtes dhe madhështia e flaktë, jashtëzakonisht burrërore e Shilerit, poezia romantike plot ndjenjë e me mësim të mençura e Hajnes etj. Aty është Dantja me vështrimin e thellë depërtues në të shkuarën dhe në të ardhmen, me pikësynimin e vet për lartësimin moral të njerëzimit. Janë skenat e pavdekshme të tragjedive shekspiriane: dueti i Romeo dhe Xhulietës, meditetim e Hamletit, zgjimi i xhelozisë së Othellos, pasionet e Lirit, halucinacionet e Makbethit etj. Është Servantesi që i dha romanit ironinë; Rabëleja-humorin dhe poezinë gjuhës së vet, me një forcë të tillë shprehëse të pakufishme për kohën, me të cilën vetëm Viktor Hygoi mund të krahasohet. Është Molieri, karakteret e komedive të të cilit kanë mbetur tipa të përjetshëm. Rasinigeniu klasik që nuk përshkroi karakteret, por pasionet, nga të cilët më të komplikuarin, po më universalin-dashurinë.

Po Volteri ku ndodhet? Sipas kronologjisë (shek. XVIII) ai duhet të ishte në radhën e librave francezë të kësaj kohe! Apo është në raftin e filozofëve? Ai me dy librat e tij, që i kam (“Esenë...” dhe “Traktatin...”) është po aq filozof sa historian. Pikëpamja historike zotëron filozofinë e tij. Në të vërtetë, ai mund të quhet pararendës i historianëve modernë me konkluzionet universale për rendin e barabartë të popujve në arenën e historisë dhe deduksione interesante si: “Lufta dhe fanatizmi janë armiqtë e progresit” etj. etj. Ja ku është “Heloiza e re” e Rusoit gjermanisht, me tezat e tij sugjestionuese për rigjenerimin e individit dhe të shoqërisë. Nga shek. XVIII shkëlqen ende forca e

mendimit filozofik francez!

Duhet të kem kaluar La Fontenin. Ç'fabula kemi lexuar prej tij së bashku me fëmijët e mi! Sa eksperiencë njerëzore në dy vargje! Po që francezët e mbajnë për krijuesin e parë të formës së vargut të lirë, e dini?

Në radhën e romantikëve të parë anglezë zëri i Kolërixhit është më i fuqishmi. Po si mund të kalosh pa u ndalur para atyre shpirtrave të rinj, delikatë, poezitë e të cilëve janë një himn madhështor drejt progresit? Janë ata që i përkasin gjeneratës poetike të romantizmit të dytë anglez: Bajroni, poeti i zjarrtë tragjik, me individualizmin aristokratik që ndikoi në romantizmin europian, Shelli me bukurinë intelektuale dhe lirizmin e pakrahasueshëm, ndoshta liriku më i madh i Anglisë dhe Kitsi me trishtimin e ndritshëm dhe ndjeshmërinë e hollë!

Aty duhet të jetë Uollter Skoti prej të cilit të gjithë e dinë se ç' do të thotë të bjerë historia, për shembull historia e Anglisë, në dorën e një mjeshtri tregimtar. Po në atë raft, janë dy libra nga Stivensoni, që është krejt ndryshe nga Skoti dhe që u dha një vlerë të lartë artistike romaneve të aventurave. Pastaj disa romane të Dikensit nëpërmjet të cilëve mund të njohësh aq bukur shoqërinë angleze të kohës kur u shkruan. Ashtu do të thosha unë, siç e kanë vënë në dukje edhe të tjerë, për romanet e Balzakut në Francë, ku njohja e thellë e natyrës njerëzore dhe e ligjeve të zhvillimit të shoqërisë është e rrallë.

I shoh së largu dhe pa i dalluar mirë i di vendet e dramave të Ibsenit, të Bjornsonit. Shkrimtarët nordikë, ashtu si Gëte dhe Shileri në letërsinë gjermane, megjithëse

ishin dy natyra të kundërta nga njëra-tjetra, e bënë të dallohet letërsinë skandinave nga ajo gjermane duke e ngritur lart.

Ç'është e vërteta më ka pëlqyer shumë teatri dhe jam përpjekur ta ndjek. Në Austri çdo shfaqje e re teatrale ishte një festë e vërtetë, pa llogaritur festivalet e përvitshme të Salcburgut, që ishin bërë ngjarje të shënuara ndërkombëtare, ashtu siç e kam treguar edhe më sipër. Po kënaqësia e shfaqjes zgjatej sepse ajo fillonte me një prelud mediatik në shtyp për autorin dhe aktorët pjesëmarrës, ashtu si dhe nga komentet pas saj, që jo rrallë kishin peshën e studimeve. Kështu, një amator i teatrit njihte po kaq mirë sa dramat gjermane ku përplaseshin pasione dhe ngjarje të furishme që i përkisnin më tepër periudhës "Stuhi dhe vrull" edhe dramat sociale të Ibsenit me aksion të fortë dramatik. Njihte si dramat e ndërlikuara moderne të Pirandelos dhe dramat e Shout, në dukje të thjeshta, po që kanë filozofi, dramat e mrekullueshme të karaktereve të Çehovit etj. Kështu dhe nëse s'kisha arritur t'i shihja të gjithë shfaqjet unë i njihja mirë ato nga komentet. Po kurdoherë isha përpjekur që t'i blija dramat mbi të cilat ndërtoheshin pjesë teatrore që luheshin në skenë, kur mundja edhe vepra të tjera të autorëve të tyre.

Librat para të cilëve kam qëndruar janë librat e vjetër të kohës së studentërisë. Ashtu si nënat, që thonë se duan më shumë ata fëmijë që kanë vuajtur, ashtu i dua dhe unë këta fëmijët e mi libra, sepse për ata kam vuajtur në kuptimin e plotë të fjalës, prandaj shoh me shqetësim çdo ndryshim sado të vogël në bibliotekën time.

Nuk është iluzion. Janë harkuar vërtet



etazheret e librave të filozofisë. Duhet t'i lëvizim e t'i vendosim në katet e poshtëm. Janë me peshë filozofët klasikë gjermanë që i kam të plotë që nga Kanti - themeluesi, Hegeli - përfaqësuesi më i shquar, Shellingu, Herderi, Fihjtja e deri te më i fundmi Fojerbahu. Qëndrojnë pranë *Bota si vullnet dhe si përfytyrim* i Shopenhauerit dhe *Das Kapital* i Marksit, ashtu si *Mein Kampf* i Hitlerit dhe *Dotrina Faschista* e Musolinit me *Manifestin e Partisë Komuniste* të Marksit dhe *Origjina e pronës private dhe e shtetit* e Engelsit. Mendimi im që në fillim ka qenë, se duke u ndodhur përballë filozofive të kundërta jemi të detyruar të vihemi në lëvizje, të zhvillohemi, të edukojmë vetitë tona të ndryshme derisa të përcaktojmë drejtimin tonë vetjak, lëvizjen tonë përfundimtare. Por më ka ndodhur në disa raste, kur më kanë bastisur shtëpinë, që të kem qenë i rrezikuar edhe nga librat, por të kem shpëtuar edhe falë tyre, siç do të tregoj më vonë.

Në pjesën e poshtme të rafteve në të majtë, në fund për nga renditja, por jo nga vlerat, janë librat e mendimtarëve të antikitetit greko-romak. Aristoteli me kritikën e tij ndaj Platonit ishte mësuesi im më i mirë në greqishten e vjetër, njohja e së cilës më shërbeu gjatë viteve të universitetit për të lexuar në origjinal. Me dëshirën për t'i njohur në origjinal kam lexuar veprën e filozofëve anglezë Darwin (me elokuencën dhe retorikën e tij në "Origjinën e llojeve") Spencer dhe Rasëll (përfaqësues të pozitivizmit dhe neopozitivizmit), Huxley që më kanë lënë mbresa dhe njëkohësisht më kanë

mbushur me kënaqësi se e zotëroja anglishten e mësuar vetë për të kuptuar vepra të një vështirësie jo të vogël.

Kujtoj me mall harenë që më përfshinte kur përpjekjet për të gjetur librin e dëshiruar më shpërbleheshin. Njëherë, në një pengëtore shtiva në dorë disa libra të letërsisë ruse në italisht dhe frëngjisht. Atëherë njoha për herë të parë Çehovin që, si Mopasani, ishte mjeshtër i prozës së shkurtër. Deri në atë kohë njihja vetëm Kiplingun me tregimet e tij të tipit "short story", po jo të kësaj madhësie. U mahnita nga ky tregimtar rus, i cili i këndonte vuajtjes shoqërore në një prozë lakonike, që për nga fuqia artistike ua kalonte veprave të mëdha epike. Kisha gjetur librat e Dostojevskit *Djajtë* dhe *Vëllezërit Karamazov*, ku njoha një paraqitje të ndryshme të ideve, një teknikë të re që them se ngjante me atë që shkrimtarë të mëvonshëm do ta përdorin për të hyrë në të fshehtat e mendjes së njeriut. Dhe më kureshtar u tregova për të njohur Gorkin, shkrimtarin proletar rus, prej të cilit që atëherë kam, veç disa novelave apo tregimeve të bukura, edhe romanin *Nëna* (italisht), roman që atëherë kishte ngjallur interes në rrethet e majta të studentëve të Vjenës. Më vonë në "Librin sovjetik" për të cilin do të flas më poshtë, do të mund të gjeja dhe ta blija gjithë veprën e tij në një botim luksoz.

Leximi i çdo libri më ka nxitur gjithmonë për të lexuar libra të tjerë të rinj. Jam përpjekur të gjeja, të njihja sa më shumë të tillë për të provuar ndryshime të reja, po edhe me etjen për të mësuar. Të mësuarit, thonë pedagogët e psikologjisë, është aventura më e madhe, ajo që e ndryshon

duke e përsosur njeriun. E vërtetë!

Aty nga vitet pesëdhjetë në Tiranë u quajt sukses hapja e një librarie me literaturë sovjetike që më vonë do të ndryshonte karakterin dhe do të pasurohej me libra ndërkombëtarë, ku mund të gjeje edhe libra gjermanisht që kalonin pa shumë kontroll (sipas periudhave) Një farë kohe kisha kënaqësinë që, në sajë të një katalogu që gjendej në librari, mund të blija libra me porosi nga të gjitha vendet e quajtura të demokracive, që jo rrallë ishin botimet më me vlerë të vendeve të Lindjes, por dhe përkthime në gjuhë të tyre të veprave perëndimore. Fillova të merresha me gjuhën ruse, të cilën s'e kisha të vështirë ta mësoja, ndofta nga serbishtja që pata studiuar në universitet. U abonova në të gjitha revistat periodike të historisë dhe të letërsisë. "Voprosi istorii" dhe "Literaturnaja gazeta" ishin abonimet që i prisja më me kënaqësi. Libra që lidheshin me historinë e popujve të BS, të Europës, veçanërisht të Ballkanit, të çdo periudhe, i lexoja me kureshtje dhe vëmendje. Bleva në fillim gjermanisht, e më vonë rusisht, pothuajse të gjitha veprat e Marksit, Engelsit, Leninit etj. U njoha me pasurinë e madhe të mendimit kritik rus, që nga Çernishevski, Dobroljubov, Bjelinski etj. Njoha Turgenievin, Tolstoin e ri (Tolstoin e madh e kisha që nga Austria), Gogolin

etj. Po mbi të gjitha, sa më thellë hyja, aq më tepër më bënte përshtypje pasuria e madhe e gjuhës ruse që mund ta krahasoje pa frikë me gjermanishten. Mahnitja nga muzikaliteti poetik i vargjeve të romanit të Pushkinit "Evgjeni Onegin" më bëri ta përjetësoja heroinën e tij në emrin e fëmijës sime të parë: Tatjana.

Kujtoj me kënaqësi të veçantë gëzimin që më sillte ardhja e herëpashershme e çdo vëllimi të Enciklopedisë së Madhe Sovjetike, një vepër madhështore për kohën; brenda disa vjetësh arriti me mijëra faqe, rreth dyzet vëllime. Arrita të kem në origjinal botime të reja, shpesh luksi, të Majakovskit me figuracionin ekstravagant për kohën dhe vendin kur i shkroi, të Eseninit me poezinë e tij fine, publicistikën e Ehrenburgut që sillte mbesa interesante nga udhëtime përtej perdes së hekurt, botime të reja të Tolstoit, të vjetër e të ri, të Shollohovit etj., ku shpirti i gjerë i njeriut rus ndriçohej në mënyrë mjeshtërore e origjinale në fusha të panjohura të spektrit njerëzor. Gjithashtu dhuratat e përvitshme në libra të rinj që botoheshin në Gjermaninë Lindore, nga Ambasada e RD Gjermane, ku shpesh shkoja si përkthyes, nuk e linin të pluhurosej aspak bibliotekën time dhe arrinin të më siguronin një ushqim të mjaftueshëm për të mos qenë i varfër.

*Marrë nga libri: Tatjana Haxhimihali, Aleks Buda: Kujtime.-Tiranë, 2005.*

# Spanët, Bokalët dhe Marulët sipas botimeve albanologjike

**Afërdita SHARXHI**  
Biblioteka Kombëtare

**N**ë shek. XIV në radhët e bujarëve shqiptarë përmenden edhe Spanët, zotër të krahinës së Pultit, në Shqipërinë e Veriut, përballë zotërimeve të Dukagjinasve.

Kjo familje me emër lulëzoi veçanërisht në shek. XV. Degë të saj gjejmë edhe në Raguzë, Shkodër, Lezhë, Durrës, Korçullë, madje dhe në Shebenik. Në dokumentet e kohës mbiemrin e kësaj familjeje e ndeshim në disa forma si Spanus, Spanich, Ispanus, Hyspanus, Yspanus etj. Rreth origjinës së familjes Spani ka pasur mendime të ndryshme. Sipas Carolus du Fresne Du Cange origjina e kësaj familjeje të shquar është e paqartë<sup>1</sup>. Megjithatë mendimi mbizotërues është se origjina e Spanëve lidhet ngushtësisht me qytetin e Drishtit në Shqipërinë e Veriut, i cili dihet që në këta shekuj ka pasur një zhvillim të madh.

Për Spanët Francesco Galvani në vëllimin e dytë të veprës së tij *Il re d'armi di*





*Sebenico* (Mbreti i armëve të Shebenikut), botuar në Venezia më 1884, shkruan:

“Me origjinë nga Drishti i Shqipërisë, Spanët u vendosën në Korçullë (Curzula) dhe figurojnë ndër familjet fisnike deri në vitin 1553. Madje duke se gëzonin titullin “Kont”, çka del qartë nga një mbishkrim që gjendet në kishën e Shën Antonit, pranë këtij qyteti, ku bëhet fjalë për ipeshkvin e Korçullës Nikollë nga familja Spani (Nicolaus de Comitibus Spanich Episcopus Curzulensis= Nikolla, nga kontët Spanë, ipeshkv i Korçullës). Më vonë, në kohët më të reja, një pasardhës i kësaj familjeje, me emrin Teodor, vjen për të banuar në Shebenik. Martohet me Palma Donzelli Bonavaz, me të cilën pati një djalë, Mikelin, që, pas shumë fatkeqësish, vdiq pas pak vitesh, pa fëmijë, aty ku kishin lindur dhe jetuar të lumtur të parët e tij”.<sup>2</sup>

Ndërsa francezi Charles Lenormant në veprën *Turcs e Monténégrins* (Turqit dhe malazezët), botuar në vitin 1866, në Paris, thotë: ...përveç katër familjeve kryesore si Kastriotët, Topiajt, Dukagjinast dhe Arianitët, që zotëronin një numër vasalësh, kishte edhe disa familje fisnike, në një territor tepër të ngushtë, që nuk e njihnin më pushtetin e kryezotit (që mund të ishte sipas rastit perandori bizantin, mbreti anzhuin apo cari serb). Fillimisht ishin Spanët, zotër të Drishtit dhe të krahinës së quajtur Postribë, në të djathtë të lumit Drin, përballë zotërimeve të Dukagjinastve, pastaj zotërit e Zadrimës, njëri prej të cilëve Lekë Zaharia.<sup>3</sup>

Në Raguzë (Dubrovniku i sotëm) familja Spani u vendos rreth vitit 1322. Spanët jetuan dhe vepruan në këtë qytet

deri në mesin e shek. XVII. Të dhënat e para për Spanët e Raguzës i sjell diplomati, profesori dhe shkrimtari i njohur raguzin Serafin Maria Çerva në veprën e tij *Bibliotheca Ragusina, in qua Ragusini scriptores eorumque gesta et scripta recensentur* (Biblioteka Raguzine, ku shqyrtohen shkrimtarët raguzinë si dhe veprat e shkrimet e tyre.), shkruar rreth viteve 1740-1742 në Raguzë, në katër vëllime. Dorëshkrimi i kësaj vepre ruhet në Bibliotekën e Manastirit Domenikan të Dubrovnikut.

Çerva shkruan se *Andrea Spani i Shkodrës, qytet epirot, erdhi në Raguzë dhe fitoi të drejtat e qytetarisë pas vitit 1380... Ishte burrë me dinjitet dhe autoritet të madh. Ai iu kundërvu fort Gjon Kastriotit, babait të Skënderbeut, kryezot i sundimtarëve të vendit, njeri shumë zulmëmadh. Një farë kohe Andrea Spani kishte qenë pengesë për sundimin e Gjonit. Por më në fund, në sajë të fatit ose të guximit burrëror, sepse Kastrioti ishte shumë i fuqishëm në pushtet, ai u detyrua të tërhiqet vetë. Erdhi pra me gruan Angjelinë, bijë e Gjergj Dukagjinit, një nga pjesëtarët i një familjeje të shquar, me të cilën pati në Raguzë shumë fëmijë, ndër të cilët Nikollën (i ati i mjekut Gjergj Spani).<sup>4</sup>*

Në shek. XIV-XVI Raguzat pati një zhvillim të madh. Pas marrëveshjes së Zarës, në vitin 1358, ky qytet fitoi autonomi të plotë dhe në fillim të shek. XV shpallet Republikë, e cila del në arenën ndërkomëtare si fuqi e madhe, krahas Republikës së Venedikut. Zhvillimi i shpejtë i saj kërkonte njerëz të ditur, të aftë në profesione të ndryshme. Në shërbim të

Republikës u vunë jo vetëm qytetarët e vet, por edhe të huajt, midis tyre edhe shqiptarë. Ndër shqiptarët shquhen muzikanti Pjetër Spani, mjekët Gjergj dhe Pjetër Spani, të cilët i takojnë familjes princërore Spani të Shkodrës, të shpërngulur në Raguzë, pra, pas pushtimit të Shqipërisë nga turqit.


Për Gjergj Spanin Çerva shkruan se ishte mendjehollë, i dhënë shumë që fëmijë pas letërsisë. Por më vonë, po sipas Çervës, falë përkujdesjes së të atit Nikollë, u dërgua në Lutecia (Paris) për të vijuar studimet në mjekësi me shpenzimet e shtetit. Me mbarimin e studimeve u kthye në Raguzë si mjek me pagë shtetërore. Punoi me pasion për të shëruar të sëmurët e qytetit të vet. Falë përvojës në fushën e mjekësisë shkruan edhe një vepër mjekësore. Gjergj Spani u martua me Tomazina Radosavën, vajzë e argjendarit të njohur raguzin Radoslav Uteshinoviç. Nga kjo martesë lindën shumë fëmijë. Gjergj Spani vdiq në Kotor më 1450.

Për mjekun tjetër të Spanëve, Pjetër Spani (Marini), Çerva shkruan se ishte nipi i Gjergj Spanit. Thuhet se ai jetoi në shek. XVI. I nxitir nga fama e gjyshit, që kishte fituar emër në mjekësi, iu kushtua po kësaj shkence. Pjetri u bë profesor i njohur në mjekësi. Por, sipas Çervës, nuk ka të dhëna për mendjemprehtësinë dhe erudicionin e tij, për botime arsimore dhe erudite.

Nga familja me emër e Spanëve ka dalë edhe muzikanti Pjetër Spani, i cili jetoi në Raguzë në shek. XV, çka del nga një kontratë e firmosur prej tij që mban datën 2.X.1452<sup>5</sup>. Pjetër Spani shërbeu si kapelan i kryepeshkopit të Raguzës. Ishte mjeshtër i disiplinës muzikore *Cantum firmum*. Në

shumë dokumente të kohës, që ruhen në Arkivin e Dubrovnikut, muzikanti i njohur Pjetër Spani ndeshet si mësues i të kënduarit.

Nuk mund të lemë pa përmendur një nga zotërit feudalë të Pultit, pinjollin më me rëndësi të Spanëve, Pjetër Spanin, bashkëkohës i Skënderbeut, që bashkë me bijtë e tij mori pjesë në Kuvendin e Lezhës, mbajtur më 2 mars të vitit 1444 pranë katedrales së Shën Kollit, ku u arrit bashkimi i parë politiko-ushtarak mbarëshqiptar. Nën presionin e Venedikut ai nuk mori pjesë në luftën e Lidhjes kundër Republikës më 1448 për çlirimin e Danjës (Dejës). Sipas Du Cange-it<sup>6</sup> që i referohet Barletit, Mikeli, i thirrur prej të tjerëve Pjetër Spani, ishte i biri i Andreas, kryezot i Drishtit. Pjetri ishte i pari që mori mbiemrin e familjes së tij *Spani*. Kishte për grua vajzën e kryezotit të Pollogut (Tetovë) dhe njëkohësisht motrën e Vojsavës, nëna e të madhit Skënderbe. Thuhet se vdiq në vitin 1465.



*Gjenealogjia e familjes Spani*

Du Cange është ndër të parët që jep pemën gjenealogjike të kësaj familjeje<sup>7</sup>, të cilën më vonë e japin edhe autorë të tjerë<sup>8</sup>.

Lidhur me stemën e Spanëve gjejmë

të dhëna tek F. Galvani. Sipas tij stema e kësaj familjeje është *një shqytë trekëndore, e lakuar, me dy prerje ngjyrë argjendi dhe të kaltër. Në prerjen me ngjyrë argjendi, në të majtë, zgjatet një krah me mëngë të kuqërremtë, duke mbajtur në dorë një kamë me dorezë ari. Në prerjen me ngjyrë të kaltër janë vendosur tre trëndafila të kuq me nga pesë fletë, të hapur e të vendosur 2 dhe 1. Përkrenarja në profil, e rrethuar me kurorë ari, është krekëzuar nga një mëngë e kuqe, që mban në dorë, si në mburojë, një kamë. Në të djathtë zbukurime me ngjyrë të kuqe dhe argjendi, në të majtë zbukurime me ngjyrë të kaltër dhe ari.* Kjo stemë gjendet në një nga aulat e Universitetit të Padovës, ku në vitin 1680 u diplomua një pjesëtar i familjes Spani, me emrin Jak (Giacomo).<sup>9</sup>

Spanët, edhe pse të shpërndarë, mbetën një familje feudale me emër.

Në botimet e hershme përmendet edhe familja fisnike shqiptare e Bokalëve, pjesëtarët e së cilës, pas pushtimit turk të Shqipërisë, shërbyen si stratiotë në Venedik, Peloponez e gjetkë. Sipas Du Cange-it<sup>10</sup> pinjollit i kësaj familjeje Nikollë Bokali, i dëbuar nga turqit, largohet nga Shqipëria dhe vendoset në Venedik. Për një kohë të gjatë shërbeu në ushtrinë venedikase. U martua me Katerinën, vajzën e Arianit Komnenit, me të cilën pati dy djem, Manol dhe Kostandin Bokalin. Manoli shërbeu në ushtrinë e perandorit Maksimilian për një kohë të gjatë, ndërsa Kostandini jetoi në Itali dhe u shqua për trimëritë e tij luftarake. Ky i fundit kishte katër fëmijë, të cilët shërbyen si stratiotë

në ushtrinë e Republikës së Venedikut. Një nga pinjollët më të njohur të Bokalëve është Teodor Bokali, i cili sipas Sathas-it, ishte një nga njerëzit më të rëndësishëm të Peloponezit, që gëzonte edhe të drejtën e prerjes së monedhave<sup>11</sup>.

Gjenealogjia dhe stema e Bokalëve përshkruhet nga Du Cange *Dy luanë, të vendosur përballë njëri tjetrit, që mbajnë së bashku një shpatë të vetme.*<sup>12</sup>

Familja Maruli, me sa duket, pas pushtimit të Shqipërisë nga turqit osmanë në shek. XIV emigroi në More. Më vonë pinjollët të kësaj familjeje u vendosën në Kostandinopojë dhe në Raguzë. Sipas Galvanit familja Maruli është familje e vjetër bujare e Splitit, stema e së cilës paraqitet: *Mburojë në formë trekëndëshi, e lakuar; me fushë të kuqe. Mbi të dy krahë argjendi, të ndarë nga njëri-tjetri, me pendë të kthyer poshtë dhe sipër tyre (krahëve) një luan me bisht e gjuhë të nxjerrë, që ecën me fytyrë të kthyer djathtas. Mbi shqytë një përkrenare në profil, e rrethuar me një kurorë ari dhe në majë me dy kallinj argjendi midis të cilëve është vendosur një luan i porsalindur, me këmbët e përparme dhe bishtin ngjyrë argjendi.* Kjo stemë gjendet në një nga aulat e Universitetit të

Maruli





Padovës, ku më 1633 kishte studiuar për drejtësi një farë Nikollë Maruli.<sup>13</sup> Gjin Varfi në veprën e tij *Heraldika shqiptare* e përshkruan stemën e familjes Maruli sipas Corienich-Neorich.<sup>14</sup>

Përfaqësuesi më i denjë i kësaj familjeje fisnike është humanisti Mikel Maruli (Tarkaniota, mbiemri i nënës së tij), i cili jetoi e krijoi në gjysmën e dytë të shek. XV. Për origjinën dhë atdheun e Mikelit, një nga studiuesit italianë të fillimit të shek. XX, G. Bottigliioni<sup>15</sup>, shkruan se dimë vetëm atë çka mund të zbulojmë nga poezitë e tij. I ati, Manila Maruli, i lindur në Dima të Akaias (More) në një familje fisnikësh e luftëtarësh stratiotë, pasi iku nga vendlindja, u vendos për një kohë të gjatë në Kostandinopojë. Kjo është arsyeja që ndonjë kritik e quan poet kostantinopojas, që derdh lot për fatkeqësitë e atdheut të vet.<sup>16</sup> I lindur në vitin 1440, sipas Bottigliioni-t, Mikel Maruli, pas rënies së Kostandinopojës më 1453, fillimisht është u vendos në Raguzë të Dalmacisë e më pas, si pasojë e presionit të osmanëve në Ballkan, kaloi matanë Adriatikut në Ankona të Italisë. Në Venedik mësoi letërsinë antike greko-latine, ndërsa në Universitetin e Padovës filozofinë. Që në moshë të re, kur ishte 17 vjeç, shërbeu si stratiot në Itali e Ballkan në luftërat kundër turqve osmanë, me të vetmin qëllim çlirimim e popujve të Ballkanit nga pushtuesit e huaj. Formimi dhe kultura që mori në universitetet italiane e ndihmuan Mikelin që të ketë shumë miq e shokë, mes të cilëve gëzonte një autoritet të padiskutueshëm. Në Kalabri u takua me Francesco Scala-n, që më pas u bë miku i tij më i ngushtë. Më vonë Mikelin e

gjejmë në Urbino, nga duhet të jetë larguar më 1472. Në Napoli, në oborrin e Aragonasve, ai depërtoi në rrethin e poetëve e humanistëve të njohur italianë, si: Sannazzaro, Acquaviva etj. Sekretari i shquar i Aragonasve, Antonello Petrucci, e ndihmoi Mikelin të formohej si artist e të zgjidhej anëtar nderi i Akademisë së Napolit. Në Firence ai shkroi veprat që e bënë të shquar si poet, filozof e pedagog, si një nga përfaqësuesit më në zë të humanizmit. Pikërisht në Firence Mikel Maruli u njoh e më pas u martua me vajzën e Bartholomeo Scala-s, poeten Alessandra Scala, Nera-n, siç e quan ai në poezitë e tij. Vitet më të bukura të jetës, që kaloi me Nerën, u ndërpre në një fatkeqësi e tmerrshme. Në vitin 1500, kur po kalonte lumin Çeçina të Toskanës, bie nga kali dhe mbytet. Pas 6 vjetësh vdiq e hidhëruar edhe Nera, së cilës poeti Maruli i kishte kënduar me aq pasion e dashuri në vargjet e tij. Jeta e tij u këput në vitet kur kishte arritur kulmin në fushën krijuese. Mikel Maruli la pas 200 vepra poetike me tematikë të ndryshme, ku mbizotërojnë epigramet dhe elegjitë në distik, por nuk mungojnë edhe format safike. Këto dhe studimet e shumta, të cilat janë ribotuar deri në ditët tona, bënë që poeti me origjinë shqiptare të zinte vendin e merituar në rrymën e humanizmit pagan. Veprat e Mikel Marulit janë të gjitha në poezi, me përjashtim të një komentit kritik mbi veprën e Lucretius-it *De rerum natura*. Poezitë e tij trajtojnë temën e dashurisë dhe të mallit për atdheun e familjen. Krijimet me temën e dashurisë, kushtuar Nerës, janë nga më të ndierat. Poezitë për atdheun

janë ndër të parat e shkruara prej Mikelit, pikërisht në kohën kur ai mori pjesë në fushatat ushtarake kundër pushtuesve osmanë. Krahas dhimbjes që ndien për atdheun e pushtuar përtej brigjeve të Adriatikut, në to poeti shpreh edhe urrejtjen ndaj pushtuesit osman si dhe gatishmërinë për të dhënë edhe jetën për lirinë e tij. Maruli ishte poet me frymëzim, kritik i mprehtë dhe vëzhgues i hollë i realitetit. Scaliero, një nga kritikët e kohës, jep këtë gjykim për Mikel Marulin *Rapidum quidem ingenium Marulli fuit, et to-*

*rrens, sed quod versibus nunc bonis, nunc malis ex tempore effutiendis potius, quam bonis auctoribus emendandis natum videtur [I mprehtë, me karakter të vrullshëm e shpërthyes, i talentuar për të krijuar poezi të bukura...].<sup>17</sup>*

Së bashku me Gjon Gazullin, Leonik Tomeon, Dhimitër Frangun, Marin Beçikemin, Marin Barletin e ndonjë tjetër Mikel Maruli dha kontributin e tij në lëvizjen që shënoi fillimet e historiografisë shqiptare në gjuhën latine.

---

1. Du Cange, Carolus du Fresne. *Historia Byzantina...Lutetiae Parisiorum*, 1680, f. 351; *Illyricum vetus et novum sive historia regnorum Dalmatiae, Croatiae, Slavoniae, Bosniae atque Bulgariae. Poonii*, 1746, f. 139-140.

2. F. Galvani. *I re d'armi di Sebenico*. Venezia, 1884, v. 1, f. 197.

3. Lenormant, Ch. *Turcs e Monténégrins*. Paris, 1866, f. 36-37.

4. Drançolli, Jahja. *Muzikantët shqiptarë në Raguzë gjatë shekujve XIV-XV*. Në: *Fjala, Prishtinë.-Mars*, 1985, f. 10, 15

5. Drançolli, Jahja. *Po aty*.

6. Du Cange, Carolus du Fresne. *Po aty*, f. 351; *Po aty*, f. 139.

7. Du Cange. *Po aty*.

8. Hopff, Karl. *Chroniques gréco-romanes*. Barlin, 1873, f. 535; *Jakova-Mërturi, Gaspër. Genealogie dei principi albanesi*. Roma, 1904, f. 4.

9. Galvani, F. A. *Il re d'armi di Sebenico*. Venezia, 1884, v.1, f. 197-198; v.2, tab. XIII.

10. Du Cange, Carolus du Fresne. *Po aty*, f. 351-352; f. 140.

11. Sathas, Konstantinos. *Documents inédits relatifs à l'histoire de la Grèce au moyen âge*. Paris, 1890, f. 156.

12. Du Cange, Carolus du Fresne. *Po aty*, 351-352; f. 140.

13. Galvani, F. A. *Po aty*, v. 2, f. 107, tab. XXV.

14. Varfi, Gjin. *Heraldika shqiptare*. Tiranë, 2000, f. 94, 116.

15. Bottiglioni, G. *La lirica latina in Firenze nella 2ª metà del secolo XV*. Pisa, 1930, f. 121-123.

16. Cian, V. Michele Marullo e Dante. Në: *Raccolta di studii critici*. Firenze, 1911, f. 42.

17. Sipas Bottiglioni, G. *Po aty*, f. 134.

## THE SPANI, BOKALI AND THE MARULI IN THE CONTEXT OF THE ALBANOLOGICAL PUBLICATIONS

*In the works of Du Cange, Lenormant, Galvani, Hopff, Sathas, Bottiglioni etc., that you may find in the Albanological collection of the National Library, the above mentioned authors claim that in XIV-XV century, when Albania was occupied by the Turkish Ottomans, many noble Albanian families fled toward Ragusa, Venetia, Peloponesus and Constantinoples. Among them we can mention the Spani, Maruli, and Bokali. Their offsprings assisted in the economical, social and cultural development of the respective countries. For the Spani family and their offsprings, the musician Pjetër Spani, the doctors Gjergj and Pjetër Spani, his nephew, relevant information is given in the book Biblioteca Ragusina, in qua Ragusini scriptores eorumque gesta et scripta recensentur, which might be find as a manuscript at the Library of the Domenican Monastery in Dubrovnik.*


*Mikel Baruli, one of the well known humanists in Italy, left an opus of 200 books of poetry with various topics, such as love, compassion and nostalgia for homeland and family.*



# BIBLIOTEKA

REVISTË E SHOATËS SË BIBLIOTEKARËVE TË KOSOVËS

2



2005

---

■ Antonio BALDACCI (1867-1950)	51
■ Marcin BIELSKI (1495-1575)	51
■ Jacques BOURCART (1891-1965)	52
■ Vincenzo CORONELLI (1650-1718)	33
■ Jacob Philipp FALLMERAYER (1790-1861)	55
■ Margaret HASLUCK (1885-1948)	56
■ Nicolae IORGA (1871-1940)	57
■ Theodor IPPEN (1861-1935)	58
■ William Martin LEAKE (1777-1860)	59
■ Gustav MEYER (1850-1900)	60
■ François POUQUEVILLE (1770-1838)	61
■ Mario ROQUES (1875-1961)	61
■ Gustav WEIGAND (1860-1930)	62

---





**Antonio BALDACCI  
(1867-1950)**

Botanisti italian Antonio Baldacci, në fund të shekullit XIX dhe në vitet e para të shekullit XX, disa herë vizitoi Gadishullin e Ballkanit për eksplorime në fushën e shkencave natyrore. Kujdesi kryesor i tij ishte botanika, ndaj edhe më të shumtën e kohës dhe të fuqive ia kushtoi shqyrtimeve floreale dhe veçorive të gjeografisë bimore të Shqipërisë dhe Malit të Zi, Greqisë deri në Kretë. Vetëm në Shqipëri, që prej vitit 1888, kur hyri për herë të parë, mbledhi 100 mijë ekzemplarë bimësh.

Duke pasur edhe interesa më të gjëra shkroi një varg studimesh e artikujsh mbi gjendjen ekonomike, politike, etnografike për rajonet që vizitoi. Dha përmes publikimeve të tij, që zenë një bibliografi të pasur, të dhëna dhe përfundime të rëndësishme për Shqipërinë dhe

shqiptarët në fushat e gjeografisë rajonale, toponomastikës, antropologjisë, historisë, arkeologjisë, agronomisë etj. Vëllimet *Itinerari albanesi* : (1892 -1902) : con uno sguardo generale all'Albania e alle sue comunicazioni stradali. [Rrugëtime shqiptare : (1892-1902) : me një shqyrtim të përgjithshëm mbi Shqipërinë dhe rrugët e saj të komunikacionit], Romë, 1917, *Albania*, Romë, 1929 (vepër gjeografike, por edhe politike, që pasoi, e plotësuar, pararendësen e saj të vitit 1926), *Studi speciali albanesi* me tre seritë: histori e politikë (1932), ekonomi, mineralogji, pylltari, agronomi, zooteknia (1933) dhe seria shkencore (1937), që përbëjnë një korpus prej 1463 faqesh si dhe shumë artikuj në shtypin shkencor botanik, gjeografik etj., mbeten një burim i çmuar për të gjithë studiuesit e shkencave albanologjike.

U nderua me shumë çmime akademike në disa vende të Europës. Shteti shqiptar e emëroi konsull-nderi në Bolonjë, qytetin e tij të lindjes.



**Marcin BIELSKI  
(1495-1575)**



I pari autor polak që u mbështet te Barleti për hartimin e një vepre tjetër për Skënderbeun është Marcin Bielski ose Wolski. Lindi në Biala të provincës Sieradz. Mori pjesë në luftërat kundër tatarëve dhe volakëve. Vdiq në vendlindje më 1575.

Në letërsinë polake njihet si poet, kronist e përkthyes. Për pikëpamjet reformiste bashkëkohësit e quajtën Luter të dytë. Vepra e tij e parë titullohet *Zywoty filozofow* (Jeta e filozofëve) (1535), e cila konsiderohet adaptim i "De Vita et Moribus Philosophorum" e Gwalter Burlejt. *Komedia Justina y Konstanciej* (Komedia e Justinit dhe Konstancës) (1557) është një nga të parat e këtij lloji në letërsinë polake.

Vepra historike *Kronika wszytkiego œwiata na szeœœ wieków...* (Kronika e mbarë botës) (1551) është e para kronikë e letrave polake. Sa qe gjallë e botoi edhe më 1554 dhe 1564 në Krakov. Në botimin e tretë, mes faqeve 241-258, shtoi *O Skanderbegu macedonie albañskim ksi' jœciu* (Historia e Skënderbeut) (1564). Kjo kronikë, më e gjata në veprën e Bielskit, u botua më vete në Varshavë më 1961. Autori është mbështetur në veprat e Volaterrano-s, Piccolomin-it, Iovio-s si dhe në kronikat hungareze etj., çka na bën të shohim tek autori një kronikan të njimentë. Mbështetja në veprën e Barletit është e dukshme. Vepra e Bielskit, e cila së bashku me atë të Barletit rrezatoi në Europën lindore për shkak se me disa fakte e pikëpamje ra ndesh me Kishën Katolike, u fut në listën e veprave të ndaluara. Censura e kohës u shpreh për të: "Latet anguis in herba"

("Në bar fshihet gjarpri"). Vepra e Bielskit mbetet dëshmi e popullaritetit të Skënderbeut në Europë edhe një shekull pas vdekjes së tij.



**Jacques BOURCART**  
(1891-1965)

Jacques Bourcart (Zhak Burkar), titullar i Katedrës së Gjeologjisë në Universitetin e Sorbonës (Paris), anëtar i Akademisë së Shkencave dhe president i Shoqatës Gjeologjike të Francës, në vitet e para të veprimtarisë së tij shkencore pati për objekt kryesisht Shqipërinë.

E sollën në vendin tonë rrethanat e Luftës I Botërore kur, si pjesëtar i Armatës franceze të Lindjes, më 1917 u vendos në Korçë, ku më pas qëndroi në përbërje të administratës ushtarake franceze në zonën juglindore. Autor i mbi 300 artikujve dhe librave shkencorë, rreth 40 prej tyre ia kushtoi Shqipërisë. Siç

shprehej edhe vetë “për historianin, etnografin ose sociologun, Shqipëria është një vend i banuar nga njëri prej popujve më të vjetër të Europës, i cili si për mrekulli, i ka ruajtur gjuhën dhe doket e tij, që janë njëkohëse me lashtësinë greke”. Njihet si një ndër themeluesit e gjeologjisë alpine të Shqipërisë; njëkohësisht hodhi bazat e gjeografisë fizike të Shqipërisë Juglindore.

Një tablo tejet interesante, sa njohëse, aq edhe shkencore mbi Shqipërinë, gjejmë në veprën e parë mbi Shqipërinë *L'Albanie et les Albanais* (Paris, 1921) [Shqipëria dhe shqiptarët], ku nënvizoi unitetin etnik, antropologjik e gjuhësor të shqiptarëve. Ndërsa, siç e klasifikojnë edhe studiuesit e gjeologjisë, vepër klasike mbi gjeologjinë dhe gjeografinë e Shqipërisë së Mesme dhe Jugore mbetet *Les confins albanais administrés par la France (1916-1920) : contribution à la géographie et à la géologie de l' Albanie Moyenne* (Paris, 1922) [Trevat shqiptare të administruara nga Franca]. Ndërkohë, në shtypin shkencor francez, publikoi artikuj e studime pjesorë mbi aspekte të veçanta të gjeologjisë së Shqipërisë si: stratigrafia, tektonika, ndër to: *Une hypothèse sur la formation de l'Adriatique* (1924), *Gisements pliocènes du Lac de Scutari (Albanie)* (1926) etj., me vlera të qëndrueshme shkencore.



### Vincenzo CORONELLI (1650-1718)

V. M. Coronelli është hartografi më i njohur italian i shekullit XVII. U doktorua në teologji, por ndonëse i angazhuar me ushtrimin e detyrimeve të përditshme të klerikut, pasioni për përpilimin e hartave dhe të globeve gjeografikë ishte angazhimi kryesor i tij.

Mes viteve 1681-1683 punoi në Paris për përgatitjen e globeve gjeografikë, mes tyre ai me diametër prej 3.85 m., kushtuar Luigjit XIV (që prej vitit 2005 ato gjenden në Bibliotekën Kombëtare të Francës). Mbasi u kthye në Venedik u emërua kozmograf zyrtar i Republikës dhe në vitin 1684 themeloi Akademinë Kozmografike të Argonautëve. Veprat e tij kryesore janë: *Morea, Negroponie & Adiacenze*, 1686; *Isolario dell'Atlante Veneto*, 1696; *Ritratti de celebri Personaggi*, 1697; *Lo Specchio del Mare*, 1698; *Atlante Veneto*, 1691-1696; *Roma antico-*

*moderna*, 1716; *Singularita di Venezia* (1708-1710).

Coronelli është i njohur në përgatitjen e hartave regionale. Hartat e tij, në të cilat pasqyrohen edhe trojet shqiptare, veçanërisht ato të Veriut, janë tipike për periudhën kur u përpiluan, të pajisura me piktura e vizatime dekorative në pjesët marginale, dhe janë botuar në veprën 12-vëllimshe *Atlante Veneto*.... Elementet gjeografike që përmbajnë hartat e Coronelli-t paraqiten me ngjyra të ndryshme, disa prej të cilave përdoren edhe në përmbajtjen e hartave të sotme. Autori ka shfrytëzuar të dhënat e nxjerra nga ekspeditat personale si edhe ato të gjeografëve dhe hartografëve paraardhës. Në harta ka edhe shumë shënime historike, topografike etj. për objekte sociale e kulti dhe elemente të tjerë me rëndësi për formimin e një tabloje të përafërt për objektet e kohës. Në harta të këtij botimi pasqyrohet bregdeti verior i Shqipërisë, për t'u ulur më në jug me Sazanin dhe Pargën. Edhe Kosova me shtrirjen e saj territoriale dhe të dhënat topografike, gjeografike e historike është e pranishme në hartat e Coronelli-t. Në hartën e parë për Kosovën të titulluar *Corso del Danubio da Vienna sino a Nikopoli, paesi adiacenti* e përmasave të mëdha, ajo identifikohet me emrin Iliricum. Harta përafrohet me vitin 1688 dhe ndodhet në atlasin e sipërpërmendur. Kjo hartë paraqet përpjekjen më të hershme të autorit në hartografimin e brendësisë së Europës Juglindore. Më pas Coronelli hartoi një hartë të së njëjtës shtrirje me një konceptim më real.



Në fondin e botimeve albanologjike vepra të Coronelli-t janë edhe *Memorie istoriogeografiche della Morea riacquistata dall'armi della Venete, del Regno di Negroponte e degli altri luoghi circonvicini, e di quelli c'hanno sottomesso nella Dalmazia, e nell'Epiro*... [Kujtime historike për Mbretërinë e Moresë të pushtuar nga ushtritë venedikase, për Mbretërinë e Negropontit dhe për vende të tjera...] (Venedik, 1687), botuar po atë vit edhe në gjermanisht dhe ribotuar me disa ndryshime një vit më pas, si dhe *Città, Fortezze, ed altri Luoghi principali Dell'Albania, Epiro, e Livadian, E particolarmente i posseduti da Venti (S.l.,s.a.)*, ku në hartën gjeografike "Goldo di Venezia", përfshihet Shqipëria e Veriut. Në vëllim gjejmë një përshkrim historiko-gjeografik të Korfuzit dhe bregdetit të Epirit, të qyteteve të Prevezës dhe Gumenicës si edhe të kryepeshkopatës së Tivarit gjatë luftërave turko-venedikase.





*J. P. Fallmerayer*

**Jacob Philipp  
FALLMERAYER  
(1790-1861)**

Kur trajton veprën e Fallmerayer-it, Eqrem Çabej thekson: “Në veprat e Fallmerayerit gjenden të bashkuara ngushtë njohuritë e thella me një talent të dalluar prej shkrimtari; ato shquhen për një sintezë të madhe historike”.

Jacob Philipp Fallmerayer (10 dhjetor 1790-26 prill 1861), fillimisht studioi teologjinë dhe filozofinë në Universitetin e Salzburgut, por shpejt prirjet e tij e drejtuan drejt historisë dhe gjuhëve semitike. Megjithatë, jeta dhe interesat e tij profesionale dhe shkencore u luhatën edhe mes karrierës ushtarake e arsimore. Më 1822 filloi të merrej me historinë e Trapezundës, duke e kurorëzuar me veprën e parë *Geschichte des Kaiserthums Trapezunt* (Munich, 1827, ribot. 1848, 1990) [Histori e Perandorisë së Trapezundës]. Kjo veper edhe sot mbetet

si bazë për historinë e mbretërimit të Komnenëve. Tezën e shtruar që në këtë veper se “kombi i famshëm i helenëve është zhdukur nga radhët e popujve dhe është zhytur në errësirë...” e zhvilloi më tej në veprën *Geschichte der Halbinsel Morea im Mittelalter* 2 vol. (Stuttgart, 1830-1836, ribot. 1965) [Historia e gadishullit të Moresë gjatë mesjetës]. Këtu hedh idenë se grekët e sotëm janë një popullsi e përzier sllavësh, me element të dytë shqiptarët. Gjatë qëndrimit disavjeçar në Greqi, Fallmerayer-i bindet për vërtetësinë e tezave të tij, veçanërisht për karakterin shqiptar të popullsisë së krahinave të gjera të Beotisë dhe Atikës. Në vëllimin e dytë (1836) thekson se revolucion i grek për pavarësi 1828-29 ishte “një revolucion krejtësisht shqiptar”. Pas një veprimtarie gazetareske në vitet 1839-40 në Greqi, Stamboll etj. botoi të famshmet “Fragmente”, *Fragmente aus dem Orient* (Stuttgart, 1845). Mes viteve 1857-61 botoi veprën e tij më të rëndësishme për shqiptarët e, veçanërisht të Greqisë, *Das albanesische Element in Griechenland*, (iii. parts). Studiuuesi Justin Rrota, duke folur për këtë veper shprehet: “... qet në shesh elementin shqiptar e sllav në Greqi. Auktori në këtë veper i ban një kritikë t’ashpër botimit të Nicocles *Peri tes autothonias ton Albanon etoi skipitar. Pragmateia istorikofilologike* (Gottingen, 1855) [Mbi autoktoninë e albanëve, d.m.th. shqiptarëve. Prejardhja dhe fisi], duke mbrojtur autoktonin e Shqiptarëve”. Në veprën me tre pjesë Fallmerayer-i merret më shumë me etnogjenezën e shqiptarëve dhe historinë e tyre deri në fillimin e periudhës nën sundimin osman. Kjo veper është botuar më 2003 edhe në shqip.



**Margaret HASLUCK**  
(1885-1948)

Skocezja Margaret Masson Hardie Hasluck, folkloriste, gjeografe, lingviste, epigrafiste dhe arkeologe, studioi në Akademinë e Elginit dhe Universitetin e Aberdinit. Për të kompletuar studimet klasike punoi në Universitetin e Kembri-xhit gjatë viteve 1907 - 1911.

Pas përfundimit të studimeve u emërua në Shkollën Britanike në Athinë, ku u martua me studiuesin Frederick W. Hasluck më 1912. Vijuan të punonin në Athinë deri në vitin 1916. Pas vdekjes së bashkëshortit më 1920 ajo u kthye në Angli. Më pas udhëtoi shumë dhe qëndroi edhe në Shqipëri për trembëdhjetë vjet me radhë, deri më 1939, veçanërisht në zonat malore të Veriut, ku jetoi me vendasit dhe u lidh ngushtë me ta.

Ka një bibliografi të pasur të punimeve shkencore; ndër to : *Christian Survivals among Certain Moslem Subjects of*

*Greece, 1924; The Nonconformist Moslems of Albania, 1925; An Unknown Turkish Shrine in Western Macedonia, 1929; Measurements of Macedonian Men, 1929; Këndime Anglisht-Shqip or Albanian-English Reader: Sixteen Albanian Folk-Stories Collected and Translated, with Two Grammars and Vocabularies, Cambridge, 1932, me përralla popullore shqiptare të treguara drejtpërdrejt nga fëmijë elbasanas; Physiological Paternity and Belated Birth in Albania, 1932; Bride-Price in Albania: A Homeric Parallel, 1933; artikullin e gjatë *The Gypsies of Albania, 1938* mbi mënyrën e jetesës dhe zakonet e romëve në Shqipëri. Vepra e saj qendrore *The unwritten law in Albania* (Ligji i pashkruar në Shqipëri), rezultat i kërkimeve të gjata dhe serioze, u përfundua nga të tjerë studiues më 1954, gjashtë vjet pas vdekjes së autores. Mbetet ky një nga punimet më të rëndësishëm mbi të drejtën zakonore të shqiptarëve, vepër së cilës i referohen, pa përjashtim të gjithë studiuesit e kësaj fushe brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ky libër sivjet u botua edhe në shqip. Margaret Hasluck ka meritën të kujdeset për redaktimin dhe botimin e veprave të rëndësishme të bashkëshortit të saj *Athos and its Monasteries, 1924; Letters on Religion and Folklore, 1926* dhe *Christianity and Islam under the Sultans, 1929*, studime me mjaft rëndësi për etnologjinë dhe jetën shpirtërore e religjioze të shqiptarëve.*



## Nicolae IORGA (1871-1940)

Nicola Iorga ishte njëherësh personalitet i letrave dhe veprimtar politik e shtetar, deri kryeministër. Lindi në Botoshan të Moldavisë Veriore më 5 qershor 1871. Mbasi kreu studimet e larta në Paris u doktorua pranë Universitetit të Lajpcigut. Më 1894 emërohet profesor në Universitetin e Bukureshtit. Njëherazi zhvilloi veprimtari të dendur letrare, artistike, arkivistike e, mbi të gjitha, historiografike. Thujse nuk mbeti degë e letërsisë dhe historisë pa u lëvruar nga Iorga. Është autor i mbi 40 dramave me tematikë nga historia e Rumanisë, vëllimeve me përshlytje udhëtimi, kritika letrare etj. Në bibliografinë kolosale të Iorgës numërohen mbi 1000 vepra, 12755 artikuj, 4963 raporte etj. Vend të merituar zënë vëllimet për historinë e Rumanisë që nga lashtësia, historia e letërsisë dhe arteve e të tjera

vepra ku ndërthuren edhe pjesë të historisë së popujve ballkanikë dhe shqiptarëve. Por gjeografia e studimeve të Iorgës është shumë më e gjerë. Prej disa vëllimesh është vepra e tij mbi historinë e kryqëzatave europiane: *Notes et extraits pour servir l'histoire des croisades au XV<sup>e</sup> siècle* (Bukuresht, 1915-16), e radhitur mes veprave të tjera mbi historinë e Bizantit, Venedikut, Europës mesjetare, Perandorisë Osmane, popullit francez, madje edhe një historie botërore prej katër vëllimesh.

Shqipërisë i kushtoi disa punime si: *Breve histoire de l'Albanie et du peuple albanais* [Histori e shkurtër e Shqipërisë dhe e popullit shqiptar] (Bukuresht, 1919), botuar shqip më 2004, *Lettres de Dora d'Istria* botuar në *Revue historique du Sud-est Europeen* (1932), ku publikon letrat e studiueses shqiptare drejtuar një shkrimtari hungarez, drejtor i një reviste letrare, letra të viteve 1877-1887 në të cilat spikasim shqetësimet e rilindasve shqiptarë. Dokumenti më i vjetër i shqipes së shkruar që njihet deri më sot, *Formula e Pagëzimit*, e shkruar nga Pal Engjëlli më 8 nëntor 1462, zbulimin e tij ia dedikon Iorgës. E gjeti atë brenda një koleksioni në Bibliotekën Laurentiana të Firences dhe e botoi në vëllimin e katërt të librit mbi kryqëzatat (1915). Trashëgimia iliro-shqiptare në kulturën europiane, luftërat e shqiptarëve kundër pushtuesve osmanë janë disa nga objektet e veprimtarisë studimore të Iorgës.

Më 27 nëntor 1940 u vra mizorisht nga pjesëtarët e organizatës fashiste rumune të "rojeve të hekurta".





**Theodor IPPEN**  
(1861-1935)

Ippen lindi më 29 nëntor 1861 në Sezemice të Bohemisë. Ndoqi studimet universitare për orientalistikë në Akademinë e Vjenës

Qëndrimi i parë i Ipenit në Ballkan ishte Shkodra, qyteti në të cilin gjatë vitit 1884 kreu funksionin e konsullit. Në vitin 1897 emërohet Konsull i përgjithshëm i perandorisë dualiste në Shkodër, funksion të cilin e kreu deri më 1904. Qëndrimin në Shqipëri e shfrytëzoi edhe për të kryer studime mbi vendin dhe popullin. Udhëtoi në zonat kufitare me Malin e Zi, te fiset malore të Kastratit, Hotit, Grudës, Kelmendit dhe Shkrelit. Më 1897 bëri një udhëtim në Shqipërinë e Mesme, në Tiranë dhe Elbasan. Vlera e Ipenit rreth çështjes shqiptare qëndron në faktin që ai ishte përkrahës i saj. Qe ndër hartuesit e memorandumit mbi formimin e një Shqipërie të pavarur. Skica e hartuar prej tij për këtë çështje u përfshi në propozimin e Austrisë

dhe Italisë. Për nivelin e lartë të trajtimit ajo u quajt *një kryevepër e eminentit dijetar të Shqipërisë*. Përpjekjet e këtij politikani mbi Shqipërinë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-1913) zënë vend në historinë shqiptare.

Ippen-i gjatë kohës së ushtrimit të aktivitetit si kryekonsull u mor dhe me historinë dhe letërsinë tonë kombëtare, u dha pas kërkimeve arkeologjike pranë rrënojave të kishave, manastireve, kuvendeve të hershme, por gjithashtu merrej edhe me studimin e etnografisë së popullit tonë. *Alte Kirchen und Kirchenruinen in Albanien*=Kisha të vjetra dhe rrënoja kishash në Shqipëri (1900, 1902) dhe *Përkujtimi mbi shkallën e vjetërsisë së Shqipërisë* janë artikuj të shkruar në vazhden e këtyre hulumtimeve. Në vitin 1916 u botua artikulli *Krahina e Shpatit në Shqipërinë e Mesme*; *Beiträge zur innere Geschichte Albaniens im 19. Jahrhundert* (Kontribute për historinë e brendshme të Shqipërisë në shekullin XIX) (studim 40-faqesh botuar në *Illyrisch-Albanische Forschungen*, Bd. 1, München dhe Leipzig, 1916). Si botimet më me rëndësi të Ippen-it njihen: *Novibazar und Kosowo. Das alte Rascien*. (Novipazari dhe Kosova. Rasha e vjetër) (Vjenë, 1892), me përshtypje mbi gjeografinë, etnografinë apo politikën në formën e skicave; *Scutari und die nordalbanische Küstenebene* (Shkodra dhe ultësira bregdetare e Shqipërisë së Veriut) (Sarajevë, 1907); *Die Gebirge des Nordwestlichen Albaniens* (Malësia e Shqipërisë Veriperëndimore) (Vjenë, 1908).

Në studimet e tij mbi etnologjinë shqiptare, jep të dhëna interesante mbi format e vendbanimeve, llojet e banesave

shqiptare, doket, zakonet, mbi të drejtën zakonore dhe besimet fetare të popullit shqiptar, gjeografinë, arkeologjinë, ekonominë etj. Botimi *Shqipëria e Vjetër*: studime gjeografike, etnografike, historike (Tiranë, 2002) përmbledh katër nga studimet e mësipërme.



### William Martin LEAKE (1777-1860)

William Martin Leake, historian, numizmat e antikuarist, gjuhëtar e topograf, përfaqësues politik i Anglisë pranë oborrit të Ali pashë Tepelenës, ishte ndër udhëtarët e parë anglezë që vizitoi dhe la punime për Shqipërinë. Përshkoi të gjitha viset shqiptare që nga Preveza, Arta, Janina, Çamëria, Filati, Delvina, Gjirokastra, Tepelena, Vlora etj. Këto udhëtime ishin në vijim të atyre që kish bërë vite më parë në Inditë Perëndimore, Egjipt, Azinë e Vogël, Greqi etj. për të cilat la librat *Topography of Athens* [Topografia e Athinës] (1821); *Journal of a Tour in Asia Minor* [Ditar rreth një

udhëtimi në Azinë e Vogël] (1824); *Travels in the Morea* (1830) and a supplement, *Peloponnesiaca* [Udhëtim në More, me një suplement për Peloponezin] (1846); *Numismata Hellenica* [Numizmatika greke] (1854), pasuar nga një suplement më 1859.

Në veprën *Travels in Northern Greece* [Udhëtim në Greqinë e Veriut] (1835), në 4 vëllime, si studiues i vëmendshëm jep informacion të bollshëm e të hollësishëm për shumë dukuri me spektër të gjerë tematik. *Researches in Greece* (1814) [Kërkime në Greqi], me shumë njoftimeve me karakter edhe ekonomik, politik, topografik etj., mbetet një vepër e mirëfilltë gjuhësore me studime për greqishten e shqipen dhe për vëzhgimet historike për vllahishten dhe bullgarishten. Veç tjerash, në këtë vepër botoi një "Gramatikë të gjuhës shqipe", në të vërtetë një "Skicë gramatikore", siç e quan edhe vetë, me shënime për shqipen, një "Fjalor greqisht- anglisht-shqip" si edhe ribotoi "Fjalorin e Dhanil Haxhiut" në greqisht-arumanisht-bullgarisht-shqip, duke i shtuar edhe anglishten. Në historinë e studimit të shqipes është i pari albanolog që shprehu mendime me vlerë për huazimet greke, latine, gote, sllave, frënge, italiane dhe turke të gjuhës shqipe. Duke karakterizuar veprën gjuhësore të Likut, albanologia ruse Agnia Desnickaja thekson: "Vepra e William Martin Leake-ut mund të konsiderohet si një sprovë interesante e një studimi të plotë të gjuhëve të Gadishullit Ballkanik, si një hap i parë për krijimin e ballkanistikës".



**Gustav MEYER<sup>1</sup>**  
**(1850-1900)**

Për shumicën e botimeve, zell e mund reth shqipes, emri i albanologut gjerman Gustav Meyer është i lidhur ngushtë me gjuhën tonë. Meyer-i, së bashku me Pedersen-in dhe Jokl-in formojnë triadën albanologjike. U lind në Gross-Strehlitz (Austri) dhe vdiq në një spital psikiatrik afër qytetit të Gracit. Veprimtarinë e mirëfilltë shkencore e nisi me kërkimet mbi gjuhësinë klasike greko-latine, më pas me greqishten mesjetare përmes *Neugriechische Studien* (Vjenë, 1894-95). Por emri i tij do të mbetet i pavdekshëm me studimet mbi shqipen. Më 1881 botoi artikullin e parë mbi gjuhën tonë *Albanesisches* ("Allgemeine Zeitung"); më pas *Über Sprache und Literatur der Albanesen* [Mbi gjuhën dhe letërsinë e shqiptarëve] fryt i kërkimeve në arbëreshët e Greqisë dhe Italisë, botuar

fillimisht në shtypin gjerman (1883) dhe më të plotë në revistën "La Nuova antologia" (1885). Shqipen si fazë moderne të një dialekti të ilirishtes, si pjesë të gjuhëve indoeuropiane e trajtoi gjerësisht në studimin *Die Stellung der Alb. Im Kreise, der Indoger. Sprachen* ("Beiträge zur Kunde d. Indog. Sp. VIII, 1884). Por vepra më madhore e Meyer-it mbetet *Albanesische Studien* [Studime shqiptare] në 6 vëllime (Vjenë, 1883-1897), ku trajtohen: emri në gjuhën shqipe, numërorët, fonetika e elementeve indoeuropiane të shqipes, fjalori greqisht-rumanisht-shqip i Kavalitit, dialektet e arbëreshëve të Greqisë dhe më tej dialektet e ndryshme të shqipes. Me mjaft rëndësi për shkencat albanologjike është "Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe" (*Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache* (Strasburg, 1891). Mbetet i rëndësishëm ky fjalor, pavarësisht se janë shfrytëzuar visaret gjuhësore paraardhëse të Hahn-it dhe Miklosiç-it, duke shfrytëzuar pasuri të ishujve gjuhësorë dhe më pak fjalorin e pasur të shkrintarëve tanë të vjetër. Meyer mbetet një ndër gjuhëtarët nismëtarë për studimin e huazimeve të gjuhës shqipe, pavarësisht se disa përfundime të tij u tejkaluan, madje u përmbysën. Trashëgimia shkencore e Gustav Meyer-it vazhdon prej mjaft dekadash të mbetet në qendër të vëmendjes së studiuesve shqiptarë dhe të huaj, ajo është bërë objekt i disa veprimtarive dhe botimeve shkencore në Shqipëri, Kosovë e më tej.

<sup>1</sup> Përgatitur sipas shënimeve albanologjike të gjuhëtarit Justin Rrota





### **François POUQUEVILLE (1770-1838)**

Konsull i Francës në oborrin e Ali pashë Tepelenës në Janinë. Personalitet i njohur shkencor dhe me një veprimtari të gjerë politike e diplomatike, me kontribut në fushën e mjekësisë dhe shkencave natyrore, historisë dhe arkeologjisë, nuk kishte si të mos reflektonte edhe mbi vitet kur jetoi, kërkoi e punoi në viset shqiptare e më tej. E para vepër ku zë vend Shqipëria dhe shqiptarët, ajo e titulluar *Voyage en Morée, à Constantinople, en Albanie, et dans plusieurs autres parties de l'Empire Othoman, pendant les années 1798, 1799, 1800 et 1801* [në tre vëllime], u botua më 1805 në Paris, po atë vit në gjermanisht edhe në Leipzig. Anglisht në Londër u botua një vit më pas, ndërsa italisht në Milano më 1816.

Në veprat *Voyage dans la Grèce* (Paris, 1820) [Udhëtim në Greqi] dhe *Histoire de la régénération de la Grèce* (Paris, 1824) [Historia e rigjallërimit të Greqisë], që njohën disa ribotime në gjuhët

kryesore të Europës, që në vitin e parë të publikimit, ndonëse edhe me ndonjë konkluzion të diskutueshëm, sjellin të dhëna e përshkrime me shumë rëndësi për vendbanimet shqiptare dhe shtrirjen e tyre në Greqinë e sotme, jetën dhe zhvillimet historike, politike, ekonomike e shpirtërore, rolin e shqiptarëve në marrëdhënie me fqinjët etj., të cilat edhe sot kanë vlera historiko-dokumentare. Megjithëse pati mjaft kontradikta politike me Ali pashë Tepelenën, në veprat e tij provoi përpjekjet e vezirit të Janinës për shkëputje nga Perandoria Osmane.



### **Mario ROQUES (1875-1961)**

Studimi i teksteve të vjetra shqipe gjeti te Mario Roques një gjurmues të mirënjohur. Linguisti Roques ishte profesor në Shkollën e Gjuhëve të Gjalla Orientale në Universitetin e Parisit, ku për shumë vite dha mësimin e shqipes. Për gjysmë shekulli drejtoi revistën shkencore franceze "Romania".

Më 1926 në këtë organ botoi artikullin me titull *Le plus ancien document de langue albanaise* [Dokumenti më i vjetër i gjuhës shqipe], ku përshkruan *Formulën e Pagëzimit*. Po në këtë organ, disa muaj më vonë i rikthehet këtij dokumenti me artikulli *Sur le plus ancien document de la langue albanaise*, ku tashmë del mbi caqet e përshkrimit. Një vit më pas Roques parashtron iniciativën për botimin e teksteve të vjetra të shqipes së shkruar. Vetëm mbas pesë vjetësh, më 1932, arriti qëllimin e dëshiruar duke botuar *Le dictionnaire albanais de 1635. Edité avec introduction et index complet. Tom. I. : Dictionarium Latino-Epiroticum par R. D. Franciscum Blanchum* (Paris, 1932), "Fjalorin" e Frang Bardhit, i pari fjalor i gjuhës shqipe. Vëllimi përbëhet nga një hyrje e gjatë prej 59 faqesh mbi familjen Bardhi, mbi ipeshkvinë e Sapës, mbi Frang Bardhin në bazë të dokumenteve të zbuluara në arkivat e Vatikanit. Më pas vijon disa vërejtje mbi vetë fjalorin, i cili vijon i botuar në mënyrë fotomekanike në 233 faqe me gjithë shtesat. Po atë vit botoi vëllimin *Recherches sur les anciens textes albanais* (Paris, 1932) [Gjurmime mbi tekstet e vjetra në gjuhën shqipe], ku jep përshkrimin e plotë të 17 botimeve dhe dorëshkrimeve më të para shqipe (1462-1710), disa të zbuluara prej tij, duke njohur botën shkencore me pasurinë e lashtë të shqipes së shkruar. Ndër to përmendim kërkimet mbi L. Matrangën, librin e të cilit e zbuloi në Bibliotekën e Vatikanit, tri vepra të Pjetër Budit që i zbuloi po në atë bibliotekë: *Dottrina christiana* (1618), *Ritvale Romanvm* (1621) [Rituali roman] dhe *Pasechdra etrefdm* (1621) [Pasqyra

e të rrëfyemit]. Po në *Recherches...* gjenden dokumente arkivore mbi Pjetër Mazrekun dhe Fjalorin e tij etj.



**Gustav WEIGAND**  
(1860-1930)

Kush merret me çështjen e gjuhës shqipe, herët a vonë do të ndeshë Gustav Weigand-in. Çmohet edhe në ditët e sotme si romanist, filolog balkanologjie dhe bulgarist, por edhe si albanolog.

Ndonëse kishte bindjen (madje është përfaqësuesi më në zë i saj), se shqipja duhej vlerësuar duke u nisur veçanërisht nga substrati trak, sot është e vjetruar, Weigand-i solli kontribute me vlera për albanologjinë. Në Universitetin e Lajpcigut në vitin 1891 fitoi të drejtën të jepte mësim dhe që nga viti 1893 ishte drejtor i Institutit për gjuhën rumune, themeluar prej tij. Nga viti 1896 deri më 1928 punoi profesor i filologjisë romane. Pas institutit rumun dhe atij bullgar e grek, në Lajpcig, në verën e vitit 1925 Weigand-i hapi edhe një institut shqiptar. Interesat e tij nuk shtrihen vetëm te rumanishtja (ka merita të veçanta në studimin e gjithë dialekteve dakorumune,

hartimin e atlasit gjuhësor të gjithë viseve rumune), por shumë shpejt te bullgarishtja dhe më në fund te shqipja.

Ka merita të mëdha për hulumtimin e shqipes si në studim dhe teori, ashtu edhe në fushën organizative. “Balkan Arkivi”, - revistë e themeluar prej tij u botua për tre vjet (1925-1928) - duhet konsideruar si organi i parë i filologjisë balkanike. Solli një kontribut të rëndësishëm për hulumtimin e shqipes. Në programin e “Ballkan-Arkiv” (Leipzig), G. Weigand ndër të tjera shkruan: “Ndërmjet shqipes, rumanishtes dhe bullgarishtes shohim një varg tiparësh të përbashkëta, që i japin këtyre tri gjuhëve një karakter të veçantë, të cilin e quaj ballkanik, prandaj, kur flas për gjuhët ballkanike, në radhë të parë e kam fjalën për këto tri gjuhë... Vetëm nëpërmjet njohjes intensive të bullgarishtes dhe depërtimit në shpirtin dhe karakterin e shqipes kuptova qartë se rumanishtja është e lidhur shumë më thellë me shqipen nga ç’pranohet zakonisht.”

Në vitet e para të veprimtarisë së tij shkencore G. Weigand trajtoi shqipen kryesisht duke marrë parasysh rumanishten, por shumë shpejt kaloi edhe te një vrojtim i izoluar i kësaj gjuhe ballkanike ende pak të njohur. Njohja e Gustav Weigand-it me shqiptarët dhe shqipen nuk bazohet vetëm te studimet në Gjermani por edhe në këndvështrimin e tij vetjak. Në periudhën nga 30 prilli i 1889-ës deri më 24 tetor 1900 ai ndërmoi një udhëtim studimesh nëpër Maqedoni, Shqipëri dhe në një pjesë të madhe të Greqisë Veriore. Në semestrin e dimrit të 1889/1900 ai për herë të parë në universitet mban leksionin me temë

“Për fillimin e studimit të gjuhës shqipe”, që ndiqet më 1900 nga “Gramatika shqipe duke pasur parasysh në mënyrë të veçantë marrëdhëniet me rumanishten”. Në vitin 1909 Weigand-i përfundon një studim të dialektit gegë të fshatit arbëresh Borgo Erizzo në Zarë.

Në vitin 1912 Weigand ndërmer sërish një udhëtim studimi për në Shqipëri, dhe rezultati ishte *Albanisische grammatik im Südgegische dialekt* (Durazzo, Elbasan, Tirana) (Leipzig, 1913) [Gramatika shqipe në dialektin gegë jugor (Durrës, Elbasan, Tiranë)]. Një vit më pas botoi *Albanesisch-deutsches und deutsch-albanesisches wörterbuch*. (Leipzig, 1914) [Fjalor shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip]. Me interes për të dhënat dhe përfundimet që sjell për folklorin dhe etnografinë e shqiptarëve të Maqedonisë, por veçanërisht për objektin e tij kryesor, gjuhën shqipe, ai sjell në *Ethnographie von Makedonien : Geschichtlich-nationaler, sprachlich-statistischer Teil* (Leipzig, 1924). Fryt i punës së tij është edhe përkthimi në gjermanisht i disa këngëve nga *Lahuta e Malcis e Fishtës*, pajisur me komente e fjalor (Lajpcig, 1925). Në fondet me vlerë të Bibliotekës sonë Kombëtare ndodhen rreth 80 koleksione librash me vlerë dhe revistash, dhuratë e albanologut të shquar.

B e f a l l i   Z o t i   P r o f - s e c r   D e k t o r  
GUSTAV VAJGAND ( WEIGAND )  
L e p i   k e  
D i s t r i b u e r   1 9 2 9

G. Weigand



---

■ Digjitalizimi, e ardhmja e bibliotekonomisë moderne

---

65

# Digjitalizimi, e ardhmja e bibliotekonomisë moderne

**Eni KAÇI**

Biblioteka Kombëtare

**“Bibliotekaria moderne” është titulli i librit të Xhafer Sylës, publikuar në Prishtinë në vitin 2005, një tjetër botim ky që u shtohet fondit të studimeve në fushën e bibliotekonomisë.**

Ai është një përshkrim i përgjithshëm i zhvillimit të bibliotekonomisë në të gjitha aspektet.

Libri nis me argumentimin e nevojës së një ligji për veprimtarinë bibliotekare dhe më tej vijon me bibliotekarinë si shkencë duke bërë një historik të shkurtër të zhvillimit të studimeve në këtë fushë. Autori komenton disa nga manifestet kryesore të UNESCO-s siç është ai për bibliotekat shkollore, thekson rolin e bibliotekave të fakulteteve në përhapjen e informacionit shkencor.

Në “Bibliotekaria moderne” Sylja ka prekur tema të rëndësishme, si: bashkëpunimi në fushën e qarkullimit të informa-

cionit bibliotekar, përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e bibliotekave, shkëmbimi dhe blerja e koordinuar e informacioneve shkencore dhe kërkimore, shfrytëzimi i burimeve elektronike, bazat e të dhënave, huazimi elektronik ndërkombëtar, ngritja mbi baza profesionale e një sistemi informativ bibliotekar. Gjithashtu është trajtuar edhe roli i bibliotekave universitare, të shkollave dhe bibliotekave publike, lidhja e tyre me zhvillimin e shoqërisë dhe të bibliotekave në tërësi si dhe një sërë temash të tjera të rëndësishme.

Por cila është e ardhmja e bibliotekonomisë? Një pyetje e rëndësishme kjo që përshkon rrjedhën e mendimeve të

autorit Xhafer Sylja, të shprehura në “Bibliotekaria moderne”. Ajo që është e sigurt, sipas tij, është përfshirja në zhvillimet marramendëse dhe të pandalshme të teknologjisë së informacionit.

Duket tentuar të trajtojë problematikën e sistemit bibliotekar në Kosovë, krahasuar ato edhe me zhvillimet më të fundit në botë, Sylja rreket t’i japë përgjigje një sërë çështjesh të rëndësishme për të ardhmen e bibliotekonomisë.

I gjithë sistemi bibliotekar në mbarë botën, por sidomos në vendet e zhvilluara, po shkon drejt një drejtimi, bibliotekave moderne, ku gjithçka është e digjitalizuar. Të gjitha elementet e sistemit të bibliotekave-katalogimi, shërbimet bibliotekare, koleksionet dhe teknologjia do të përfshihen në “revolucionin informativ”, që ka nisur e duket të jetë i pashmangshëm.

Një bibliotekë digjitale, apo siç është shprehur edhe vetë Sylja në librin e tij, një bibliotekë moderne, duket se është e ardhmja e sigurt e bibliotekonomisë. Për të, biblioteka digjitale duket se përbën zgjidhjen e mundshme, e ndoshta më të mirë, për detyrat e shtruara, të cilat në këtë libër vështrohen përmes edhe kërkesave më elementare për të arritur deri në një model eventualisht të mundshëm të organizimit të bibliotekave digjitale, në të gjitha mjediset shkencore e publike.

Duket se një nga qëllimet kryesore të Sylës është të nxisë përsiatjet mbi tendencat e ndryshme në zhvillimin e shoqërisë së informacionit dhe gjithashtu të vërë në dukje se informacioni dhe teknologjia e tij duhen afruar edhe me aspektin shoqëror. Autori përpiket të njohë opinionin profesional bibliotekar me polemikat dhe

diskutimet në qarqet e bibliotekarëve dhe të ekspertëve të informacionit.

Autori rreh të trajtojë aspektet social-kulturore të zhvillimit të shoqërisë së informacionit. Është fjala për shoqërinë e civilizuar, në të cilën brenda zhvillimit social-ekonomik, rol dominues ka informacioni dhe dituria, ku, sipas tij, veprimtaritë shërbyese dominojnë mbi ato industriale, ndërsa njohuritë teorike dhe akademike mbi përvojën dhe rutinën tradicionale. Prej kohësh vendet më të zhvilluara kanë kaluar në një tjetër fazë, në atë të shoqërisë së informacionit. Me të drejtë Xh. Sylja pohon edhe në librin e tij se “*zgjerimi i teknologjisë së informacionit është pasojë e drejtpërdrejtë e tre elementeve të ndërlydhura me njëra-tjetrën: i shtimit të menjëhershëm të informacionit shkencor dhe profesional, i varësisë së përgjithshme që kanë krijuar individët, e më gjerë edhe shoqëria nga informacioni, si dhe i zhvillimit marramendës së teknologjisë kompiuterike dhe telekomunikuese*”.

E ndërsa i jep prioritet zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe ndikimit të saj të pashmangshëm në shoqëri, autori nuk mund të anashkalojë edhe rreziqet që mund të vijnë prej saj. “*Transformimet teknologjike duhet të analizohen brenda një konteksti të caktuar social, me të gjitha efektet ... , pozitive dhe negative*”, do të theksojë më tej Sylja. Ekzistojnë një varg konfliktesh individuale-psikike të shkaktuara nga përdorimi i teknologjisë kompiuterike. Një ndër ta është edhe varësia e komunikimit ndërnjerëzor, që megjithëse përsoset gjithnjë edhe më shumë me ndihmën e kompiuterit nga




mënyra e centralizuar e mekanika e radhitjes dhe ruajtjes së informacionit, krijon një varësi gjithnjë edhe më të madhe nga programi i punës, i lidhjes në rrjet, nga struktura e bazave të të dhënave, etj.

*“Nga njëra anë kompiuteri është një vegël efektive, që jep virtualitete komunikative dhe të arritshmërisë së informacionit, që nuk pranohen nga mendja njerëzore, por nga ana tjetër kompiuteri mund të jetë një mjet kontrolli që u ofron pushtetin e pakufizuar atyre, të cilët kanë mbikëqyrje mbi informacion. Dilema kryesore e shoqërisë tashmë është si t’i jepet hov kësaj kontradikte”, do të nënvizojë Sylja në faqet e “Bibliotekaria moderne”. Duket se zgjidhjen e kësaj dileme autori e gjen në rolin që duhet të marrin në të ardhmen bibliotekat. Zhvillimi bashkëkohor, shkencor e teknologjik, si edhe puna e punonjësit të bibliotekës, shprehin domosdoshmërinë e shndërrimit të bibliotekave tradicionale në qendra informacioni, duke pasur një rol më aktiv në ndihmë të shoqërisë. Roli i saj është i orientuar nga vetarsimimi, mbajtja dhe ruajtja e informacionit si dhe plotësimi i nevojave të lexuesve. Por zhvillimi i madh teknologjik dhe nevojat aktuale kulturore të shoqërisë objektivisht kërkojnë edhe zhvillimin dhe përshtatjen e bibliotekave ndaj kërkesave të shoqërisë.*

*Me të drejtë në librin e tij Sylja ngre një çështje të rëndësishme: Çfarë biblioteke kërkojnë lexuesit?*

Hipotezat që parashtrohet autori duket se arrijnë në një konkluzion interesant, por edhe të rëndësishëm. Është vetë lexuesi



ai që, me kërkesat dhe nevojat e tij, ndikon në zhvillimin e bibliotekave. Zhvillimi i shoqërisë ndikon në mënyrë të pashmangshme edhe në zhvillimin e vetë bibliotekave. Ky fakt kushtëzon funksionin gjithnjë edhe më të ndërlikuar dhe më kompleks të bibliotekarit dhe nevojën për kualifikimin e tij të vazhdueshëm, njohjen e nevojave të ambientit shoqëror dhe të vetë lexuesve.

Në punimet e tij Sylja i ka dhënë një vend të rëndësishëm zhvillimit të teknologjisë së informacionit, ndikimit të tij në vetë zhvillimin dhe të ardhmen e bibliotekarisë. Zhvillimet që po sjell teknologjia e informacionit po ndikojnë ndjeshëm në shfrytëzimin e burimeve elektronike dhe blerjen e koordinuar të materialeve për pasurimin e koleksioneve. Bibliotekat në shoqërinë e informacionit po kalojnë nga tradicionale në biblioteka elektronike e virtuale. Në mënyrë të natyrshme, autori

i ka trajtuar këto çështje në kuadër të problematikave të bibliotekonomisë në Kosovë, duke tentuar përherë parashtrimin e këndvështrimit të tij mbi gjetjen e rrugëzgjdhjeve.

Bibiotekaria në Kosovë dhe e ardhmja e saj është një nga çështjet më të prekura. Duke parashtruar përvojën ndërkombëtare në këtë fushë ai paraqet rrugën që duhet të ndjekë bibliotekonomia në Kosovë. Shtetet europiane kanë ngritur bazat juridike për ndërtimin e standardeve unike për qarkullimin e informacionit, krahas ecurisë së metodikës, metodologjisë, kualifikimi, specializimit të vijueshëm profesional etj. Qëllimi, sipas Sylës, është që bibliotekat të rritin rolin e tyre si qendra të rëndësishme kulturore dhe që të ndikojnë edhe më shumë se deri sot në rritjen e nivelit të përgjithshëm kulturor të shoqërisë. Për të, sistemi bibliotekar duhet të ndërtohet sipas metodologjisë së re të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian, që është refleksi i globalizimit të teknologjive dhe të standardeve në kulturën botërore.

Vend të veçantë zë në botim përdorimi i bibliotekës, studimi i nevojave të përdoruesve, format e propagandimit dhe të përhapjes së librit, si dhe roli i librit në edukimin e fëmijëve. Si një botim përmbledhës i tërë veprimtarisë bibliotekare në kushtet e sotme, autori nuk lë pa përmendur dhe proceset e pasurimit të bibliotekave dhe të përpunimit bibliotekar bibliografik të materialeve. Autori, gjithashtu trajton domosdoshmërinë e përsosjes së mënyrave të bashkëpunimit të ndërsjellë me bibliotekat e tjera simotra në rajon e më gjerë gjatë grumbullimit dhe shkëmbi-

mit të materialit bibliotekar, sigurimin e sistemit të shtjellimit të materialit, të krijimit dhe të shpërndarjes së informacionit sipas standardeve, krijimin e një sistemi unik rajonal në aspektin e zhvillimit të veprimtarisë bibliotekare brenda së njëjtës hapësirë gjuhësore dhe kulturore. Me të drejtë ai shtron harmonizimin e legjislacionit për bibliotekat dhe veprimtarinë e tyre me kushtet e reja në të cilat ndodhet Kosova. I drejtë duket se është shqetësimi mbi rëndësinë e zbatimit të metodave të cilat do të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve, ende të pazgjidhura, që qëndrojnë para bibliotekarëve e për të cilat vetëm ata janë të kualifikuar.

Pavarësisht ndonjë "hallakatjeje" në organizimin e mendimeve dhe në rrjedhën e të shprehurit të tyre, studimet e përmbledhura në librin "Bibliotekaria moderne" të Xhafer Sylës mbeten një kontribut me vlerë në fushën e bibliotekonomisë.

## Digjitalizimi, e ardhmja e bibliotekonomisë moderne

"Bibliotekaria moderne" është titulli i librit të Xhaferr Sylës, publikuar në Prishtinë në vitin 2005, një tjetër botim ky që u shtohet fondit të studimeve në fushën e bibliotekonomisë.

Në "Bibliotekaria moderne" Sylja ka prekur tema të rëndësishme, si: bashkëpunimi në fushën e qarkullimit të informacionit bibliotekar, pëmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e bibliotekave, shkëmbimi dhe blerja e koordinuar e informacioneve shkencore dhe kërkimore, shfrytëzimi i burimeve elektronike, bazat e të dhënave, huazimi elektronik ndërkombëtar, ngritja mbi baza profesionale e një sistemi informativ.

bibliotekar. Gjithashtu është trajtuar edhe roli i bibliotekave universitare, të shkollave dhe bibliotekave publike, lidhja e tyre me

zhvillimin e shoqërisë dhe të bibliotekave në tërësi si dhe një sërë temash të tjera të rëndësishme.

## DIGITALIZATION THE FUTURE OF THE MODERN LIBRARIANSHIP

*"The Modern Librarianship" is the title of a book published by Xhaferr Sylja in Prishtina during 2005, one more publication which enrich the fund of the studies in the field of librarianship.*

*In his book, Mr. Sylja speaks up regarding certain relevant issues such as: the cooperation in the field of circulation of the library information, improving the legislative framework of libraries, the exchange and the coordinating purchase of the scientific information, the exploitation of the electronical resources, the databases, the electronical international lending etc. In this book you can find arguments regarding the role of the university libraries, schools and public libraries as well as their connection with the society and other important issues.*



---

■ Rregullat e katalogimit dhe Kërkesat Funksionale për Regjistrimet Bibliografike	71
■ Bibliotekat publike shqiptare në Shoqërinë e Informacionit	89
■ Biblioteka e Universitetit të Tiranës: histori dhe perspektivë	94
■ Biblioteka dhe shërbimet e informacionit parlamentar	99
■ Biblioteka Aleksandrina	105
■ Bibliotekat publike në Spanjë	114
■ Direktiva të Këshillit të Europës/EBLIDA për legjislacionin dhe politikat bibliotekare në Europë	120
■ Udhëzues të projektit CALIMERA	130

---

# Rregullat e katalogimit dhe Kërkesat Funksionale për Regjistrimet Bibliografike

**Farfuri XHAJA**  
Biblioteka Kombëtare

## Rregullat e katalogimit - pak histori

Vendosja e rregullave të katalogimit si domosdoshmëri për organizimin e informacionit bibliotekar ka qenë shqetësim i hershëm për bibliotekarët. Botimi i Antonio Panizzit (1787-1879) *Rules for the compilation of the catalogue* (Rregullat e hartimit të katalogut) në vitin 1841 konsiderohet kodi i parë më i plotë i katalogimit. Ai hartoi 91 rregulla për ndërtimin e katalogut të British Museum dhe vlen të përmendet deklarimi i tij, i cili ka vlerë edhe sot: “Lexuesi mund ta njohë veprën që kërkon; por nuk mund të mendohet që ai të dijë të gjitha hollësitë e botimeve të ndryshme të kësaj vepre; këtë informacion ai ka të drejtë ta marrë nga katalogët”. Ky argument i tij qëndron edhe sot në themel të katalogut modern.

Charles Cutter (1837-1903) botoi në vitin 1876 *Rules for a printed dictionary*

*catalog* (Rregullat për katalogun alfabetik të shtypur), botim i ribotuar shumë herë. Këto rregulla shërbyen si bazë për katalogët e shumë bibliotekave. Ai përcaktoi në mënyrë të qartë ç’duhet të realizojë një katalog dhe si:

### 1. T’i mundësojë përdoruesit të gjejë një libër për të cilin ai di:

- autorin;
- titullin;
- subjektin.

### 2. Të tregojë çfarë ka biblioteka:

- nga një autor i caktuar;
- për një subjekt të caktuar;
- për një lloj të caktuar të literaturës.

### 3. Të ndihmojë në gjetjen e një libri:

- sipas botimit (bibliografikisht);

- sipas karakterit (letrar ose joletrar).

*Për të realizuar këto duhet:*

1. autori element hyrës me referimet e nevojshme;
2. titulli element hyrës ose referim për titullin;
3. subjekti dhe numrat e klasifikimit elemente hyrëse dhe referimet e nevojshme;
4. dhënia në përshkrim e botimit dhe shtypit, me shënime kur është e nevojshme;
5. shënime.

Edhe shumë bibliotekarë të tjerë punuan në këtë fushë dhe rregullat e katalogimit u bënë një grumbull normash të ndërlikuara, ndonjëherë kontradiktore dhe konfuze. Bibliotekari amerikan Seymour Lubetzky (1898-2003) punoi për thjeshtimin e tyre duke u nisur nga disa parime bazë. Idetë e tij ndikuan ndjeshëm në studimin lidhur me Kërkesat Funktionale për Regjistrimet Bibliografike (Functional Requirements for Bibliographic Records - FRBR). Të ndalemi në funksionin që ai i përcakton kryetitullit të përshkrimit bazë ose elementit hyrës kryesor:

*Funksioni i përshkrimit bazë mbështetet në faktet se:*

- a) materialet e bibliotekës - librat, dorëshkrimet, regjistrimet audio e video etj. - janë *paraqitje* të veprave të autorëve, jo vetë veprat;
- b) një vepër e caktuar mund të paraqitet

në bibliotekë në forma dhe botime të ndryshme, me emra autorësh të ndryshëm dhe tituj të ndryshëm;

- c) katalogu i një biblioteke duhet ndërtuar jo vetëm 1) për të treguar nëse biblioteka e ka ose jo një njësi apo botim të caktuar, me emrin e një autori të caktuar apo titull të caktuar, por edhe 2) për të identifikuar autorin dhe veprën e paraqitur me anë të një njësie ose botimi dhe për të lidhur veprat e ndryshme të autorit si edhe botimet dhe përkthimet e ndryshme të një veprë. Ndonëse objektivi i dytë është burimi i shumë vështirësive në katalogim, ai gjithnjë ka qenë i rëndësishëm në parimet bazë të katalogut - t'i japë mundësi përdoruesit të katalogut (bibliotekar apo lexues) të përcaktojë me siguri nëse biblioteka e ka ose jo një vepër të caktuar me çfarëdo emri apo titulli dhe të zgjedhë atë botim ose përkthim të veprës që plotëson kërkesën e tij.

*Sipas Lubetzky-t qëllimet e katalogut janë:*

- 1) të tregojë nëse gjendet në bibliotekë një njësi ose botim i caktuar, me një emër autori të caktuar dhe titull të caktuar;
- 2) të identifikojë autorin dhe veprën e paraqitur me anë të një njësie ose botimi dhe të lidhë veprat e ndryshme të një autori si edhe botimet dhe përkthimet e ndryshme të një veprë.

Përfundimet e arritura bazoheshin në katalogët e shtypur në formë libri ose me skeda dhe tregojnë se si janë kuptuar, zbatuar dhe përmirësuar qëllimet e



katalogëve gjatë dy shekujve. Nga sa shihet objektivat e katalogëve janë t'i krijojnë mundësi përdoruesit të gjejë një libër kur di autorin, titullin ose subjektin dhe të tregojë ç'ka biblioteka nga një autor i caktuar, për një subjekt apo për një lloj të caktuar literature. Pra objektivat janë gjetje dhe grupim.

Pas përfundimeve të mësipërme, Federata Ndërkombëtare e Shoqatave dhe Institucioneve Bibliotekare (IFLA) filloi punën për një analizë rrënjësore të teorisë dhe praktikës së katalogimit në nivel ndërkombëtar. Rezultati i parë i rëndësishëm i kësaj nisme ishte hartimi i parimeve të katalogimit, të cilat u paraqitën në Konferencën Ndërkombëtare të mbajtur në Paris në vitin 1961 (të njohura me emrin *Parimet e Parisit*).

***Sipas këtyre parimeve katalogu duhet të jetë një mjet efektiv për të gjetur:***

- 1) nëse biblioteka e ka një libër të caktuar të specifikuar sipas: a) autorit dhe titullit të tij, ose b) kur libri nuk ka autor, vetëm sipas titullit, ose c) kur autori dhe titulli janë të papërshtatshëm apo të pamjaftueshëm për identifikim, sipas një zëvendësuesi të përshtatshëm për titullin;
- 2) a) cilat vepra të një autori të caktuar dhe b) cilat botime të një vepre të caktuar gjenden në bibliotekë.

Siç shihet, edhe në *Parimet e Parisit* objektivat e katalogut janë gjetje dhe grupim.

Një skedar i ndërtuar mirë realizon sistemim të informacionit dhe orienton përdoruesin. Këto arrihen si pasojë e zbatimit të rregullave të përshkrimit, njësimi të pikave hyrëse dhe përdorimit të referimeve dhe udhëzimeve të nevojshme. Po të vërejmë objektivat e përcaktuara nga Lubetzky, praktikisht është e pamundur që ato të arrihen plotësisht me katalogët e shtypur në letër ose ata me skeda. Kompiuterat dhe bazat e të dhënave e bëjnë shumë më të lehtë menaxhimin e informacionit kur përcaktohen rregulla për realizimin e lidhjeve mes veprave, krijuesve të tyre dhe subjekteve.

Në vijim të qartësimi të këtij problemi u organizua Takimi Ndërkombëtar i Ekspertëve të Katalogimit (zhvilluar në Kopenhagen në vitin 1969), i cili miratoi një rezolutë për krijimin e standardeve ndërkombëtare për formën dhe përmbajtjen e përshkrimeve bibliografike. Standardi i parë i përgatitur sipas kësaj rezolute, Standardi Ndërkombëtar për Përshkrimet Bibliografike të Botimeve Monografike (*International Standard Bibliographic Description for Monographic Publications - ISBD-M*) doli në vitin 1971. Pas tij u botuan standarde edhe për llojet e tjera të materialeve.

Gjatë kësaj periudhe ka ndryshuar shumë mjedisi në të cilin vepron standardet dhe parimet e katalogimit. Faktorët kryesorë të këtij ndryshimi janë zhvillimi i sistemeve të automatizuara për krijimin dhe përpunimin e të dhënave bibliografike dhe rritja e bazave të të dhënave, si kombëtare ashtu dhe ndërkombëtare. Këto përbajnë regjistrime të realizuara dhe të përdorura nga mijëra biblioteka pjesëma-

rrëse në programe të katalogimit të përbashkët. Zhvillimi i katalogimit të përbashkët është nxitur jo vetëm nga mundësitë që krijon teknologjia e re, por edhe nga rritja e nevojës për të reduktuar koston e katalogimit duke minimizuar dublimet. Presionet ekonomike i detyrojnë bibliotekat të përpiqen për të thjeshtuar procesin e katalogimit dhe për të bërë katalogime të nivelit sa më minimal, me qëllim që të përballohet shtimi i madh i botimeve. Nga ana tjetër ka një rritje të nevojës për përshtatje të kodeve dhe praktikave të katalogimit me format e reja të botimeve elektronike dhe të aksesit nëpërmjet rrjeteve në burimet e informacionit. Ishte ky ndryshim i mjedisit që nxiti organizimin e Seminarit të Stokholmit për Regjistrimet Bibliografike në vitin 1990, të sponsorizuar nga Programi i Kontrollit Bibliografik Universal, Formati MARC (UBCIM) dhe Sektori i IFLA-s për Kontrollin Bibliografik. Ndonëse pjesëmarrësit në seminar paraqitën realitetin ekonomik me të cilin përballen bibliotekat dhe nevojën për reduktim të koston së katalogimit, njëkohësisht ata mbështetën rëndësinë e plotësisht të kërkesave të përdoruesve për lloje të ndryshme materialesh. U pranua se presioni i vijueshëm për një “nivel minimal” katalogimi kërkonte riekzaminim të kujdesshëm të raportit ndërmjet elementeve të të dhënave në një regjistrim dhe nevojave të përdoruesit. U pranua gjithashtu se zhvillimi i programeve të përbashkëta të katalogimit, kombëtare dhe ndërkombëtare, kërkon një standard të miratuar për një nivel regjistrimi “bazë” ose “themelor”.

Në Seminarin e Stokholmit u miratuan nëntë rezoluta, njëra prej të cilave ka të bëjë me studimin për përcaktimin e Kërkesave Funktionale të Regjistrimeve Bibliografike. Qëllimi i këtij studimi është të përcaktojë qartë funksionet e regjistrimeve bibliografike në kushtet e mediave të ndryshme, aplikimeve të ndryshme dhe kërkesave të ndryshme të përdoruesve. Studimi mbulon të gjitha funksionet e regjistrimeve bibliografike në kuptimin më të gjerë, d.m.th. një regjistrim që përmbledh jo vetëm elementet përshkruese, por edhe pikat hyrëse (ose elementet e kërkimit) (emër, titull, subjekt etj.), elemente të tjera të organizimit (klasifikimi etj.) dhe adnotimet.

Një detyrë e dytë e grupit të studimit ishte rekomandimi i një niveli bazë të të dhënave për regjistrimet e krijuara nga agjencitë bibliografike kombëtare. Formulimi i rekomandimeve për nivelin bazë të regjistrimeve bibliografike kombëtare është në përgjigje të nevojave për të formuluar një standard bazë që do t'u mundësojë agjencive bibliografike të thjeshtojnë koston e katalogimit nëpërmjet krijimit, si domosdoshmëri, të regjistrimeve nën nivelin e plotë, por njëkohësisht të sigurojnë se të gjitha regjistrimet e prodhuara nga agjencitë bibliografike kombëtare plotësojnë kërkesat bazë të përdoruesve.

Anëtarët e grupit për kryerjen e studimit u caktuan nga Seksioni i Katalogimit dhe Seksioni i Klasifikimit dhe Indeksimit të IFLA-s. Në përfundim të studimit disaveçar u arrit në raportin e njohur me titull *Kërkesat Funktionale për Regjistrimet Bibliografike* (FRBR).

## Ç'është FRBR

Ndonëse kataloguesit katalogojnë prej shumë vitesh duke zbatuar rregullat e katalogimit dhe ka më shumë se 30 vjet që është krijuar formati MARC, nuk është kryer ndonjë analizë sistematike për të vënë në dukje informacionin më të nevojshëm për katalogun dhe si i përdorin përdoruesit të dhënat. FRBR studion se cili informacion i duhet përdoruesit të katalogut dhe si mund të përdoret me sa më shumë efektivitet ky informacion. Në këtë studim shpjegohen lidhjet që ekzistojnë ndërmjet librave, krijuesve të tyre dhe subjekteve. Ai është shprehje e rregullave themelore të katalogimit dhe të bibliotekomisë në tërësi. FRBR është një përshtatje e modelit të katalogimit për mjedis të kompiuterizuar.

Studimi i FRBR ka dy objektiva kryesore. *Së pari*, krijimin e një kuadri të përcaktuar dhe të strukturuar qartë për lidhjen e të dhënave që përmbajnë regjistrimet bibliografike me nevojat e përdoruesve për këto regjistrime. *Objektivi i dytë* është rekomandimi i një niveli bazë të funksionit të regjistrimeve të krijuara nga agjencitë bibliografike kombëtare. FRBR nuk është standard që duhet zbatuar siç janë ISBD, AACR2 apo formati MARC. Ai është një model që ndihmon për të kuptuar se sa i plotësojnë standardet dhe praktikat e katalogimit detyrat e përdoruesve dhe si mund të funksionojnë më mirë katalogët për të plotësuar kërkesat e tyre. Atëherë lind pyetja se cilat janë detyrat e përdoruesve. Pikërisht kjo është edhe pikënisja e studimit - identifikimi i detyrave të

përdoruesve, detyra që synojnë të përfshijnë gjithçka bën përdoruesi kur përdor bibliografitë kombëtare dhe katalogët e bibliotekës.

### Këto detyra janë:

- Përdorimi i të dhënave *për të gjetur* materialet në përshtatje me kriteret e kërkimit të përdoruesve (p.sh. kërkimi i të gjitha materialeve për një subjekt të caktuar ose kërkimi për një regjistrim që ka dalë me një titull të caktuar);
- Përdorimi i të dhënave të gjetura *për të identifikuar* një entitet (p.sh për të vërtetuar se një dokument i përshkruar në një regjistrim korrespondon me dokumentin e kërkuar nga përdoruesi, ose për të bërë dallimin midis dy teksteve apo regjistrimeve që kanë titull të njëjtë);
- Përdorimi i të dhënave *për të zgjedhur* një entitet që përshtatet me kërkesat e përdoruesit (p.sh. për të zgjedhur një tekst në atë gjuhë që përdoruesi e kupton, ose për të zgjedhur një variant të një programi kompiuteri që është i përshtatshëm me kompiuterin dhe sistemin e operimit të disponueshëm nga përdoruesi);
- Përdorimi i të dhënave *për të siguruar* akses në entitetin e përshkruar (p.sh. për të bërë një porosi për blerjen e një botimi, për të paraqitur një kërkesë për huazim të një kopjeje të një libri që gjendet në koleksionet e bibliotekës ose për të aksesuar nëpërmjet rrjetit një dokument elektronik të depozituar në një kompiuter në distancë).



Nga detyrat e mësipërme duket se përdoruesit e regjistrimeve bibliografike mbulojnë një spektër të gjerë. Në këtë kategori përfshihen jo vetëm klientët dhe punonjësit e bibliotekës (punonjësit e shërbimit informues, kataloguesit, punonjësit e pasurimit, të huazimit ndërbibliotekar), por edhe botuesit, shpërndarësit, shitësit si edhe prodhuesit dhe përdoruesit e shërbimeve informuese jashtë shërbimeve bibliotekare tradicionale. Gjithashtu merren parasysh një seri aplikimesh, ku përdoren regjistrimet bibliografike, si: në proceset e pasurimit, të katalogimit, të inventarit, të qarkullimit e huazimit ndërbibliotekar si edhe në shërbimet referuese dhe të kërkimit të informacionit.

Studimi përpiqet të jetë gjithëpërfshirës edhe për sa u përket llojeve të materialeve (materialet në formë teksti, ato hartografike, muzikore, audio-vizuale, grafike dhe tredimensionale), llojeve të mediave fizike të përshkruara në regjistrimet bibliografike (në letër, film, shirit magnetik, mjedis ruajtës optik) dhe të gjitha mënyrave të regjistrimit të informacionit (analoge, akustike, elektrike, digjitale, optike etj.).

Regjistrimi bibliografik është trajtuar si bashkësi të dhënash që lidhen me entitetet e përshkruara në katalogët e bibliotekës dhe në bibliografitë kombëtare. Në këtë agregat të dhënash përfshihen elemente përshkruese të të dhënave siç janë ato të përcaktuara në ISBD; elemente të dhënash të përdorura si pika hyrëse për persona, organizma, tituj dhe subjekte; elemente të tjera të dhënash që përdoren për

organizimin e një skedari regjistrimesh siç janë numrat e klasifikimit; adnotimet si abstrakte dhe përmbledhje dhe të dhëna specifike për kopjet që gjenden në koleksionet e bibliotekës, siç janë numrat e inventarit dhe numrat e vendit.

Studimi përcakton qartë entitetet me interes për përdoruesit e regjistrimeve bibliografike, atributet (vetitë) e çdo entiteti dhe llojet e lidhjeve që veprojnë ndërmjet entiteteve. Veçohen entitetet që janë objektet kyç me interes për përdoruesit e regjistrimeve bibliografike. Identifikohen karakteristikat ose atributet e çdo entiteti dhe lidhjet ndërmjet entiteteve që janë më të rëndësishme për përdoruesit në formulimin e kërkimeve bibliografike, interpretimin e përgjigjeve të këtyre kërkimeve dhe orientimin në universin e entiteteve të përshkruara në regjistrimet bibliografike.

Atributet dhe lidhjet e identifikuar në studim reflektojnë gjerësinë e përdorimit të informacionit bibliografik dhe rëndësinë për përdoruesit të aspekteve të përmbajtjes dhe të formës së materialit të paraqitur në regjistrimet bibliografike.

Elementet bazë të modelit të studimit (entitetet, atributet dhe lidhjet) janë rrjedhojë e analizës logjike të të dhënave të pasqyruara në regjistrimet bibliografike. Burimet kryesore të përdorura në këtë analizë janë ISBD, GARE (*Guidelines for Authority and Reference Entries*), GSARE (*Guidelines for Subject Authority and Reference Entries*), Manuali UNIMARC etj.

## Entitetet bibliografike

Modeli i studimit përcakton tre grupe entitetesh:

### Entitetet e grupit të parë

Në *grupin e parë* përfshihen katër entitete: vepra, shprehja, manifestimi dhe njësia.

**Vepra** (entitet abstrakt) është krijim intelektual ose artistik. E njohim përmes realizimeve ose shprehjeve të ndryshme të saj. P.sh. *Hamleti* i Shekspirit është një vepër, jo një botim i caktuar, version apo përkthim i veçantë. Vepra është koncept intelektual. Po kështu, për *Iliadën* e Homerit si vepër nuk i referohemi ndonjë teksti të veçantë të veprës, por krijimit intelektual që qëndron pas të gjitha shprehjeve të ndryshme të kësaj vepre. Ripunimet e një teksti më të vjetër shihen si shprehje të të njëjtës vepër dhe jo si vepra të veçanta. Po ashtu, shkurtimeve apo zgjerimet e një teksti ekzistues ose shtimi i partëve të një kompozimi muzikor konsiderohen shprehje të ndryshme të të njëjtës vepër. Përkthimet nga një gjuhë në tjetrën, transkriptimet dhe aranzhimet muzikore si edhe dublimet e filmave konsiderohen gjithashtu shprehje të ndryshme të të njëjtës vepër origjinale. Kur modifikimi i një vepre përfshin punë të pavarur intelektuale ose artistike në një shkallë të lartë, rezultati konsiderohet si vepër e re. Kështu, rishkrimet, përshtatjet për fëmijë, paroditë, variantet muzikore të një teme dhe përpunimet e lira të një kompozimi muzikor konsiderohen vepra të reja. Edhe përshtatjet e një vepre nga një formë letrare ose artistike në një tjetër (p.sh.

dramatizimet, adaptimet nga një mjedis i artit grafik në një tjetër etj.) konsiderohen vepra të reja. Abstraktet, përmbledhjet janë gjithashtu vepra të reja.

**Shprehja** është realizimi intelektual ose artistik i një vepre që mund të jetë në formë alfa-numerike, muzikore, simbole koreografike, tinguj, imazhe, objekt ose kombinim i tyre. Është një formë e veçantë intelektuale ose artistike që merr një vepër sa herë që realizohet. Teksti origjinal i *Hamletit* është një shprehje, po ashtu një shprehje tjetër është përkthimi në frëngjisht, në shqip ose në gjermanisht. Përderisa forma e shprehjes është karakteristike e pandarë (e qenësishme) e shprehjes, çdo ndryshim i formës (p.sh. nga sistem alfa-numerik në fjalë me zë) rezulton në një shprehje të re. Po ashtu ndryshimet në procedurat ose mjetet intelektuale që janë përdorur për të shprehur një vepër (p.sh. përkthimi nga një gjuhë në një tjetër) rezultojnë në realizimin e një shprehjeje të re. *Si përfundim*, çdo ndryshim në përmbajtjen intelektuale ose artistike është ndryshim i shprehjes. Kështu një tekst i ripunuar ose i modifikuar konsiderohet shprehje e re, pavarësisht sa i vogël mund të jetë modifikimi.

**Manifestimi** është konkretizimi fizik i një shprehjeje të një vepre. Paraqet të gjitha objektet fizike që kanë karakteristika të njëjta, si për sa i përket përmbajtjes intelektuale, ashtu dhe formës fizike. Përkthimi në frëngjisht i *Hamletit* (një shprehje e veprës), i botuar në vitin 1946, është një manifestim i kësaj shprehjeje. Kur një vepër realizohet, rezultati i shprehjes së veprës konkretizohet fizikisht në një mjedis që mund të jetë letër, shirit

dëgjimor, shirit video, material plastik etj. Ky konkretizim fizik është manifestimi i veprës. Në disa raste mund të jetë vetëm një ekzemplar fizik i prodhuar për manifestimin e veprës (p.sh. dorëshkrimi i autorit, një pikturë origjinale në vaj etj.). Në raste të tjera prodhohen shumë kopje për të lehtësuar shpërndarjen në publik. Në këto raste ka angazhim të një procesi prodhimi më formal dhe përgjegjës të këtij procesi janë botuesi, prodhuesi ose shpërndarësi. Ka edhe raste kur bëhet vetëm një numër i kufizuar kopjesh të një ekzemplari origjinal për qëllime të caktuara si studime private (p.sh. dublimi i një regjistrimi origjinal të një pjese muzikore) ose për qëllime ruajtjeje (p. sh. një fotokopje në letër të qëndrueshme e një daktilografimi origjinal të autorit). Si në rastin kur qëllimi i prodhimit është i gjerë (p.sh. në rastin e botimit etj.), ashtu dhe kur është i kufizuar (p.sh. në rastin e kopjeve të prodhuara për studim privat etj.), kompleti i kopjeve të prodhuara në çdo rast përbën një manifestim. Të gjitha kopjet e prodhuara që janë pjesë të të njëjtit komplet, janë kopje të të njëjtit manifestim. Kufijtë ndërmjet dy manifestimeve caktohen në bazë të përmbajtjes intelektuale dhe të formës fizike. Çdo ndryshim i

formës fizike konsiderohet manifestim i ri.


*Njësia* është një ekzemplar i vetëm i një manifestimi, një kopje e një manifestimi në raftet e bibliotekës. P.sh. një kopje e *Hamletit* në frëngjisht, botuar më 1946, gjendet me një numër vendi të caktuar në raftet e Bibliotekës Kombëtare të Francës, një kopje tjetër gjendet në një bibliotekë tjetër etj. Ka edhe raste kur entiteti i përcaktuar si *njësi* përmban më shumë se një objekt fizik (p.sh. një monografi që ka dalë në dy vëllime të lidhur veças, një regjistrim që ka dalë në tre disqe kompaktë etj.).

Në kuptimin e përmbajtjes intelektuale dhe të formës fizike, një njësi që demonstroi një *manifestim* është e njëjtë me vetë *manifestimin*. Megjithatë, mund të ketë ndryshime nga njëra *njësi* te tjetra, edhe kur *njësitë* demonstrojnë të njëjtin *manifestim*, kur këto ndryshime janë pasojë e veprimeve të jashtme (p.sh. dëmtime që ndodhin pasi është prodhuar *njësia*, lidhje e kryer nga biblioteka etj.).

Të katër këto entitete janë produkt i një angazhimi intelektual ose artistik. Ato formojnë një hierarki, në krye të të cilës është vepra. Në skemën e mëposhtme paraqitet lidhja mes entiteteve të këtij grupi.

### Skema 1. Entitetet e grupit të parë dhe lidhja mes tyre






Entitetet e grupit të parë, siç shihet në figurë, paraqesin aspekte të ndryshme të interesave të përdoruesve për produktet e punës intelektuale ose artistike. Entitetet e përcaktuara si *vepër* (krijim i veçantë intelektual ose artistik) dhe *shprehje* (realizimi intelektual ose artistik i një *vepre*) reflektojnë përmbajtjen intelektuale ose artistike. Entitetet e përkufizuara si *manifestim* (konkretizimi fizik i *shprehjes* së një *vepre*) dhe *njësi* (një ekzemplar i vetëm i një *manifestimi*) reflektojnë formën fizike.

Lidhjet e paraqitura në skemë tregojnë

se një vepër e vetme mund të realizohet nëpërmjet një ose më shumë shprehjeve, ndërsa një shprehje është realizimi i një dhe vetëm një vepre. P.sh. një vepër mund të përkthehet në disa gjuhë (lidhja një me shumë). Një shprehje mund të paraqitet me një ose më shumë manifestime dhe një manifestim mund të paraqesë një ose më shumë shprehje (lidhje shumë me shumë). Një manifestim konkretizohet me një ose më shumë njësi, por një njësi ilustro një dhe vetëm një manifestim, p.sh. të gjitha kopjet e një libri të shtypur (lidhja një me shumë).

**Lidhja mes entiteteve të grupit të parë duket qartë në shembullin e mëposhtëm.**



Duke përdorur lidhjet që analizojnë FRBR lehtësohet orientimi në katalog. Në katalog të gjitha manifestimet paraqiten si të barabarta dhe shpesh duken si dublime, ndaj përdoruesi duhet të përqendrohet në një shprehje të caktuar të veprës. Duke pasur parasysh FRBR-në është më e lehtë të drejtohesh në katalog dhe mënyra e paraqitjes së informacionit është më e kuptueshme.

### Entitetet e grupit të dytë

Entitetet e grupit të dytë janë entitetet përgjegjëse për përmbajtjen intelektuale ose artistike, prodhimin fizik dhe shpërndarjen ose kujdestarinë e entiteteve të grupit të parë. Përcaktohen dy entitete përgjegjëse: *person* dhe *organizëm*.

*Personat* trajtohen si entitete vetëm në kuptimin e angazhimit të tyre për krijimin ose realizimin e një vepre (p.sh. si autorë, kompozitorë, artistë, redaktorë, përkthyes,


drejtorë, interpretues etj.) ose janë subjekt i një vepre (p.sh. subjekt i një vepre biografike ose autobiografike, historike etj.). Përkufizimi i entitetit person na jep mundësi të emërtojme dhe identifikojmë individin në mënyrë të njëtrajtshme, pavarësisht se si shfaqet emri i tij në shprehje ose manifestime të veçanta të një vepre. Përkufizimi i entitetit person na jep gjithashtu mundësi të tregojmë lidhjet midis një personi të caktuar dhe një vepre ose shprehjeje të një vepre për të cilën ky person është përgjegjës ose midis një vepre dhe personit që është subjekt i veprës.

*Organet kolektive* përfshijnë organizma dhe grupe individësh që identifikohen me një emër të veçantë, ku përfshihen grupe të rastit dhe grupe që përbëjnë mbledhje, konferenca, kongrese, ekspozita, festivale, panaire etj. Ky entitet përfshin edhe organizma që veprojnë si autoritete territoriale, që ushtrojnë

funksiione shtetërore në një territor të caktuar, si: federatë, shtet, rajon, bashki etj. Organi kolektiv trajtohet si entitet vetëm në rastet e angazhimit të tij në krijimin ose realizimin e një vepre ose është subjekt i një vepre. Përkufizimi i

organit kolektiv si entitet na jep mundësi të emërtojmë dhe identifikojmë organizmin ose grupin në mënyrë të njëtrajtshme, pavarësisht se si shfaqet emri i tij në një shprehje ose manifestim të veçantë të një vepre.

**Skema 2.** Lidhja mes entiteteve të grupit të parë dhe të dytë



Skema 2 tregon llojin e lidhjeve “të përgjegjësisë” që ekzistojnë ndërmjet entiteteve të grupit të dytë dhe atyre të grupit të parë. Skema tregon se një vepër mund të krijohet nga një ose më shumë persona ose nga një ose më shumë

organizma. Dhe anasjelltas, një person ose organizëm mund të krijojë një ose më shumë vepra. Një shprehje mund të realizohet nga një ose më shumë persona ose organizma dhe një person ose organizëm mund të realizojë një ose më



shumë shprehje. Një manifestim mund të prodhohet nga një ose më shumë persona ose organizma, një person ose organizëm mund të prodhojë një ose më shumë manifestime. Një njësi mund të zotërohet nga një ose më shumë persona dhe/ose organizma; një person ose organizëm mund të zotërojë një ose më shumë njësi.


### Entitetet e grupit të tretë

Entitetet e *grupit të tretë* shërbejnë si subjekte të veprave dhe janë *koncepti* (nocion ose ide abstrakte që mund të jenë subjekt i një veprë), *objekti* (material konkret frymor ose jofrymor që mund të jetë subjekt i një veprë), *ngjarja* (veprim

ose ndodhi që mund të jetë subjekt i një veprë) dhe *vendi* (në aspektin e të qënit subjekt i një veprë). Këto entitete lidhen me entitetin *vepër* të grupit të parë. Një vepër mund të ketë si subjekt të saj një ose më shumë koncepte, objekte, ngjarje ose vende. Dhe anasjelltas, një koncept, objekt, ngjarje ose vend mund të jetë subjekt i një ose më shumë veprave.

Përkufizimi i këtyre entiteteve na jep mundësi t'i emërtojmë dhe identifikojmë ato në mënyrë të njëtrajtshme, pavarësisht nga prania, mungesa ose forma e emrit të tyre e shfaqur në një shprehje apo manifestim të caktuar të një veprë.

Skema e mëposhtme tregon lidhjet mes vepërës dhe entiteteve të tjera.



## Atributet

Çdo entitet ka një seri atributesh (veçori karakteristike) që lidhen me të. Këto i shërbejnë përdoruesit për të formuar pyetjet dhe për të interpretuar përgjigjet kur kërkon informacion. Atributet mund të jenë të qenësishme në entitet (të brendshme), siç janë karakteristikat fizike (p.sh. mjedisi fizik dhe dimensionet e një objekti), si dhe veçori që janë informacion i etiketuar (p.sh. të dhënat në faqen e titullit, në kapak ose në kutinë mbajtëse të njësisë). Atributet e brendshme përcaktohen duke ekzaminuar vetë njësinë. Atributet mund të jenë edhe të jashtme, kur kërkohet konsultim me burim tjetër të jashtëm.

Secili nga entitetet e çdo grupi ka atributet apo vetitë e tij karakteristike. P.sh. disa nga atributet e entitetit vepër janë: titulli i veprës, forma (novelë, dramë, ese, simfoni, koncert, hartë, pikturë etj.), data e krijimit të veprës, mjedisi i interpretimit (për vepër muzikore), përdoruesit për të cilët është destinuar vepra etj. Shprehja ka attribute: titullin, formën, gjuhën, shkallën (për hartat) etj. Atributet e manifestimit janë: titulli i tij, botuesi, data e botimit, forma e bartësit, dimensionet, identifikuesi (p.sh. ISBN), kushtet e disponueshmërisë dhe shumë të tjera. Ndërsa njësia ka si attribute pozicionin ose numrin e vendit, barkodin, gjendjen fizike, origjinën, kushtet e aksesit etj. Po kështu kanë veçoritë karakteristike të tyre edhe entitetet e tjera të grupit të dytë dhe të tretë. P.sh. për entitetin person atributet janë : emri i personit, datat lidhur me të (të lindjes dhe të vdekjes), titujt e nderit dhe specifikime të tjera.

## Lidhjet

Lidhjet janë pjesa më kritike e FRBR. Ato janë lidhje mes entiteteve të grupeve të ndryshme dhe entiteteve të të njëjtit grup. Lidhjet shërbejnë si mënyrë për të përshkruar marrëdhënien ndërmjet një entiteti dhe një tjetri, duke ndihmuar kështu përdoruesin të shfletojë një bibliografi, katalog ose bazë të dhënash bibliografike. Përdoruesi formulon një pyetje kërkimi duke përdorur një ose më shumë attribute të entitetit për të cilin ai po kërkon dhe ndërmjet këtyre attributeve gjen entitetin e kërkuar. Lidhjet e pasqyruara në regjistrimin bibliografik sigurojnë informacion shtesë që e ndihmon përdoruesin në bërjen e lidhjeve ndërmjet entitetit të gjetur dhe entiteteve të tjera që kanë lidhje me të.

Siç është theksuar edhe më sipër, historikisht objektivat e katalogut kanë qenë t' i krijojë mundësi përdoruesit të gjejë një libër kur di autorin, titullin ose subjektin dhe të tregojë ç'ka biblioteka nga një autor i caktuar, për një subjekt të caktuar apo për një lloj të caktuar letërsie - pra, objektivat janë gjetje dhe grupim. Një skedar i ndërtuar mirë i realizon këto objektiva përmes zbatimit të rregullave, unifikimit të pikave hyrëse dhe përdorimit të referimeve dhe udhëzimeve. Kërkesat funksionale të regjistrimeve bibliografike na japin mundësi për të shpjeguar vlerën e informacionit që hedhim në regjistrim dhe për t' u orientuar më mirë në katalogët online. P.sh. në një katalog që ka shumë regjistrime të një autori për botime në formate fizike të ndryshme nuk është e lehtë të orientohesh. Janë pikërisht lidhjet mes tyre që lehtësojnë orientimin. Katalogët

online kanë shumë përparësi ndaj atyre tradicionale, siç janë kërkimi me fjalë kyç, aksesimi në më shumë regjistrime bibliografike, kontrolli i termave të njësuar etj. Faktor kryesor i këtyre përparësive janë realizimi i lidhjeve. Katalogu i kompiuterizuar nuk është kopje e katalogut tradicional me skeda, por një rrjet të dhënash të lidhura mes tyre që i japin mundësi përdoruesit të realizojë detyrat e nevojshme.

Aktualisht në praktikën e katalogimit bëhen disa lidhje. Ne lidhim titujt e mëparshëm me titujt e rinj të serialet që ndryshojnë titullin, emrin e mëparshëm me emrin e ri të termit e njësuar, vëllimet e një vepre me vëllime, botime e ribotime të një vepre, përkthimin me origjinalin etj. sipas rastit. Këto i bëjmë duke përdorur shënimet, titujt uniformë, përshkrimet (apo pikat hyrëse) shpesh. Megjithatë, këto nuk janë bërë pjesë integrale e funksionimit të katalogut elektronik deri në atë shkallë që i shpjegon modeli i FRBR. Në praktikë ne nuk i realizojmë rregullisht lidhjet e rekomanduara. P.sh. mungesa e rregullsisë në pasqyrimin e lidhjeve midis titujve, duke mos zbatuar titullin uniform është e theksuar sidomos tek përshkrimet e vjetra. Ky fakt diskutohet edhe nga vendet më të zhvilluara në këtë fushë. Po ashtu ndodh dhe me rolin e personit ose organizmave në lidhje me një vepër, shprehje, manifestim ose njësi. AACR2 lejon vendosjen e disa roleve të personave si redaktorë, ilustratorë, intervistues etj. Po ashtu, formati MARC lejon përdorimin e gjerë të kodeve relatore, por që në praktikë përdoren pak. Këto kanë rëndësi për të kuptuar lidhjen midis emrit dhe veprës ose shprehjes dhe nuk mund të

manipulohen nga vetë kompiuteri nëse nuk plotësohen.

Duke pasur parasysh entitetet, atributet dhe lidhjet mes entiteteve, të përfytyrojmë si funksionon një katalog i bazuar në FRBR. Përdoruesi mund të kërkojë në katalogun elektronik për një vepër me titull “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” dhe i shfaqet një listë me 26 regjistrime me vite botimi e gjuhë të ndryshme si edhe dy filma me vite të ndryshme prodhimi. Autori i veprës është Ismail Kadare. Duke përdorur hiperlink-un tek emri i autorit, shfaqet lista e krijimeve të tij. Kadare shfaqet edhe si subjekt (ka biografi për të, shkrime për veprat e tij etj.). Përdoruesi mund të zgjedhë një nga manifestimet e “Gjeneralit të ushtrisë së vdekur”, që është botuar nga një botues i caktuar. Ai mund të shohë gjithashtu përmes hiperlink-ut se ç’libra të tjerë ka botuar ky autor dhe ç’është shkruar për të. Të gjitha entitetet (vepra, shprehjet, subjektet, vendet, konceptet) ndërthuren me anë lidhjes të ndërlikuara, duke krijuar një rrjet marrëdhëniesh mes tyre.

Katalogu i bazuar në FRBR e bën koleksionin e bibliotekës më të hapur të përdoruesit, pasi shton mënyrat e përdorimit të katalogut. FRBR ndihmon bibliotekarët jo vetëm për menaxhim më të mirë të koleksioneve lokale, por edhe të katalogëve përmbledhës që kanë miliona regjistrime nga e gjithë bota.

Hierarkia në FRBR është vepër-shprehje-manifestim-njësi. Kur katalogojmë fillojmë nga një rrugë tjetër, katalogojmë njësinë që kemi në dorë. Nga kjo ndërtojmë një regjistrim bibliografik që synon të përshkruajë një manifestim, kopjet e të cilit mund të jenë në biblioteka



të ndryshme. Kështu, regjistrimi mund të përdoret edhe nga të tjerë përmes rrjetit. Po ashtu bëhen edhe regjistrimet e termave të njësuar për të kontrolluar mënyrën e identifikimit të veprave dhe shprehjeve që konkretizohen në manifestimin që ne përshkruajmë dhe që lidhen me emrin e personit ose të organizmit përgjegjës për krijimin e veprës ose shprehjes. Në sistemet e integruara bibliotekare kjo lidhje midis regjistrimeve bibliografike dhe atyre të termave të njësuar është reale dhe e bën mirëmbajtjen dhe funksionimin e katalogut më të lehtë se sa kur këto lidhje nuk ekzistojnë. Lidhja të regjistrimit e termave të njësuar bëhet edhe për emërtimet lëndore të koncepteve të shprehura në vepër e të vendosura në regjistrimin bibliografik (emërtimet lëndore dhe numrat e klasifikimit).

### **Kërkesat bazë për regjistrimet bibliografike kombëtare**

Duke u bazuar në modelin e paraqitur në FRBR, përdoruesit mund të përdorin regjistrimet bibliografike për shumë qëllime, si p.sh. për të evidentuar burimet e informacionit që ekzistojnë për një subjekt të dhënë ose një person të caktuar, brenda një burimi informacioni të dhënë (p.sh. në tërësinë e burimeve të mundshme të informacionit, në tërë prodhimtarinë e botuar të një vendi, në fondet e një biblioteke të caktuar ose grupi bibliotekash etj.); për të verifikuar ekzistencën ose disponueshmërinë e një dokumenti të caktuar për ta blerë, për ta dhënë hua ose për ta huazuar; për të identifikuar burimet prej ku mund të merret një dokument dhe mundësinë e përdorimit

të tij; për të vendosur nëse ekziston regjistrimi i një njësie që i shtohet koleksionit apo duhet krijuar regjistrim i ri; për të ndjekur një njësi kur ajo lëviz gjatë një procesi siç është lidhja apo trajtimi për konservim; për të përcaktuar nëse një njësi mund të jepet për qarkullim ose t'i dërgohet për huazim ndërbibliotekar një biblioteke tjetër; për të zgjedhur një dokument ose grup dokumentesh që plotësojnë kërkesat për informacion të përdoruesve; ose për të përcaktuar kërkesat fizike për përdorim të një njësie lidhur me aftësitë e përdoruesve ose me kërkesat speciale të pajisjeve për përdorimin e njësish etj. Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se elementet e të dhënave të regjistrimit bibliografik dhe lidhjet mes tyre i japin mundësi përdoruesit *të gjejë, të identifikojë, të zgjedhë dhe të sigurojë* njësinë. Po t'i referohemi shembullit të mësipërm, kërkimi i përdoruesit për një kopje të *Gjeneralit të ushtrisë së vdekur* ndjek me saktësi radhën e detyrave të përcaktuara më sipër. Ai kërkon një entitet vepër, dallon librin nga filmat, përjashton librat e përshtatur për një kategori të caktuar përdoruesish apo versionet dëgjimore dhe bën kërkesë për të huazuar manifestimin e zgjedhur.

FRBR përcakton një nivel bazë të të dhënave të regjistrimit bibliografik për të kryer këto funksione. Të dhënat minimale të domosdoshme për regjistrimet bibliografike të rekomanduara për agjencitë bibliografike kombëtare grupohen në elemente përshkruese dhe elemente të organizimit.

Elementet përshkruese përfshijnë të gjithë ata elemente që sipas AACR2

rekomandohen për përshkrimin e nivelit të dytë, i cili konsiderohet i mjaftueshëm për agjencitë bibliografike kombëtare. Mund të themi se ky nivel përshkrimi përdoret edhe në Katalogimin në Botim dhe në Bibliografinë Kombëtare të Librit Shqip. Në renditjen e zonave dhe të elementeve të çdo zone të rekomanduar në FRBR bie në sy zona e shënimeve, në të cilën jepet informacion për: formën e shprehjes së veprës, shënim për gjuhën, shënim për karakteristika dalluese të shprehjes, të dhëna për periodicitetin (serialet), shënim për mjedisin e paraqitjes së shprehjes (nota muzikore ose regjistrim zonor), shënim për botimin dhe historinë bibliografike (vijim, shtojcë, pjesë plotësuese), ripunim, përkthim, vepër burimore, aranzhim (muzikë), shënim për përshkrimin fizik (mjedisi, numërimi i fletëve, fashikujt), shënim për kërkesat e sistemit (burime elektronike), shënim për lidhjen dhe disponueshmërinë (burimi për pasurim/akces), shënim për kufizime përdorimi apo aksesit; shënim për mënyrën e aksesit, adresa e aksesit (burime elektronike me akses në distancë).

## Elementet e organizimit

Këto janë pikat hyrëse ose elemente kërkimi dhe përfshijnë:

*- emra si pika hyrëse për person(a) ose organizëm(a) me përgjegjësi parësore për veprën, me përgjegjësi parësore për shprehjen;*

*- tituj si pika hyrëse (titulli i veprës), shtesa të titullit uniform (gjuha, karakteristike tjetër dalluese), mjedisi*

*i shfaqjes (muzikë), tregues numerik (muzikë), çelësi (muzikë), të dhëna për aranzhimin (muzikë);*

*- seri si pika hyrëse;*

*- emërtime lëndore/numra klasifikimi si pika hyrëse.*

Ndonëse këto kërkesa rekomandohen si normë për regjistrimet e përfshira në bibliografinë kombëtare, nuk është e domosdoshme që të konsiderohen si kërkesa absolute. Agjencitë bibliografike kombëtare mund të përfshijnë në bibliografinë kombëtare edhe kategori materialesh për të cilat mund të jetë i mjaftueshëm një nivel minimal të dhënash që mund të mos përputhen me ato të rekomanduara për regjistrimin e nivelit bazë. Njëkohësisht dihet se agjencitë bibliografike kombëtare, për kategori të caktuara materialesh mund të zbatojnë nivel më të plotë trajtimi nga ai i kërkesave bazë.

Modeli FRBR ndihmon për të kuptuar dhe për të zhvilluar më tej marrëveshjet për përshkrimin bibliografik, kodet dhe sistemet e katalogimit, për krijimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave bibliografike. Kombinimi i strukturës së FRBR me sistemet moderne të kompiuterizimit krijon mundësi të shumta për rritjen e efektivitetit të kërkimit. Menjëherë pas miratimit të FRBR u ripunua seria e standardeve ISBD dhe ribotimet e tyre (të disponueshme në Bibliotekën Kombëtare) janë në përputhje të plotë me kushtet e FRBR-së. FRBR po përdoret edhe nga Komiteti i AACR2 jo vetëm për të rifreskuar terminologjinë, por edhe për të përmirësuar mënyrat tradicionale të lidhjeve të elementeve.

OCLC dhe shërbime të tjera bibliografike të ngjashme po e përdorin FRBR për të ristrukturuar sistemet e tyre.

FRBR-ja është një material me vlerë të veçantë për kataloguesit po aq sa

ISBD-ja, AACR2, formati MARC dhe GARE. Ai mund të gjendet në adresën <http://www.ifla.org/VII.s13/sc.htm>, si dhe në Bibliotekën Kombëtare i përkthyer në gjuhën shqipe.

## BIBLIOGRAFI

---

Alan Danskin. Bibliographic records in the computer age/Alan Danskin, Ann Chapman. Library and Information Update, Vol. 2, Nr. 9, 2003, f. 42-43.

Barbara Tillet. What is FRBR? : a conceptual model for the bibliographic universe. Washington, DC, Library of Congress Cataloging Distribution Service, 2003.

Carlo Ghilli, Mauro Guerrini. FRBR : analisi del record e nuovi codici di catalogazione, Bolletino AIB, 2003, Nr. 2, f. 145-149.

Gunilla Jonnson. The Basis for a record : in the light of Functional Requirements for Bibliographic Records, IFLA Journal, 2003, Vol. 29, nr. 1, f. 41-47.

Nicola Tangari. I documenti musicali e FRBR, Bolletino AIB, Nr. 2, 2003, f. 179-188.

Thomas B. Hickey, Edward T. O'Neill, Jenny Toves. Experiments with the IFLA Functional Requirements for Bibliographic Records (FRBR), D-lib Magazine, September 2002, Vol. 8, Nr. 9, ISSN 1082-9873.

William Denton. FRBR and Fundamental Cataloguing Rules, May 2003. <http://www.miskatonic.org/library/frbr.html>



## CATALOGUING RULES AND FUNCTIONAL REQUIREMENT FOR BIBLIOGRAPHIC RECORDS

*Functional Requirement for Bibliographic Record is a study undertaken by UBCIM. The aim of the study is to define the functions performed by the bibliographic record to various media, various applications and various user needs. The second aim was to recommend a basic level of functionality and a basic data requirements for records created by national bibliographic agencies.*

*Bibliographic record is treated as integrity of data, including data elements defined at ISBD, data used as access points for person names, corporate bodies, titles and subjects as well as other elements such as class numbers, annotations, access numbers, call numbers etc. The study clearly determines entities of interest for users of bibliographic records, attributes associated with each of the entities and relationships that operate between entities. The principal sources used in the analysis are ISBD, GARE and UNIMARC. The study takes into account the wide range use of bibliographic records: acquisition, cataloguing, inventory, circulation and interlibrary loan, preservation and for reference and information retrieval.*



# Bibliotekat publike shqiptare në Shoqërinë e Informacionit

**Etleva DOMI**

Biblioteka Kombëtare

Duke vlerësuar rëndësinë e informacionit në një shoqëri të hapur dhe progresin e teknologjisë së informacionit në mbarë botën, edhe në Shqipëri tanimë është hartuar dhe zhvilluar një Strategji Kombëtare për Informacionin dhe Teknologjinë e Komunikimit, e cila synon të mbështesë dhe të përkrahë lirinë e informacionit dhe të qenit të informuar si një e drejtë themelore e qytetarëve (sanksionuar në nenin 19 të Deklaratës së të Drejtave të Njeriut), ç'ka është arritur duke zhvilluar infrastrukturën teknike dhe duke futur teknologji moderne të informacionit, si: Internetin, postën elektronike, automatizimin, krijimin e rrjeteve të komunikimit etj. Teknologjitë e Informacionit dhe të Komunikimit kanë filluar të jenë në qendër të vëmendjes të programit së qeverisë shqiptare, çfarë dëshmohet edhe nga numri i madh i nismave të ndërmarra në nivel kombëtar apo lokal, të cilat synojnë ngritjen e infrastrukturës në shkolla dhe institucione publike, përfshirë edhe bibliotekat. Në krahasim me teknologjinë,

përbërësi më i rëndësishëm i teknologjisë së informacionit është informacioni.

Në këto kushte, hartimi i një strategjie kombëtare për zhvillimin e rrjetit të bibliotekave në Shoqërinë e Informacionit është domosdoshmëri, të cilën Biblioteka Kombëtare e ka konsideruar si një ndër detyrat e saj parësore.

Ndonëse në komunitetin e bibliotekarëve prej kohësh është ndër nevoja e ndërmarrjes së nismës për hartimin e strategjisë kombëtare për sistemin bibliotekar kombëtar, në përgjithësi, dhe zhvillimin e rrjetit të bibliotekave publike - si institucione kyç të Shoqërisë së Informacionit - në veçanti, ndonëse janë përpiluar rezoluta për zhvillimin e shërbimeve të bibliotekave publike shqiptare për komunitetin lokal, ndonëse janë bërë përpjekje për të tërhequr vëmendjen e autoriteteve lokale dhe qendrore për t'i dhënë përparësi problemit të zhvillimit të bibliotekave dhe një mbështetje më të fuqishme financiare, me keqardhje konstatojmë që në shumicën e rasteve thirrjet kanë rënë në

vesh të shurdhët. Prandaj, Biblioteka Kombëtare është angazhuar në një projekt ambicioz, i cili është plotësisht në përputhje me politikën dhe me programin për integrimin e Shqipërisë në rrjetet globale të informacionit dhe përdorimin e teknologjive të reja në dobi të individëve dhe gjithë shoqërisë shqiptare.

I mbështetur në politikën prioritare për librin, bibliotekat dhe kulturën të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, projekti është menduar të konceptohet si një hap për rrjetin e bibliotekave publike shqiptare për të bashkëpunuar përmes projektesh të ndryshme me bibliotekën e huaja, për t'u përfshirë në nisma europiane e për t'u përshtatur kështu me zhvillimet bashkëkohore tani e në të ardhmen.

Përbajtja e projektit të sjell ndër mend shprehjen e filozofit grek Demosten që "mundësitë e vogla janë shpesh fillimi i nismave të mëdha". Tani, në shekullin XXI, 2000 vjet më vonë, ne ende përpiqemi të shfrytëzojmë "mundësitë e vogla" për të ndërtuar ndërmarrjen e madhe të përdorimit të dijes së përbashkët të njerëzimit. Prandaj këtë projekt do ta konsideroj si fillimin e nismës së madhe për të përdorur gjithnjë e më shumë teknologjitë e reja në të gjithë sistemin bibliotekar, në mënyrë që të ndërtojmë fillimisht ndërmarrjen e madhe - që është rrjeti bibliotekar shqiptar - dhe, më vonë, themelin e bibliotekës virtuale digjitale, gjë që vërtetë kërkon mjaft punë.

Projekti do të ketë për qëllim të ofrojë një strategji kombëtare për zhvillimin e bibliotekave publike, të munguar deri më sot, e cila synon përcaktimin dhe

përballimin e sfidave të kohës, angazhimin gjithnjë e më tepër të tyre në procesin e ndryshimeve të mëdha të kalimit nga koleksionet tradicionale në bibliotekën elektronike moderne, duke digjitalizuar, demokratizuar dhe mirëmenaxhuar fluksin e madh të informacionit, duke stimuluar zhvillimin e shërbimeve të reja të dobishme për qytetarët shqiptarë, ofrimin e shërbimeve që t'u përgjigjen kërkesave gjithnjë në rritje të përdoruesve dhe shndërrimeve sociale pasi shekulli që po jetojmë është shekulli i informacionit. Shërbimet e reja që bibliotekat do të ofrojnë për komunitetin e biznesit (e-Business), për mësimdhënien dhe trajnimin në distancë nëpërmjet Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (e-Education) etj. të evidentuara saktë dhe për imtësisht në një plan veprimi bashkëkohor pesëvjeçar, krijojnë një vizion të ri për të ardhmen e tyre.

Projekti është një nismë e dobishme që synon shndërrimin e bibliotekave publike në porta të dijes së botës së informacionit elektronik. Ai do të jetë një dokument i plotë, i bazuar në legjislativin shqiptar, dhe në përputhje të plotë me rekomandimet e Bashkimit Europian, Komisionit Europian, IFLA-s, UNESCO-s dhe organizmave të tjerë ndërkombëtare. Projekti ka mjaft vlerë për orientimin si duhet të veprimtarisë së bibliotekave publike në kushtet e Shoqërisë së Informacionit. Kujtoj raportin e Kombeve të Bashkuara ku thuhet: "Kërkohen përpjekje vendimtare për të çuar vendet në zhvillim - dhe njerëzit kudo që janë - drejt bashkëbisedimit "global"". Dhe janë bibliotekat publike që kanë mundësi të



shumta për të bashkuar atë që shpesh e quajmë “ndarje globale”.

Projekti do të synojë të nxitë politika dhe praktika të reja në kushtet e epokës digjitale në bibliotekat publike. Krijimi i një gateway në këto biblioteka me informacion në shqip do të ofronte mundësi të mëdha strategjike për përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe mundësi demokratike duke siguruar akses të lirë e të barabartë në informacion për të gjithë.

Duke e konceptuar bibliotekën publike si një shërbim me bazë lokale, që plotëson nevojat e komunitetit lokal dhe vepron po brenda tij, nëpërmjet krijimit të websiteve me informacione të nevojshme për përdoruesit projekti duhet të parashikojë edhe sigurimin e referencave digjitale, që është në fakt një zgjerim i shërbimit referues tradicional, shërbim që qysh nga mesi i viteve '90 po ofrohet në shumicën e bibliotekave perëndimore. Krijimi i praktikave të reja të shërbimeve në disa rajone të Shqipërisë do të jetë një model edhe për rrjete të tjera kombëtare bibliotekare. Projekti do të jetë gjithashtu shprehje e rëndësisë së mbështetjes së politikave dhe programeve për përmirësimin e shërbimit të bibliotekave publike nga qeverisja qendrore apo rajonale.

Mungesa deri më sot e një strategjie për bibliotekat publike në Shqipëri, vështirësitë e pengesat me të cilat ato ndeshen për përmbushjen e detyrave të tyre, kanë qenë shtysë për një projekt të tillë. Si njohëse e mirë e gjendjes së bibliotekave publike në Shqipëri, mendoj se Biblioteka Kombëtare do të jetë plotësisht në gjendje të hartojë një projekt me objektiva të qarta për të kapërcyer

sfidat me të cilat këto biblioteka ndeshen sot. Në një situatë të tillë kur bibliotekat kryesore publike të vendit po bëjnë përpjekje për të informatizuar shërbimet e përdoruesve dhe për të krijuar katalogët e tyre elektronikë, projekti në fjalë do të shënojë hapin e parë të krijimit të rrjetit kombëtar të bibliotekave publike.

Synohet që ky projekt të renditet ndër më ambiciozët në sistemin kombëtar bibliotekar. Nuk duhet të harrojmë që sa më i fuqishëm të jetë rrjeti bibliotekar, aq më i qytetëruar do të jetë vetë ai vend pasi, siç ka nënvizuar edhe shkrimtari dhe bibliotekari i madh argjentinas Borges “Ka dy sekrete të mëdha të qytetërimit: burimi i Bibliotekës dhe i Kohës”.

Meqenëse në sistemin bibliotekar të çdo vendi, bibliotekat publike përbëjnë pjesën më të rëndësishme, edhe projekti që do të paraqitet duhet ta shohë zhvillimin e strategjisë së bibliotekave publike në Shqipëri si një mjet të rëndësishëm për zhvillimin kulturor, social dhe ekonomik.

Strategjinë e zhvillimit të bibliotekave publike e konsideroj si një ndër hallkat më të rëndësishme të sistemit tonë bibliotekar, ndonëse është strategji e pjesshme, nga ku mendoj se edhe duhet filluar. Mbështetja e hartimit të strategjisë në kuadrin ligjor, që jo dëndur ndodh, do të ndihmojë jo vetëm për të përmirësuar gjendjen ekzistuese, por edhe për të menduar për të ardhmen e bibliotekave publike në shkallë vendi.

Krahas funksionit të tij kryesor si udhërrëfyes profesional shërbimesh të reja për bibliotekat publike, projekti duhet të jetë një model dhe platformë konkrete pune për të tjera bashkëpunime në rrjet

apo shërbime në tërë sistemin kombëtar bibliotekar. Ai duhet të shënojë një kontribut të rëndësishëm në integrimin e bibliotekave publike shqiptare në rrjedhën e bibliotekave europiane si dhe të shënojë, siç thamë më sipër, hapin e parë në ndërtimin e bibliotekës virtuale shqiptare.

Do të sugjeroja që në planin e veprimit, që do të jetë pjesë e projektit, të përfshiheshin në modele pilot më shumë se tri bibliotekave publike, duke u dhënë përparësi edhe atyre bibliotekave që ende nuk kanë pasur mundësi përfshirjesh në të tilla projekte, donëse përpjekjet e tyre nuk kanë mundur. Gjithashtu, do të propozoja që të planifikohet edhe blerja e një programi kompiuterik të posaçëm që bibliotekat e përfshira në projektin pilot të hyjnë në një shërbim referimesh digjitale falas për komunitetin, të quajtur QuestionPoint, ku një pyetje referuese e bërë në një bibliotekë të mund të dërgohet në një tjetër, e cila mund t'i përgjigjet më mirë. Në këtë lloj rrjeti shërbimesh, ndofta, mund të përfshihet edhe Biblioteka Kombëtare.

Mendoj që në përshkrimin e situatës së bibliotekave publike shqiptare hartuesit e projektit duhet të bëjnë një parashtrim më të detajuar, shoqëruar me të dhëna statistikore, ku të pasqyrohet gjendja e tyre në epokën e Internetit dhe implementimi i teknologjive të reja, çka do të ulë koston

e shpenzimeve të parashikuara për udhëtime studimore të ekspertëve shqiptarë apo të huaj për mbledhjen e të dhënave statistikore në Shqipëri. Për një informacion të tillë mund të bashkëpunohet me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Shpreh bindjen se me këtë sugjerim do të bashkohen edhe specialistët e kësaj Ministrie, pasi kjo do të jetë edhe një shtysë për të mundësuar krijimin e regjistrit kombëtar të bibliotekave.

Biblioteka Kombëtare ka caktuar si bashkëhartues të projektit Robert Davies, një ndër ekspertët më të shquar të menaxhimit të projekteve paneuropiane për bibliotekat publike, njohës i mirë dhe mik i bibliotekave shqiptare, dhe Ramazan Vozga, menaxher i Qendrës së Trajnimit Bibliotekar dhe koordinator i disa projekteve europiane, në të cilat ka qenë përfshirë edhe Shqipëria. Mendoj se është e domosdoshme edhe mbështetja dhe nxitja e nga ana e drejtuesve të sektorit të librit dhe bibliotekave në Ministri për paraqitjen e këtij projekti në Këshillin Kombëtar të Bibliotekave, në kuadër të kujdesit që duhet treguar ndaj komunitetit të bibliotekarëve, posaçërisht për ristrukturimin administrativ dhe teknologjik të bibliotekave publike dhe përmirësimin e kuadrit ligjor të veprimtarisë së bibliotekave, këtyre institucioneve të rëndësishme të kulturës.

## THE ALBANIAN PUBLIC LIBRARIES IN THE INFORMATION SOCIETY

*In Albania had been already compiled and developed a National Strategy regarding the Information and the Technology of Communication, which intend to support and forge the freedom of information and being informed as a foundamental right for every citizen. In this framework there is indispensable the set up of a national strategy to developing the network of the libraries. That is the main reason why the National Library of Albania is involved in a ambitious project compatible with the policies and the overall programmes for the integration of Albania in the global networks of information and using of the new technologies in the benefit of the individual and the Albanian society in general.*

*This project - supported by the priorities regarding the politics of the Ministry of Tourism, Culture, Youth and Sport regarding book, libraries and culture - has been conceited to urge the cooperation of the Albanian public libraries through various projects with other libraries in the region and further and in this way to become part of European initiatives and to adopt itself with the contemporary developments nowadays and in the future.*



# Biblioteka e Universitetit të Tiranës: histori dhe perspektivë

**Kledi SHEGANI**

Biblioteka e  
Universitetit të Tiranës

**D**ija është faktori konkurrues vendimtar në shoqërinë e informacionit.

Për këtë arsye mënyra si trajtojmë informacionin do të marrë rëndësi përherë e më të madhe, ndërkohë që revolucioni digjital ndikon mbi punën dhe jetën tonë të përditshme, sidomos në sektorë që kanë ndikim të drejtëpërdrejtë nga kjo teknologji, siç janë bibliotekat.

Në këtë kontekst është i padiskutueshëm roli i bibliotekave të fakulteteve të Universitetit të Tiranës si institucione që i kanë shërbyer pothuajse të gjitha gjeneratave të njerëzve të dijës: mjekëve, shkencëtarëve, shkrimtarëve, publicistëve dhe studentëve. Kështu, biblioteka nuk mund të konsiderohet më thjesht si një shtëpi modeste e librit, por shumë më tepër, një portë e hapur drejt dijës duke ofruar mundësi pafund.

Që në vitin 1957, kur mori udhë Universiteti i Tiranës, bashkë me të hapi dyert dhe biblioteka e tij duke e sjellë të plotë imazhin e botës studentore, edhe pse

brenda kontureve krejtësisht të përcaktuara. Ndër vite studentë, profesorë dhe intelektualë kanë lënë emrat e tyre nëpër skedarët e bibliotekave si lexuesit më të rregullt, si njerëzit e studimit dhe të punës, të rezultateve dhe novacioneve.

Krahas zhvillimit të shoqërisë edhe biblioteka universitare si institucion kërkimor - shkencor dhe arsimor ka fituar fizionominë e saj dhe sot është ndër institucionet më të rëndësishme shkencore në vend.

Bibliotekat e fakulteteve të Universitetit të Tiranës janë:

*Biblioteka e Fakultetit të Mjekësisë;*

*Biblioteka e Fakultetit Histori-Filologji (që mbulon edhe Fakultetin e Gjuhëve të Huaja);*

*Biblioteka e Fakultetit të Drejtësisë;*

*Biblioteka e Fakultetit Ekonomik;*  
*Biblioteka e Fakultetit të Shkencave*  
*të Natyrës;*

*Biblioteka e Fakultetit të Shkencave*  
*Sociale;*

*Biblioteka e Fakultetit të Infermierisë.*

Vitet e fundit bibliotekat e Universitetit të Tiranës po synojnë drejt koleksioneve pa mure dhe gjithë trashëgimia e tyre, e sistemuar nëpër raftë, falë teknologjive kompiuterike, po pasurohet me të dhëna dhe informacione tashmë të pranishme nëpër rrjetë të ndryshme bibliotekash në të gjithë botën. Një fakt domethënës në këtë pikë është edhe krijimi i bibliotekave pranë departamenteve, që po lehtëson shumë komunikimin e studentëve dhe pedagogëve me librin. Përmendim këtu Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, ku pranë çdo departamenti funksionon biblioteka me libra në gjuhën përkatëse. Kështu funksionon biblioteka e Departamentit të Gjuhës Frënge, e Departamentit të Gjuhës Italiane, e Departamentit të Gjuhës Gjermane si dhe biblioteka me libra në turqisht dhe greqisht pranë Departamentit të Gjuhëve Sllavo-Balkanike.

E gjithë kjo po tenton të modifikojë shërbimin tradicional dhe të rrisë mundësinë e përvetësimit të një sasive sa më të madhe informacioni edhe pse rruga për realizimin e këtij shërbimi është e gjatë. Por e rëndësishme është që ka filluar të ecet në të.

Me anë të programeve të ndryshme mbështeten projekte në fushën e bibliotekonomisë, të cilat ndihmojnë në hapjen e shoqërisë shqiptare përmes hyrjes dhe shpërndarjes së informacionit bibliotekar, pasurimit të tij dhe rritjes së nivelit profe-

sional të shërbimit ndaj lexuesit. Nëpërmjet blerjes së librave biblioteka sjell informacion të ri dhe pasuron fondin e saj. Ajo synon përdorimin sa më të gjerë të këtij fondi nga studentët dhe promovon teknologjinë që ndihmon organizimin dhe shërbimin e materialeve që disponon biblioteka.

Ndryshimet e shumta në teknologji, rritja progresive e diversiteteve kulturore, kompleksiteti në rritje, intensifikimi i marrëdhënieve ekonomike, politike dhe sociale janë faktorë që kanë zënë vend në shoqërinë njerëzore këto vitet e fundit. Dhe biblioteka si vendtakim i dijës me njerëzit, i studentëve me botën e pafund të informacionit që ajo rezervon, nuk ka se si të mos i reflektojë këto ndryshime progresiste.

Për të parë konkretisht situatën nëpër bibliotekat e Universitetit, duhen marrë në konsideratë disa faktorë:

**1. Makroambienti,** pra e thënë më qartë faktorët e jashtëm që ndikojnë në punën dhe në përditshmërinë e bibliotekave

Bibliotekat, këto elemente qendrore të shoqërisë së re të informacionit, ndajnë me të nevojën e ndryshimeve organizative thelbësore, që u lejon atyre të përballen në mënyrë efikase me transformimet e ambienteve në të cilat ato operojnë. Bibliotekat e Universitetit janë pjesë e rëndësishme e sistemit edukativ kombëtar dhe luajnë rol jodytësor në brendësi të ambientit social dhe komunitar.

Reforma universitare ka hapur portat e konkurrencës dhe një aspekt i rëndësishëm është ajo çka ndodh në frontin e integritit europian që nuk ka sesi të mos ndikojë edhe në veprimtarinë e Universitetit, duke krijuar lidhje të ndërsjellta mes asaj çka disponon si bibliotekë apo asaj

çka i ofron rruga e gjatë e integritit të shoqërisë sonë në shoqërinë europiane. Nga ana tjetër, rritja e numrit të studentëve dhe zhvillimi i multikulturalizmit kanë rolin e tyre në këtë kuadër. Përsa i përket aspektit teknologjik, gjuha kompiuterike, me të cilën kanë filluar të flasin të gjitha bibliotekat, është një emërues i përbashkët, nën të cilin duhet të vendosen të gjitha veprimet nëpër bibliotekat e universiteteve tona.

**2. Mikroambientin,** puna pra që bëhet brenda në bibliotekë.

Vitet e fundit, nën shtysën e faktorëve të jashtëm që përmendëm më sipër, bibliotekat universitare kanë zhvilluar shërbime speciale po t'u referohemi p.sh. krijimit të bazave të të dhënave, që kanë filluar të marrin një rol të rëndësishëm në rrjetin e informacionit që qarkullon nëpër universitete.

Por, në fakt, bibliotekat duhet të zhvillohen më shumë në drejtim të teknologjisë, ndërsa kualifikimi i stafit dhe përmirësimi i kushteve nëpër sallat e leximit duket se kanë ecur më shpejt se sa futja e teknologjive të reja kompiuterike. Dhe kjo është e kuptueshme nëse u referohemi kushteve konkrete të vendit tonë, ku nuk mungojnë aftësitë dhe përkushtimi, por mundësitë janë të pakta.

Bibliotekat pranojnë se ndryshimet e shpejta përbëjnë sot mënyrën e jetesës së bibliotekave dhe shërbimeve të informacionit. Është detyrë e bibliotekarëve që të menaxhojnë mirë ndryshimet për t'i bërë ato sa më pak të ndikueshme në punën e përditshme të studentëve dhe pedagogëve.

E ardhmja e bibliotekave të universitetit i takon një rrjeti të përbashkët për grumbullimin, përpunimin dhe ndërtimin e bazave të të dhënave, zbatimin e standardeve dhe praktikave të vlerësimit e sigurimit të shërbimeve cilësore. E gjithë kjo do të synojë zbatimin e parimeve konkrete në regjistrimin e kontributit të bibliotekave në kërkime të ndryshme, në mësimdhënie, në përfitimim e dijeve dhe në përgjithësi në zhvillimet e praktikave shkencore të vendit, si edhe në grumbullimin e të dhënave me qëllim vlerësimin e bibliotekave universitare.

Pranohet përgjithësisht se një bibliotekë universitare ka karakter dinamik dhe jo statik. Kjo do të thotë se mënyra e organizimit dhe funksionimit të saj duhet të diferencohet progresivisht dhe të transformohet, në mënyrë që të ecë paralelisht me objektivat arsimore dhe studimore të komunitetit universitar, të cilit i përket. Rritja e përdorimit të teknologjisë, rritja e numrit të informacioneve të botuara si dhe nevoja e hyrjes on-line në to, rrisin preokupimet për ofrimin e shërbimeve të mëtejshme.

Është detyrë e vetë punonjësve të bibliotekave të universiteteve që me rritjen e angazhimit të tyre profesional dhe me përkushtimin ndaj punës dhe risive që sjell koha ta shndërrojnë bibliotekën në një institucion të fjalës, jo vetëm me funksion informues, por edhe krijues.

Shumë veprimtari të organizuara nga drejtuesit dhe punonjësit e bibliotekave, domosdo sigurojnë një qasje në informata, ide dhe krijimtari, në ngritjen e nivelit edukativo-arsimor për të gjithë ata që janë shfrytëzues të bibliotekës.



Prandaj parësore për bibliotekën e universitetit është përzgjedhja dhe organizimi i informacionit, gjë që mundëson ngritjen në një standard më të lartë të nivelit të bibliotekës.

Bibliotekat universitare të Tiranës po shkojnë drejt informatizimit të informacionit dhe mendohet në një të ardhme jo të largët të vendoset në rrjet informacioni i të gjithë fakulteteve të Universitetit të Tiranës.

E ardhmja, edhe pse si nocion i takon diçkaje që do të vijë, ka nisur të projektohet që më parë në mendimet dhe në projektet e përgatitura për t'i dhënë një hapësirë shumëdimensionale punës me librin.

Nga bibliotekat e Universitetit të Tiranës ia vlen të përmendet përvoja e bibliotekës së Fakultetit të Drejtësisë, e cila ka rreth 3 vjet që ka kompiuterizuar informacionin dhe ka krijuar bazën e të dhënave në fushën e drejtësisë, duke qenë kështu e vetmja bibliotekë fakulteti në sistemin universitar të vendit. Për kompiuterizimin e fondit të librave të bibliotekës është përdorur programi WIN/ISIS, instaluar nga Biblioteka Kombëtare. Nëpërmjet këtij programi, pedagogu apo studenti e kërkon librin në katalogun elektronik, që ofron shërbime jo vetëm për studentët dhe pedagogët e Fakultetit të Drejtësisë, por edhe për studentët e Shkollës së Magjistraturës dhe punonjësit e praktikës gjyqësore. Në këtë bibliotekë përdoret gjithashtu programi LH5, me anë të të cilit shumëfishohen skedat. Çdo tre muaj përpilohet një listë bibliografike me librat e rinj që kanë hyrë në fondin e bibliotekës, gjë që e ndihmon lexuesin të

marrë informacion për literaturën e re që mund të shfrytëzojë në këtë bibliotekë.

Rruga nëpër të cilën ka kaluar biblioteka e Fakultetit të Drejtësisë shprehë një që në një të ardhme jo të largët të bëhet rruga nëpër të cilën do të kalojnë edhe bibliotekat e fakulteteve të tjera të UT-së, duke krijuar kështu imazhin e vërtetë të bibliotekës së Universitetit të Tiranës, si prapavijë me rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punëve të studentëve dhe pedagogëve.

Kontaktet e vijueshme me bibliotekat homologe nëpër botë tregojnë se stafit të bibliotekave të Universitetit të Tiranës nuk i mungojnë idetë apo dëshirat, por duhet vëmendje më e madhe nga organet kompetente për krijimin e hapësirave të nevojshme. Që bibliotekat e Universitetit të Tiranës të kalojnë në një stad tjetër zhvillimi, tashmë si një e tërë, si një strukturë me rol të pazëvendësueshëm në mbarëvajtjen e punës studentore dhe të stafit akademik të fakulteteve, duhet realizuar, ndër të tjera, lidhja e Internetit nëpër bibliotekat e fakulteteve dhe vendosja në rrjet e të gjitha bibliotekave. Njehsimi i programit të katalogimit në të gjitha bibliotekat dhe vendosja e programit WIN/ISIS për të gjithë fakultetet do të ishte me interes. Përgatitja e akteve nënligjore për përdorimin e bibliotekave universitare dhe bazave të të dhënave në Internet lidhur me të drejtat e autorit është e domosdoshme. Në këtë pikë mendoj se duhet të bëhen përpjekjet maksimale për t'i dhënë statusin e merituar kësaj biblioteke dhe vendin e munguar në morinë e institucioneve shkencore të vendit.

Kudo qofshin universitetet, ato mbajnë një përgjegjësi tepër të veçantë përmes arsimimit të specialistëve të ardhshëm dhe rezultateve të kërkimit dhe punës shkencore, e cila është thelbësore për zhvillimin e shoqërisë. Në këtë sistem vlerash, padyshim, që biblioteka përbën një pjesë

integrale të nevojshme për vijimësinë me sukses të studimit, kërkimit dhe punës shkencore, si një proces që zhvillohet dhe merr trajta të reja, por gjithnjë në thelb mbetet karakteri dinamik dhe marrëdhënia e dyzuar mes realitetit dhe historisë, mes të shkuarës dhe perspektivës.

### THE LIBRARY OF THE UNIVERSITY OF TIRANA: HISTORY AND FUTURE PROSPECT

*Since 1957, the year when the University of Tirana started its way, opened the door of the library of this university. During the years students, professors, and scholars have left their tracks on the library's catalogues being the most regular readers.*

*Nowdays is indispensable the role of the libraries of the various faculties of the Tirana University, the most prestigious and usefull institutions in serving all the generations.*

*During the last years the libraries of the University of Tirana intend to open a new era, book collections without walls and their heritage due to technological systems and compiuters is enriching itself with information available in various networks and libraries all over the world. At this there is a very eloquent fact: the set up of libraries for every department, which makes things easier and facilitate the communication between the students and their professors with the book.*

# Biblioteka dhe shërbimet e informacionit parlamentar

**Zana BUFI**

Biblioteka e Kuvendit të Shqipërisë

**P**arlamentarët konsiderohen si profesionistë në përdorimin e informacionit. Ata përbëjnë atë që në kuptimin e mirëfilltë të fjalës quhet “asambleja e të folurit” të kombit, apo vendi i shkëmbimit të informacionit.

Por, parlamentarët nuk e konsiderojnë veten si profesionistë në grumbullimin e informacionit. Kjo i dallon ata prej studiuesve ose kërkuesve që përdorin bibliotekat e tyre universitare dhe prej funksionarëve që grumbullojnë dhe përpunojnë burimet e nevojshme për hartimin e një dokumenti. Parlamentarët dëshirojnë të kenë një seleksionim inteligjent dhe kompetent të fakteve e opinionëve, të përgatitura nga ekipi i informacionit të bibliotekës; ata pastaj bëjnë interpretimin e tyre personal mbi faktet. Për realizimin e shërbimit të informacionit parlamentar personeli i bibliotekës nevojitet të ketë aftësi në njohjen e procedurës parlamentare dhe të kuptojë metodat e ndryshme të publikimit të dokumenteve

dhe të debateve parlamentare. Kjo përbën gjithnjë e më tepër dhe objektin e sistemeve të indeksimit të informatizuar.

Faktor që duhet të merret në konsideratë në plotësimin e kërkesave për informacion është koha. Parlamentari ka nevojë për një informacion të shpejtë, të cilin ai mund ta përdorë menjëherë për të dhënë argumentin vendimtar në momentin e duhur, shpesh në publik. Nga ana tjetër, ai nuk ka nevojë për informacion të vjetruar, për shkak se faktet mund të jenë të tejkaluara në momentin kur ato përdoren. Prandaj kërkohet që shërbimet e informacionit parlamentar të realizohen në kohë sa më të shpejtë dhe të ndjekin aktualitetin në vijimësi; një informacion gojor mundet nganjëherë të ketë



dobi shumë më të madhe se një raport me shkrim. Shërbimet e informacionit të kryera nga personeli i Bibliotekës së Parlamentit janë rritur dhe janë organizuar në mënyrë që të “kursejnë” kohën e parlamentarëve.

Një tjetër faktor, që duhet marrë parasysh, krijohet nga fakti se informacioni që i jepet një parlamentar menjëherë mund të bëhet publik. Personeli i informacionit që punon për parlamentarët duhet të pranojë që sapo ata të jenë prononcuar mbi një temë gojarisht ose me shkrim, informacioni i përket parlamentarit, i cili është i lirë ta përdorë atë si të dëshirojë. Ky fakt i jep vlerë të madhe kapacitetit të gjykimit dhe saktësisë së punës të ekipit të informacionit.

Në kërkesat për informacion *parlamentarët nuk pranojnë një hierarki në brendësinë e Asamblesë së tyre*. Kjo nuk është e lehtë për personelin të orientohet në mes të gjithë kërkesave të njëkohshme që vijnë prej parlamentarëve të ndryshëm. Prej tij kërkohet te jetë i gatshëm të trajtojë në kohën e duhur çështje të natyrave të ndryshme si dhe të tregohet i shkathët për të realizuar disa kërkesa në një kohë të shkurtër.

Biblioteka ose shërbimi i informacionit parlamentar nuk mundet të funksionojë vetëm brenda personelit të përhershëm. Shumëllojshmëria e interesave parlamentarë, nevoja e ndjekjes se aktualitetit, vështirësia e orientimit në labirintet e administratës publike dhe faktorë të tjerë, e bëjnë të paevitueshme nevojën e ndihmës nga jashtë bibliotekës. Përvoja e shumë vendeve tregon se në shumicën e rasteve personat dhe organizmat e ftuar për ndihmë kanë vullnet të mirë për t’iu përgjigjur nevojave të parlamentit. Është fjala për format e bashkëpunimit të zakonshëm, si

gadishmëria ose dhënia e materialeve. Nganjëherë ndodhin edhe raste kur ata që ofrojnë ndihmën e tyre të shpeshojnë që informacioni i dhënë personelit të parlamentit të ndjekë rrugën e tij deri në diskutimin publik dhe të forcojnë kështu pozicionin e tyre në një debat të përgjithshëm. Prandaj kërkohet që personeli i bibliotekës të jetë i aftë të ndajë faktet prej opinioneve, për të informuar parlamentarët në mënyrë të qartë.

## Cilat janë burimet e informacionit parlamentar?

Sasi e madhe informacioni jepet nga komisionet, megjithëse punët efektive zhvillohen në seanca plenare. E rëndësishme është që i gjithë ky informacion të sistemohet plotësisht.

*Burimi* i rëndësishëm informacioni është veprimtaria e Qeverisë. Propozimet politike, projektet e ligjeve, raportet mbi veprimtarinë e administratës publike etj. janë gjithashtu burime të cilat përdoren paralelisht me informacionin për veprimtarinë e qeverisë. Por ka edhe fusha të tjera të rëndësishme të informacionit qeveritar, si: bashkësia e raporteve midis qeverisë dhe mediave, komunikatat dhe konferencat e shtypit, komunikimet qeveritare në radio dhe në televizion, veprimtaritë e agjencive të informacionit qeveritar në paraqitjen e politikave dhe të punës së saj të përditshme, që shërbejnë për informimin e parlamentarëve. Burim tjetër janë botimet e shumta të bëra nga qeveria, shpesh të shpërndara falas për publikun, të cilat informojnë qytetarët për të drejtat dhe detyrat e tyre. Një pjesë e madhe e këtij informacioni paraqitet në formën e dokumenteve të

vulgarizuara. Ai mund t'u shërbejë parlamentarëve nga një pikëpamje e dyfishtë. *Së pari*, sepse zgjedhësit e tij janë qytetarë dhe informacioni i Qeverisë mund të jetë i dobishëm për ta. *Së dyti*, sepse zgjedhësit e tij gjenden nën autoritetin e pakufizuar të Qeverisë dhe kjo do të thotë se në një farë mase Qeveria u shfaqet atyre nëpërmjet këtyre publikimeve; ata mund të dëshirojnë që përvojën e tyre të ballafaqimit me politikën qeverisëse dhe administruese ta shkëmbejnë me parlamentarët që ata kanë zgjedhur.

*Burimi i madh i informacionit është ai me origjinë juridike.* Për këtë arsye personeli i bibliotekave parlamentare specializohet në të gjitha fushat e së drejtës për të qenë në gjendje të japë informacion juridik të plotë.

Qarku i informacionit që nisët nga parlamenti, qeveria e pushteti juridik dhe shkon drejt publikut plotësohet nga *mediat*. Është media ajo që krijon çdo ditë skenën mbi të cilën parlamenti lidhet me situatat dhe opinionet e njerëzve për këto situata. Është, pra, shumë e rëndësishme që bibliotekat e parlamenteve t'i kushtojnë kohë të madhe shërbimit të shtypit dhe të organizojnë përdorimin e plotë të tij. Ekziston gjithashtu një nevojë gjithmonë në rritje për të mbledhur informacion në shiritat magnetikë ose në videokaseta që merren nga shërbimet e radiotelevizionit. Në shumë parlamente të botës shërbimet e shtypit janë gjithnjë të gatshme *on-line*. Por, janë shërbimet e informacionit parlamentar ato që nëpërmjet aftësisë seleksionuese dhe trajtimit të shpejtë të tyre vënë në dispozicion të punës së parlamentarëve informacionin e këtyre bazave të të dhënave. Një konceptim i tillë

shpjegon arsyen pse shërbimet e informacionit parlamentar janë mjaft të kush-tueshme. Ato kanë një intensitet të madh pune dhe e justifikohen me rëndësinë e vetë institucionit.

Në kontekstin e çështjeve të trajtuara më sipër, rëndësi të veçantë kanë nismat për bashkëpunim midis bibliotekave dhe qendrave kërkimore parlamentare me qëllim shkëmbimin e informacionit, të cilit i shërben edhe Qendra Europiane e Kërkimit dhe e Dokumentacionit Parlamentar për shërbimet e informacionit parlamentar të shteteve anëtare të Komunitetit Europian dhe të Këshillit të Europës.

## Si janë të organizuara bibliotekat e parlamenteve?

Shumica e bibliotekave parlamentare janë krijuar nga mezi i shekullit të kaluar, pas Kongresit të Vjenës më 1815: në Portugali më 1836, në Spanjë më 1841, në Belgjikë më 1830, në Greqi më 1845, etj. Natyrisht, ato kishin një karakter tradicional në arkitekturën e tyre, në organizimin e shërbimeve dhe, në shumë raste, në kulturën e gjerë humaniste që trajtonin. Në disa vende si në Francë ose në Portugali, ku trashëgimia kulturore e ruajtur prej institucioneve fetare ishte zhdukur, bibliotekat e reja parlamentare morën mjaft koleksione të çmuara. Aktualisht këto përbëjnë probleme suplementare për bibliotekarët e sotëm të cilët kërkojnë të ekuilibrojnë përgjegjësitë e tyre midis konservimit të së kaluarës dhe informacionit që duhet të ndikojë në të ardhmen. Zhvillimet e kohëve të fundit, rritja e ndjeshme e vëllimit të informacionit

për parlamentarët, shtimi i personelit etj. kanë detyruar shumë parlamente, si për shembull në Norvegji, Finlandë ose Mbretërinë e Bashkuar, që një pjesë të madhe të shërbimeve të tyre të pajisura me teknologji të informacionit ta zhvendosin në mjedise të tjera jashtë ndërtesës kryesore të Parlamentit.

Megjithëse misioni kryesor i bibliotekave parlamentare është që t'u shërbejë anëtarëve të parlamentit, vende të ndryshme kanë veçoritë e veta. Në disa raste ndarja midis pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv respektohet me rreptësi edhe nga bibliotekat, prandaj ato mbeten si biblioteka të posaçme për parlamentarët. Në Gjermani dhe Suedi ato kanë detyrë specifike që të ndihmojnë departamentet qeveritare dhe grupet e tjera të veçanta që zhvillojnë veprimtari parlamentare; në Greqi e Finlandë ato i shërbejnë një publiku të gjerë.

Ndryshimet më të rëndësishme dhe më interesante midis parlamenteve shihen në mënyrën se si ato kanë organizuar *shërbimet e kërkimeve* (studimeve hulumtuese), që në të vërtetë janë zhvilluar vetëm pas fundit të Luftës së Dytë Botërore. Në Gjermani dhe në Suedi ato më parë kanë funksionuar në përbërje të bibliotekës, por për shkaqë të ndryshme më pas u kthyen në shërbime të veçanta të pavarura. Në Mbretërinë e Bashkuar ato mbetën në bibliotekë qysh prej krijimit të tyre më 1945, ndërsa në Francë nuk kanë bërë kurrë pjesë në bibliotekë.

Si rregull, bibliotekat parlamentare janë nën kontrollin e kryetarëve të parlamenteve dhe autoriteti i tyre në përgjithësi mund të ushtrohet nëpërmjet një sekretari të përgjithshëm, ose duke e konsideruar bibliotekën si një departament autonom në

kuadrin e shërbimeve parlamentare. Është praktikë shumë e përhapur ajo e krijimit të komisioneve për bibliotekën, në përgjithësi të përbëra nga anëtarë të parlamentit, por që mund të përfshijnë edhe funksionarë, midis të cilëve natyrisht edhe ata të vetë bibliotekës.

Në shumë parlamente personeli i bibliotekave konsiderohet në nivelin e funksionarëve me funksione publike. Në përgjithësi, personeli i bibliotekave ndahet në tri kategori të përgjithshme: administratorë, specialistë (ku përfshihen specialistët e statistikës, shkencëtarët e juristët) dhe personeli ekzekutiv. Niveli akademik i personelit është i lartë dhe nevoja në rritje për specialistë ka bërë që nëpunësit e bibliotekës të hyjnë në kategorinë e mesme. Në bibliotekat më të vogla specialistët priren të marrin rolin e bibliotekarëve konsultues për fusha të ndryshme, ndërsa në ato më të mëdhatë, ata veprojnë si specialistë të fushave të caktuara, shpesh të asistuar nga personeli i kualifikuar. Në Congressional Research Service të Kongresit Amerikan, efektiviteti i të cilit përbëhet nga qindra persona, kjo formulë e fundit është aplikuar deri në krijimin e një Departamenti Konsultimi dhe të disa departamenteve kërkimi për fusha të veçanta.

## Ç'farë shërbimesh realizojnë bibliotekat parlamentare?

Shërbimet tradicionale të bibliotekave parlamentare vijnë në dispozicion të parlamentarëve. Në radhë të parë ato kryejnë me zell të veçantë detyrat e veta të arkivit, duke nënkuptuar këtu koleksionet e plota të akteve parlamentare si dhe botimet



qeveritare. Në disa raste, si në Suedi, arkivat parlamentare janë pjesë e bibliotekës. Meqenëse roli i katalogut mbetet gjithmonë i rëndësishëm, sistemet e klasifikimit janë të shumëllojta dhe për to në biblioteka harxhohet një sasi e madhe energjie me qëllim që të ndiqen qoftë problemet aktuale (sidomos ato kombëtare), qoftë ato të veprimtarisë parlamentare. Meriton të vihet në dukje fakti që shumë biblioteka gjatë viteve tetëdhjetë, dhe sidomos kohët e fundit, kanë eliminuar katalogët tradicionalë të skedave dhe kanë adaptuar sisteme të kompiuterizuara. Të gjitha bibliotekat janë abonuar në një numër shumë të madh periodikësh dhe kanë koleksione të rëndësishme në fushat e statistikës dhe të së drejtës, të cilat janë dy burimet e informacionit mbi të cilat mbështeten të gjitha veprimtaritë e Qeverisë, prandaj janë edhe me interes parlamentar. Fushat e mbuluara nga bibliotekat pasqyrojnë interesat e parlamentarëve, duke dhënë në të njëjtën kohë një pasqyrë të shoqërisë që këta të fundit përfaqësojnë.

Të gjitha bibliotekat mbledhin me zell të madh dokumentacionet e Kombeve të Bashkuara dhe të agjencive të tyre apo të Komunitetit Europian. Pjesë të nxjerra nga shtypi mblidhen, sistemohen dhe botohen në shkallë të gjerë; është e arsyeshme që në këtë fushë të futet gjerësisht përdorimi i sistemeve elektronike të arkivimit mbi disqe optike. Dokumentacioni i shtypit merr një rëndësi të veçantë për të mbajtur në dijeni parlamentarët mbi çështjet e mëdha dhe mbi debatet kryesore politike. Të gjitha bibliotekat japin një shërbim aktiv konsultimi në këtë fushë.

Shërbimet e specializuara në dispozicion të ligjvënësit janë bërë më të natyrshme se dhënia e volumeve, e materialeve të tjera të

shtypura dhe më të vlefshme se fotokopjimi falas. Regjistrimet video të emisioneve televizive po përhapen gjithmonë e më shumë. Mjaft biblioteka botojnë indekse, lista dhe buletine informacionesh mbi koleksionet e librave e të dokumentacionit të veprimtarisë së parlamentit. Botimet më të zakonshme që lidhen me koleksionet janë listat e hyrjeve ose listat e artikujve të shtypit me interes parlamentar. Përsa i përket dokumentacionit parlamentar, si rregull ai botohet në formë të fletoreve të debateve parlamentare ose të dokumenteve (ligjeve) parlamentare. Ka biblioteka që botojnë buletine informacioni mbi punimet parlamentare. Disa biblioteka kujdesen edhe për botime indeksesh me interes më të gjerë, si Bibliografia Vjetore e Botimeve Zyrtare, botuar nën kujdesin e bibliotekës së Parlamentit suedez. Disa prej tyre, si ajo daneze, pas çdo zgjedhjeje legjislative botojnë manualin parlamentar që përmban të dhënat biografike të parlamentarëve. Shumë raporte dhe dokumente të tjera me kërkesë të parlamentarëve, sidomos për subjekte të aktualitetit ose për legjislacionin e kohës, jepen në buletin e Qendrës Europiane për Kërkime dhe Dokumentacion Parlamentar. Disa biblioteka përgatisin manualë të vegjël dhe broshura për aspekte të veçanta të veprimtarisë së tyre; ato kanë edhe një program modest botues të destinuar kryesisht për një publik të jashtëm. Jo të gjitha bibliotekat botojnë raporte vjetore, por ato që e bëjnë këtë, si për shembull Norvegjia, i botojnë ato në serinë e dokumenteve parlamentare.

Megjithëse bibliotekat parlamentare janë të themeluara rreth 100 vjet më parë, vetëm në 30 vitet e fundit ato janë shndërruar në

burim informacioni të rregullt për ligjvënësit. Kjo pjesërisht i dedikohet zhvillimit të përpunimit të informacioneve, që i bën parlamentarët më të varur nga institucionet e financuara nga shteti, dhe shtrirjes gjithnjë e më të gjerë të pushtetit të qeverisë në shoqëritë moderne; në këto kushte, interesat e parlamentit bëhen më të gjera dhe në të njëjtën kohë më të specializuara. Është e kuptueshme që veprimtaria e bibliotekave

parlamentare do të vazhdojë të përbëjë një nga sferat më dinamike të punës së bibliotekave për shkak të natyrës kërkuese të klientëve të tyre. Është një fakt i pamohueshëm që parlamentet e vendeve të ndryshme përballojnë një problematikë të përbashkët dhe kanë nevojë për shkëmbime reciproke informacioni. Probleme të përbashkëta mund të çojnë në zgjidhje të përbashkëta.

### THE LIBRARY AND THE SERVICES OF THE PARLAMENTARY INFORMATION

*Although the parliamentary libraries were founded almost 100 years ago, we may say that only in the last 30 years those became a regular source of information for the lawmakers. This progress must be dedicated to the wide-spread of the legislativ power in the framework of the our modern society. But in this situation the parliamentary concerns becomes more specified and in the same time more complex.*

*The activity of the parliamentary libraries will continue to be one of the more dynamic spheres of the work of the library network regarding the needs of their users. The parlaments of different countries have common concerns and that's why they need to have a mutual exchanging of information. Common concerns might bring you to common solutions.*

*The article argues issues such as which are the sources of parliamentary information, how are organized the libraries of various parlaments, what kind of information do they offer and so on and so forth.*

# Biblioteka Aleksandrina

**Mirlona BUZO**

Biblioteka Kombëtare

**A**leksandrina është një bibliotekë e madhe dhe qendër kulturore buzë Detit Mesdhe si përkujtim i Bibliotekës së Aleksandrisë, më e madhja e lashtësisë, dhe gjithashtu një përpjekje për të ringjallur diçka nga shkëlqimi që përfaqëson ajo periudhë e hershme e studimit dhe diturisë.

*Biblioteka Aleksandrina* nuk është vetëm një bibliotekë. Ajo është qendër e krijimtarisë, kulturës, dialogut dhe tolerancës. Gjithashtu është një platformë e imagjinatës së mendjes njerëzore dhe tempull i dijes. Aleksandria u zgjodh nga Aleksandri i Madh si kryeqytet i perandorisë së tij në vitin 320 p.e.s. dhe shumë shpejt u shndërrua në qytetin më të fuqishëm dhe me influencë në rajon. Biblioteka origjinale e Aleksandrisë u themelua më 288 p.e.s nga Ptolemeu I. Ajo ishte tempull i mendimeve (*Mouseion* në greqisht, *Museum* në latinisht) dhe funksionoi si akademi, qendër studimi dhe bibliotekë. Mendimtarët e mëdhenj të



kohës grumbulloheshin në Aleksandri për të studiuar dhe shkëmbyer idetë e tyre. Biblioteka kryesore ishte vendosur në rajonin mbretëror të qytetit. Ekzistonte edhe një pjesë shtesë që quhej “biblioteka bijë”, e vendosur në Serapeum në pjesën jugperëndimore të qytetit. Nuk është krej-



tësisht e qartë kur u shkatërrua Biblioteka antike e Aleksandrisë. Mendohet të jetë dëmtuar nga zjarri gjatë pushtimit të Jul Cezarit në vitin 48 p.e.s. dhe gjatë ekspeditës ushtarake të Aurelit në vitin 272 të e.r. Në vitin 391 të e.r. u dogjën edhe ndërtesat në Serapeum, çka shënon dhe fundin e këtij institucioni. Në vendin ku 700.000 rrotulla papirusesh mund të depozitonih të gjithë njohuritë njerëzore, qyteti egjiptian i Aleksandrisë - në udhëkryqin midis Europës, Azisë dhe Afrikës - do të ishte vendi më i përshtatshëm për bibliotekën më të madhe të botës antike. Por Biblioteka e ngritur sërishti hapet me një ndërtesë spektakolare, me sistemin katalogues më të përparuar në botë, transport të kompiuterizuar të librave, CD, mikrofilma, lidhje Interneti dhe me një sistem parandalues të zjarrit për të siguruar bibliotekën, e cila nuk duhet të vuajë të njëjtin fat të mëparshëm. Ideja e rigjallërimit të bibliotekës së vjetër daton më 1974, kur u ngrit një komision nga Universiteti i Aleksandrisë dhe zgjodhi vendin për ndërtimin e bibliotekës së re, midis ndërtesës së universitetit dhe bregdetit, pranë vendit ku ndodhej biblioteka antike. Ideja e rikrijimit të bibliotekës së vjetër shumë shpejt u përkrah nga agjenci të ndryshme. UNESCO-ja mbështeti menjëherë idenë e financimit të këtij rajoni mesdhetar si një qendër epërsie kulturore dhe shkencore. Në vitin 1988 u organizua një konkurs arkitekture për të zgjedhur një projekt të përshtatshëm për vendndodhjen dhe pasurinë bibliotekare të tij. Nga 1.400 projekte të paraqitura, fitues u shpall projekti i paraqitur nga Snohetta, një zyrë projektsh arkitekture

norvegeze. Ndërtimi filloi në 1995 dhe ka kushtuar 220 milion \$. Biblioteka u përrua zyrtarisht në 16 tetor 2002. Përmasat e objektit janë shumë të mëdha: biblioteka ka hapësirë për 8 milion libra. Salla kryesore e leximit mbulon një hapësirë prej 70.000 m<sup>2</sup> me 2000 vende leximi. Kompleksi përmban: biblioteka të specializuara për materiale audiovizuale, për të verbrit, fëmijët, të rinjtë, mikroforma, libra të rrallë dhe koleksione speciale, 3 muze (antikitetet, dorëshkrimet, historia e shkencës), dy ekspozita të përhershme, gjashtë galeri për ekspozita të përkohshme, qendër konference për mijëra persona, shtatë institute që mbulojnë: dorëshkrimet, dokumentacionet e trashëgimisë, kaligrafinë dhe shkrimin, studimet për Mesdheun dhe Aleksandrinë, qendra arti, kërkime shkencore, forume për diskutime. Kompleksi pret më shumë se 800.000 vizitorë në vit dhe në të organizohen rreth 500 veprimtari në vit. Arkitektura e bibliotekës është e mrekullueshme. Ndërtesa është 32 m. E lartë me tavanë me panele xhami, me një pjerrësi drejt detit si një diell në perëndim, me diametër prej 160 m. Muret janë prej graniti gri, të mbuluar me shkronja nga 120 shkrime të ndryshme.





## Funksionet e Bibliotekës

*Biblioteka Aleksandrina* ka shumë funksione, përgjegjësi dhe qëllime. Ajo synon të krijojë një qendër ndërkombëtare studimore përmes koleksioneve të saj të librave, revistave, gazetave, burimeve multimedia dhe elektronike. Hapësira e leximit është konceptuar që lexuesi të ketë kontakt të drejtpërdrejtë me burime të shumta (fonde të hapura). Struktura spektakolare dhe komfote krijon atmosferën e duhur për lexuesit e saj. Fondet e hapura paraqesin koleksionet e bibliotekës përmes një hapësire leximi, e cila mund të mbajë 2000 lexues, 200 salla leximi të pajisura me rreth 330 kompiutera. Biblioteka është menduar të ketë një nga sallat e leximit më të mëdha në gjithë botën.

*Biblioteka Kryesore* është e ndarë në 5 biblioteka të veçanta, secila me specialitetin e saj: *Salla kryesore e Leximit*, *Biblioteka Taha Hussein për të Verbrit dhe ata me Aftësi të Kufizuara*, *Biblioteka e Fëmijëve*, *Biblioteka për të Rinjtë dhe Biblioteka e Arteve dhe Multimedia*. Ndërsa librat e rrallë, dorëshkrimet dhe kolek-

sionet speciale trajtohen veçanërisht nga *Qendra e Dorëshkrimeve*.

Të gjitha këto biblioteka të specializuara funksionojnë si një e tërë, duke plotësuar nevojat e një morie lexuesish. Ashtu si një teatër ka ekipin e prapaskenës së tij, edhe sektorët e bibliotekës, përveç stafit profesional, kanë stafin e ndihmës që kujdeset për çdo aspekt të bibliotekës.

Biblioteka përbëhet edhe nga sektorë të tjerë, si: *Bibliotekat e specializuara*, *Shërbimet digjitale të bibliotekës*, *Shërbimet teknike*, *Shërbimet e aksesit*, *Shërbimet publike dhe Shërbimet e artit dhe multimedia*, *Zyra e Biznesit dhe e Buxhetit*

Qëllimi parësor i bibliotekës është të nderojë të shkuarën, të promovojë të tashmen dhe të zbulojë të ardhmen.

## Bibliotekat speciale

Me katër bibliotekat e specializuara Biblioteka u vjen në ndihmë të gjithë përdoruesve të saj. Këto janë: Taha Hussein (Biblioteka për të Verbrit dhe me Aftësi të Kufizuara të të Parit, Biblioteka e Fëmijëve, Biblioteka për të Rinjtë dhe Biblioteka e Arteve dhe Multimedia).

## Biblioteka Taha Hussein

Ofron një koncept të ri mbi nevojat e veçanta të përdoruesve me aftësi të kufizuara të të parit, duke bërë të mundur që ata të kenë akses në të gjitha burimet e bibliotekës. Ajo është e pajisur me paketa programesh të veçanta që i lejon të verbrit të kenë akses në web, në baza të

dhënësh, në OPAC dhe të printojnë materialet që u nevojiten duke përdorur printer Braille. Ndodhen skanera të veçantë që përdorin software të posaçëm për të transferuar tekstet në të folur për t'u dhënë mundësi përdoruesve të lexojnë çdo material të botuar në gjuhë të ndryshme.

## Biblioteka e Fëmijëve

Siguron burime mësimore, argëtuese dhe kulturore për fëmijët 6-12 vjeç. Ajo synon hapjen e një dritareje drejt botës dhe përgatitjen e një gjenerate për të përballuar sfidat në epokën e digjitalizimit. Qëllimi i *Bibliotekës së Fëmijëve* është të zhvillojë të lexuarit, studimin dhe aftësitë krijuese të fëmijët përmes programeve dhe veprimtarive të ndryshme. Kjo bibliotekë përmban rreth 15.170 volume që përfshijnë libra me figura, referenca dhe materiale multimedia.

"My Book Digital and Printed", është një program ku fëmijët mund të lexojnë libra të digjitalizuar në kompiuter ose t'i printojnë ato dhe më pas t'i lidhin. (<http://archive.bibalex.org/mybook/fp/>)

## Biblioteka për të Rinjtë

Kjo Bibliotekës hap një botë të pafund njohurish, argëtime, kulturë dhe informacion për të rinj 12-16 vjeç. Biblioteka u paraqet të rinjve teknologjinë e informacionit, zhvillon diturinë globale, inkurajon bashkëveprimin social brenda dhe jashtë bibliotekës dhe zhvillon aftësitë studimore të tyre.

Biblioteka e të Rinjve është anëtare në IEARN (Rrjeti Ndërkombëtar për Edukimin), me akses në një rrjet ku përf-

shihen mbi 100 vende. Ky rrjet bën që të rinjtë të punojnë së bashku *online* duke përdorur Internetin dhe Teknologjitë e Komunikimit.

## Biblioteka e Arteve & Multimedia

U krijua për të tërhequr sa më shumë përdorues në botën e arteve interaktive. Biblioteka përmban materiale të ndryshme audiovizuale, si: video dhe audiokaseta, CD, DVD, disketa, slajde dhe filma që funksionojnë me pajisje teknike nga më modernet. Koleksioni mbulon subjekte të ndryshme si: edukimi, besimi, kultura, politika etj. Biblioteka multimedia ka dy mjedise për përdoruesit: mjedis për punë me grupe dhe mjedis me poste individuale.

## Departamenti i Dorëshkrimeve

Është i një rëndësie të veçantë dhe përbëhet nga dy institucione akademike: *Qendra e Dorëshkrimeve* dhe *Muzeu i Dorëshkrimeve*. *Qendra e Dorëshkrimeve* përbëhet nga një numër sektorësh të integruar, të cilët veprojnë në bashkëpunim të ngushtë me *Muzeun e Dorëshkrimeve*. *Qendra e Dorëshkrimeve* përmban këta sektorë:

### *Spektori i Botimit të Trashëgimisë.*

Objekti kryesor i tij është ruajtja e dorëshkrimeve dhe librave të rrallë nga dëmtimi i mundshëm, nga kontakti direkt ose kushtet e ruajtjes. Specialistët e grafikës, duke përdorur skanera të teknologjisë së lartë ose aparate të fuqishme



digjitalë, marrin imazhet e dorëshkrimeve dhe kryejnë procesin e digjitalizimit. Këto kopje ruhen në CD, kështu një variant i digjitalizuar i dorëshkrimit është i aksesueshëm në ekranët virtualë të shfletueshëm me anë të të prekurit. Kjo mënyrë realizon dy qëllime: *së pari* dorëshkrimi origjinal ruhet nga kontakti direkt dhe është i ruajtur; mbijetesa e dorëshkrimit është e garantuar për shekujt që do të vijnë. *Së dyti*, bëhet reklamimi i koleksioneve të rralla, pa patur kontakt direkt me përdoruesit.

Spektori vepron në dy fusha paralele: *Së pari* përgatiten botimet elektronike në CD. Këto botime realizohen në kuadrin e projektit: *Biblioteka Digjitale e Dorëshkrimeve*. Botimi i parë në CD përmban koleksionin e dorëshkrimeve më të rralla të Bibliotekës. Botimi i dytë në CD paraqet disa materiale të rralla të koleksionit të trashëgimisë islame në xhaminë e *al-'Arif bi-Allâh Abû al-'Abbâs al-Mursî*. Punohet për CD-në e tretë, e cila përmban një koleksion të shquar të dorëshkrimit të Institutit Fetar të Smuas. CD e katërt do të përmbajë dorëshkrime të zgjedhura nga koleksioni i Bibliotekës së Universitetit të Uppsala-s (Suedi). Spektori zotëron një program të sofistikuar për shfletimin virtual të dorëshkrimeve, i cili lejon përdoruesit të kthejnë faqet e ndryshme të dorëshkrimit origjinal përmes prekjes me gisht të ekranit. Kështu përmes këtij programi është bërë e mundur edhe paraqitja e Papirusit të Vjenës, i cili është e vetmja shenjë e mbijetuar nga Biblioteka antike e Aleksandrisë. Veç kësaj sektori ka përgatitur një vizitë virtuale të ekspozitave të ndryshme të muzeut,

që mund të jetë i aksesueshëm nga çdo vend i botës. *Së dyti* sektori përgatit botime në formë të shtypur. Gjithashtu dalin edhe botime në seri si: *Multilingual Heritage Publishing*, dhe *Catolog of Selected Rarities* të Bibliotekës Aleksandrina.

### ***Spektori i Restaurimit (Laboratori).***

Përveç riparimit dhe dezinfektimit të librave në përdorim, sektori ka punësuar specialistë të kualifikuar, të cilët kanë ndërmarrë restaurimin e dorëshkrimeve, librave të rrallë dhe hartave. Dorëshkrimet dhe librat e rrallë i nënshtrohen trajtimit kimik përpara fillimit të punës së riparimit. Më pas dorëshkrimet restaurohen, mblidhen dhe lidhen në formë manuale. Këto lidhje pajisen me kapakët origjinalë të restauruar. *Së fundi*, njësitë e restauruara ruhen në kuti të posaçme. Laboratori është i pajisur me një makinë për përpunimin e librave të rrallë. Që nga krijimi i tij në vitin 1996 sektori ka restauruar 166 dorëshkrime, 1102 libra të rrallë, 67 harta të vjetra.

***Spektori i aktiviteteve akademike dhe përkthimeve speciale.*** Tashmë i ngarkuar me përkthime speciale të trashëgimisë nga/ose në arabisht, anglisht, frëngjisht, italisht, spanjisht dhe greqisht, sektori mbështet orientimin akademik të Qendrës drejt një sërë detyrash të integruara. Ai koordinon veprimtaritë dhe ngjarjet ndërkombëtare akademike me veprimtaritë e organizmave paralele në vende të tjera. Organizon programe trajnimi për stafin e Qendrës dhe Muzeut të Dorëshkrimeve.



## Koleksionet e Bibliotekës

Biblioteka Aleksandrina krenohet me koleksionet e saj, të cilat përfshijnë shumë subjekte që nga artet deri te zoologjia. Ajo përpiket të rritë pasurinë intelektuale dhe të plotësojë nevojat specifike të përdoruesve të saj dhe ka një politikë të qartë të zhvillimit të koleksioneve. Kjo politikë vendos parimet që drejtojnë zgjedhjen dhe ruajtjen e materialeve të bibliotekës dhe prioritetet e zhvillimit të koleksioneve të saj.

Biblioteka e Re është projektuar për të strehuar 8 milion vëllime, nga të cilat 500.000 në fonde të hapura brenda sallës kryesore të leximit dhe 7.5 milionë në fonde të mbyllura. Pjesa më e madhe e librave që ndodhen në hollin kryesor të leximit janë klasifikuar sipas Sistemit Dhjetor të Djuit. Koleksionet e përgjithshme përfshijnë materiale të shtypura të të gjitha llojeve: libra, periodikë, punime konferencash, harta, materiale referuese etj.

Bibliotekat speciale dhe koleksionet speciale përfshijnë materiale multimedia, disertacione dhe njësi të tjera unike etj. Veç materialeve të shtypura, biblioteka

siguron akses në shumë burime elektronike me vlerë.

Fondet e mbyllura nuk janë direkt të aksesueshme nga publiku dhe mund të kenë kufizime të ndryshme në përdorimin e tyre për shkak të vjetërsisë, gjendjes fizike, vlerave ose kritereve të tjera të vendosura. Të gjitha këto njësi në fonde të mbyllura mund të shihen me kërkesën e përdoruesit pranë mjedisit të shërbimit referues.

Në përputhje me traditën, Historia e Shkencës është subjekti i dytë i interesit të veçantë për Bibliotekën Aleksandrina, i demonstruar nga Muzeu i Historisë së Shkencës vendosur në Planetarium. Zhvillimi i shpejtë i shkencës dhe teknologjisë ka rritur kërkesat etike, veçanërisht në fushën e bioteknologjisë dhe klonimit. Në fushën e shkencës, etika e Shkencës dhe teknologjia, gjenetika dhe bioteknologjia janë thelbësore në planin e zhvillimit të koleksioneve. Duke luajtur një rol të rëndësishëm si një burim kryesor informacioni për vendet e Lindjes së Mesme, biblioteka i jep prioritet edhe zhvillimit të subjekteve të tilla si: Përkatesia gjinore, Uji dhe Mjediti.

Gjithashtu biblioteka përpiket të demonstrojë shkrimet e ndryshme dhe marrëdhëniet midis tyre. Kjo bibliotekë është fokusuar edhe në aspektet teknike të shkrimit e shtypit (historia e shtypit) si dhe aspekte artistike të shkrimit të demonsttruara në kaligrafi.

Përdërisa Egjipti është djep i qytetërimit, është e natyrshme që kjo bibliotekë t'i japë rëndësi egjiptologjisë në zhvillimin e koleksioneve të saj. Qëllimi është të

ndërtohet një koleksion shumëgjuhësh për të gjithë lexuesit, duke përfshirë si profesionistët e egjiptologjisë ashtu edhe turistët.

## Koleksionet speciale

Përveç shërbimeve të mësipërme, biblioteka gjithashtu siguron edhe shërbime të tjera përmes koleksioneve të veçanta të saj, si:

*Sektori i Nobel-it.* I vendosur në katin e tretë, ky sektor është dhuratë nga miqtë skandinavë të kësaj biblioteke. Sektori përbëhet nga Salla Nobel, Salla Gad Rausing dhe Salla Soderberg. Salla Nobel siguron akses për studiuesit e interesuar në letërsi. Është një sallë madhështore që përmban koleksionet e librave të Çmimit Nobel në Letërsi nga 1901-2003. Veprat janë në gjuhën origjinale të shkrimtarëve dhe me përkthime në gjuhën arabe, angleze dhe franceze.

*Auditori Gad Rausing,* i quajtur këshu për nder të familjes suedeze Rausing, përbëhet nga një dhomë e vogël leksionesh, që mund të përdoret për forume të ndryshme ose për shkëmbim përvoja ndërmjet studiuesve.

Në *Sallën Söderberg,* të quajtur me këtë emër për nder të familjes Söderberg, e cila kontribuoi në financimin e Sektorit të Nobel-it, përdoruesit kanë akses në Muzeun e Nobel-it i depozituar në dy kompiutera. Qëllimi i këtij projekti është të informojë përdoruesit për Çmimet Nobel, t'u ngjallë interesin studentëve për fituesit e këtij çmimi dhe t'i reklamojë publikut rëndësinë e shkencës, letërsisë dhe paqes. Ky është një muze virtual që përm-

ban këto informacione digjitale.

*Koleksioni i dokumenteve qeveritare.* Ky është një koleksion i dokumenteve qeveritare dhe agjencive të tjera si Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi European, organizata të specializuara ndërkombëtare dhe agjenci të tjera botuese qeveritare. Objektivat parësore të kësaj qendre të informacionit janë: sigurimi, organizimi dhe shpërndarja e botimeve të prezantuara nga agjencitë dhe organet e ndryshme qeveritare dhe siguri mi i shërbimeve referuese dhe informuese lidhur me historinë, veprimtarinë, strukturën dhe botimet e organizmave që përbëjnë koleksionin e dokumenteve qeveritare.

## Biblioteka Aleksandrina - bibliotekë digjitale për shekullin XXI

Veç funksioneve tradicionale të shërbimit fizik të vizitorëve, depozitimit dhe shtimit të dorëshkrimeve dhe koleksioneve të saj, biblioteka synon të bëhet një institucion i vërtetë digjital për të ardhmen. Për të qenë një bibliotekë për epokën e digjitalizimit, ajo ka krijuar një Departament të fuqishëm të Teknologjisë së Informacionit dhe ka adoptuar digjitalizimin e informacionit kudo që të jetë e mundur. Në sajë të partneritetit është përfshirë në programe të tilla si:

*Shfletimi virtual (Virtual Browser):* Ky program bën të mundur për lexuesit të shohin një dorëshkrim, të shfletojnë faqet e tij, të zmadhajnë pjesën që dëshirojnë, të gjejnë menjëherë përkthimin dhe të dëgjojnë komente dhe shpjegime lidhur me të.



*Biblioteka digjitale e dorëshkrimeve:* Objekti kryesor i këtij projekti është të ruajë dorëshkrimet dhe librat e rrallë nga dëmtimet që rezultojnë nga kontakti direkt ose kushtet e ruajtjes. Digjitalizohen këto dorëshkrime dhe librat e rralla. Më pas kopjet ruhen në CD, kështu që ato janë në dispozicion të shumë lexuesve njëkohësisht, të cilët ndihmohen të përballen me sfidën e epokës së digjitalizimit. Kopja e parë e CD-së mbahet, të tjerat shpërndahen.

*Biblioteka digjitale arabe:* Kanë filluar përgatitjet për një projekt që lidhet me krijimin e një biblioteke të integruar arabe në Internet. Gjithashtu kjo bibliotekë do të synojë të paraqesë libra të saj të përkthyer në anglisht.

*Shërbime të integruara digjitale të bibliotekës:* vizitorët e website-it të bibliotekës përfitojnë nga shërbimet e ndryshme të saj. Ata njihen me politikat e bibliotekës, prioritetet dhe veprimtaritë. Website hedh dritë mbi shërbimet e bibliotekës, pasurimin dhe materialet, të cilat janë të disponueshme.

*Huazimi ndërbibliotekar i materialeve digjitale:* Biblioteka do të adoptojë këtë koncept si një pjesë kyçe të strategjisë së saj. Kështu një përdorues nga çdo bibliotekë e vendit do të jetë në gjendje të ketë akses në veprat e digjitalizuara. Nëse kërkohet libër ose video, këto janë të disponueshme në çdo bibliotekë tjetër.

## Vizioni për të ardhmen

Ekziston një plan për përhapjen e qendrave arkivore në Internet në mbarë botën. The Internet Archive (IA) u krijua nga Brewster Kahle në ShBA. Qendra e parë është vendosur në Kaliforni, e dyta në *Bibliotekën Aleksandrina* dhe më pas në Europë dhe Azi me qëllim krijimin e bibliotekës universale digjitale, e cila synon ruajtjen e trashëgimisë humane dhe sigurimin e aksesit për të gjithë këtë trashëgimi.

Internet Archive në *Bibliotekën Aleksandrina* përfshin koleksione web-i nga viti 1996 deri 2006, 2000 orë transmetim të televizionit egjiptian dhe amerikan dhe 1000 filma arkiv. Ajo paraqet 1.5 petabits të të dhënave të depozituar në 880 kompiutera. Arkivi është plotësisht i shfrytëzueshëm dhe koleksioni aksesohet përmes adresës <http://archive.bibalex.org>.

Ky do të jetë fillimi i një tendence ndërkombëtare drejt digjitalizimit të përmbytjes së bibliotekave dhe krijimit të bibliotekave ndërkombëtare. Partneriteti do të përfshijë edhe biblioteka të tjera me qëllim krijimin e një sistemi universal digjital të bibliotekave. Ndërsa Biblioteka e Aleksandrisë mbante memorjen e njerëzimit nëpërmjet papiruseve, *Biblioteka e Re Aleksandrina* do të mbajë memorjen e re digjitale të njerëzimit përmes Internetit.

## REFERENCA

---

Annual Report of BA, 2005

The Bibliotheca Alexandrina: a truly digital library for the 21<sup>st</sup> century. The internet Archive: toward to universal access to all human knowledge

Abdelaziz Abid

Information Society Division, 2003

UNESCO, library development and the World Summit on the information society

Marwa El Sahn

The multimedia library at Bibliotheca Alexandrina, 2003

The ancient library of Alexandria and the re-built of the modern one

Sameh M. Arab

The latest wonder of the world

Brian Whitaker, 2000

Web site of Bibliotheca Alexandrina

### THE BIBLIOTHECAE ALEXANDRINA

*The Bibliotheca Alexandrina is a major library, cultural center, science and academic research located on the shore of the Mediterranean Sea in the Egyptian city of Alexandria. It is both a commemoration of the Library of Alexandria that was lost in antiquity and an attempt to rekindle something of the brilliance that this earlier center of study and erudition represented. Whereas the Ancient Library of Alexandria kept the memory of humanity through papyrus scrolls, the New Library of Alexandria will help keep the new digital memory of humanity through the Internet.*

# Bibliotekat publike në Spanjë

**Odetta MEMA**

Biblioteka Kombëtare

Spanja ka një popullsi prej më shumë se 41 milion banorësh dhe një sipërfaqe prej 504.782 km<sup>2</sup>. Ajo ndahet në 17 rajone të mëdha autonome dhe ka 8.006 bashki.

Organizimi i bibliotekave publike spanjolle është bërë sipas strukturës së decentralizuar të vendit. Kështu, sipas vartësisë së tyre administrative, ato mund të klasifikohen në tre grupe kryesore: biblioteka publike shtetërore, biblioteka në vartësi të rajoneve autonome dhe bibliotekat e bashkive në vartësi të qeverisjes vendore.

A) 51 bibliotekat publike shtetërore, të vendosura kryesisht në kryeqytetet e provincave, varen nga Ministria e Kulturës nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Librit, Arkivave dhe Bibliotekave. Shteti ka përgje-gjësinë e bashkërendimit dhe automatizimit të tyre, ndërsa autoritetet rajonale janë përgjegjëse për menaxhimin, buxhetin dhe stafin. Ky është padyshim grupi i bibliotekave publike më të pajisura dhe më të mira të vendit dhe roli i tyre në sigurimin e materialeve për lexim, të shërbimeve të informacionit dhe të huazimit ndërbibliotekar ka qenë gjithmonë i rëndësishëm. Këto biblioteka përgjithësisht kanë burimet më të mëdha dhe ofrojnë shërbimet më të përparura dhe moderne.

B) 171 bibliotekat e tjera publike ose rrjetet e bibliotekave varen drejtpërsëdrejti nga rajonet autonome, të cilat janë përgjegjëse për krijimin, bashkërendimin dhe zhvillimin e bibliotekave brenda territoreve të tyre përmes sigurimit të mbështetjes profesionale dhe financiare.

C) Por shumica e bibliotekave publike spanjolle (3.541) financohen nga autoritetet vendore. Ligji i administratës vendore para-shikon detyrimin për sigurimin e shërbimeve të leximit publik në qytete me mbi 5.000 banorë. Megjithatë, një numër i madh bashkish me më pak se 5.000 banorë gjithashtu sigurojnë shërbime bibliotekare. Në disa qytete të mëdha ka rrjete metropolitane të bibliotekave publike.

Gjatë 20 viteve të fundit në bibliotekat publike spanjolle ka patur një rritje të rëndësishme të ritmeve të zhvillimit dhe të modernizimit (ndërtesa dhe pajisje, koleksione dhe shërbime, staf dhe menaxhim). Bibliotekat publike janë shërbimi kulturor më i gjerë në Spanjë. Ka 4.441 pika shërbimi bibliotekar në më se 4.930 bashki, në të cilat jeton 92% e popullsisë.

Prej kohësh bibliotekat publike në Spanjë janë përpjekur të krijojnë ndërmjet tyre marrëdhënie të atilla që të lehtësojnë arritjen e objektivave të veta. Përvoja çoi në bindjen që asnjë bibliotekë vetëm me

forcat e saj nuk mund të kënaqë kërkesat e lexuesve, sidomos në kushtet e shtimit marramendës të prodhimit të librave dhe materialeve të tjera informuese. Bashkëpunimin ndërmjet bibliotekave publike u



provua si mënyra më e përshtatshme për të lehtësuar grumbullimin, përpunimin dhe shërbimin e të gjithë informacionit të mundshëm.

Biblioteka publike moderne në Spanjë lindi në shekullin e 19-të, kur shteti u erdhi në ndihmë autoriteteve lokale apo mori përgjegjësinë e drejtpërdrejtë në ngritjen dhe mirëmbajtjen e shërbimit bibliotekar për të gjithë pjesëtarët komunitetit. Në këtë mënyrë, për të mbajtur në kontroll këto shërbimeve apo për të lehtësuar përhapjen e planifikuar të tyre në të gjithë territorin, apo ndoshta për të dy këto motive, filluan të zhvillohen strukturat organizative, që e ngritën shërbimin bibliotekar në një shkallë më të lartë.

Fryt i këtyre dy tendencave është lindja e tipeve të strukturave që parandalojnë funksionimin e veçuar apo të pavarur të bibliotekave. Në këtë aspekt mund të flitet për sistem të bibliotekave, qëllimi i të cilit sendërton vullnetin politik të administratës përkatëse për të organizuar apo rregulluar funksionimin e shërbimit bibliotekar. Që në fillim sistemi i bibliotekave publike u zhvillua në drejtim vertikal nga lart poshtë, duke krijuar një kornizë të përbashkët dhe disa mekanizma të bashkëveprimit për të organizuar dhe shpërndarë shërbimin e bibliotekave në një hapësirë gjeografike të përcaktuar. E gjitha kjo nuk bie ndesh me parimin e decentralizimit, por mbështet bashkërendimin e punëve të sistemit të bibliotekave publike.

Kështu, mënyra e organizimit përcaktohet dhe nxit marrëdhënie bashkëpunimi ndërmjet këtyre bibliotekave të integruara në aspekte të ndryshme, si: zhvillimi i koleksioneve, përpunimi teknik i

fondeve, automatizimi i shërbimit dhe shkëmbimit bibliotekar, ruajtja e fondeve, kualifikimi i vijueshëm i personelit bibliotekar etj. Në fund të fundit, ajo që ka rëndësi të konstatohet është fakti që efektiviteti i punës së bibliotekave publike të veçuara do të ishte i ulët, ndaj edhe janë krijuar rrjetet dhe sistemet.

Kërkesat në rritje të një popullate përherë e më të formuar, që pretendon më shumë nga shërbimi publik, përballohen përmes punës në grup dhe mundësive në rritje të sigurimit të sasive të mëdha të informacionit në kushtet aktuale të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Shërbimet e bibliotekës publike sot edhe në këtë vend nuk mund të konceptohen në formë të veçuar, por vetëm brenda kornizës integruese të bashkëpunimit, e çfarëdo lloji qoftë kjo, që vendos lidhje mes bibliotekave dhe institucioneve të ndryshme nga të cilat ato varen.

Elemente të rëndësishme të sistemeve bibliotekare spanjolle janë organet tekniko-administrative dhe ato këshillimore. Këto të fundit zakonisht nënkuptojnë këshillin e bibliotekës, i cili përbëhet nga pjesëtarë të brendshëm, në varësi të postit që mbajnë, dhe pjesëtarë të emëruar, zakonisht nga fusha të tjera të jetës qytetare. Këto organe këshillimore nuk ndërhyjnë në kompetencat e organeve të nivelit administrativ.

Peshën më të madhe e mbajnë, pra, organet tekniko-administrative, të cilat janë të ngarkuara me planifikimin, bashkërendimin, mbështetjen dhe inspektimin e bibliotekave publike. Normalisht bëhet fjalë për Ministrinë e Kulturës apo ndonjë organ tjetër ekuivalent në administratën

lokale. Ekzistenca e shërbimit bibliotekar (por edhe atij arkivor, muzeor etj.) parashikohet sipas normativave të përcaktuara qartë.

Funksionet e planifikimit dhe bashkërendimit, që kryejnë këto organe, shprehen kryesisht në instrumente konkrete që ndihmojnë orientimin e politikës bibliotekare, kryesisht instrumente të planifikimit vjetor, gjithnjë në varësi të buxhetit. Në disa bibliotekave publike të përparuara vihet re ekzistenca e planeve më të mëdha dhe më të drejtuara për zhvillimin e bashkërenduar të shërbimeve bibliotekare në territorin e një komuniteti. Këto plane zakonisht përmbajnë studimin e situatës reale të shërbimeve në një moment të caktuar dhe në të njëjtën kohë edhe vizionin për përmirësimin e këtyre shërbimeve në të ardhmen.

Funksion tjetër i përbashkët i të gjitha organeve tekniko-administrative është krijimi dhe mirëmbajtja e një regjistri të bibliotekave publike, i cili shërben si element bazë i drejtimit dhe kontrollit të sistemit. Zakonisht detyra e mbledhjes së informacionit statistikor mbi bibliotekat u ngarkohet këtyre organeve.

Konfigurimi i organeve tekniko-administrative ndryshon në funksion të faktorëve të ndryshëm. Në shumicën e komuniteteve autonome, që në Spanjë përfshijnë disa provinca, funksionet e tyre ushtrohen nga bibliotekat qendrore të komunitetit që konceptohen si institucione me një rol të rëndësishëm në përpilimin e politikave bibliotekare lokale. Në këto raste shtrirja territoriale dhe popullsia së cilës do t'i shërbehet janë një arsye për të përqendruar funksionet dhe për të

favorizuar në të njëjtën kohë një lidhje më të fortë mes orientimeve të bibliotekës qendrore dhe atyre të bibliotekave të tjera.

Elemente të tjera thelbësore të sistemit të bibliotekave janë edhe qendrat bibliotekare, të cilat kanë "kompetenca lokale" që lidhen me bibliotekat publike të një ndarjeje territoriale të caktuar. Qendrat bibliotekare organizohen në një strukturë piramidale, në majën e së cilës është një bibliotekë, e cila funksionon si kokë e sistemit (mbledhja dhe konservimi i prodhimit bibliografik rajonal, përpilimi i bibliografive, katalogëve përmbledhës etj.). Kjo bibliotekë, e emërtuar sipas lokalitetit ku vepron, konsiderohet kështu drejtuese e sistemit. Detyrë kryesore e saj është bashkërendimi teknik i punëve dhe krijimi i lidhjeve me sistemet e tjera të bibliotekave vendase dhe të huaja.

Përsa u përket bibliotekave publike të lagjeve, që shërbejnë shumicën e qytetarëve spanjollë, duhet thënë se ato janë krijuar nga autoritetet lokale, por me mbështetjen e një administrate më të lartë. Autoritetet lokale, p.sh. bashkitë, fillimisht ishin ngarkuar të siguronin mjediset dhe personelin e këtyre bibliotekave si edhe të krijonin fondin libror themelues, pastaj të mbështesnin rritjen e tij etj.

Përveç shërbimeve fikse, pothuajse në të gjitha bibliotekat publike është parashikuar një shërbim bibliotekar lëvizës me synimin që nëpërmjet tij t'i shërbehet asaj pjese të popullsisë, e cila, si pasojë e shpërndarjes gjeografike, e ka gati të pamundur të shfrytëzojë shërbimet e zakonshme bibliotekare.

Mund të thuhet se në Spanjë ka gjetur zbatim porosia e shprehur në *Manifestin*

e UNESCO-s mbi bibliotekat publike, sipas të cilës për të siguruar bashkërendimin dhe bashkëpunimin e bibliotekave në nivel kombëtar, legjislati dhe planet strategjike duhet të përcaktojnë dhe promovojnë një rrjet bibliotekash në nivel kombëtar, bazuar në norma të pranuar të shërbimit.

Si kudo, edhe në Spanjë asnjë bibliotekë më vete, sado e madhe qoftë dhe sado fonde që të ketë, nuk mundet të kënaqë si duhet kërkesat e lexuesve të saj. Për këtë arsye janë krijuar mekanizma të përbashkëta të punës që lejojnë përmbushjen në një shkallë më të lartë të kërkesave të përdoruesve, sidomos në kushtet e burimeve financiare të kufizuara. Në shumicën e rasteve, lidhjet mes bibliotekave publike janë të varura, në radhë të parë, nga distanca mes tyre, e kushtëzuar kjo shpesh nga ndarja territoriale. Por bëhen përpjekje që lidhjet dhe marrëdhëniet mes bibliotekave të mos reduktohen vetëm te kapërcimi i pengesave territoriale të tilla dhe të shtrihen në të gjitha nivelet, kombëtar apo ndërkombëtar.

Siç u tha më lart, bibliotekat publike nuk kufizohen vetëm me marrëdhëniet me bibliotekat simotra, por janë të hapura për bashkëpunim edhe me shërbimet apo sistemet e tjera (bibliotekat shkollore, universitare, të specializuara etj.) si edhe me shërbime të tjera të karakterit edukativ dhe kulturor. Duket se mirëkuptimi dhe dëshira e përbashkët është kyçi i suksesit të efektivitetit të bibliotekave publike.

Në Spanjë ndryshimet politike dhe sociale të tre dekadave të fundit kanë favorizuar një zhvillim të paparë të shërbimit në bibliotekat publike. Në të

njëjtën kohë është nxitur edhe krijimi i strukturave të bashkëpunimit dhe bashkërendimit, të përshtatura me realitetin administrativ, me synim që të favorizohet mundësia e sigurimit të këtij shërbimi për të gjithë qytetarët.

Natyrisht që traditat e zonave të ndryshme kanë qenë një element thelbësor që ka kushtëzuar përmirësimin këtij shërbimi, por dëshira për të përparuar në këtë drejtim ka qenë e pranishme në të gjithë organizmat e përfshirë në këtë proces zhvillimi, gjë që ka çuar në parime dhe politika konverguese si edhe në objektiva të përbashkët.

Që nga viti 1985, kur me ligj u vendos si i detyrueshëm një shërbim bibliotekar publik në të gjitha njësitë administrative me më shumë se 5.000 banorë, ka patur një ndërgjegjësim dhe përparim të konsiderueshëm të autoriteteve lokale, të cilat gjithnjë e më mirë e kanë kuptuar se një nga rrugët më efektive për të lehtësuar aksesin në kulturë dhe informacion të qytetarëve është zhvillimi i bibliotekave publike. Në të njëjtën kohë, autoritetet lokale kanë marrë përsipër sfidën për përmirësimin e këtij shërbimi dhe, mbi të gjitha, promovimin dhe krijimin e strukturave të konsoliduara të marrëdhënieve mes bibliotekave, të cilat lejojnë një shpërndarje më të gjerë dhe një përmirësim të shërbimit për publikun si edhe një përdorim më efikas të burimeve publike.

Përgjithësisht pranohet që mbetet ende për të bërë si për të përmirësuar bibliotekat publike, ashtu dhe për të vendosur lidhje dhe sisteme më produktive, çka nënkupton që autoritetet përkatëse të marrin përgjegjësitë që u takojnë, kryesisht që,



në nivel lokal apo nacional, të planifikojnë burimet e nevojshme financiare për të vendosur dhe mirëmbajtur një shërbim modern në bibliotekat publike duke krijuar kështu mundësi për një menaxhim sa më të frytshëm të tyre. Në këtë rrafsh, i kushtohet rëndësi e veçantë sidomos vendosjes së marrëdhënieve bashkëpunuese për organizimin e shërbimeve të përba-

shkëta për të gjitha bibliotekat, si forma më e gjetur për të përdorur sa më mirë burimet financiare gjithmonë të kufizuara.

Në përfundim, mund të thuhet se përvoja spanjolle dëshmon se edhe në fushën e bibliotekave publike bashkimi i përpjekjeve jep një rezultat gjithmonë më të mirë se në rastet e një funksionimi të veçar të tyre.

### Sa biblioteka publike ka në Spanjë?

Njësi administrative	Pika shërbimi brenda ndërtesave	Biblioteka lëvizëse	Totali i shërbimeve
3.658	4.370	71	4.441

Ka 3.358 bashki me pika shërbimi brenda ndërtesave dhe 1.806 bashki të mbuluara nga biblioteka lëvizëse. Po ashtu ka 71 biblioteka lëvizëse që operojnë në

10 nga 17 rajonet. Në vitin 2002 kishte një mesatare prej 9.298 banorësh për një pikë shërbimi bibliotekar në të gjithë vendin.

### Koleksionet

Libra	Dorë-shkrime	Materiale audiovizuale	Materiale elektronike	Mikro-forma	Hartografi	Muzikë	Grafike
4528 217	17887	242853 0	338790	440129	30894	6746 3	2850 90

Koleksionet e bibliotekave spanjolle numërojnë 48.890.970 njësi ose 1.18 kopje për frymë. Materialet e shtypura përfaqësojnë 92% të koleksioneve të

bibliotekave publike. Materialet e reja - audio dhe video kasete, CD - zenë 5.6% të numrit total.

## PUBLIC LIBRARIES IN SPAIN

*As regards the legal framework, the Spanish library system is defined as a set of basic regulations of general application for the whole country. However, most regions have their own library Act, which establishes the framework of the library system in their territory. According to their administrative dependence, libraries can be classified into three main groups: State libraries, libraries depending on the Autonomous Communities (regional authorities) and municipal libraries that depend on local government.*

*The 51 **State Public Libraries**, located in the province's capital city (with some exceptions), depend on the Ministry of Education, Culture and Sport through the Directorate General of Book, Archives and Libraries. The State is in charge of their co-ordination and automation, while the Autonomous Regions are responsible for their management, budget and staff.*

*Some other **public libraries** (171) or **library networks** depend directly on the **Autonomous Communities**. The regional Governments are responsible for the constitution, coordination and development of library systems within their territories, providing both technical and financial support.*

*But most Spanish **public libraries** (3541) are run and funded by **local authorities**. There is a basic Act for local administration which establishes the obligation to provide public reading services in those towns with more than 5.000 inhabitants.*

*In the last 20 years, an important increase in rates of development and modernisation has taken place in Spanish public libraries (buildings and equipment, collection and services, staff and management). Public libraries are the most extended cultural service in Spain. There are nearly 4100 library service points in more than 3000 municipalities, where 92% of the population lives. All this data confirms the key role of public libraries in meeting the challenges of the Information Society.*

# Direktiva të Këshillit të Europës/ EBLIDA për legjislacionin dhe politikat bibliotekare në Europë<sup>1</sup>

## Hyrje

Bibliotekat përbëjnë një pjesë thelbësore të infrastrukturës kulturore, arsimore dhe informuese të shoqërisë. Përveç kësaj, ato formojnë një pjesë të pazëvendësueshme të trashëgimisë kulturore. Kjo ide është veçanërisht e rëndësishme në Europën bashkëkohore për një sërë arsyesh:

### i.

ajo garanton mbrojtjen e të drejtës themelore njerëzore të lirisë së shprehjes dhe të aksesit publik në informacion;

### ii.

ajo nxit zhvillimin demokratik të teknologjisë së re dhe të globalizmit, në të cilin bibliotekat janë aktorë kryesorë në politikat kulturore europiane për teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit;

### iii.

ajo përplotëson prirjet e globalizimit duke theksuar përmasën lokale dhe zhvillimin e shoqërive shumëgjuhëshe dhe shumëkulturore;

### iv.

ajo mbështet reformat ekonomike dhe institucionale që zhvillohen në Europën

Lindore, të cilat nxjerrin në pah rëndësinë e bibliotekave në demokratizimin e shteteve;

### v.

ajo siguron zhvillimin dhe ruajtjen e koleksioneve kombëtare në çfarëdo formë ose përmbajtje.

Meqenëse përgjithësisht pranohet se asnjë vend nuk i përket plotësisht botës demokratike për sa kohë banorët e tij nuk kanë të drejta të barabarta dhe akses të lirë në informacion, është e rëndësishme që këto parime të vihen në zbatim, nëpërmjet bashkëveprimit europian, në nivel ndërkombëtar.

Në këtë kontekst, Këshilli i Europës ka vendosur të shqyrtojë fushën e bibliotekave me qëllim që të hartojë një paketë ligjesh me synim fuqizimin dhe, aty ku duhet, harmonizimin e legjislacionit dhe të politikave kombëtare përkatëse të vendeve anëtare.

Edhe pse natyra komplekse e problemit tenton në njëfarë mënyre njëtrajtshmëri të legjislacionit dhe ligje iluzore, ai mrekullisht nxjerr në pah nevojën për një përpjekje të përbashkët për të formuluar një paketë ligjesh që përputhen me vlerat demokratike, që janë



në pajtim me parimet kushtetuese të vendeve anëtare dhe që janë premtues për të mbështetur politikat e tyre në lidhje me legjislacionin dhe veprimtarinë bibliotekare.

Këto direktiva mbështeten në të njëjtat parime të konventave ndërkombëtare të përkrahura nga Këshilli i Europës dhe organizata të tjera ndërkombëtare në fusha të përafërta dhe veçanërisht:

- Konventën për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive themelore, Neni 10;
- Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Neni 19, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 217 A;
- Marrëveshjet Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 16.12.1966, Neni 19;
- Marrëveshjen Kornizë të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 01.02. 1995;
- Direktivën e Këshillit të Bashkimit Europian të 19 nëntorit 1992 për të drejtën e qiradhënies dhe të drejtat e huadhënies dhe për të drejta të caktuara lidhur me copyright-in në fushën e pronësisë intelektuale;
- Sugjerimin e Komisionit për një Direktivë të Parlamentit dhe Këshillit Europian për harmonizimin e aspekteve të caktuara të copyright-it dhe të drejtave që lidhen me të në Shoqërinë e Informacionit, COM (97) 628 final-97/0539 COD;
- Manifestin e IFLA-UNESCO për bibliotekat publike (1994);

- Deklaratën e IFLA-s për Bibliotekat dhe Lirinë Intelektuale (mars 1999);
- Konventën UNIDROIT për Objektet e Vjedhura ose të Eksportuara Ilegalisht (1995);
- Direktivat e IFLA-UNESCO për legjislacionin e kopjes së detyruar (1981);
- Rekomandimet e përfshira në Raportin për koleksionet e depozituara të botimeve elektronike, botuar nga Komisioni Europian (1996).

## **Direktivat e fundit nënvizojnë domosdoshmërinë e :**

### i.

sigurimit të koherencës, në nivele të ndryshme në hierarkinë e normave ligjore, midis normave që lidhen me legjislacionin e bibliotekave dhe normave të zbatuara në fusha të tjera të përafërta;

### ii.

zgjërimit të sferës së dispozitave tradicionale për bibliotekat, me qëllim që të merren në konsideratë të gjitha çështjet që lidhen me legjislacionin e bibliotekave;

### iii.

vendosjes së një baraspeshe midis interesave të të gjithë individëve e enteve juridike të përkatëse dhe kategorive të ndryshme të specialistëve të librit e të informacionit.

Duhet theksuar se, që të jetë i efektshëm, legjislacioni i bibliotekave duhet të marrë në konsideratë kushtet dhe interesat e ndryshme të shteteve anëtare.

*U rekomandohet autoriteteve përgjegjëse të shteteve anëtare:*

**i.**

të miratojnë masa legjislative ose të tjera në përputhje me parimet e përvijuara në Direktivat, të cilat të synojnë sjelljen e legjislacionit ekzistues në një linjë me të njëjtat parime;

**ii.**

të përhapin Direktivat sa më shumë, të jetë e mundur në organizmat dhe personat e interesuar.

## **Direktiva të KE/EBLIDA për legjislacionin dhe politikat bibliotekare**

### **I. Liria e shprehjes dhe aksesit i lirë në informacion**

1. Bibliotekat janë krijuar për përfitim të bashkësive të përdoruesve duke mbështetur kështu të drejtat e tyre për akses në informacion dhe ide.

**i.**

Shërbimet bibliotekare duhet t'u sigurohen qytetarëve pa dallim race, kombësie, besimi fetar, kulture, bindjesh politike, moshe, të metash fizike dhe vështirësish në të mësuar, gjinie ose orientimi seksual.

**ii.**

Një grup materialesh, mjetesh dhe shërbimesh të informacionit themelor të financuara nga fonde publike duhet të jenë pa pagesë për përdoruesin dhe të përdorshme në mënyrë të barabartë nga të

gjithë anëtarët e bashkësisë së përdoruesve pavarësisht mundësisë të tyre për të paguar.

**iii.**

Materiali nuk duhet të përjashtohet ose të shfrytëzohet nga rrjete të refuzuara për arsye të tjera veç atyre të ligjit në fuqi.

**iv.**

Bibliotekat duhet të grumbullojnë materiale dhe të sigurojnë akses në burime mbi bazën e cilësisë dhe të lidhjes me kërkesën e bashkësisë së përdoruesve.

**v.**

Koleksionet dhe burimet duhet të marrin në konsideratë diversitetin e bashkësive që u shërbejnë në fushën e përmbajtjes, gjuhëve dhe formave që ato sigurojnë.

**vi.**

Bibliotekat duhet të përpiqen të sigurojnë nivelet dhe cilësitë më të mira të aksesit intelektual dhe fizik në materialet dhe burimet e tyre.

**vii.**

Pikat e shërbimit bibliotekar duhet të jenë të vendosura në mënyrë të përshtatshme, të shfrytëzueshme prej të gjithëve, me pajisje që u shërbejnë atyre që vuajnë nga vështirësi të shikimit, dëgjimit etj.

### **2. Parime të zhvillimit të koleksioneve**

**i.**

Zhvillimi i koleksioneve të bibliotekave duhet të bazohet në gjykimin e pavarur profesional pa ndërhyrjen e ndikimeve

politike, sektare, komerciale dhe të tjera, në këshillim me organet përfaqësuese të përdoruesve, grupeve të bashkësisë dhe institucione arsimore, informuese dhe kulturore.

#### ii.

Politikat e zhvillimit të koleksioneve duhet të rishikohen herë pas here me qëllim që të pasqyrojnë nevojat dhe mundësitë në ndryshim. Zhvillimi i koleksioneve duhet të jetë një proces transparent dhe politikat mbi të cilat ai mbështetet duhet të bëhen publike.

#### iii.

Minoritetet duhet të shërbehen me materiale në gjuhën e tyre, që kanë të bëjnë me kulturën e tyre, gjithashtu me materiale në gjuhën e tyre që pasqyrojnë kulturën e bashkësisë më të gjerë të to. Përveç kësaj, koleksionet bibliotekare duhet t'i prezantojnë bashkësisë më të gjerë kulturat e minoriteteve.

#### iv.

Bibliotekat duhet të jenë pjesë e një sistemi ose e sistemeve brenda një vendi që bashkëveprojnë në çështjet e pasurimit dhe shkëmbim-huazimit të koleksioneve dhe që kanë marrëdhënie të ngushta pune me institucionet e tjera kulturore, arsimore dhe informuese.

#### v.

Bibliotekat duhet të sigurojnë akses në materiale që nuk janë pjesë e koleksioneve të tyre përmes shërbimeve të huazimit kombëtar e ndërkombëtar dhe të shpërndarjes së dokumenteve, përfshirë përdorimin e shërbimeve të infor-

macionit elektronik dhe informacionin në rrjet.

3. Lidhur me parimet e aksesit të rrjeteve elektronike , bibliotekat duhet:

#### i.

të shfrytëzojnë plotësisht potencialin e informacionit në rrjet, veçanërisht Internetin, që siguron akses në informacion në një mënyrë që nuk është e mundur me koleksionet e materialeve të printuara;

#### ii.

të përipiqen të sigurojnë akses elektronik në burimet e informacionit në interes të përdoruesve dhe gjithashtu të ngrenë pika të aksesit publik me nivelin e duhur të mbështetjes dhe udhëheqjes që mundëson përdorimin e pavarur të informacionit në rrjet;

#### iii.

të mos lejojnë me dashje aksesin në Internet të materialeve që janë të paligjshme brenda juridiksionit në të cilin ato shfrytëzohen. Përsa u përket materialeve të tjera u lihet përdoruesve të caktojnë informacionin që ata duan të shfrytëzojnë;

#### iv.

të formulojnë politikat e përdorimit të Internetit për të shprehur objektivat dhe metodat e sigurimit të aksesit publik në informacionin në rrjet;

#### v.

të respektojnë të drejtat e përdoruesve, përfshirë të drejtën e mirëbesimit dhe të fshehtësisë;



vi.

të rishikojnë herë pas here politikat e tyre për pikat e aksesit publik dhe zbatimin në praktikë në këshillim me organizma dhe shoqata të shoqërisë civile me qëllim që të bëjnë të mundur që të arrihen qëllimet dhe objektivat e shërbimit.

## II. Bibliotekat në politikat kombëtare të librit dhe informacionit

### 4. Legjislacioni dhe politika e bibliotekave duhet:

i.

të sigurojnë statusin e nevojshëm ligjor dhe platformat profesionale për të gjitha llojet e bibliotekave brenda kornizës së politikës kombëtare të informacionit;

ii.

të baraspeshojnë përqendrimin në parime të përgjithshme dhe paraqitjen më të hollësishtme të standardeve dhe rezultatit;

iii.

të sigurojnë një platformë që mund të qartësojë marrëdhëniet midis bibliotekave dhe faktorëve të tjerë në “botën e librit” si edhe në universin më të gjerë të dijes;

iv.

të përfshijnë të gjitha llojet e bartësve të informacionit, jo vetëm informacionin digjital të Internetit, me qëllim që të garantojnë akses të lirë në informacion për të gjithë qytetarët;

v.

t’i përcaktojnë shërbimet bibliotekare si një forcë të domosdoshme për mbështetjen dhe zhvillimin e demokracisë. Veç kësaj, autoritet qendrore dhe vendore duhet të sigurojnë mekanizmat e domosdoshëm organizativë, ekonomikë dhe kontrollues që mundësojnë këtë funksion dhe t’u sigurojnë shërbimeve bibliotekare vendin e duhur në politikën kombëtare të informacionit;

vi.

të ofrojnë orientime për matje cilësore të rezultateve për llojet e ndryshme të bibliotekave.

### 5. Autoritetet dhe institucionet duhet:

i.

të sigurojnë struktura të qarta për të gjitha nivelet e sektorit të bibliotekave duke qartësuar rolet, detyrat dhe përgjegjësitë për organet që kanë të bëjnë me qeverisjen e bibliotekave;

ii.

të përpiqen të zhvillojnë infrastrukturën e domosdoshme për të nxitur bashkëveprimin midis llojeve të ndryshme të bibliotekave, duke njohur misionin dhe detyrat e tyre të veçanta në një kuadër më të gjerë të sigurimit të informacionit kombëtar.

### 6. Shërbimet bibliotekare. Llojet e bibliotekave, niveli i shërbimit, treguesit e rezultateve

i.

Për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, duhet

që, sa të jetë e mundur, të zbatohen standarde teknike dhe standarde që lidhen me telekomunikacionin, rrjetet elektronike dhe pajisjet përkatëse.

## ii.

Prodhimi dhe shpërndarja në rritje e përmbajtjeve në formë digjitale po mjegullojnë kategoritë tradicionale të bibliotekave. Bibliotekat dhe rrjetet bibliotekare, pavarësisht agjencive të tyre financuese, duhet të kenë përgjegjësinë për t'i shërbyer bashkësisë së bibliotekës dhe shoqërisë në përgjithësi.

## iii.

Nxënësve dhe studentëve duhet t'u mësohen aksesit i saktë në informacion dhe procedurat e përdorimit për të mundësuar shfrytëzim sa më të mirë të pajisjeve të informacionit si në sistemin e informacionit ashtu dhe në shoqëri në përgjithësi; dhe kjo duhet të përfshihet në orientimet dhe curricula-t në të gjitha nivelet e arsimit.

## iv.

Shërbimet bibliotekare për grupe të veçanta përdoruesish duhet të shprehen njëpërnjë në legjislacion dhe/ose rregullore dhe të sigurohen pjesërisht përmes shërbimeve të rregulluara të përmbajtura në shërbimet e zakonshme bibliotekare, pjesërisht përmes bibliotekave të veçanta dhe pjesërisht përmes shërbimeve të përqendruara.

## v.

Duhet të ndërmerren studime për të parë se si zhvillimet e reja në përdorimin e

teknologjisë së informacionit të zbatuara në sektorë të tjerë të shoqërisë, p. sh. shërbimet me "kartë krediti", mund të zbatohen në shërbimet bibliotekare digjitale në zhvillim.

## vi.

Autoritetet bibliotekare në nivel kombëtar duhet të kenë parasysh se shërbimet bibliotekare në zhvillim, brenda politikës kombëtare dhe ndërkombëtare të informacionit, synojnë të konvergojnë me institucionet e sektorëve të arkivave, bibliotekave dhe muzeve.

## 7. Financimi i bibliotekave. Qeverisja vendore dhe qendrore

### i.

Marrëdhënia midis nivelit të pritshëm të shërbimit dhe sigurimit të burimeve të përshatshme për arritjen e tij duhet të jetë e qartë pavarësisht llojit të bibliotekës dhe nivelit të autoritetit që qeveris bibliotekën.

### ii.

Financimi i bibliotekave duhet të jetë përgjithësisht një përgjegjësi publike. Shërbimet bibliotekare të financuara pjesërisht nga burime të tjera nuk duhet të bien ndesh me integritetin profesional të bibliotekarëve dhe përzgjedhjen e materialeve bibliotekare si dhe nuk duhet të minojë parimet themelore të aksesit të lirë dhe ofrimin pa pagesë të disa shërbimeve bazë.

### iii.

Autoritetet bibliotekare dhe bibliotekat, së bashku, duhet të ngrenë struktura orga-

nizative, mekanizma mbikëqyrjeje dhe kontrolli që do të sigurojnë përfitimin më të mirë të mundshëm prej parave publike të të shpenzuara për shërbimet bibliotekare nëpërmjet përcaktimit të instrumenteve për matje reale të rezultateve dhe kontroll cilësor në lloje të ndryshme bibliotekash.

#### iv.

Buxhetet e bibliotekave duhet të pasqyrojnë ndikimin e teknologjive të reja dhe duhen siguruar burime për trajnimin e duhur të stafit dhe të përdoruesve për një përdorim të frytshëm të mjeteve dhe shërbimeve të reja.

### 8. Arsimitimi dhe trajnimi

#### i.

Arsimimi bibliotekar duhet të pasqyrohet në dispozitat legjislativë dhe politikën bibliotekare kombëtare si domosdoshmëri për shërbimet bibliotekare për të siguruar një prurje të kënaqshme të bibliotekarëve profesionistë dhe personelit tjetër.

#### ii.

Autoritetet bibliotekare duhet të nxitin shkëmbimin e stafit bibliotekar përmes hartimit të programeve europiane të shkëmbimit të stafit.

### III. Bibliotekat dhe industritë e dijes

9. Në ligjet që kanë të bëjnë me copyright-in dhe të drejtat e fqinjësisë bibliotekat duhet të njihen si organizata me funksion publik - të financuara nga fonde publike -

për të mundësuar gjetjen dhe përdorimin e informacionit.

#### i.

Qeveritë duhet të vendosin një pozicion ligjor për bibliotekat lidhur me copyright-in dhe të drejtat e fqinjësisë.

#### ii.

Bibliotekat duhet të lejohen të realizojnë funksionet e tyre publike pavarësisht llojit të materialit që posedojnë, qoftë ai informacion i shtypur, audio-vizual ose digjital. Për pasojë, përjashtimet nga copyright-i që zbatohen për materialet e shtypura duhet, sa të jetë e mundur, gjithashtu të zbatohen edhe për materialet digjitale. Në biblioteka duhet të lejohet shfletimi i faqeve të Internetit.

#### iii.

Organizmat politikë duhet të sigurojnë kushtet ligjore dhe financiare, duke garantuar akses pa pengesa të qytetarëve në informacionin kulturor, shkencor, arsimor dhe social përmes bibliotekave, pavarësisht formës në të cilin ai është depozituar, transportuar ose shpërndarë.

10. Për materialet që nuk mbulohen nga rregullat e të drejtës kombëtare të huazimit, mbajtësit e të drejtave, në këshillim me përdoruesit e informacionit të mbrojtur prej copyright-it, duhet të vendosin cili informacion do të jetë i shfrytëzueshëm lirisht për përdorim publik. Si kompensim për përdorimin e informacionit duhet, me marrëveshje, të caktohet një shumë e pranueshme.



i.

Qeveritë kanë detyrim të veçantë të japin akses në informacionin e prodhuar prej tyre.

**11.** Bibliotekat duhet të bëjnë përpjekje të matura për të siguruar që informacioni i mundësuar përmes marrëveshjeve kolektive, licencimit ose formave të tjera të përdoret brenda dispozitave të këtyre marrëveshjeve.

i.

Duhet të krijohen organizma të marrëveshjes kolektive, të cilat janë të mandatuar të negociojnë me mbajtësit e të drejtave ose organizatat e tyre.

ii.

Brenda bibliotekave përdorimi i materialit të mundësuar përmes rrjeteve elektronike duhet të jetë pa pagesë për përdoruesit.

**12.** Bibliotekat duhet të lejojnë kopjimin dhe riprodhimin në mjediset e tyre në përputhje me ligjin kombëtar të copyright-it.

#### **IV. Mbrojtja e pasurisë bibliotekare**

**13.** Kopja e detyruar është instrumenti kryesor për ngritjen e koleksioneve kombëtare të një natyre pasurore. Objektivat kryesore në këtë fushë duhet të shpallen si më poshtë:

i.

krijimi i koleksionit kombëtar me qëllim ruajtjen, zhvillimin dhe transmetimin e kulturës kombëtare brezave të ardhshëm;

ii.

hartimi dhe botimi i bibliografisë kombëtare;

iii.

shfrytëzimi i botimeve të depozituara.

**14.** Sigurimi i kopjeve të detyruara nuk duhet të zëvendësojë politikat e pamjaftueshme qeveritare të librit dhe informacionit. Për këtë qëllim kopja e detyruar duhet:

i.

Të marrë formën e normave të detyrueshme të parashikuara për të detyruar botuesit/prodhuesit të dërgojnë kopje në institucionet kombëtare depozituese. Dërgimi vullnetar nuk duhet të dekurajohet në qoftë se ai arrin të njëjtin objektiv si normat e detyrueshme.

ii.

Të mbulojë të gjitha kategoritë e botimeve dhe për secilën prej tyre të hartohen politika të përshtatshme. Me zgjerimin e legjislacionit të kopjes së detyruar në mbulimin e të gjitha llojeve të bartësve të informacionit, përfshirë materialin digjital, bëhet imperative ngritja e një ure midis legjislacionit të kopjes së detyruar dhe legjislacionit të copyright-it. Ky legjislacion duhet të sigurojë akses në materialin elektronik të depozituar dhe të ofrojë një kompensim të arsyeshëm të mbajtësit të copyright-it.

**15.** Me qëllim që të rritet efektiviteti i dispozitave të kopjes së detyruar dhe të arrihet që praktika e saj të mos jetë e

dëmshme për aktorët e tjerë të librit, duhet të zbatohen rregullat e mëposhtëm:

i.

Institucionet depozituese duhet të jenë në gjendje të sigurojnë shërbime bibliografike efikase dhe shfrytëzim të përshtatshëm të botimeve të depozituara, mundësisht përmes rrjeteve elektronike me qëllim që të rritet frytshmëria. Bibliotekat Kombëtare dhe/ose agjencitë e tjera kombëtare bibliografike duhet gjallërisht të bashkëveprojnë me organizata të tjera qeveritare dhe joqeveritare për një shërbim më të mirë të krejt bashkësisë që mbulojnë bibliotekat si edhe të shoqërisë në tërësi.

ii.

Depozitimet e kopjeve të shtypura duhet të mbahen në një nivel të arsyeshëm, duke shkuar nga tri në pesë, sipas nevojave kombëtare. Për shkak të kostos së lartë të të programeve të konservimit, duhet shumë angazhuar me kujdes paralelizmi në politikat lidhur me kopjet e detyruara të materialeve zanore, audio-vizuale, filmike dhe elektronike.

iii.

Botimet e luksit ose të çmuara duhet të depozitohen në një numër të kufizuar kopjesh.

iv.

Moszbatimi i rregullave të kopjes së detyruar duhet të ndëshkohet me masa financiare ose të tjera.

v.

Pasojë e zbatimit të mekanizmave të

kopjes së detyruar duhet të jetë realizimi i shërbimeve bibliografike kombëtare në kohë dhe gjithëpërfshirëse. Në disa raste, kopja e detyruar mund të shërbejë gjithashtu për krijimin e arkivave për prodhuesit e saj.

vi.

Modelet e bashkëveprimit të institucioneve depozituese duhen analizuar dhe nxitur më tej.

vii.

Është e domosdoshme në të ardhmen të ndërmerren kërkime dhe hulumtime për të shqyrtuar aspektet ligjore, teknike dhe financiare të kopjes së detyruar të botimeve elektronike.

16. Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me transferimin ndërkufitar të trashëgimisë së shkruar rekomandohet që:

i.

dokumentet e trashëgimisë së shkruar, të bibliotekave ose jo, duhet të integrohen në përcaktimin dhe/ose listën e objekteve kulturore të mbrojtura me rregulla të kontrollit të eksportimit; në rastin e veçantë të dokumenteve të trashëgimisë në biblioteka, nuk duhet të lejohet eksportimi i tyre i përhershëm, lejohet vetëm eksportimi i përkohshëm;

ii.

konventa UNIDROIT e vitit 1995 për Objektet Kulturore të Vjedhura ose të Eksportuara Ilegalisht është dokument reference në problemet e vjedhjes ose eksportimit ilegal si një zgjerim i

Rekomandimit 1372 (1998) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës;

iii.

duhen siguruar rregulla kombëtarë për të kontrolluar lëvizjen ndërkufitare të objekteve kulturore në përputhje me Direktivat e Këshillit të Europës (Rregullore e Këshillit e 9 dhjetorit 1992 dhe tekstet pasuese);

iv.

bashkëveprimi administrativ dhe ligjor për trashëgiminë e shkruar duhet fuqizuar për shkak të brishtësisë së tij të veçantë;

v.

duhen nxitur programet e parashikuara për sigurimin dhe aksesin në informacionin e trashëgimisë së shkruar të transferuar gjatë Luftës II Botërore.

*Përkthyer nga Mirela Mersini*

---

<sup>1</sup> Miratuar nga Këshilli i Europës & EBLIDA në Strasburg më 20 janar 2000 si dhe nga IFLA.



# Udhëzues të projektit CALIMERA

## Digjitalizimi

CALIMERA është akronimi i projektit të Bashkimit Europian *Cultural Applications: Local Institutions Mediating Electronic Resource Access* (Zbatime Kulturore: Institucionet Lokale Ndërmjetësojnë Aksesin në Burime Elektronike 2003-2005). Si një nismë paneuropiane (sepse në të u përfshinë edhe vende joanëtare të BE-së, mes tyre edhe Shqipëria), ky projekt arriti të mobilizonte institucionet lokale, veçanërisht bibliotekat, që të luajnë një rol të ri si faktorë kyç në drejtim të mundësimit kudo dhe në çdo kohë të aksesit të vërtetë në shërbime të Teknologjive të Shoqërisë së Informacionit për të gjithë, duke synuar kështu vënien e trashëgimisë kulturore europiane në funksion të qytetarëve.

Si një ndër arritjet e këtij projekti, padyshim, ishte hartimi i një pakete me 23 udhëzues të hartuar nga ekspertë europianë të fushës së zbatimit të teknologjive të informacionit në institucionet e trashëgimisë kulturore, veçanërisht në biblioteka. Në këtë numër të revistës po botojmë udhëzuesin për digjitalizimin, si një ndër sfidat e reja me të cilën po përballen ose do të përballen mjaft shpejt edhe bibliotekat shqiptare.

BE-ja ka deklaruar se “Digjitalizimi është një hap i parë thelbësor për krijimin e përbajtjes digjitale që do të mbështesë një Europë gjithë digjitale. Ai është një veprimtari e rëndësishme në ruajtjen e trashëgimisë kulturore kolektive të Europës, që siguron akses të përmirësuar për qytetarët në këtë trashëgimi për të zgjeruar arsimin dhe turizmin dhe për të zhvilluar industritë me përbajtje elektro-

nike”. Ai ka rënë dakord të bashkërendojë programet kombëtare të digjitalizimit dhe ka hartuar Parimet e Lundit [1], të cilat kanë çuar në Planin e Veprimit të Lundit [2]. Për të nxitur një metodologji të përbashkët për digjitalizimin e materialit kulturor dhe për të lehtësuar zbatimin e Planit të Veprimit të Lundit, më 2002 është materializuar projekti Minerva [3]. Përfitimet nga digjitalizimi përfshijnë

akces më të gjerë dhe më të lehtë, ruajtje të origjinaleve dhe mundësi për të shtuar vlera në imazhe dhe koleksione si edhe mundësi për fitim të ardhurash.

Digjitalizimi është procesi i krijimit të dokumenteve digjitale duke konvertuar materiale analoge. Kopja digjitale që rezulton, ose surrogati digjital, klasifikohet pastaj si material digjital dhe u nënshtrohet të njëjtave rregulla shfrytëzimi si edhe materialet “e lindura digjitale” (materiale të krijuara në format digjital, që nuk kanë asnjë ekuivalent të ngjashëm). Cilësia e kësaj kopjeje, formati i përdorur për ta ruajtur atë, përshkrimi i saj, ruajtja afatgjatë, metoda e servirjes të përdoruesi dhe mbrojtja nga shkeljet e të drejtave të pronësisë intelektuale janë disa nga gjërat që duhen marrë në konsideratë. Veç kësaj, për çdo lloj materiali të digjitalizuar duhen marrë në konsideratë edhe faktorë specifikë për të qenë të sigurt që prodhimi digjital do të përdoret apo do të shfrytëzohet plotësisht tani dhe në të ardhmen.

Duhen marrë në konsideratë edhe problemet e stafit. Kështu, nuk duhet anshkualuar rëndësia e aftësive profesionale drejtuese për t’u siguruar që materialet origjinale të mos dëmtohen gjatë një projekti digjitalizimi. Çdo projekt digjitalizimi siguron mundësi për të realizuar një konservim të domosdoshëm. Stafit do të duhet të trajnohet në aspektet teknike të digjitalizimit dhe të kuptojë procedurat e tij. Stafit do të duhet gjithashtu të trajnohet në përdorimin produktit përfundimtar dhe në ndihmën ndaj përdoruesve. Ai duhet të ketë shprehuri të reja të punës në mjedisin

digjital meqë kërkesat gjithnjë e më tepër do të merren në mënyrë elektronike dhe grupe të reja përdoruesish që historikisht nuk kanë përdorur shërbime tradicionale mund të kërkojnë tani një shërbim. Shprehitë janë të karakterit teknik, planifikues, që kanë të bëjnë me marketingun dhe instruksionet.

Projektet e digjitalizimit krijojnë mundësi për partneritete me institucione të tjera të trashëgimisë kulturore dhe organizatat tregtare. Ato duhet të përfshijnë bashkimin e burimeve për të krijuar koleksione të reja virtuale, ndarjen bashkarisht të ekspertizës dhe/ose pajisjeve dhe punën me programues dhe furnizues software-ësh. Bashkëpunimi me organizata mësimore dhe/ose grupe komunitare mund, gjithashtu, të çojë në krijimin e burimeve të “lindura digjitale”. Projekti Minerva ka hartuar një manual të *Praktikës Pozitive* [4] dhe udhëzues teknikë [5], që cilat shërbejnë si udhëzues praktikë për projekte digjitalizimi.

## Planifikimi dhe rrjedha e punës

Është e rëndësishme të planifikohet me kujdes dhe me themel projekti. Plani duhet të përfshijë:

- qëllimet e digjitalizimit, p. sh. për të siguruar akses në koleksione që janë në përdorim, për të mbrojtur njësi delikate nga dëmtimi gjatë përdorimit, për të krijuar një koleksion virtual, për të shenjuar një grup të veçantë përdoruesish, për të kontribuar në një rrjet rajonal,

- kombëtar apo ndërkombëtar;
- çfarë do të digjitalizohet. Kjo do të përcaktohet në një masë të madhe nga qëllimet e digjitalizimit dhe nëse do të sigurohet leja nga mbajtësit e të drejtave;
- kush do ta kryejë punën. Mund të jetë stafi i brendshëm, staf i specializuar me kontratë provizore, stafi i një organizate partnere ose një kontraktues komercial. Stafii i përfshirë duhet të ketë mjetet mbrojtëse përkatëse. Stafii drejtues i familjarizuar me materialet duhet të përdoret gjithnjë për ndonjë zhvendosje ose bartje veçanërisht të materialeve delikate. (Kjo gjithashtu mund të ishte një mundësi për të realizuar ndonjë punë konservuese.);
- ku do të kryhet puna. Në shumicën e rasteve do të jetë e preferueshme që puna të bëhet në vend për të shmangur rreziqe të tilla si humbje ose dëmtim origjinalesh, kosto transporti etj. Në rastin më të mirë duhet siguruar një hapësirë e veçantë duke mbajtur parasysh kushtet e ndriçimit, temperaturën, lagështirën etj., veçanërisht kur digjitalizohen origjinalë delikatë;
- kur do të bëhet. Duhet marrë parasysh kohët e zëna, pushimet e stafit, ekspozitat e veçanta ose veprimtari apo projekte të tjera. Duhet hartuar një plan pune me afate kohore të përcaktuara;
- si do të bëhet. Kjo pjesë e planit duhet të përfshijë detajet e kohës së punës dhe është e rëndësishme të dokumentohen materialet që po digjitalizohen dhe ecuria e punës. Një sistem regjistrimi, shenjimi dhe datimi do të ishte i vlefshëm. Skedarët duhet të emërtohen gjatë procesit të digjitalizimit;
- një strategji ruajtjeje. Kjo duhet të ekzistojë që nga faza e planifikimit për të siguruar vazhdimësinë dhe përdorimin afatgjatë të koleksionit. Ruajtja do të varet nga dokumentimi i të gjitha procedurave teknologjike që çojnë në krijimin e objektit digjital dhe mjaft informacion i rëndësishëm mund të sigurohet në këtë moment të krijimit;
- gjëra të tjera duhen mbajtur parasysh në fazën e planifikimit përfshirë çështje të tilla ligjore si IPR (Intellectual Property Rights), zgjedhja e formatit digjital, hardware, software, metodat e shpërndarjes ose formati i pritshëm dhe natyrisht kostoja.

## Konsiderata financiare

Digjitalizimi mund të jetë i kushtueshëm dhe institucionet duhet të kërkojnë rrugë për shtimin e fondit të tyre bazë p. sh.:

- duke bërë lobing dhe avokati në nivele lokale dhe kombëtare;
- duke influencuar opinionin publik dhe duke formuar grupe miqsh;
- duke aplikuar për grante për projekte të veçanta digjitalizimi. Vitet e fundit është vënë re rritja e kulturës së tenderimit në bibliotekat, muzetë dhe arkivat në mjaft vende. Qeveritë, BE, trustet bamirëse dhe organizma të tjerë kanë preferuar t'i kanalizojnë fondet përmes tenderave ose paraqitjes konkurruese së kërkesave. Shoqatat kombëtare të profesionistëve duhet të jenë në gjendje të japin këshilla lidhur me burimet e financimit. Website-i *Europa* përmban një



udhëzues për mundësitë e financimit brenda BE-së [6];

- partneriteti me institucione të tjera të përfshira në këtë punë;
- disa forma të sigurimit të të ardhurave. Disa vende do të jenë të kufizuara nga ligji nëse ato lejohen ose jo të nxjerrin të ardhura ose të kenë shërbime me pagesë, përfshirë shërbimet e vlerës së shtuar-TVSh.

Sasia dhe lloji i materialit që do të digjitalizohet do të varet nga fondet dhe vendimet që do të merren mbi bazën e përparësive. Kjo mund të bazohet në qëllimet e projektit (ruajtja ose rritja e aksesit), rrallësia ose vlera e origjinaleve, kushtet e tyre, përdorimi i mundshëm etj. Alternativat me kosto krahasimisht të ulëta mund të jenë të përshtatshme për disa qëllime. P. sh. kamerat digjitale, skanerat etj. të parashikuar për tregun e brendshëm mund të çojnë në rezultate të një cilësie të mjaftueshme për projekte komunitetesh të vogla.

## Përzgjedhja

Kriteret e përzgjedhjes do të jenë, siç u tha më lart, të varura në një masë të madhe nga qëllimet e projektit dhe mund të përfshijnë p. sh.:

- çështje ligjore si nëse është e mundur të sigurohet leje për fotokopjim;
- audiencia e përzgjedhur;
- rëndësia e njëjësive në trashëgiminë kulturore të komunitetit, rajonit, vendit, Europës dhe botës;
- rrallësia e njëjësive;

- gjendja e tyre dhe nevoja për ruajtje e origjinaleve përmes varianteve të digjitalizuara si një alternativë;
- lidhja me projekte të tjera;
- çështje financiare si kërkesa për nxjerrje të ardhurash nga përdorimi ose shitja e CD-ROM-ve, vlerësimi i parave dhe i kostos.

## Hardware dhe software

Këto duhen zgjedhur që në fazën e planifikimit, duke marrë parasysh sigurinë, koston, lehtësinë e përdorimit, nevojat e stafit për trajnim, koston e mirëmbajtjes, hapësirën e nevojshme, mundësitë e fitimit etj. Pajisjet duhet të jenë në gjendje të regjistrojnë dhe ruajnë me zgjedhjen më të lartë të mundshme. Ndikimet e ruajtjes gjithashtu duhen patur parasysh sepse imazhe me zgjedhje të larta krijojnë skedarë më të mëdhenj dhe kërkojnë më tepër hapësirë depozitimi.

Pajisjet duhet të jenë të përshtatshme për materialet që do të digjitalizohen. Duhet marrë në konsideratë pikat e mëposhtme:

### *Skanera*

- duhen përdorur vetëm skanera të sheshtë për materiale të palidhura ose dokumente;
- materialet e lidhura do të kërkojnë vend për vendosjen e librit ose kamera digjitale;
- skanerat në rastin më të mirë së paku duhet të jenë të mëdhenj sa materiali më i madh që do të skanohet për të shmangur palosjen dhe dëmtimin.

*Pajisje skanimi 3D*

- këto mund të përdoren për objekte muzeore ose ndërtesa historike.

*Kamera digjitale*

- kamerat mund të përdoren për objekte muzeore ose libra të lidhur etj.;
- kamerat mund të përdoren për të regjistruar veprimtari, ndërtesa, vende dhe peizazhe;
- për të patur cilësi pamjeje të mirë është e rëndësishme cilësia e lenteve optike etj.;
- një mbështetëse për të mbajtur materialin që do të fotografohet është e domosdoshme;
- do të duhet një trekëmbësh për kameran;
- në shumicën e rasteve do të duhet ndriçim shtesë;
- do të duhen filtra për të reduktuar shfytirimin e ngjyrës.

*Videokamera*

- nevojitet për të të nxjerrë variantin digjital prej filmave dhe videove tradicionale;
- pajisja regjistruese përdoret për prodhimin e imazheve të filmave dhe si të tilla do të kërkohen për projekte të realizimit të përmbytjes që rezultojnë në materiale “të lindur digjitale”;
- gjithashtu është një mjet i fuqishëm për paraqitjen e një pamjeje të vazhdueshme të të gjitha slajdeve të një objekti ose për të treguar një hapësirë tredimensionale;

- gjetja e kamerave relativisht të lira e bën këtë lloj paraqitjeje të mundshme për institucione më të vogla, kryesisht muze dhe galeri, të cilat nuk mund të kenë pajisje për të krijuar përmbajtje realiteti virtual të plotë.

*Pajisje regjistrimi zëri*

- pajisja do të nevojitet për të prodhuar një produkt digjital nga media analoge;
- përdoret gjithashtu për prodhimin e zërit (fjalim, muzikë etj.) dhe si e tillë do të kërkohet për projekte për krijim përmbajtjes që rezultojnë në materiale “të lindura digjitale”.

**Software**

Software mund të kërkohen për të përpunuar produktin digjital p. sh. për korrigjimin e ngjyrës së imazheve digjitale, qethjen ose ngjeshjen e buzëve të materialit për shpërndarjen me web. Një software i tillë mund të jetë në gjendje:

- të hapë materiale mjaft të mëdhenj;
- të modifikojë rezolucionin dhe thellësinë e ngjyrës;
- të ruajë versione të ndryshme në materialë madhësish të ndryshme;
- të kopjojë pjesë të një imazhi dhe ta ruajë atë si një material tjetër;
- të eksportojë imazhe në materiale formatesh të ndryshme.

Përzgjedhja e software-t të përshtatshëm duhet të marrë parasysh materialin që po digjitalizohet, p. sh. në qoftë se do-

kumentet përmbajnë material të shkruar me dorë atëherë do të kërkohet një paketë OCR (optical character recognition). Website TASI (Technical Advisory Service for Images) përmban këshilla mbi të gjitha aspektet e digjitalizimit, përfshirë hardware dhe software. [7]

## Formatet e skedarëve

Imazhi ose objekti i prodhuar përmes procesit të digjitalizimit do të mbahet në një material me format të veçantë. Është e preferueshme të përdoren formate standardesh të hapur kur krijohet burime të digjitalizuara për t'u siguruar që burimet janë të ripërdorshme dhe mund të krijohen, modifikohen dhe shpërndahen nga një larmi aplikimesh software. Kjo do të rritë ndërveprueshmërinë dhe për pasojë aksesin, do të reduktojë varësinë të një furnizues dhe do të ndihmojë ruajtjen nga vjetrimi. Kopjet e realizuara duhet të jenë në një format që mbështet imazhe të mëdha me cilësi të lartë (p. sh. TIFF - Tagged Image Skedar Format- për imazhet fotografike).

Për riprodhimin e burimeve është e preferueshme të përdoret më shumë se një format me madhësi dhe rezolucione të ndryshme, duke mos harruar që përdoruesit do të kenë lloje të ndryshme hardware dhe software si edhe nivele të ndryshme transmetimi të dhënash. Kopjet e realizuara zakonisht do të jenë në formate më të vegjël të përshtatshëm për transmetim në Internet (p. sh. JPEG, PNG (Portable Network Graphics) ose GIF (Graphical Interchange Format) për

imazhe fotografike). Për më tepër hollësi shih pikën *Standarde* më poshtë.

## Standartet

Standartet janë tepër të rëndësishme sepse mospasja në përdorimin e standardeve të formateve të skedarëve dhe të ruajtjes së medias mund:

- të jetë pengesë kryesore në shkëmbimin ndërkombëtar të skedarëve të imazheve dhe në krijimin e burimeve në rrjet;
- të çojnë në vjetrim (në pajtim me standartet është një tregues i arsyeshëm i mbështetjes së ardhshme të një formati ose mediumi).

Ekzistojnë standarde formatesh të ndryshme për lloje të ndryshme formatesh digjitale si edhe për realizimin, ruajtjen dhe shpërndarjen:

### ▪ Realizimi i tekstit dhe ruajtja

Ka standarde për: kodimin e shkronjave [8] dhe formatet e dokumenteve [9].

### ▪ Shpërndarja e tekstit

Përsëri për udhëheqje në kodimin e shkronjave shih [8]. Për formatet e dokumenteve këshillohet versioni më i fundit i XHTML ose HTML, megjithëse formate të patentuara si PDF (Portable Document Format), RTF (Rich Text Format) ose Microsoft Word mund të jenë të përshtatshme si alternativa. Shih: HyperText Markup Language [10];



Extensible HyperText Markup Language [11]; Portable Document Format [12].

#### ▪ Realizimi i imazheve fotografike dhe ruajtja

- Imazhet fotografike janë *raster* (për fotografi), *vector* (për objekte ose forma gjeometrike) ose *grafik jovektor* (për vizatime me linja). Për këshillim shih [13].

- Kur krijohmë imazhe *raster* duhen mbajtur parasysh rezolucioni hapësinor (pixel-ë

për inch) dhe rezolucioni i ngjyrave (thellësia bit). TIFF (Tagged Image Skedar

Format) [14] është më i zakonshmi.

- Për imazhet *vector* duhet përdorur formati SVG (Scalable Vector Graphics [15]).

Formati i patentuar *Macromedia Flash* [16] mund të jetë i përshtatshëm në raste të tjera.

- PNG (Portable Network Graphics) [17] është formati më i zakonshëm për imazhet grafike *non-vector*.

#### ▪ Realizimi i imazheve fotografike

Imazhet fotografike të realizuara përmes Internetit duhet të jenë në formatin JPEG (Joint Photographic Expert Group) format [18] ose JPEG/SPIFF (JPEG Still Picture Interchange Skedar Format) [19]. Mund të gjeni më tepër informacion mbi JPEG [20] dhe JPEG 2000 [21], gjithashtu ka edhe një standard të ISO-s [22].

Imazhet vector mund të realizohen duke përdorur: GIF (Graphics Interchange Format) [23]; PNG (Portable Network Graphics) format [24]; ose SVG

(Scalable Vector Graphics) format [25].

#### ▪ Realizimi i imazhit video dhe ruajtja e tij

- Video mund të depozitohet duke përdorur formatin AVI (Audio Video Interleave) [26, por mund të përdoret edhe një format MPEG (Moving Pictures Expert Group) [27] ose madje Microsoft WMF (Windows Media Format), Microsoft ASF (Advanced Systems Format) ose Apple Quicktime [28]. Standardet gjenden në website-in MPEG [29].

#### ▪ Realizimi i videove

- Duhet kujtuar që aksesit në video është në varësi të gjerësisë së frekuen-cave, kështu që është e këshillueshme që të sigurohet më tepër se një skedar me format apo funksionim cilësor. Videot e parashikuara për marrje informacioni duhet të jenë në format MPEG-1 [30] ose Microsoft WMF (Windows Media Video), AVI (Audio Video Interleave) ose Apple Quicktime (hollësi gjenden në faqet web përkatëse [28]). Videot për lexim të pandërprerë të dhënash duhet të jenë në Microsoft ASF (Advanced Streaming Format), WMF ose Apple Quicktime (hollësi gjenden në faqet web përkatëse [28]).

#### ▪ Realizime zanore dhe ruajtja e tyre

- Mund të ruhen: në formate jo të ngjeshura si Microsoft WAV (valë) ose Apple AIFF (Audio Image Skedar Format) (hollësi gjenden në faqet web

përkatëse [28]); ose në formate të ngjeshura si MP3 [31], formatin Microsoft WMA (Windows Media Audio) [28], Real Audio [32] ose Sun AU [33]. AES (Audio Engineering Society) [34] dhe IASA (International Association of Sound and Audiovisual Archives) [35] bëjnë rekomandime që duhen marrë në konsideratë.

#### ▪ Realizimet zanore

- Si edhe te videot, aksesit këtu varet nga gjerësia e frekuencave, kështu që duhen siguruar një varg skedarësh me cilësi të ndryshme. Më poshtë keni rekomandimet AES [34] dhe IASA [35].

#### ▪ Realizimi i 3D dhe ruajtja

- Digjitalizimi i materialeve tredimensionale është veçanërisht i rëndësishëm për muzetë. Videot digjitale janë një alternativë me kosto të ulët për krijimin e modeleve 3D, por janë tepër të kufizuara në mundësitë ndërvepruese. Për më tepër mbi teknologjitë 3D shih website-t e Web 3D Consortium [36] ose 3dsite [37].

#### ▪ Realizimi i 3D

- VRML (Virtual Reality Markup Language) dhe X3D [38] janë standardet kryesore që përdoren për vizita virtuale dhe modelet 3D. Një alternativë është *shockwave 3D* [39]. Kjo e lejon përmbajtjen të jetë e shikueshme nga çdokush me versionin më të fundit (*free shockwave viewer*), por deri tani ky nuk ka kapacitetet e VRML.

IPR (Intellectual Property Rights). Rëndësia e kësaj çështjeje nuk duhet neglizhuar, së këtejmi në qoftë se nuk sigurohet e drejta për të fotokopjuar, digjitalizimi nuk mund të realizohet. Ka dy aspekte këtu:

1) *Vendosja e copyright-it*. A e ka institucioni të drejtën për të bërë kopje digjitale? Do të jetë e nevojshme të sigurohet e drejta mbi materiale, veçanërisht në rast se parashikohet që ai të publikohet në web, dhe ky mund të jetë një proces që do kohë dhe që kushton. Ky është një faktor në procesin e përzgjedhjes dhe duhet të mbahet parasysh që në fazën e planifikimit.

2) *Sigurimi i copyright-it*. Ç'është drejta mbi imazhet e digjitalizuara institucioni ka ndërmend të ketë? A do të gjenden imazhet në mënyrë të lirë apo do të shfaqen në web me format të vogël dhe do të kërkohet pagesë për kopje më të qarta? Kjo duhet marrë në konsideratë në fazën e planifikimit. Nxjerrja e të ardhurave mund të jetë një faktor për bërësit e politikave dhe organizmat financuese.

Copyright-i i materialeve të vendosura në Internet duhet mbrojtur me mjete teknike si: *shenja të dukshme; shenja digjitale të padukshme* [40]; *kodimi i imazheve; frenimi i publikimit në imazhe me rezolucion të ulët; frenimi i publikimit në imazhe me pjesë të vogla të një imazhi të vetëm; frenimi i shfaqjes me përdorues të autorizuar të regjistruar*. Të gjitha këto metoda kanë argumente pro dhe kundër dhe duhen marrë në konsideratë në lidhje me qëllimet dhe objektivat e projektit dhe institucionit.

Website-i i Universitetit të Nju Jorkut Bufalo përmban lidhje me mjaft faqe të vlefshme [41] dhe për këshillim shih faqen e copyright-it të TASI TASI (Technical Advisory Service for Images) [42].

Organizatrat mund të duan të nxitin ripërdorimin e përmbajtjes së tyre, veçanërisht në kontekstin e nxitjes së të mësuarit. Kjo mund të arrihet përmes përdorimit të licensës Creative Commons [43]. Licença e mësipërme shpreh qartë rrugët përmes të cilave njësitë digjitale mund të ripërdoren dhe tabelat në Appendix demonstronjë si mund të zbatohet kjo në lidhje me publikimin në Internet të imazheve me rezolucion të ulët.

## Projektimi dhe paraqitja

Mjaft projekte digjitalizimi në fushën kulturore do të çojnë në krijimin e website-ve [44] pavarësisht se disa do të jenë vetëm për përdorim në institucione. Shembuj të një përdorimi të tillë janë: shfaqje informacioni ndërveprues në muze; ekspozim digjital të dokumenteve ose librave të dëmtueshëm në arkiva ose biblioteka; ekspozim digjital i objekteve në muze si për të mbrojtur njësitë e dëmtueshme nga ekspozimi në dritë, ashtu edhe për të ekspozuar një objekt me formë shumëkëndore; katalogë, indekse dhe guida për përdorim nga vizitorët në institucion, përfshirë guida audio; digjitalizim me qëllim përmirësimin e aksesit për njerëz me paaftësi.

Për publikim në web duhen mbajtur parasysh pikat e mëposhtme: lehtësi e navigimit p. sh. lidhjet me faqen e fillimit,

me skemën e site-ve ose tryezën e lëndës në çdo faqe; aksesin nga njerëz me paaftësi; përdorimin e kujdesshëm të animimeve, pop-up-ve, Flash etj. me mundësi për shmangien e tyre; akses multilingual.

Përgatitja e botimit në Internet përfshin përgatitjen e skedës mostër në përputhje me kërkesat operacionale të Internetit, çka zakonisht do të thotë reduktim i madhësisë dhe cilësisë së skedarit për të mundësuar download-ime të shkurtra. Kur botohen imazhe më të mëdha, kjo mund të realizohet me anë të një lidhjeje nga faqja web me një paralajmërimin që download-imi mund të jetë i ngadaltë.

Përpunimi i imazheve dhe botimi audio dhe video i software-ve sigurohen përmes qirasë ose furnizohen me hardware. Shikuesit e 3D dhe të materialeve të realitetit virtual nuk janë të shumtë, megjithëse PC-të me një fokus në lojëra kanë shpesh përforcues të hardware-ve dhe kujtesë grafike të rritur që mund të përmirësojnë gjendjen.

Sisteme të tjera shpërndarjeje janë CD-të dhe DVD-të.

## Ruajtja

CD-të dhe DVD-të mund të përdoren gjithashtu për depozitimin e koleksioneve digjitale. Materiali digjital do të mbahet në makinat server, ku duhet të bëhet *back-up*, në rastin më të mirë së paku ruhen dy lloje të veçanta mediash. CD-R-et kanë qenë deri më tash një media e zakonshme për *back-up*, por tani ato janë zëvendësuar nga DVD-të, të cilat mund



të depozitojnë një skedar më të madh. Shiriti Digjital Linear (DLT) është ende në përdorim, kështu që përveç DVD kemi edhe DLT. Sidoqoftë ka një tendencë të rritjes së depozitimit të të dhënave në pajisje mobile *hard drive* dhe të transferimit të tyre në servera të rinj edhe jashtë kohës së punës duke u reduktuar kështu rreziku i vjetërimit të mediave.

Digjitalizimi u mundëson muzeve, bibliotekave dhe arkivave të të sigurojnë përdorues të rinj si edhe t'u shërbejnë përdoruesve tradicionalë në mënyra të reja. Digjitalizimi mund të transformojë mënyrën me të cilën përdoren koleksionet si edhe mënyrën se si janë organizuar vetë institucionet. Teknologjia digjital ofron rrugë të reja të plotësimit të misioneve kryesore të tilla si arsimit, kërkimi dhe pasuritë kulturore. Muzetë, bibliotekat dhe arkivat duhet të vlerësojnë krijimin e modeleve të reja të biznesit për të siguruar vazhdimësinë, pa rënë në konflikt me objektivat dhe detyrat bazë të tyre.

Në të ardhmen do të ketë adoptime në shkallë të gjerë të standardeve teknike që do të çojnë në ndërveprueshmëri me koleksioneve.

Hartuesit e politikave duhet të punojnë për pajtueshmëri me të drejtat e njeriut me qëllim që të mundësojnë akses të hapur në burimet digjitale.

Meqë mediat e sotme, padyshim, do të vjetroheshin brenda rreth 5 vjetësh, institucionet duhet të vendosin politika rigorozë të *back-up* dhe transferimit të informacionit.

Tendenca në rritje për depozitimin e të dhënave "në Internet" si edhe futja e të dhënave në pajisje mobile *hard drive*

lehtëson transferimin e të dhënave nga një medium në tjetrin. Sa më tepër serverat bëjnë *back up* dhe shpërngulen në servera të rinj pa ndërprerje, aq më tepër do të rritet varësia në mediat mobile si ruajtëse *back up*. Në një kuptim më të gjerë pritet që mediat të zhvillohen për të qenë më të përshtatshme për ruajtje të përhershme të koleksioneve digjitale.

Bashkëpunimi mes institucioneve duhet të çojë në ngritjen e depozitimeve komunitare dhe, lidhur me këtë, në bashkëpunimin në ruajtjen e objekteve digjitale. [45]

Gjithnjë e më tepër materialet do të krijohen në formë digjitale. Institucionet do të duhet të vendosin politika që materialet e "lindura digjitale" të ruhen dhe të bëhen të shfrytëzueshme.

Në të ardhmen metoda të reja kërkimi do t'u mundësojnë përdoruesve të kërkojnë për çdo objekt ose imazh digjital, për ta parë dhe bërë *download* atë pa qenë nevoja të dinë nëse origjinali ruhet në PC-të e tyre.

Për një vizion të së ardhmes shih *The Dicult Report: Technical Landscapes for tomorrow's cultural economy: unlocking the value of cultural heritage* European Commission, 2002. ISBN 9282862658. [46]

[1] Parimet e Lund-it [http://www.cordis.lu/ist/directorate\\_e/dicult/lund\\_principles.htm](http://www.cordis.lu/ist/directorate_e/dicult/lund_principles.htm)

[2] Plani i veprimt Lund [http://www.cordis.lu/ist/directorate\\_e/dicult/lund\\_ap\\_browse.htm](http://www.cordis.lu/ist/directorate_e/dicult/lund_ap_browse.htm)

- [3] Projekti Minerva <http://www.minervaeurope.org/>
- [4] Good Practices Handbook, botuar nga Minerva Working Group 6. Version 1.3. 3 Mars 2004. [http://www.minervaeurope.org/structure/workinggroups/goodpract/document/goodpractices1\\_3.htm](http://www.minervaeurope.org/structure/workinggroups/goodpract/document/goodpractices1_3.htm)
- [5] Minerva Technical Guidelines for Digital Cultural Content Creation Programmes. Version 1.0. 8 Prill 2004. <http://www.minervaeurope.org/publications/technicalguidelines.htm>
- [6] Europa: Grante dhe huazime <http://europa.eu.int/grants/>
- [7] TASI (Technical Advisory Service for Images): Image Capture: Hardware and Software <http://www.tasi.ac.uk/advice/creating/hwandsw.html>
- [8] Jukka Korpela: *A tutorial on character code issues.* <http://www.cs.tut.fi/~jkorpela/chars.html>
- [9] AHDS *Guide to good practice: creating and documenting electronic texts.* <http://ota.ahds.ac.uk/documents/creating/>
- [10] HTML 4.01 HyperText Markup Language <http://www.w3.org/TR/html401>
- [11] XHTML 1.0 Extensible HyperText Markup Language <http://www.w3.org/TR/xhtml1/>
- [12] Portable Document Format (PDF) <http://www.adobe.com/products/acrobat/adobepdf.html>
- [13] TASI: Advice: Creating digital images <http://www.tasi.ac.uk/advice/creating/creating.html>
- [14] TIFF (Tagged Image Skedar Format) <http://www.itu.int/itudoc/itu-t/com16/tiff-fx/docs/tiff6.pdf>
- [15] SVG (Scalable Vector Graphics) <http://www.w3.org/TR/SVG>
- [16] Macromedia Flash <http://www.macromedia.com>
- [17] PNG (Portable Network Graphics) <http://www.w3.org/TR/PNG/>
- [18] JPEG (Joint Photographic Expert Group) format <http://www.w3.org/Graphics/JPEG>
- [19] JPEG/SPIFF (JPEG Still Picture Interchange Skedar Format) <http://www.jpeg.org/public/spiff.pdf>
- [20] Më tepër informacion mbi JPEG në <http://www.jpeg.org> ose <http://www.faqs.org/faqs/jpeg-faq/>
- [21] Standardi JPEG 2000 gjendet në <http://www.jpeg.org/jpeg2000/index.html>
- [22] ISO/IEC 15444
- [23] GIF (Graphics Interchange Format) <http://astronomy.swin.edu.au/~pbourke/dataformats/gif/>

- [24] Formati PNG (Portable Network Graphics) <http://www.w3.org/TR/REC-png-multi.html>
- [25] Formati SVG (Scalable Vector Graphics) në <http://www.w3.org/TR/SVG12/>
- [26] Formati AVI (Audio Video Interleave) <http://support.microsoft.com/default.aspx?id=kb:en-us:Q316992>
- [27] Formati MPEG (Moving Pictures Expert Group) <http://www.chiariglione.org/mpeg/>
- [28] Microsoft <http://www.microsoft.com/> ; Apple <http://www.apple.com/>
- [29] Standardet MPEG <http://www.chiariglione.org/mpeg/standards.htm>
- [30] Formati MPEG-1 <http://www.chiariglione.org/mpeg/standards/mpeg-1/mpeg-1.htm>
- [31] Formati MP3 <http://www.mp3-tech.org>
- [32] Real Audio <http://www.real.com>
- [33] Sun AU <http://www.sun.com/>
- [34] Audio Engineering Society (AES) <http://www.aes.org/>
- [35] International Association of Sound and Audiovisual Archives (IASA) <http://www.iasa-web.org/>
- [36] Web 3D Consortium <http://www.web3d.org>
- [37] 3dsite, inc <http://www.3dsite.com>
- [38] VRML (Virtual Reality Markup Language) dhe X3D <http://www.web3d.org>
- [39] shockwave 3D <http://www.macromedia.com>
- [40] Për më tepër mbi *watermarking* shih <http://www.webreference.com/content/watermarks/>
- [41] Website i Universitetit të Nju Jorkut, Buffalo, <http://ublib.buffalo.edu/libraries/units/cts/preservation/digires.html>
- [42] TASI (Technical Advisory Service for Images) faqja e copyright-it <http://www.tasi.ac.uk/advice/managing/copyright.html>
- [43] Creative Commons <http://www.creativecommons.org>
- [44] Ka me mijëra website që kanë të bëjnë me projektimin dhe realizimin e web site-ve, mes të cilave:  
<http://www.essdack.org/webdesign/>  
<http://www.htmlgoodies.com>  
<http://www.iasl-slo.org/creatingweb.html>
- [45] Shih website-in Digjital Preservation Coalition në <http://www.dpconline.org/text/index.html>.



[46] *The Dicult Report: Technical Landscapes for tomorrow's cultural economy: unlocking the value of cultural heritage*. Komisioni Europian, 2002. Raport i plotë ISBN 92-828-5189-3. Përmbledhja ekzekutive ISBN 92-828-6265-8. <http://www.dicult.info/pages/report.php>

## LIDHJE

### Ndërkombëtare

*Projekti Google i digjitalizimit*

Koleksionet e pesë institucioneve akademike më të rëndësishme të botës do të digjitalizohen nga Google. Faqe të skanuara të librave në institucionet publike do të bëhen të shfrytëzueshme online. Bibliotekat që po punojnë me Google janë biblioteka e universitetit të Oksfordit, bibliotekat universitare në Michigan, Harvard dhe Stanford dhe biblioteka publike e Nju Jorkut. <http://business.timesonline.co.uk/article/0,,9075-1403143,00.html>

### Armeni

*Biblioteka digjitale e literaturës klasike armene nga shek. V deri në shek. XVIII*

Ky projekt digjitalizon lloje të ndryshme të literaturës armene: ligjore, ekonomike, gjeografike, historike, filozofike, teologjike, mjekësore etj. dhe po punon mbi një bazë të dhënash të objekteve muzeorë për të krijuar një version virtual të muzeut me

klasifikimin e tij tredimensional. <http://www.digilib.am>

### Bullgari

*Projekti Varna e Vjetër*

Synon të ruajë historinë e Varnas në foto dhe tekste për brezat e ardhshëm dhe ta popullarizojë atë mes qytetarëve. Pjesë dhe foto ekspozitash janë grumbulluar, restauruar me teknologji speciale dhe ruajtur në CD “folëse” dhe në web. CD-të janë edhe në anglisht. Website-i është vetëm në bullgarisht. <http://www.libvar.bg/old-varna/>

*Projekti i pallatit Euxinograd*

Foto të pallatit, parku dhe dokumente arkivore janë mbledhur, digjitalizuar dhe rregulluar sipas 6 fushave kryesore. Përngjasime 3D të sallave të pallatit ose një udhëtim në park janë parashikuar për fazën tjetër të projektit. Gjendet vetëm në bullgarisht në CD-ROM. Është planifikuar versioni Web.

### Kroaci

*Koleksioni Digjital “Silvije Strahimir Kranjcevic”*

Koleksion materialesh të digjitalizuara (koleksion i teksteve të plota poetike, dorëshkrime, histori familjesh, arkiva familjesh, korrespondencë, fotografi), që i referohen këtij poeti të shquar kroat të shek. 19. Përfshin një inventar të hollësishëm dhe një bazë të

dhënash të të gjitha njësive për të lehtësuar kërkime të mëtejshme. Gjetend online dhe në CD-ROM. <http://www.sskranjcevic.hr>

## Republika Çeke

*Këshjtjella e kryepeshkopit dhe kopshtet në Kromiõi•*

Shembull i digjitalizimit të librave në një institucion lokal <http://digi.azz.cz>

Gjithashtu është digjitalizuar një koleksion monedhash <http://coins.azz.cz>

*Database i vulave në arkivat çeke*

Projekt i Ministrisë së Brendshme <http://database.aipberoun.cz/pecete>

*Digjitalizimi i dokumenteve rajonale (DRD)*

Synimi është të digjitalizohen burimet rajonale nga arkivat si gazeta dhe revista, kronika klubesh dhe komunash, kronika personale dhe familjare si edhe dokumente të rëndësishme nga arkivi i distrikteve dhe koleksione të tjera. <http://www.soka-cr.cz>; <http://www.knihovna-cr.cz>

*Projekti Memoria*

Siguron akses në një komplet të tërë dokumentesh të digjitalizuara dhe përshkrime të hollësishme të dokumenteve historike dhe gjithashtu të dhëna bibliografike nga një varg burimesh në bazën e të dhënave *Memoria*. Projekti

pranon të dhëna të të gjitha llojeve. <http://www.memoria.cz>

## Francë

*Biblioteka Valenciennes*

Siguron akses në mikrofilma të digjitalizuara të dorëshkrimeve të vjetra. <http://www.ville-valenciennes.fr/bib/fondsvirtuels/microfilms/accueil.asp>

## Islandë

*Harta të Islandës në Internet*

Të gjitha hartat antike të Islandës (më të vjetra se 1900) që janë në koleksionin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Islandës dhe të Bankës Qendrore të Islandës janë konvertuar në format digjital dhe gjenden në Internet. <http://www.bok.hi.is/kort>

## Irlandë

*Pyet mbi Irlandën*

Ky është një site portal pilot për akses në përmbajtje kulturore lokale si biblioteka, muze dhe arkiva në Irlandë. Projekte të ndryshme pilot digjitalizimi gjenden këtu, përfshirë Waterford Museum of Treasures (objekte 3D), Cork Archives Institute, Waterford City Library (Optical Character Recognition) dhe Mayo County Library (materia audio dhe video). <http://www.askaboutireland.com/bestpractice.html>

## Luksemburg

*Bibliothèque nationale de  
Luxembourg*

Po realizon një projekt të madh digjitalizimi. <http://www.bnl.lu/>

## Poloni

*Cieszynska Biblioteka Wirtualna  
(CBW) / Cieszyn Virtual Library  
(CVL)*

Akses në Internet në materiale bibliotekare të digjitalizuara që lidhen me Ćel'sk Cieszynski (rajon multikulturor në kufirin Poloni-Republika Ćeke).  
<http://www.ata.com.pl/kcc/biblioteka/>

*Thesarë të Arkivave polake*

Pamje digjitale të shoqëruara me përshkrim arkivor, shënim mbi përmbajtjen dhe të dhëna bibliografike. Dokumentet janë skanuar ose fotografuar nga kamera digjitale (rezolucioni deri në 600 dpi), ruajtur në formatin "tiff" dhe paraqitur në Internet në formatin "jpg". <http://www.poland.pl/articles/?c=421>

## Rumani

*Digjitalizimi i shtypit të vjetër në  
Dobrudjean (DPDV)- Projekt i  
bibliotekës "Ioan N. Roman"  
Constanta*

Digjitalizimi i shtypit të vjetër në Dobrudjean (1889-1940) që ka qenë në

mikrofilm dhe format letër. <http://www.biblioteca.ct.ro>

*Monumente nga muzetë e hapura në  
Rumani*

Forma elektronike të monumenteve të arkitekturës popullore të ruajtura në muze ose "in situ". <http://www.cimec.ro/aer/aeretrn.htm>

## Rusi

*Koleksionet e Muzeut Pushkin*

Koleksione të ndryshme në muzeun *Pushkin* dhe vende të tjera, të digjitalizuara duke përdorur sistemin e precizionit të lartë EPOS dhe teknologjinë e skanimit "lente fluturuese" që nuk e dëmtojnë origjinalin. <http://www.eposgroup.ru>

*Kujtesa e Karelias*

Biblioteka Kombëtare e Republikës së Karelias ka hartuar dhe realizuar këtë projekt si pjesë të programit federal "*Memory of Russia*". Qëllimi është të konservojë fonde librash të rrallë dhe unikalë që kanë të bëjnë me studimet lokale, ndërkohë që sigurohet akses i gjerë i tyre në Internet. Digjitalizimi gjithashtu do të mundësojë mundësi të tjera pune me botime të rralla (kërkime tekst, kërkim dokumentesh me përshkrim drejtshkrimor, import të teksteve në formate të ndryshme etj.).

<http://library.karelia.ru/rus/prog/pamyat2002.shtml>



## Serbi dhe Mali i Zi

*Digjitalizimi i dorëshkrimeve dhe fragmenteve të hershme të shtypura nga Biblioteka e Manastirit të Franceskanëve në Santa Clara, Kotor;*

CD-ROM "Archives, libraries and monuments of Kotor"

Këto projekte të Qendrës për Ruajtjen dhe Prezantimin e Trashëgimisë Dokumentare "Notar" lidhen me ruajtjen, vlerësimin, përshkrimin dhe prezantimin e koleksioneve historike.

<http://www.cdknotar.cg.yu>; <http://www.matf.bg.ac.yu/iak>

*Qendra Kombëtare e Digjitalizimit (NCD)*

Ky është një consortium për digjitalizimin e materialeve apo objekteve të institucioneve kulturore dhe shkencore, përfshirë Institutin e Matematikës SANU dhe Fakultetin e Matematikës Beograd (që siguron mbështetjen teknike), Bibliotekën Kombëtare të Serbisë, Muzeun Kombëtar Beograd, Institutin Arkeologjik, Arkivin e Republikës së Serbisë, Institutin e Mbrojtjes së Monumenteve dhe Arkivin e Filmit Jugosllav. Ka një bashkëpunim me institucione të tjera kulturore dhe shkencore nga Serbia dhe Mali i Zi. Disa projekte janë duke u realizuar. <http://www.ncd.matf.bg.ac.yu>

## Slovakia

*CEMUZ - Central Register of Museum Objects in Slovakia*

Më 2002 Muzeu Kombëtar Slovak realizoi projektin CEMUZ për digjitalizimin e objekteve muzeore (vlerësuar 8 milionë në total) dhe ngriti një bazë të dhënash për t'u përdorur si pjesë e Regjistrimit të Kulturës dhe për të qenë pjesë e portalit të përbashkët dhe sistemit shtetëror të informacionit. <http://www.cemuz.sk>

## Spanjë

*Archivo De La Ciudad*

Akses online në imazhe digjitale të koleksionit të arkivave në Arganda, kryesisht për qëllime mësimore. Website i këtij arkivi lokal është një nga shembujt më të mirë të përdorimit të teknologjive të reja në Spanjë. <http://www.ayto-arganda.es/archivo>

*Digjitalizimi gazetave të vjetra në bibliotekat publike spanjole*

Digjitalizimi po kryhet me teknologji të fjalës së fundit. Baza e të dhënave që do të përftohet do të përfshijë përshkrime bibliografike të njësisve origjinale (sipas Dublin Core Metadata Initiative) dhe metadatat të strukturave të skedarëve (sipas Metadata Encoding & Transmission Standard). <http://www.digibis.com/prensa.htm>

*Documentos Virtuales del Archivo  
Histórico de Sueca*

Të gjitha dokumentet nga 1264 deri më 1954 janë digjitalizuar dhe gjenden në <http://sapiens.ya.com/webarchivo/>

*Patrimonio.es (2004-2008)*

Program digjitalizimi i trashëgimisë spanjole kulturore, shkencore dhe natyrore qëllimi i të cilit është ruajtja, katalogimi dhe përhapja. Përfshin një listë të nismave të ndryshme për digjitalizimin në sektorin e trashëgimisë kulturore. <http://patrimonio.red.es/>

*Biblioteka Virtuale në Andaluzi*

Dokumente të digjitalizuara mund të aksesohen përmes katalogut të bibliotekës virtuale që lejon kërkim sipas autorit, titullit ose lëndës ose nëndarjeve si Biblioteka e Hartave, Biblioteka e Grafikës, Biblioteka Referative Andaluziane, Biblioteka e Gazetave, Biblioteka e Filmit etj. Përfshin burime shtesë nga kultura dhe të mësuarit në shkolla si: “Sot në historinë e Andaluzisë” dhe “Studioj dhe mësoj me Bibliotekën Virtuale të Andaluzisë”. <http://www.juntadeandalucia.es/cultura/bibliotecavirtualandalucia/>

*Përkthyer nga Ramazan Vozga*

*Biblioteka Virtuale e Trashëgimisë  
Bibliografike Spanjole*

Prototipi për Bibliotekën Virtuale të Trashëgimisë Bibliografike Spanjole, realizuar nga Nëndirektorati i përgjithshëm për Koordinimin Bibliotekar. <http://www.digibis.com/digibib>

## Suedi

*Digitaliseringsprojekt inom arkiv,  
bibliotek och museer*

Projekt digjitalizimi i përbashkët. <http://www.kultur.nu/rapporter/digitaliseringsprojekt.html>

## Turqi



*Akdas – Atatürk Kitaplıǵı Dijital  
Arşiv Sistemi (Atatürk Library  
Digitized Archive System, Istanbul  
Greater City Municipality)*

Vepra të periudhës së Perandorisë Osmane si gazeta, dorëshkrime, libra, kartolina, harta etj. janë digjitalizuar dhe projekti është në progres për të adoptuar teknologji të reja për të shpejtuar digjitalizimin. Veprat e digjitalizuara janë vënë në shërbim të menjëhershëm për përdorim brenda institucionit. <http://www.ibb.gov.tr/minisite/kutuphaneler/>

## APPENDIX

Licensa *Creative Commons* [43] shpreh qartë rrugët në të cilat njësitet digjitale mund të jenë të ripërdorshme dhe

kjo tabelë e prodhuar nga Projekti Minerva [3] demonstroi se si ajo mund të aplikohet në lidhje me publikimin në Internet të imazheve me rezolucion të ulët.

Lloji i imazhit	Informacioni teknik	Përdorime tipike	Kushtet e licensës
I vogël	JPG 72 dpi thellësi e bit-it e 24-bit ngjyrë ose 8-bit hije 120 pixel-a për dimensionin më të gjatë	<b>arsimor:</b> përfshirë montazhin <b>komercial:</b> asnjë	Fushë veprimi jokomerciale, jo vepra që burojnë së këtëjmi [fakultative] 
Rezolucion i ulët	JPG 150 dpi thellësi e bit-it e 24-bit ngjyrë ose 8-bit hije maksimumi i 600 pixel-ave për dimensionin më të gjatë	<b>arsimor:</b> përdorim në një prezantim ose esse <b>komercial:</b> përzgjedhje imazhesh dhe layout fillestar, mundësi për licensim për përdorim në website dhe prezantime	Fushë veprimi jokomerciale, jo vepra që burojnë së këtëjmi [fakultative] 
Rezolucion i lartë	TIFF 600 dpi thellësi e bit-it e 24-bit ngjyrë ose 8-bit hije	<b>arsimor:</b> shikim detajesh, kopje arkivi <b>komercial:</b> prodhim multimedial, riprodhim shtypi, përhapje	Copyright



---

■ Biblioteka e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike

149

---



# Biblioteka e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike

**Besa KASAPI**

Universiteti Politeknik

---

**B**iblioteka e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike (FIE) është një nga bibliotekat universitare e krijuar në vitin 2003.

Për të kryer më mirë misionin e saj në ndihmë të procesit mësimor si dhe për të siguruar akses në informacion përdoruesve të saj, FIE me fondet e tij dhe në bashkëpunim dhe me qeverinë zvicerane hartoi dhe zbatoi projektin për krijimin dhe funksionimin e qendrës *Multimedia Library*. Qendra u përrurua më 26 tetor 2004. Kjo qendër është ndërtuar mbi bazën e shkencës së informacionit dhe bibliotekonomisë dhe ofron për përdoruesit e saj shërbim të lirë në sallën e koleksioneve si dhe nëpërmjet teknologjive bashkëkohore, gjë që e bën këtë qendër një model të mirë për bibliotekat universitare në vendin tonë.

Fondi i librave (rreth 2500) dhe teknologjia që disponon kjo qendër ka krijuar bërthamën e një biblioteke cilësore në profilin e saj. Organizimi i koleksioneve është me fonde të hapura, por është krijuar dhe katalogu elektronik, gjë që i

jep mundësi përdoruesve të orientohen dhe të gjejnë me lehtësi informacionin e duhur.

## Misioni dhe politikat e saj

Biblioteka shkencore e FIE është biblioteka universitare në funksion të procesit mësimor në Fakultet, është një mbështetje e fuqishme për stafin pedagogjik, për studentët e të gjitha niveleve dhe për të gjithë specialistët e fushave të inxhinierisë elektrike e elektronike kudo që janë. Misioni e saj është të shërbejë si qendër informacioni për përdoruesit e saj (studentë, pasuniversitarë, pedagogë e studiues kërkimorë-shkencorë të këtyre fushave), ku të ofrohen mundësi për njohuri të reja dhe për marrjen e tyre në mënyrë sa më efektive. Kjo gjë është arritur nëpërmjet futjes së teknologjisë së re dhe

shërbimeve të kompiuterizuara, duke kthyer këtë bibliotekë me shërbime dhe fizionomi tradicionale në një bibliotekë moderne, bashkëkohore, me të gjithë parametrat që ka sot një bibliotekë e automatizuar.

## Koleksionet "Multimedia Library" të FIE

Koleksionet e Qendrës "Multimedia Library" në pjesën më të madhe janë botime të reja të viteve të fundit dhe botime të vetme në këtë fushë. Ato kryesisht janë në gjuhë të huaj (anglisht, italisht, gjermanisht etj.) si dhe në gjuhën shqip.

### *Përmbajtja e koleksioneve është kryesisht si më poshtë:*

*Libra të fushave të inxhinierisë elektrike (energjetikës dhe industrisë);*

*Libra të fushave të inxhinierisë elektronike (elektronikës, informatikës dhe telekomunikimit);*

*Libra të matematikës dhe fizikës;*

*Dispensa e dorëshkrime të fushave të mësipërme;*

*Fondi referues: enciklopedi, fjalorë të terminologjisë tekniko-shkencore për fushat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike nga specialistë të këtyre fushave;*

*Burime elektronike (disketa, CD-ROM) që kanë të bëjnë me anën praktike të fushave përkatëse;*

*Softë të ndryshme profesionale (MatLab, AutoCad, Xollinix etj.).*

Është realizuar përpunimi bibliografik i koleksionit duke zbatuar standardet

ndërkombëtare ISBD dhe rregullat Anglo-Amerikane të katalogimit (AACR2), ndërsa klasifikimi është bërë sipas sistemit të Klasifikimit Decimal Universal (UDC). Gjithashtu është bërë katalogimi lëndor duke u mbështetur në treguesin e Emërtimeve Lëndore të Bibliotekës Kombëtare dhe në LCSH (Library of Congress Subject Headings).

Në këtë qendër është krijuar katalogu elektronik, që është një bazë elektronike e standardizuar e mbështetur në Standardet ISBD, AACR2 dhe UNIMARC. Katalogu elektronik në sajë të instalimit të programit WIN/ISIS (i quajtur soft i kërkimit të informacionit), serverit të instaluar dhe rrjetit Wireless LANs (rrjet pa tel), bën të mundur që përdoruesi të marrë informacionin e duhur në një kohë të shkurtër. Me anë të modulit të kërkimit bëhet e mundur që përdoruesi të kërkojë në katalogun elektronik (sipas elementeve të kërkimit p.sh.: autorit, titullit, subjektit etj.) informacionin e duhur dhe ta marrë atë me lehtësi. Ky katalog i kompiuterizuar përmirëson aksesin në fondet e bibliotekës aq më tepër kur ai të pasqyrohet edhe në Internet.

Organizimi i koleksioneve në këtë qendër informacioni është në fond të hapur dhe vendosja e koleksioneve në raftë është bërë sipas subjektit, pra sipas fushave dhe nënfushave të shkencave përkatëse, ndërsa brenda çdo subjekti librat janë renditur alfabetikisht sipas mbiemrit të autorit ose titullit për librat pa autor.

Për të siguruar sa më mirë fondin e kësaj qendre dhe për të shmangur mundësinë e përvetësimit të njëjësive



bibliotekare nga përdorues të veçantë janë marrë masa mbrojtëse. Këtë gjë e realizon më së miri instalimi i sistemit të kontrollit (check-point), në sajë të vendosjes të një pllake magnetike në libër dhe një dërr të daljes speciale që jep sinjal.

## Shërbimet

Shërbimin që ofron qendra “Multimedia Library” është në kushtet e bibliotekave me fonde të hapura, si shërbim koherent dhe si mënyra më e mirë për krijimin e mundësive për përdorim të lirë të koleksioneve në bibliotekë. Kjo qendër është pajisur me komoditetin dhe teknologjinë e fundit dhe është në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve dhe studiuesve të shkencave ekzakte. Organizimi i punës në këtë qendër bazohet në rregulloren e hartuar në përputhje me Ligjin nr. 8576, datë 3. 02. 2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë” Neni 30, por edhe në kërkesat specifike të FIE.

Qëllimi i punës së shërbimit në bibliotekën e FIE është, të bëjë të mundur që informacioni të kalojë lirshëm nga burimi tek ata që janë të interesuar për të. Kjo lidhet me organizimin e qendrës në mënyrë të tillë, që përdoruesi të orientohet me lehtësi, të gjejë ndihmën e nevojshme, të ketë kushte të përshtatshme për shfrytëzimin e koleksioneve dhe orar shërbimi të mjaftueshëm.

Këtij qëllimi i ka shërbyer më së miri automatizimi i të gjitha proceseve teknike në bibliotekë. Kjo gjë është arritur nëpërmjet instalimit të programeve të automatizimit të punës në biblioteka si:

1. Programi “ResourceMate 2.0”, i cili është një soft i standardizuar që shërben për menaxhimin e bibliotekave universitare. Me anën e këtij softi mund të krijohet katalogu elektronik dhe të realizohet kërkimi (sipas elementeve të kërkimit: autor, titull, subjekt etj.), për një kohë të shkurtër. Gjithashtu bëhet qarkullimi i koleksioneve si dhe inventarizimi i tyre në mënyrë të automatizuar, ku çdo njësi bibliotekare ka barkodin e saj me anën e të cilit bëhet identifikimi i menjëhershëm me anën e skanerit të instaluar;
2. Për çdo individ që dëshiron të anëtarësohet bëhet pajisja me Library Card, që është një kartë që ka barkodin e saj të programuar (të lexueshëm) nga sistemi, me anën e të cilës mundësohet hyrja në ambientin e bibliotekës dhe identifikimi i përdoruesit.

Me anën e këtij programi mund të merren statistika të ndryshme. Ky soft mundëson dhe printimin e të gjitha skedave sipas rregullave standarde të AACR, etiketave dhe kartelave të xhepave, gjë që mund ta realizojmë dhe me anë të programit *Librarian's helper (LH5)*, të cilin e kemi të instaluar.

Në sajë të instalimit të serverit dhe rrjetit Wireless LANs së bashku me kompiuterat e shërbimit çdo përdorues mund të hyjë e të marrë informacionin e duhur në katalogun elektronik në një kohë të shkurtër. Me anën e këtij programi mund të përfitohen lista bibliografike, të cilat organizohen sipas autorit, subjektit,

numrit të vendit etj.

Kjo qendër është e gatshme të ofrojë katalogun e saj në on-line në rast se krijohet faqja në Internet për FIE, ku çdokush mund të marrë informacionin e duhur për koleksionet e kësaj qendre.

### *Shërbimet që ofron qendra “Multimedia Library janë:*

*Kartën elektronike të anëtarësimit;  
Katalogun elektronik;  
Shërbim në fond të hapur;  
Internet;  
Fotokopjim;  
Printim;  
Burime elektronike;  
Softe të ndryshme profesionale;  
Shërbim në projektor;  
Guidë njohëse.*

### *Objektivat*

Kthimi i bibliotekave në qendra të rëndësishme të informacionit për përdoruesit e saj kërkon një angazhim të madh për ta mbajtur në këtë nivel dhe për ta çuar më tej shërbimin në qendrën *Multimedia Library*, që ajo t’i përgjigjet sa më mirë kërkesave bashkëkohorë.

### *Për këtë arsye, disa nga objektivat kryesorë janë:*

Sigurimin e aksesit të drejtpërdrejtë dhe të lirë për të gjitha kategoritë e përdoruesve të saj;

Pasurimin e koleksioneve me botime bashkëkohore e të përshtatshme për të

mbështetur programin mësimor dhe shkencor të FIE;

Njohjen e koleksioneve dhe shërbimeve të saj nëpërmjet krijimit të materialeve referuese dhe krijimit të faqes në Internet;

Abonimin në bazat e të dhënave elektronike dhe periodikë profesionale;

Pasurimin e saj me punimet shkencore dhe botimet e reja që u përkasin fushave të inxhinierisë elektrike dhe elektronike;

Sigurimin e pjesëmarrjes aktive të të gjitha kategorive të përdoruesve në pasurimin e koleksioneve dhe mirëmbajtjen e pajisjeve;

Organizimin e promovimeve të botimeve të reja profesionale;

Sigurimin e bashkëpunimit të ndërsjellë me qendra analoge brenda dhe jashtë vendit.

### **Biblioteka e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike**

Biblioteka e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike (FIE) është një nga bibliotekat universitare e krijuar në vitin 2003. Për të kryer më mirë misionin e saj në ndihmë të procesit mësimor si dhe për të siguruar akses në informacion përdoruesve të saj, FIE me fondet e tij dhe në bashkëpunim dhe me qeverinë zvicerane hartoi dhe zbatoi projektin për krijimin dhe funksionimin e qendrës *Multimedia Library*. Qendra u përrua më 26 tetor 2004. Kjo qendër është ndërtuar mbi bazën e shkencës së informacionit dhe bibliotekonomisë dhe ofron për përdoruesit e saj shërbim të

lirë në sallën e koleksioneve si dhe nëpërmjet teknologjive bashkëkohore, gjë që e bën këtë qendër një model të mirë për bibliotekat universitare në vendin tonë.

Fondi i librave (rreth 2500) dhe teknologjia që disponon kjo qendër ka krijuar

bërthamën e një biblioteke cilësore në profilin e saj. Organizimi i koleksioneve është me fonde të hapura, por është krijuar dhe katalogu elektronik, gjë që i jep mundësi përdoruesve të orientohen dhe të gjejnë me lehtësi informacionin e duhur.

## THE LIBRARY OF THE ELECTRICAL ENGINEERING FACULTY

*The Library of the Engineering Faculty (LEF) is part of the network of the university libraries founded at 2003. To have a better performance and to assist in a proper way the the process of teaching, as well as to ensure acesses for her members, LEF compiled and applied a project regarding Multimedia Library, with their own funds as well as in cooperation with Swiss government.*

*In 26 October 2004 this center was inaugurated, where everyone can find a contemporary technology, which makes this Library a pattern for the university libraries all over the country. This library count in its collections 2500 items. The technology makes this library the core of the qualitative library. The collections of the books are organized with open collections and in the same time everyone can search on an electronic catalogue, which offers a easy way to the people to get oriented and find out the necessary information.*



- 
- Konvertimi retrospektiv i skedarëve tradicionalë
- 

155

# Konvertimi retrospektiv i skedarëve tradicionalë

Informatizimi i proceseve dhe shërbimeve bibliotekare në Bibliotekën Kombëtare shënoi një hap të madh përpara në përshtatjen e funksioneve të saj me kërkesat e përdoruesve në kushtet e reja të shoqërisë së informacionit. Por, duke qenë se në bazën elektronike të të dhënave filluan të hidhen, sipas përvojës në të gjithë botën, vetëm hyrjet e reja, u krijua një mospërputhje, sepse përdoruesit siguronin informacion bibliografik në formë elektronike vetëm për materialet që kishin hyrë në bibliotekë pas automatizimit të saj. Pra, në skedarin elektronik mungonte informacioni për gjithë atë trashëgimi me vlera të pallogaritshme që ruhet në koleksionet e bibliotekës. Ky fakt, pra që informacioni elektronik për hyrjet e vjetra mungonte, ka qenë një shqetësim i përhershëm për drejtuesit dhe specialistët e Bibliotekës Kombëtare. Janë bërë konsulta për këtë problem, madje është ngritur edhe një grup pune, i cili, duke studiuar përvojën e huaj, por edhe duke mbajtur parasysh situatën konkrete të institucionit, ka hartuar udhëzimin përkatës. Mbështetur mbi këtë fazë përgatitore, u hartua projekti për konvertimin retrospektiv të skedarëve të Bibliotekës Kombëtare dhe do të fillojë puna për implementimin e tij. Në këtë kuadër do të sigurohen mjetet financiare, stafi, pajisjet e teknologjisë së informacionit etj. të

nevojshme për këtë proces kaq të rëndësishëm.

Projekti synon që regjistrimet që do të krijohen si rezultat i konvertimit retrospektiv të mbeten në zotërim të publikut. Kjo është në përputhje me kërkesën dhe rekomandimet e Këshillit të Europës për konvertimin retrospektiv të fondeve të bibliotekave. Qëllimi i projektit është konvertimi elektronik i skedarëve tradicionalë, konkretisht i skedarit të librit shqip, në funksion të përmirësimit të informacionit dhe shërbimit ndaj përdoruesve si edhe të zgjerimit të bashkëpunimit ndërbibliotekar.

Konvertimi retrospektiv është procesi nëpërmjet të cilit të dhënat për çdo njësi të një biblioteke hyjnë në një sistem kompiuteri, i cili lejon akses në katalogun elektronik. Zakonisht konvertimi retrospektiv bëhet për të siguruar regjistrime *full MARC* të çdo njësie, të cilat janë një format standard që lejon shkëmbim të dhënash mes adresash ose sistemesh të ndryshme.

Dihet që Biblioteka Kombëtare ka fondet më të pasura dhe më me vlerë në vend, por një pjesë e kësaj pasurie të çmuar nuk është e arritshme në mënyrë elektronike nga përdoruesit dhe një rreth më i gjerë

lexuesish brenda dhe jashtë vendit. Realizimi i projektit të konvertimit retrospektiv do të krijojë mundësinë për të bërë të shfrytëzueshme në mënyrë elektronike, madje edhe përmes Internetit, një herë e përgjithmonë informacionin bibliografik për këtë pasuri të vlefshme të trashëgimisë kombëtare të shkruar. Nisur edhe nga përvoja e bibliotekave të huaja ky projekt parashikon gjithashtu që, ndërsa realizohet konvertimi retrospektiv, koleksionet e bibliotekës të pajisen me barkode.

Katalogimi elektronik i fondeve më të vjetra dhe më të veçanta (antikuar, albanologji-balkanologji etj.) vjen si një sfidë e shumëfishtë: financiare, profesionale, teknologjike etj. Pikërisht përballimi i kësaj sfide përbën edhe objektivin e projektit të konvertimit retrospektiv të katalogëve të Bibliotekës sonë. Në Fondin e Arkivit të Librit Shqip gjenden mbi 51.000 tituj nga skedarët tradicionalë të papasqyruar në katalogun elektronik të Bibliotekës Kombëtare. Si pasojë e ndryshimit të rregullave të përshkrimit bibliografik dhe të tabelave të klasifikimit, hyrjet e librit shqip që nga viti 1989 (rreth 8.300 tituj) janë vendosur në skedarë të veçantë nga ata të hyrjeve që nga fillimet e bibliotekës deri në atë vit (rreth 42.700). Pra, ky është "inventari" i materialeve bibliotekare që do t'u nënshtrohet proceseve të konvertimit retrospektiv.

Ka disa mënyra konvertimi, por, duke pasur parasysh gjendjen e skedarëve të bibliotekës sonë, është zgjedhur ajo e hedhjes së skedave në sistemin e integruar bibliotekar ADLIB nëpërmjet radhimit në

kompiuter, ndryshe nga mënyra të tjera si p. sh. ajo me skanim të skedave ekzistuese. Bazë për konvertimin retrospektiv do të merret skedari alfabetik universal i librit shqip, sepse nga skedarët që disponohen ai është më i përshtatshmi, më i ploti dhe përmban edhe numrat e inventarit dhe numrat e vendit për çdo kopje. Elementet e përshkrimit që gjenden në skedë do të organizohen në zona sipas kërkesave të programit në nivelin maksimal të mundshëm. Të gjitha elementet që bëjnë pjesë në skedarin e termave të njësuar (autor, shtëpi botuese, seri, klasifikim, fjalë kyçe) do të njësohen duke u konsultuar me skedarin e termave të njësuar që tashmë është krijuar në ADLIB, si edhe me burime të tjera referuese. Përveç elementeve të përshkrimit bibliografik, regjistrimi do të plotësohet me të gjitha elementet e tjera të domosdoshme si numrat e vendit, numrat e inventarit. Për realizimin me sukses të këtij projekti kërkohen njohuri të përshkrimit bibliografik dhe të klasifikimit. Për të siguruar efektivitetin sa më të lartë, puna do të organizohet në çifte, ku njëra punonjëse do të merret me përshkrimin bibliografik duke hedhur në ADLIB të dhënat e skedës, duke i organizuar elementet sipas zonave, ndërsa tjetra do të plotësojë klasifikimin dhjetor e lëndor dhe kontrollon regjistrimin.

Rezultati përfundimtar i këtij projekti do të jetë sigurimi për përdoruesit i informacionit bibliografik elektronik për krejt koleksionin e fondeve të Bibliotekës Kombëtare, duke mundësuar kështu një shërbim bibliotekar më të shpejtë dhe më efektiv.



## THE RETROSPECTIVE CONVERSION OF THE TRADITIONAL CATALOGUE

*The aim of this project is the electronical conversion of the traditional card catalogues at the National Library; to be more concret, the card catalogue of the Albanian book, putting them in function of the improvement of the information and service toward the readers, as well as the enlargement of the interlibrarian cooperation.*

*The National Library has the richest and worthiest collection in the country, but a part of it is electronically unreachabeable from the users, inside and outside the country. The applying in practice of the retrospective conversion will make possible the electronical access , even through Internet, of the bibliographical information, this valuable tresure of our written national heritage.*

---

■ Manifesti i Aleksandrisë për bibliotekat	159
■ Rezoluta e Luksemburgut e CENL-së për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore europiane	161
■ Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s z. M. Koïchiro Matsuura me rastin e Ditës Botërore të Aftësimit në Informacion - 8 shtator 2005	163

---

# Manifesti i Aleksandrisë për bibliotekat<sup>1</sup>

Bibliotekat dhe shërbimet informuese japin ndihmesën e tyre në tërë veprimtarinë e shoqërisë së informacionit. Ato mundësojnë lirinë intelektuale përmes sigurimit të aksesit në informacion, ide dhe vepra në çdo mjedis dhe pavarësisht nga kufijtë.

Ato ndihmojnë në ruajtjen e vlerave demokratike dhe të drejtave civile universale paanësisht dhe i kundërvihen çdo forme të censurës.

Roli unik i bibliotekave dhe shërbimeve informuese është se ato u përgjigjen kërkesave dhe pyetjeve të veçanta të individëve. Kjo plotëson transmetimin e përgjithshëm të dijeve nga media dhe i bën bibliotekat dhe shërbimet informuese jetike në një shoqëri të hapur të informacionit dhe demokratike. Bibliotekat janë të domosdoshme për një qytetari të mirinformuar dhe qeverisje transparente.

Ato ndërtojnë kapacitete duke nxitur mësimin e përdorimit të informacionit dhe duke ofruar mbështetje dhe trajnime për përdorimin efektiv të burimeve të informacionit, përfshirë teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për nxitjen e programeve të zhvillimit, sepse burimet njerëzore janë themelore në progresin ekonomik. Në këtë mënyrë bibliotekat ndihmojnë ndjeshëm në zbutjen e ndarjes digjitale dhe të pabarazisë së informacionit që rrjedh prej saj. Ato ndihmojnë në bërjen realitet të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, përfshirë uljen e varfërisë. Ato do të bëjnë gjithçka investime tepër modeste. Vlera e kompensimit është të paktën 4-6 herë e investimit. Për arritjen e synimit të aksesit në informacion nga të gjithë, IFLA mbështet ekuilibrin dhe paanësinë e të drejtës së autorit. IFLA është gjithashtu fuqimisht e angazhuar në nxitjen e brendisë shumëgjuhëshe, të diversitetit kulturor dhe të nevojave të veçanta të popujve indigjenë dhe minoriteteve. IFLA, bibliotekat dhe shërbimet informuese ndajnë vizionin e përbashkët të një *Shoqërie Informacioni për të gjithë*, të pranuar nga Samiti Botëror i Shoqërisë së Informacionit i mbajtur në Gjenevë në dhjetor 2003. Ky vizion mbështet një shoqëri



gjithëpërfshirëse të bazuar në të drejtat themelore të njeriut si në aksesin ashtu dhe shprehjen e informacionit pa kufizime dhe ku secili të jetë në gjendje të krijojë, të aksesojë, të përdorë dhe të ndajë informacion dhe dije.

*IFLA u drejtohet qeverisjeve kombëtare, rajonale dhe vendore, si dhe organizmave ndërkombëtare:*

- të investojnë për bibliotekat dhe shërbimet informuese si elemente jetike në strategjitë, politikat dhe buxhetet e tyre për shoqërinë e informacionit;
- të përmirësojnë dhe zgjerojnë rrjetet bibliotekare për të arritur përfitimin maksimal të mundshëm për qytetarët dhe bashkësitë e tyre;
- të mbështesin aksesin pa kufizim në informacion dhe lirinë e shprehjes;
- të nxisin aksesin e hapur në informacion dhe të shmangin barrierat në akses.
- të njohin rëndësinë e mësimit të përdorimit të informacionit dhe të mbështesin fuqimisht strategjitë për krijimin e një popullsie të mësuar dhe të aftë, e cila të mund të rrisë përfitimet nga shoqëria globale e informacionit.

---

<sup>1</sup> Miratuar në Aleksandri, Egjipt  
Biblioteka Aleksandrina, 11 Nëntor 2005.

# Rezoluta e Luksemburgut e CENL-së për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore europiane<sup>1</sup>

Konferenca e drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare (CENL) konsideron se bibliotekat digjitale dhe digjitalizimi i trashëgimisë kulturore dhe shkencore lehtëson aksesin global në përmbajtje dhe mbështet të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe kërkimin shkencor, arsimin dhe veprimtaritë argëtuese. CENL mbështet fuqimisht një qasje bashkëvepruese dhe me rreze të gjerë në problemet e digjitalizimit nga ana e bibliotekave kombëtare europiane dhe institucioneve të tjera të rëndësishme.

CENL mbështet plotësisht Parimet e Lund-it, të cilat theksojnë vlerën dhe rëndësinë e përmbajtjes kulturore dhe shkencore europiane të digjitalizuara.

CENL beson se diversiteti kulturor dhe shumëgjuhësia janë vlera thelbësore të kulturës europiane. Për të nxitur ndërgegjësimin për vlerën e diversitetit kulturor dhe gjuhësor është e domosdoshme që koleksionet e pasura të bibliotekave kombëtare europiane dhe të institucioneve të tjera kulturore të bëhen të dukshme në Internet, meqë ky është mjeti themelor i aksesit në informacionin e shkuar, të sotëm dhe të ardhshëm.

CENL, përmes krijimit të Bibliotekës Europiane, ofron një platformë model dhe rrjet organizativ për bashkëveprim midis bibliotekave kombëtare dhe për bashkërendimin

**CENL**  
Foundation Conference of European National Librarians

<sup>1</sup> Adoptuar në takimin vjetor të CENL-së, Luksemburg, 30 shtator 2005  
Miratuar nga bordi i CENL-së, dhjetor 2005  
Miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i CENL-së, 5 dhjetor 2005

e nismave kombëtare në një nivel evropian dhe shmang dublimin e punës. CENL është e bindur për krijimin e një rrjeti të veprimtarive digjitale si dhe për nxitjen dhe shkëmbimin e përvojave lidhur me ruajtjen e objekteve digjitale dhe të digjitalizuara. Biblioteka Europiane është një pikë ideale e hyrjes në materialin e digjitalizuar të bibliotekave kombëtare dhe të institucioneve të tjera kulturore evropiane.

CENL do të angazhohet gjallërisht me propozimet e konsultës së financuesve në Direktoratin e Shoqërisë së Informacionit dhe Medias dhe pret të jetë faktor kryesor në nismat vijuese. CENL do të përpiqet për financime dhe partneritete të mëtejshme për të arritur qëllimet e saj. E prirur ndaj rëndësisë në rritje që u jepet partneriteteve publike/private në veprimtarinë bibliotekare CENL do të përpiqet të hartojë një tërësi të përbashkët kushtesh negociuese për të mbështetur bibliotekat në synimin e tyre për të baraspeshuar kërkesat e sektorit privat me përgjegjësitë e tyre që lidhen me të mirën publike shoqëruar me kujdesin ndaj koleksioneve kombëtare. CENL do të mundësojë që kërkesat e mbajtësve të të drejtave të respektohen në marrëveshje të reja.





Organisation des Nations Unies  
pour l'éducation, la science et la culture

## Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s z. M. Koïchiro Matsuura me rastin e Ditës Botërore të Aftësisimit në Informacion - 8 shtator 2005

**N**e kremtojmë sot Ditën Ndërkombëtare të Aftësisimit në Informacion 2005. Në këtë ditë gjejmë rastin të përshëndesim rezultatet e arritura nga një numër i madh njerëzish në mbarë botën - burra dhe gra, - që kanë pranuar komunikimin përmes fjalës së shkruar. Ne përgëzojmë ata si dhe të gjithë tjerët - mësues, miq, fqinj, anëtarë familjesh etj., - mbështetja e të cilëve ka qenë e domosdoshme. E megjithatë, optimizmi nuk ka shumë vend në këtë Ditë Ndërkombëtare të Aftësisimit në Informacion. Ndërkohë që ka rreth 800 milion të rritur analfabetë në botë, ku 2/3 e tyre janë gra dhe më tepër se 100 milion fëmijë të moshës shkollore nuk shkojnë në shkollë, nuk ka dyshim që mbetet shumë për të bërë.

Përveç kësaj, këto të dhëna statistikore nuk kanë dalë nisur nga shtrirja dhe natyra e sfidës së Aftësisimit në Informacion në shkallë botërore. Dhe kjo për dy arsye madhore:

*Së pari*, është e dukshme që një numër i madh fëmijësh braktisin shkollën fillore pa mësuar shkrim e këndim. Një numër i madh vendesh të zhvilluara, pavarësisht sistemit të tyre arsimor shumë të organizuar e mirëpajisur, konstatojnë që një përqindje e madhe fëmijësh nuk kanë mundur të përfitojnë prej tij. Të përballur me probleme të mëdha - varfërinë, përjashtimin dhe kufizimin, - mjaft vende në zhvillim provojnë vështirësi për të ndalur fluksin e fëmijëve që braktisin shkollën. Vitet e fundit një numër i madh fëmijësh kanë humbur në radhët e errëta të analfabetëve.

*Së dyti*, ofertat e kufizuara të mundësive konkrete, që u lejojnë të rriturve të fitojnë, të ruajnë dhe të përmirësojnë aftësinë për të lexuar, shkruar dhe mësuar bëjnë që qindra miliona persona, veçanërisht gra, të jenë të dënuara të jetojnë në analfabetizëm. Në shek. XXI kjo situatë është e papranueshme.

Pikërisht për të vënë në dukje këto dy sfida, që janë të ndërvarura dhe të lidhura me probleme të tjera të arsimimit dhe zhvillimit, ka nisur aksioni në favor të *Arsimimit për të gjithë*. Periudha 10-vjeçare e Kombeve të Bashkuara për Aftësimin në Informacion (2003-2012), që është ngushtësisht e lidhur me nismën *Arsimimi për të gjithë* dhe që udhëhiqet e bashkërendohet nga UNESCO-ja, synon të shtojë përpjekjet në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare për të realizuar objektivin e Dakarit - përgjysmimin e përqindjes së analfabetizmit deri në vitin 2015.

Këtë vit kjo Ditë i kushtohet rolit të Aftësimin në zhvillimin afatgjatë. Prandaj që prej vitit 2005 kjo është shprehur edhe në nismën e UNESCO-s *Dekada e Kombeve të Bashkuara për Arsimimin për Zhvillimin Afatgjatë (2005-2014)*, ku vetë ajo është udhëheqëse dhe bashkërenduese ndërkombëtare.

Si bazë e çdo arsimimi, trajnimit dhe përvetësimi të mëtejshëm, Aftësimi në Informacion është i domosdoshëm në zhvillimin njerëzor afatgjatë në shoqëritë e sotme, që janë komplekse dhe ndryshojnë me shpejtësi. Në shoqëri të tilla, nocionet fillestare të leximit, shkruarit dhe llogaritjeve matematikore, nuk mjaftojnë për të siguruar një komunikim dhe një pjesëmarrje reale në to. Për më tepër, Aftësimi në Informacion në të vërtetë po merr dimensione të reja përballë evolucionit teknologjik e kulturor. Si pasojë, kapacitetet e aftësimin duhet të kompletohen dhe përditësohen, në mënyrë që secili të ketë besim në vetvetë për përballimin e situatave që ndryshojnë dhe pasigurive të reja. Jetëgjatësia e Aftësimin në Informacion kalon detyrimisht nga kjo përshtatje.

Strumbullari i marrëdhënive ndërmet *Aftësimin në Informacion dhe Zhvillimit Afatgjatë* është shtetësia, e kuptuar kjo jo si një e drejtë, por si një përpjekje aktive, krijuese dhe dinamike e gjithë qenies që krijon dhe rikrijon jetën e saj. Në këtë këndvështrim, Aftësimi në Informacion është një kusht paraprak për një pjesëmarrje të vërtetë shoqërore dhe një instrument i fuqishëm në rrafsh individual dhe kolektiv. Një bashkësi njerëzish me kompetenca mjaft të zhdërvjellta është thelbësore për të përballuar sfidën e zhvillimit afatgjatë.

Mënyra me të cilën ne mësojmë të përshtatemi do të përcaktojë mirëqenien dhe sigurinë tonë, dhe ndoshta edhe mbijetesën tonë.

Programet e Aftësimi në Informacion janë mjete të dobishme dhe efikase për të transmetuar ide dhe informacione, që kanë të bëjnë me *Arsimimin për Zhvillimin Afatgjatë*. Në disa raste, si për shembull projektet e Aftësimi në Informacion që lidhen me brezat e ardhshëm ose me mjetet e jetesës afatgjatë, është e mundshme një sintezë e ngushtë. Duke pritur orientimin e programeve të Aftësimi në Informacion drejt perfeksionimit, përfshirja dhe marrja parasysh e kushteve lokale, duhet të ushtrojë fuqishëm influencë në metodat e *Arsimimit për Zhvillimin Afatgjatë*, veçanërisht në kontekste joformale.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Aftësimi në Informacion 2005, u bëj thirrje qeverive, organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile dhe sektorit privat, që t'i kushtojnë kujdes dhe mbështetje Aftësimi në Informacion - instrument jetik për realizimin e *Zhvillimit Afatgjatë*. Këtë muaj udhëheqësit e mbarë botës do të mbledhen në Nju Jork për të analizuar përparimet e arritura që prej shpalljes së Deklaratës së Mijëvjeçarit 5 vjet më parë. Është momenti të kujtojmë që arsimimi në përgjithësi dhe Aftësimi në Informacion në veçanti janë të domosdoshëm për vazhdimësinë, që mbështetet para së gjithash në kapacitetet njerëzore dhe zhvillimin e tyre.



- 
- Dita Botërore e Librit në Bibliotekën Kombëtare 167
  - Në përkujtim të shkrimtarit dhe përkthyesit Mustafa Greblleshi 168
  - Promovohet libri me kujtime “Endur në tisin e kohës” i Vedat Kokonës 169
-

# Dita Botërore e Librit në Bibliotekën Kombëtare

**B**iblioteka Kombëtare tashmë e ka kthyer në traditë festimin e Ditës Botërore të Librit. Në këtë kuadër, më 23 prill 2005, në bashkëpunim me Shoqatën e Botuesve të Shqipërisë dhe Shtëpinë e Librit dhe të Komunikimit, ajo organizoi në një prej mjediseve të veta tryezën e rrumbullakët me temë “Libri dhe liria e informacionit”, në të cilën morën pjesë botues, autorë dhe punonjës të bibliotekave të Tiranës.

Mes të tjerash u theksua se në lirinë e aksesit në informacion implikohen edhe çështje të marrëdhënieve të këtij institucioni me botuesit, që kanë të bëjnë me korrektesën dhe dorëzimin në kohë të ekzemplarëve të detyruar, çka çënon lirinë e informacionit, për të cilën koncepti kohë është tejet i rëndësishëm. Në një plan më të përgjithshëm tryeza u shfrytëzua për të shprehur dhe ballafaquar idetë lidhur me librin dhe lirinë e informacionit. Me të drejtë u ngrit edhe shqetësimi për mungesën e sondazheve dhe anketimeve të leximit, gjë që pengon botuesit dhe bibliotekat të programojnë si duhet punën e tyre në shërbim të lexuesit.

Dr. Aurel Plasari, drejtor i Bibliotekës Kombëtare, lexoi mesazhin që z. Kouçhiro Matsuura, Drejtor i Përgjithshëm i UNESCO-s, u ka dërguar, me rastin e 10-vjetorit të festimit të kësaj dite, bibliotekave kombëtare dhe shoqatave të bibliotekarëve kudo në botë.

Me interes u ndoq gjithashtu edhe promovimi i dy dokumenteve të rëndësishme të IFLA-s. Në “Rezolutën për bibliotekat, shërbimet e informacionit dhe lirinë intelektuale” u bëhet thirrje këtyre institucioneve të sigurojnë akses pa kufi në informacion. Ato thirren të angazhohen e t’u ofrojnë përdoruesve të tyre akses pa kufizime në burimet bibliotekare, të kundërshtojnë çdo formë të censurës si dhe të venë në përdorim lloje të ndryshme materialesh që reflektojnë diversitetin e shoqërisë, nisur nga konsiderata vetëm profesionale.

Dokumenti tjetër, “Manifesti i IFLA-s për Internetin” nënvizon se hyrja e lirë në informacion është e rëndësishme për arritjen e lirisë, barazisë dhe për një konceptim më të gjerë të botës. Në këtë kuadër theksohet se bibliotekat janë institucionet më të përshatshme dhe efektive që sigurojnë rrugët kryesore të hyrjes në Internet.

# Në përkujtim të shkrimtarit dhe përkthyesit Mustafa Greblleshi

SHKURT 2005

Më 11 shkurt 2005 Biblioteka Kombëtare organizoi një veprimtari përkujtimore kushtuar shkrimtarit, përkthyesit dhe publicistit Mustafa Greblleshi (1922-1986), për të cilin shumë gjëra kanë mbetur ende të parrëfyera. Autori i romanit “Gremina e dashunisë” (1941), i humorit nën pseudonimin Liu i Cakut dhe i përkthimit të “Njëmijë e një netëve”, i kujtuar rrallë në mjediset letrare, u përkujtua kështu në institucionin më të rëndësishëm të librit.

Për drejtorin e Bibliotekës Kombëtare Dr. Aurel Plasarin, Greblleshi është një ndër mjeshtërit e përkthimit. “Por kontributi i tij nuk mbetet vetëm në fushën e letërsisë. Greblleshi ka qenë një ndër intelektualët dhe publicistët e njohur të viteve ‘30”, theksoi Plasari.

Botuesja Brikena Çabej, e cila ka ribotuar të plotë “Njëmijë e një netët”, tha me bindje se, ndonëse Greblleshi nuk njihet shumë nga brezi i ri, ai mbetet një nga mjeshtërit e fjalës shqipe. “Të lexosh si përkthimet, ashtu edhe librat e shkruar prej tij, vë re se ato janë vërtetë brilante, me fjalë të rralla dhe e mbajnë shumë bukur leximin”, tha ajo.

Prezantimi i tre vëllimeve të përrallave të “Njëmijë e një netëve”, sjellë në shqip nga frëngjishtja dhe botuar nga shtëpia botuese “Çabej”, u kthye në një takim-homazh kushtuar njeriut dhe krijuesit me vlera të shquara. Studiues dhe bashkëkohës të M. Greblleshit, si: Muzafer Xhaxhiu, Dionis Bubani etj. vunë në dukje pikërisht karakterin dhe ndershmërinë e tij, mjeshtërinë në fushën e krijimtarisë dhe të përkthimit.

Pjesëmarrësit panë nga afër materiale të ndryshme të tij, si dorëshkrime, libra, artikuj në organe të shtypit që ishin ekspozuar në mjediset ku u organizua takimi.

Familjarë të Mustafa Greblleshit falënderuan dhe përshëndetën organizatorët e veprimtarisë përkujtimore për nder të njeriut të tyre të dashur.



# Promovohet libri me kujtime “Endur në tisin e kohës” i Vedat Kokonës

QERSHOR 2005

Studiues, shkrimtarë, përkthyes, familjarë dhe bashkëkohës u mblodhën më 17 qershor 2005 në Bibliotekën Kombëtare për të promovuar librin me kujtime “Endur në tisin e kohës” të Vedat Kokonës. Veprimtaria u organizua nën kujdesin e drejtorit të Bibliotekës Kombëtare, studiuesit Aurel Plasari.

Njohësit e Vedat Kokonës dhe të veprave dhe përkthimeve të tij i cilësuan ato si një gur të çmuar në kulturën shqiptare për shkak të vlerës artistike, autenticitetit dhe besueshmërisë historike.

Z. Plasari, pasi vuri në dukje se fusha e kujtimeve sot është një nga fushat më “pis” në kulturën shqiptare, tha se përshtypja e tij e parë është se kujtimet e Kokonës karakterizohen nga një ndershmëri e madhe, gati absolute. “Janë kujtime tejet të ndershme, me disa dimensione të rëndësishme historiko-politike, që fshihen prapa pjesës lirike, pjesës së tregimeve të flirteve, të dashurisë...”, nënvizoi ai. Dr. Plasari përfundoi duke thënë se “Vedat Kokona mbron një tipologji që është shumë e rëndësishme për kulturën shqiptare të inteligjencies së ndershme që di të barazllogohet nga të gjitha ato forca politike të papëlqyeshme, që i shikon jo në të mirë të atdheut apo kombit”.

Përkthyesi Edmond Tupja vuri në dukje se libri mundëson njohjen me ngjarjet e asaj kohe, Vedat Kokonën dhe stilin e tij. “Ai është jo vetëm memorialist, por edhe shkrimtar. Është dashnor i fjalës, leksikograf, është një mozaik i ndërtuar bukur, është një model. Vedat Kokona ka qenë besnik ndaj stilit të tij...”, theksoi studiuesi.

Sipas familjarëve, jashtë këtij libri kanë mbetur shumë detaje e ndodhi për shkak se Kokona u nda nga kjo jetë pa e përfunduar librin e tij të kujtimeve. Le të shpresojmë që një ditë të mblidhen me kujdes çka mbetur prej tyre: dorëshkrime, letërkëmbime, foto etj.

---

■ Java e Bibliotekës në Kosovë

171

---

# Java e Bibliotekës në Kosovë

PRILL 2005

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës në bashkëpunim me Zyrën Amerikane në Prishtinë organizoi në Prishtinë prej 11 deri më 18 prill 2005 edicionin III të manifestimit tradicional *Java e Bibliotekës në Kosovë*, që radhitet ndër ngjarjet më të rëndësishme të jetës kulturore dhe shkencore të Kosovës. Në këtë veprimtari morën pjesë personalitete të kulturës, shkencës dhe artit, drejtues të bibliotekave, specialistë të bibliotekonomisë nga Kosova, Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Egjipti, Austria etj.

Në fjalën e tij drejtori i BKUK-së z. Sali Bashota, pasi njohu të pranishmit me përvojat dhe arritjet e bibliotekave të rrjetit bibliotekar në Kosovë, falenderoi në mënyrë të veçantë Zyrën Amerikane në Prishtinë, e cila ka dhënë ndihmesën e saj të vyer për konsolidimin e institucioneve kulturore në përgjithësi dhe BKUK në veçanti, si dhe u urojë mirëseardhjen ekspertëve të huaj, që pranuan ftesën për të ndjekur veprimtarinë.

Gjatë *Javës së Bibliotekës në Kosovë*, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës u organizuan veprimtari të ndryshme kulturore dhe bibliotekare.

Në sesionet e bibliotekonomisë kumtesit dhe debatuesit u përqëndruan krye-

sisht në problemet e automatizimit të shërbimeve të përdoruesve dhe menaxhimit të ndryshimeve në epokën e re digjitale. Lektorët e huaj me kumtimet e tyre sollën përvojat e vendeve të tyre. Me interes u ndoq referimet: "*Biblioteka e Aleksandrisë, e kaluara dhe e tashmja*", mbajtur nga ambasadori Taher Khalifa (përfaqësues i Bibliotekës së Aleksandrisë nga Kajroja), "*Roli i bibliotekarëve në epokën e informacionit*" (zgj. Mary Sommers Pierce, Austri), "Menaxhimi i ndryshimeve në biblioteka" nga ekspertët e shquar të bibliotekonomisë z. S. Short dhe I. Owens (USA) " etj. Përfaqësuesja e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, zgj. Etleva Domi, mbajti temën "Bibliotekat shqiptare në epokën e informacionit dhe teknologjive të reja".

Java u shoqërua edhe me veprimtari të tjera si: përirimi i ekspozitës fotografike "Prishtina e vjetër", ekspozitës "Libri ndërkombëtar", promovime botimesh të BKUK-së, "Ora letrare " nga PEN QENDRA e Kosovës etj. Në kuadër të Javës së Bibliotekave në Kosovë u mbajt sesioni shkencor kushtuar Gjergj Kastriot-Skënderbeut me rastin e 600-vjetorit të lindjes së tij. Po këtë Javë u përrua Arkivi i Shkrimtarëve dhe Këndi i NATO-s.



**Recensione**

173

**Hyrje të reja**

181

**Website**

190



# Recensione



**Libraries as places : buildings for the 21<sup>st</sup> century** [*Bibliotekat si vende : ndërtesat në shekullin 21*] : proceedings of the Thirteenth Seminar of IFLA's Library Buildings and Equipment Section together with IFLA's Public Libraries Section, Paris, France, 28 July – 1 August 2003 / ed. by Marie-Françoise Bisbrouck etc. - München : Saur, 2004.  
210 f. : me il. ; 21 cm. – (IFLA publications ; 109)  
ISBN 3-598-21839-7

Botimi përmbledh materialet e seminarit të 13-të të IFLA-s të organizuar nga Seksioni i Ndërtesave dhe Pajisjeve Bibliotekare në bashkëpunim me Seksionin e Bibliotekave Publike. Këto seminare organizohen çdo dy vjet për t'u dhënë mundësi arkitektëve dhe bibliotekarëve të shkëmbejnë përvojat në fushën e planifikimit të bibliotekave dhe të ndërtimit të tyre. Teknologjia digjitale, presionet ekonomike, siguria, ndryshimet në kërkesat e përdoruesve janë disa nga faktorët që u japin formë të re bibliotekave të sotme. Këta faktorë ndikojnë në çdo aspekt të veprimtarisë bibliotekare dhe kërkojnë rigjykim të hapësirave në shumë drejtime si: hapësirat e përdoruesve, hapësirat e koleksioneve, hapësirat e shërbimeve, hapësirat e veprimtarive, hapësirat sociale, hapësirat intelektuale dhe ato virtuale. Materialet e seminarit përqendrohen në këto çështje:

- *Ripërcaktimi dhe riformimi i hapësirave bibliotekare sot;*
- *Biblioteka si vend mësimi për të zhvilluar autonominë e përdoruesve;*
- *Ndërtesat bibliotekare përballë detyrimeve (standartet, hapësirat, siguria etj.);*

- *"Biblioteka e gjelbër": a jemi në gjendje sot të nxisim ndërtime bibliotekare që nga ana e mjedisit të jenë të besueshme dhe vende të shëndetshme për të jetuar dhe punuar? Dhe sa kushton kjo?*

Qëllimi i seminarit dhe i botimit është të tërheqë vëmendjen në studimin e çështjeve që ndikojnë në zhvillimin e hapësirave bibliotekare në të ardhmen. Në materialet e paraqitura në seminar në vend të parë është renditur prezantimi i Kenneth Dowlin, i cili ka një përvojë 40-vjeçare në fushën e bibliotekonomisë dhe 34 vjet drejtor i bibliotekës publike. Gjatë kësaj periudhe ai ka drejtuar ndërtimin e tri bibliotekave publike qendrore të 16 degëve dhe rinovimin e 20 të tjerave. Dowlin-i ka njohuri të gjera në projektet e ndërtimit dhe njëkohësisht njihet si ekspert në përdorimin e teknologjive të reja në biblioteka. Pas një historiku të shkurtër të bibliotekave në aspektin e funksionimit të tyre, autori përqendrohet në përshkrimin e disa bibliotekave të ndërtuara pas viteve '70 në vende të ndryshme, moment kur filloi përdorimi i teknologjisë së re në biblioteka. Ai tërheq vëmendjen në disa veçori që

duhen mbajtur parasysh në projektimin e bibliotekave në të ardhmen si biblioteka hibride. Ndër të renditen:

- *Sistemi i integruar bibliotekar. Sistemi i automatizimit duhet të jetë i besueshëm, me shtrirje të gjerë, pa shkëputje dhe të shërbejë si sistem nervor i organizmit.*
- *Disponueshmëria e informacionit. Koleksionet pësojnë transformime dramatike. Mjetet e menaxhimit të koleksioneve duhen parë në bashkëpunim me bibliotekat e tjera. Pasurimi dhe spastrimi mund të kryhen me anë të sistemeve të automatizuara.*
- *Akcesi në informacion.*
- *Hapësirat e studimit. Hapësirat për studim duhet të jenë të ndryshueshme dhe të përshtatshme në përputhje me mjetet dhe pajisjet dhe zhvillimet e teknologjisë.*
- *Udhëzime për informacion. Janë të domosdoshme udhëzimet për studentët, përdoruesit e tjerë dhe për vetë personelin e bibliotekës dhe për këtë krijohen mjedise të posaçme.*
- *Printimi i informacionit. Ky bëhet kundrejt kërkesës së përdoruesve dhe në bashkërendim me autorët dhe botuesit.*

Veç këtyre, renditen edhe një seri veçorishtë tjera, si: poste pune individuale, pajisje për vlefshmërinë e kartelës së përdoruesit, pika të shpërndarjes së informacionit, mirëmbajtje e aparaturave, ruajtje e dokumenteve, qendër e komunikimit me bashkësinë, mjedis për prezantime elektronike etj. Bazuar në veçoritë e paraqitura, autori jep mendime për projektimin e bibliotekave në të ardhmen. Për të arritur sukses duhen vlerësuar dhe kombinuar mirë roli i bibliotekës, veçoritë dhe raportit i drejtë ndërmjet mjedisit fizik dhe atij virtual.

Krahas ndërtimit të bibliotekave të reja, lind edhe nevoja e ndryshimeve në ato ekzistuese. Arkitekti Claus Bjarrum në materialin e paraqitur tregon se ndryshimi i kërkesave të përdoruesve dhe zhvillimi i teknologjisë së informacionit në bibliotekat publike i detyron profesionistët e bibliotekave, politikanët dhe arkitektët të rimendojnë për konceptimin dhe projektimin e bibliotekës publike. Ai përshkruan punën e bërë për riprojektimin e një biblioteke në Danimarkën

në bashkëpunim të ngushtë me personelin e bibliotekës. Modelet e paraqitura pasqyrojnë ndryshimet, veçoritë dhe përdorimin e bibliotekës lidhur me:

- *integrimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;*
- *automatizimin e bibliotekës deri në vetëshërbimin në huazim dhe kthim libri;*
- *koleksionet kundrejt aksesit;*
- *biblioteka virtuale kundrejt asaj fizike;*
- *kuptimin e ri të estetikës bibliotekare;*
- *projekte moderne për të tërhequr gjeneratën e re.*

Autori e ka përqendruar punën në tri faza:

- *analizë e hollësishtme e ndërtesës ekzistuese dhe e përdorimit të saj;*
- *zhvillimi i një programi të rishikuar të funksionimit të bibliotekës;*
- *paraqitja e disa modeleve alternative dhe analiza e kostos për secilin.*

Ndonëse punimi përqendrohet në punën për projektimin e një biblioteke të caktuar, autori jep informacion të një natyre më të përgjithshme, me qëllim që të shërbejë edhe për projekte të ristrukturimit të bibliotekave të tjera.

Vend të konsiderueshëm në botim zënë edhe punimet që i kushtohen ndërtimit të qendrave të studimit në universitete si dhe bibliotekave universitare. Një ndër to është Biblioteka Lanchester në Britaninë e Madhe, prezantuar nga Patrick Noon, punonjës i kësaj biblioteke. Projekti i bibliotekës së re duhet të plotësonte disa objektiva si:

- *krijimin e një qendre me efektivitet të lartë për akses në informacion, studim dhe mësim që plotëson angazhimet e universitetit ndaj studentëve;*
- *sigurimin e shërbimit të informacionit me cilësi të lartë në mbështetje të mësimdhënies, studimit dhe veprimtarisë shkencore;*
- *sigurimin e fleksibilitetit maksimal brenda ndërtesës për të përshtatur shërbimet me kërkesat në ndryshim;*
- *krijimin e një ndërtese me efektivitet të lartë për sa i përket energjisë, pa kompromentuar funksionin;*



- *dhënien e një kontributi të rëndësishëm në plotësimin e nevojave për informacion, studim e mësim të banorëve, shërbimeve dhe bizneseve të bashkësisë përreth;*
- *krijimin e një ndërtese me të cilën të krenohet universiteti dhe qyteti.*

Ndërtimi dhe arkitektura e kësaj biblioteke është vlerësuar me disa çmime. Një element kyç në suksesin e projektit është përfshirja e sa më shumë punonjësve në procesin e planifikimit. U krijuan grupe për çdo aspekt të ndërtimit, për shtrirjen e kateve, vendosjen e rafteve dhe specififikimet përkatëse, pajisjet, qarkullimin, strategjinë e teknologjisë së informacionit etj. Një ndër detyrat e vështira ishte edhe komunikimi me arkitektët për t'u shpjeguar atyre se biblioteka nuk është vend për të ruajtur sa më shumë libra, por ajo ofron shërbime për publikun, informacion për ta dhe siguron vende për të punuar dhe studiuar. Mirëkuptimi i specialistëve të bibliotekës me arkitektët çoi në një sukses të shkëlqyer.

Një problem tjetër me interes për sa u përket ndërtesave të bibliotekave është dhe ekzistenca e tyre në ndërtesa që janë monumente kulture. Arkitekti spanjoll Ignasi Bonet në prezantimin e tij vë në dukje se disa nga godinat e bibliotekave


në Barcelonë bëjnë pjesë në trashëgiminë kulturore. Vendimi për të ngritur bibliotekë në një ndërtesë historike është bazuar në disa kritere. Por me kalimin e viteve, në vartësi të llojit të ndërtesës dhe të kërkesave të bibliotekës, ndihet nevoja e ndërhyrjes së thellë arkitekturore, duke ndikuar në strukturën e ndërtesës. Puna e bërë mund të rezultojë në një bibliotekë të mirë ose jo. Lidhur me këtë, autori jep shembuj se si duke ruajtur vlerat e trashëgimisë kulturore dhe duke gjetur zgjidhje arkitekturore të arsyeshme, është arritur në biblioteka të suksesshme. Ai ka paraqitur llojet e ndërtesave, të cilat janë përshtatur për biblioteka. Këto paraprakisht i janë nënshtruar një studimi të detajuar ku përfshihen: analiza historike dhe e trashëgimisë, mundësitë për ndërhyrje arkitekturore duke ruajtur vlerat dhe kërkesat funksionale të bibliotekës. Mbi bazën e këtij studimi merret vendim për të vazhduar më tej.

Botimi mbyllet me përshkrimin e disa bibliotekave të Francës, të parashikuara për t'u vizituar nga pjesëmarrësit e seminarit. Ndër to janë: biblioteka publike rajonale, biblioteka universitare, biblioteka speciale si dhe Biblioteka Kombëtare e Francës, e cilësuar si një nga bibliotekat më të mëdha dhe më moderne të botës.

*Farfuri Khaja*



Publications 116



**Continuing professional development – preparing for new roles in libraries** [Zhvillimi i vijueshëm profesional - përgatitja për role të reja në biblioteka] : a voyage of discovery : sixth World Conference on continuing professional development and workplace learning for the library an information professions / IFLA ; ed. by Paul Genoni and Graham Walton. – München : Saur, 2005. 307 f. : 21 cm. – (IFLA Publications : 116) ISBN 3-598-21844-3

Botimi është përbledhje e materialeve të paraqitura në Konferencën e Gjashtë Botërore të seksionit të IFLA-s për Zhvillimin e Vijueshëm Profesional dhe të Mësuarit Gjatë Punës. Shefja e këtij seksioni paraprkishtë bën një historik të zhvillimit të tij dhe shpjegon shkaqet e ndryshimit të emrit nga Tavolina e Rrumbullakët për Arsimin e Vijueshëm Profesional në Seksionin e Zhvillimit të Vijueshëm Profesional dhe të Mësimit Gjatë Punës. Ndryshimi i emrit lidhet me qëllime më të zgjeruara të këtij seksioni dhe me disa veçori karakteristike që duhen pasur parasysh.

**Së pari**, ai zgjeron konceptin e arsimit të vijueshëm profesional në zhvillim të vijueshëm profesional, duke përfshirë të gjitha aspektet e rolit të profesionistit dhe duke vënë në dukje se arsimit është vetëm një nga rrugët nëpërmjet të cilës individët vazhdojnë të mësojnë, rriten dhe zhvillohen si profesionistë përmes karrierës së punës dhe jetës profesionale.

**Së dyti**, shtimi i konceptit “të mësuarit gjatë punës” tregon përfshirjen e të gjitha llojeve të ndryshme të veprimtarive zhvilluese që lidhen me vendin e punës, si zhvillimin formal të punonjësve dhe programet e trajnimit në vendin e punës, ashtu dhe mundësitë më pak formale të të mësuarit që ndodhin gjatë jetës normale të punës. Shembuj të këtyre janë këshillimet, udhëzimet dhe trajnimet, po ashtu dhe të mësuarit e përqendruar, që ndodh në raste projektesh të veçanta dhe të përvojës së vendit të punës.

**Së treti**, kombinimi i zhvillimit të vijueshëm profesional me të mësuarit në vendin e punës tregon se veprimtaritë e të mësuarit gjatë punës kanë kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së forcave të punës dhe në rritjen e standardeve të praktikës profesionale. Ndaj, sa më shumë ta pranojmë të mësuarit gjatë punës si të vlefshëm dhe të dobishëm dhe sa më shumë ta përfshijmë atë në planet tona si strategji trajnimi dhe zhvillimi profesional, aq më shumë vlera do të fitojmë prej tij.

Janë kryer disa studime lidhur me vlerën e të mësuarit në vendin e punës dhe punimet e këtij seksioni i kushtohen kryesisht këtij aspekti të zhvillimit profesional. Theksohet se çelësi i ndryshimeve të sotme janë rritja e vazhdueshme e informacionit dhe zhvillimet e shpejta të teknologjisë së kompiuterit dhe rrjeteve. Paraqiten analiza studimesh për të identifikuar njohuritë dhe aftësitë e duhura të bibliotekarëve dhe të punonjësve të informacionit për të përballuar sfidat e shekullit XXI. Institute të bibliotekonomisë dhe informacionit kanë përgatitur lista të disiplinave të nevojshme në këtë fushë. Ndër to renditen: informacioni dhe shoqëria, organizimi i informacionit, shërbimet informuese, menaxhimi dhe zhvillimi i koleksioneve, burimet dhe kërkimi i informacionit, sistemet e informacionit, menaxhimi i web-it, menaxhimi dhe arkivimi i regjistrimeve, studime në shkencën e bibliotekonomisë dhe të informacionit etj. Krahas

tyre vend të veçantë zë aftësimi i punonjësve në teknologjinë e informacionit.

Disa nga materialet e paraqitura janë studime që kanë të bëjnë me funksionet e bibliotekave akademike, kërkesat për aftësim profesional të punonjësve të këtyre bibliotekave dhe të personelit pedagogjik. Ndryshimet në këto biblioteka kanë ndikuar në organizimin e tyre si dhe në punën e përditshme të punonjësve. Objektivat e studimeve janë: vënia në dukje e ndryshimeve që ka sjellë teknologjia në strukturën organizative të bibliotekave dhe dinamika e kryerjes dhe e bashkërendimit të detyrave nga ana e personelit të bibliotekës; përcaktimi i ndikimit të ndryshimeve në rolin dhe detyrat e personelit profesionist dhe atij ndihmës të bibliotekave; përcaktimi i nevojave dhe kërkesave të punonjësve të bibliotekave për zhvillimin e vijueshëm profesional; rekomandimi i veprimtarive për të mësuar gjatë punës.

Ndërsa për bibliotekarët shkollat dhe kurset e zhvillimit profesional po organizohen edhe online, trajnimi i personelit ndihmës ka mbetur në nivel lokal dhe brenda vendit të punës. Zakonisht kjo kategori punonjësish trajnohet për një punë të caktuar, për të cilën janë punësuar dhe nuk marrin orientim të përgjithshëm për misionin, politikën dhe procedurat e institucionit. Kjo do t'i ndihmonte ata ta shohin punën e tyre në kuptim më të gjerë. Lidhur me këtë problem është zhvilluar një projekt pilot në tre biblioteka në SHBA për të zhvilluar dhe testuar një kurs online për asistentët e bibliotekave akademike dhe shkencore. Në përfundim u përcaktuan disa sugjerime për kurset online që mund të zhvillohen në të ardhmen.

Botimi, duke qenë përmbledhje studimesh e trajton formimin dhe zhvillimin e vijueshëm profesional në të gjitha aspektet. Një ndër të është motivimi i bibliotekarëve për të marrë pjesë në

veprimtaritë e zhvillimit profesional. Motivimi shihet si faktor i rëndësishëm në përcaktimin e kohës së shpenzuar për veprimtaritë e zhvillimit profesional, përfshirë kurse, seminare, konferenca, lexim literature, diskutime me kolegët dhe trajnim gjatë punës. Gjithnjë e më të domosdoshme po bëhen programet e trajnimit për ruajtjen digjitale, si pasojë e shtimit të burimeve elektronike të informacionit. Këto mund të zhvillohen në nivel institucional, departamenti dhe individi. Një renditje e tillë është për shkak të qëllimit dhe jo të rëndësisë. Institucioni është në shkallën më të lartë për shkak të madhësisë dhe gjerësisë. Ai sponsorizon me fonde të gjitha veprimtaritë.

Nisur nga nevoja e bibliotekarëve për zhvillimin e njohurive dhe të aftësive profesionale, shkollat e bibliotekonomisë dhe informacionit rishikojnë programet e arsimit dhe të zhvillimit të vijueshëm. Në këtë botim të IFLA-s jepet përvoja e Shkollës së Bibliotekonomisë dhe Informacionit në Universitetin e Ilinoit në hartimin dhe zbatimin e një programi të shumanshëm për zhvillimin e vijueshëm profesional. Rol të rëndësishëm në zhvillimin profesional luajnë dhe shoqatat bibliotekare, pasi ato janë organizata që në shumë vende kanë përgjegjësinë e zhvillimit të standardeve të arsimit dhe të praktikës profesionale bibliotekare. Disa nga punimet e paraqitura i kushtohen përmirësimit cilësor dhe rolit të këtyre shoqatave në hartimin dhe zhvillimin e standardeve të edukimit profesional.


Autorët e punimeve të përfshira në këtë botim janë pedagogë të degës së bibliotekonomisë dhe informacionit në vende të ndryshme të botës dhe punonjës specialistë në biblioteka publike, akademike dhe speciale. Studimet e paraqitura prej tyre ndihmojnë institucionet e interesuara në hartimin e programeve të formimit dhe të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në të ardhmen.

*Farfuri Xhaja*





Publications 115



*e-Learning for Management and Marketing in Libraries = e-Formation pour le marketing et le management des bibliothèques [Mësimi elektronik për marketingun dhe menaxhimin e bibliotekave] : papers presented at the IFLA Satellite Meeting, Section Management and Marketing, Geneva, Switzerland, July 28-30, 2003 / ed. by Daisy McAdam. – Munchen : Saur, 2005. 165 f. : 21 cm. – (IFLA publications ; 115)*  
 Një pjesë e kumesave në frëngjisht.  
 ISBN 3-598-21843-5

Botimi është një përmbledhje e materialeve të paraqitura në konferencën e seksionit të Menaxhimit dhe Marketingut të IFLA-s, organizuar në verën e vitit 2003 në Gjenevë me një numër bibliotekarësh specialistë të mësimit elektronik dhe i adresohet një publiku profesionistësh të informacionit dokumentar.

Me zhvillimin e informacionit dhe të teknologjive të reja, të mësuarit në distancë sot është një tendencë dinamike dhe universale, sepse tashmë mund të informohemi dhe të mësojmë pa qenë nevoja për kontakt fizik me “mësuesin”. Është normale për një shoqatë ndërkombëtare si IFLA si dhe për specialistët profesionistë të informacionit dhe të menaxhim-marketingut të bibliotekave të interesohen për këtë fenomen e të shohin domosdoshmërinë e “qeverisjes” së informacioneve dhe dokumenteve. Tashmë, jo vetëm interesimi, por edhe investimi për këtë metodë është domosdoshmëri për të gjithë profesionistët e bibliotekave. Ata që e kanë aplikuar këtë lloj pedagogjie e dinë se jo vetëm thjeshtëzohen gjërat, por kjo mënyrë të detyron të punosh dhe të mësosh më shumë. Shpesh na duhet të rishohim në thellësi formimin, njohuritë, aftësitë dhe kualifikimin tonë, prandaj informimi në distancë paraqet shumë përparësi, sepse ky proces mund të vijojë edhe në shtëpi në mënyrë të pavarur përpara kompjuterit. Dita e punës kështu mund të shtrihet edhe pasdite e ngandonjëherë

dhe në darkë, prandaj duhet të përfitojmë gjerësisht nga kjo. Prof. Réjan Savard, profesor i shkollës së bibliotekonomisë dhe shkencës së informacionit në Universitetin e Montréalit, pikërisht duke u nisur nga këto përparësi, thekson se kolegët e Gjenevës e të ENSSIB-it (École Nationale Supérieure des Sciences de l’Information et des Bibliothèques-Shkolla e Lartë Kombëtare e Shkencave të Informacionit dhe të Bibliotekave) duhen përgëzuar për nismën dhe propozimin që i bënë seksionit të Edukimit dhe të Informacionit të IFLA-s për bashkimin me seksionin e Menaxhim-Marketingut, për zhvillimin e kësaj veprimtarie, që i shërben zhvillimit të vijueshëm profesional.

Bibliotekat po shohin se roli i tyre në shkencën e informacionit po rritet në mënyrë spektakolare, sidomos me shumëllojshmërinë e dokumenteve dhe të burimeve elektronike, të cilat vazhdimisht shkurtojnë distanca. Sigurisht këto kërkojnë strategji të reja menaxhimi dhe marketingu me qëllim që përdorimi i këtyre burimeve të reja të mos jetë i kushtueshëm. Sot ka një evolucion të mësimit elektronik sidomos me projektet e reja të partneritetit në rrjetin e burimeve elektronike. Në këtë botim paraqiten analiza studimesh dhe projekte nga lektorë dhe specialistë të informacionit dhe bibliotekonomisë. Kështu, Florence Muet dhe Marian Follet japin përvojën e shkollës së tyre (ENSSIB), e cila ka si mision të

formojë bibliotekarët dhe punonjësit e shërbimeve të dokumentacionit dhe të mësimi elektronik shkencor e teknik. Modulet e trajnimit që paraqiten këtu, të trajtuara në aspektin organizativ dhe teknik, kanë pasur sukses të plotë në ENSSIB. Me fillimin e një projekti të edukimit në distancë në vitin 2000, u krijua një mjedis i posaçëm për teknologjitë e reja të edukimit. Tre vitet në vijim treguan arritjet e këtij projekti eksperimental, vënie në jetë të përvojave të tjera dhe dëshirën për ndarjen dhe transferimin e burimeve ndërmjet partnerëve të ndryshëm. Materiali bën një përshkrim të aspekteve pedagogjike dhe teknike të dy kurseve që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe marketingun e shërbimeve të informacionit në edukimin e vijueshëm.

*Ailsa Nicholson*, specialiste nga Britania e Madhe paraqet përvojën e saj, duke dhënë tipe të ndryshme të të mësuarit në distancë që përdoren aktualisht në Britaninë e Madhe dhe arsyet e suksesit të tyre. Shqyrtohen dallimet që ekzistojnë midis studentëve të zakonshëm dhe atyre në moshë të madhe, të cilët kanë hyrë vonë në shkollën e lartë dhe vihet në dukje se mësimi elektronik mund të jetë ndihmë e veçantë për këta të fundit. Në prezantimin e saj autorja shpjegon se si mësuesit e marketingut përdorin Internetin për mësimin në distancë dhe si ndihmon LTSN, BEST (the Learning & Teaching Support Network-Rrjeti i Mbështetjes të të Mësuarit dhe Mësimdhënies; BEST-the Bussines Education Support Team-Grupi Mbështetës i Edukimit në Biznes) me trajnime në mbështetje të akademikëve. Së fundi, shkrimi analizon disa nga zbatimet e teknologjisë së re në biblioteka dhe bën thirrje për bashkëpunim të ngushtë midis bibliotekave dhe lektorëve.

Ndërsa *Anne Piponnier*, nga Universiteti i Bordeaux 3 në Francë, objekt të prezantimit të saj ka dimensionin evropian për çështje të trajnimit në mësimin e përdorimit të informacionit. Materiali paraqet rezultatet e një projekti evropian studimi të kryer gjatë viteve 1999-2003 nën kujdesin e programit Socrates, kushtuar edukimit të vijueshëm të mësimdhënies evropiane.

*John Ellison*, pedagog i departamentit të bibliotekomisë dhe informacionit në Universitetin e Buffalos në New York, bën një analizë të problemeve kryesore lidhur me mësimin e Internetit dhe paraqet nëntë parime mbi të cilat

mbështetet programi i shkollës për mësimin në distancë. Ai vë në dukje përparësitë dhe të metat e mësimi në distancë përmes Internetit.

*Më poshtë renditen disa prej përparësive:*

- Përparësia kryesore e mësimi në distancë është se siguron arsimim cilësor të studentëve që jetojnë shumë larg universitetit;
- Bibliotekarët e huaj nga e gjithë bota mund të marrin lehtësisht pjesë në diskutimet e klasës;
- Studentët nga vende të ndryshme dhe nga distanca të ndryshme sjellin përvoja dhe perspektiva të reja të procesit mësimor dhe edukativ;
- Kurset e mësimi në distancë kanë mundësinë për t'u organizuar më mirë se kurset në klasa brenda ndërtesës;
- Njëherësh zhvillohet lënda e mësimi në distancë, përpunohet përmbajtja dhe shpërndahet;
- Vlerësimet përfundimtare dhe ato javore nuk marrin kohën e mësimi dhe rezultati është i menjëhershëm;
- Shënimet e arkivuara dhe diskutimet janë të mundshme për t'u rishikuar nga studentët;
- Ka mundësi më të shumta për diskutime të gjera;
- Puna në rrjet nxit pjesëmarrje dhe diskutime të menduara në orën e mësimi;
- Shpërndarja e mësimëve mund të bëhet nga kudo ku ka një linjë Interneti;
- Nuk shpenzohet kohë për udhëtime vajtje-ardhje në universitet për mësimet;
- Në mësimin në distancë marrin pjesë më shumë studentë të popullsisë të ndryshme;
- Orët zyrtare online, diskutimet dhe takimet në grup duket se tërheqin më shumë studentë;
- Në mësimin në distancë përdoren më shumë materiale multimedia si për dhënie mësimi ashtu dhe për studim;
- Studentët shpesh duket se nuk e ndalojnë komunikimin me profesorët, sepse procesi i të mësuarit në orët e mësimi në distancë i përafrohet metodës së tyre personale të komunikimit;
- Është e lehtë të lidhesh shënimet dhe diskutimet e orës së mësimi me site plotësuese dhe burime në Web;

- Eksperiencia e marrjes së mësimi në distancë ndihmon bibliotekarët e ardhshëm në lidhje me përdoruesit e bibliotekës, të cilët marrin mësimë të ngjashme;
- Megjithëse mësimi në distancë është shpesh në formën e një prezantimi në grup, përgjigjet janë individuale, në formën profesor-student. Gjithsecilit i kërkohet të lexojë shënimet, por jo kushdo mund të lexojë përgjigjet e profesorit për secilin;
- Profesorët mund të ruajnë pronësinë e përmbajtjes së kursit;
- Përdorimi i gjerë i imazheve të skanuara, audioklipeve, videoklipeve dhe lidhjet me burimet në WWW mund të përfshihen në shënimet e kursit;
- Studentët ndjehen më pak të emocionuar për të shprehur mendimet e tyre.
- Profesorët e mësimi në distancë duhet të jenë të përgatitur për komentet që do të bëhen rreth leksionit të tyre, gjë që nuk ndodh në klasë;
- Mungesa e mbështetjes së mjaftueshme nga departamenti dhe universiteti;
- Zakonisht nuk është e mjaftueshme koha dhe energjia e kërkuar për t'iu përgjigjur siç duhet volumit të madh të mesazheve që kërkon praktika e zhvillimit të mësimi në distancë;
- Kufizime të teknologjisë së veçantë të përshtatshme për mësimin në distancë;
- Duhet më shumë teknika për të motivuar studentët që të ndjekin mësimin në distancë;
- Sasia e materialit që duhet shtypur përmes tastierës është shumë e madhe;
- Ndërlikime në vlerësimin e detyrave të studentëve.

### *Ndërkohë që disa nga të metat janë:*

- Të mësuarit nëpërmjet Internetit krijon një problem që shpesh nuk haset në klasë. Është shumë e lehtë të lidhesh me lexime plotësuese kur mëson nëpërmjet Internetit. Kjo mund të jetë e mrekullueshme për profesorët, por mund të bëhet një problem i madh për studentët që planizojnë javën e tyre të mësimi dhe u duhet të mendojnë edhe për shtesat e momentit të fundit;

Botimi përmban edhe prezantime të autorëve të tjerë lidhur me projektet e zhvilluara ose që janë në zhvillim për edukimin në distancë në vende të ndryshme të botës. Edukimi në distancë është në procesin e shkundjes së rutinës personale dhe profesionale të pedagogëve dhe studentëve. Materialet e paraqitura në këtë botim të IFLA-s për edukimin në distancë dhe menaxhimin e marketingun në biblioteka janë çështje të ditës dhe nënvleftësimi i tyre është në dëmin tonë.

*Alda Biçoku*



# Hyrje të reja

## Libra

**The Virtual customer : a new paradigm for improving customer relations in libraries and information services** : satellite meeting, São Paulo, Brasil, August 18-20, 2004 [*Klienti virtual : model i ri për përmirësimin e marrëdhënieve me klientët në biblioteka dhe shërbimin informues*] / ed. by Sueli Mara Soares Pinto Ferreira, Rejean Savard. - München : Saur, 2005.

XVI, 385 f. ; 21 cm. - (IFLA Publications, ISSN 0344-6891; 117)

Titulli paralel edhe në spanjisht, frëngjisht e portugalisht. - Bibliogr. në fund të çdo kumtese. ISBN 3-598-21845-1  
P 528/ 48 D

Koncepti i "klientit virtual" prej disa vitesh është bërë pjesë e fushës së bibliotekave dhe të shërbimeve të informacionit. Në shumë vende kompiuteri dhe Interneti janë tashmë pjesë e mjedisit të bibliotekave. Angazhimi i bibliotekave për të menaxhuar njëkohësisht koleksionet dhe shërbimet tradicionale dhe virtuale, ose ajo që e quajmë karakteri hibrid i bibliotekave, ka zënë vend në mentalitetin e bibliotekarëve. Ky karakter hibrid i bibliotekave do të vazhdojë të ekzistojë edhe për shumë e shumë vite. Krahas shërbimit fizik, të themi, të bibliotekës ndaj përdoruesit, është e nevojshme të shihet edhe ana virtuale e bibliotekës. Afrimi i klientit dhe plotësimi i kërkesave të tij në distancë është një sfidë që ndryshon shumë nga modeli tradicional. Vlerësimi i kërkesave të përdoruesve në distancë kërkon aftësi të veçanta, ndaj dhe materialet e përfshira në këtë botim i kushtohen këtij subjekti. Autorët e punimeve kanë prekur që nga çështje të përgjithshme si demokratizimi i aksesit në

informacionin digjital, deri te bibliotekat virtuale dhe shërbimet e reja, duke mos harruar edukimin e përdoruesve dhe të bibliotekarëve, krijimin e website-ve, informacionin sa më të specializuar etj. Botimi shërben si udhëzues për shërbime më të mira ndaj klientëve virtuale.

**World guide to library, archive, and information science associations** [*Guidë botërore e shoqatave bibliotekare, arkivore dhe të shkencës së informacionit*] / ed. by Marko Schweizer. - 2<sup>nd</sup> completely revised and expanded ed. - München : Saur, 2005.

510 f. ; 21 cm. - (IFLA Publications, ISSN 0344-6891 ; 112-114)  
ISBN 3-598-21840-0

Ribotimi i këtij materiali referues është kontribut me vlerë për bashkësinë profesionale ndërkombëtare. Kanë kaluar 15 vjet që nga botimi i mëparshëm në vitin 1990 dhe gjatë kësaj periudhe profesioni i bibliotekonomisë është zhvilluar dhe specializuar në mënyrë të ndjeshme. Është rritur numri i shoqatave kombëtare e ndërkombëtare, ka vende që kanë ndryshuar emrin etj. Ajo që ka më shumë rëndësi është fakti se Interneti është bërë një burim komunikimi i pakrahasueshëm. Të gjitha këto e bënë të nevojshëm ribotimin e guidës.

Shoqatat që përfshihen në këtë botim referues janë organizata jo-fitimprurëse në fushat e bibliotekonomisë, dokumentimit, shkencës së informacionit dhe arkivave. Ato janë grupuar në dy kategori:

1. *Shoqata ndërkombëtare, ku përfshihen shoqata me anëtarësi të dy ose më shumë*

vendeve (p.sh. Skandinavia, Europa, Azia Juglindore etj.). Ato mund të jenë të përgjithshme (si p.sh. IFLA) ose të specializuara (p.sh. Shoqata Ndërkombëtare e Bibliotekave Ligjore);

2. Shoqatat kombëtare, ku përfshihen shoqata që veprojnë në nivel kombëtar, të përgjithshme ose të specializuara sipas subjektit, llojit të bibliotekës, punonjësve etj. Nuk janë përfshirë shoqata që mbulojnë provinca ose rajone brenda një vendi.

Në fillim janë renditur shoqatat ndërkombëtare sipas alfabetit të emrit të tyre, ndërsa shoqatat e grupit të dytë janë vendosur në renditje alfabetike sipas emrave të vendeve. Paraqitja e çdo zëri të guidës është dhënë në formë të njësuar.

Botimi është i pajisur me indekse që lehtësojnë përdorimin si: indeksi i emrave të shoqatave, lista e akronimeve, indeksi i revistave zyrtare, emrat e personave zyrtarë, indeksi lëndor dhe indeksi i vendeve me shoqata kombëtare dhe ndërkombëtare.

**Possijskaā Gosudarstvennaā Biblioteka : stranicy istorii (60-90-e gody veka)** [Biblioteka Shtetërore Ruse : faqe nga historia e viteve 60-90 të shekullit XX]. - Moskva : Possijskaā Gosudarstvennaā Biblioteka, 2003. 200 f. : me il. ; 29 cm.

Botimi është përgatitur me rastin e 175-vjetorit të Bibliotekës Shtetërore të Rusisë. Materiali është grupuar në tre kapituj. *Kapitulli i parë* i kushtohet pasurimit të bibliotekës me botimet e vendit dhe me literaturën e huaj. *Kapitulli i dytë* bën një paraqitje historike të koleksioneve, si: fondi i botimeve zyrtare dhe normative, fondi i botimeve hartografike, fondi i dorëshkrimeve, fondi i disertacioneve, fondi i materialeve muzikore, fondi i librit të rrallë, fondi i mikrofilmave, fondi i gazetave; flitet për krijimin dhe zhvillimin e fondit të literaturës së bibliotekonomisë dhe bibliografisë si dhe për ruajtjen e dokumenteve në të shkuarën, sot dhe në të ardhmen. *Kapitulli i fundit* u kushtohet shërbimeve të bibliotekës ndaj përdoruesve duke filluar me një historik të departamentit të shërbimit në tërësi, duke u ndalur në disa nga këto shërbime, si: shërbimi bibliografik, shërbimi informues ndaj lexuesve, organizimi dhe përdorimi i katalogëve dhe kalimi nga katalogët me skeda tek ata elektronikë. Botimi mbyllet me një tregues të emrave që ka marrë biblioteka që nga krijimi në vitin 1828 e deri në vitin 1992, kur mori emrin që mban sot, Biblioteka Shtetërore Ruse.

## Artikuj

Amarasiri, Upali

**Rising from the wreckage : development of tsunami-affected libraries in Sri Lanka** [*Ngritja nga rrënojat : ndërtimi i bibliotekave të dëmtuara nga tsunami në Sri Lanka*] / Upali Amarasiri.

Në: IFLA Journal. - Vol. 31 (2005), nr. 4, f. 307-314.

Përshkruhen dëmtimet në bibliotekat publike, shkollore dhe të llojeve të tjera, të shkatuara nga tsunami i dhjetorit 2004 në brigjet e Sri Lankës dhe në vendet e tjera aziatike. Nënvizohen përpjekjet për rindërtim që janë në proces, përfshirë dhe krijimin e një komiteti kombëtar për menaxhimin e fatkeqësive për bibliotekat, shërbimet informuese dhe arkivat, angazhimin e bashkësive lokale dhe reagimet e komunitetit ndërkombëtar. Theksohet nevoja e një programi rikonstruksioni për bibliotekat dhe e krijimit të një skuadre ndërkombëtare të ndihmës së shpejtë që të bashkëpunojë me bibliotekarët, arkivistët, arkeologët vendas në zonat që preken nga fatkeqësi të tilla, për të identifikuar dhe vlerësuar situatën dhe për të marrë masa për rimëkëmbje.

Armstrong, Chris

**Defining information literacy for the UK** [*Përkufizimi i aftësisimit në informacion sipas Britanisë së Madhe*] / Chris Armstrong.

Në: Library and Information Update. - Vol. 4 (2005), nr. 1-2, f. 22-25.

Ka një konfuzion rreth kuptimit të saktë të konceptit *Aftësim në Informacion* dhe në përshkrimin e kompetencave që ai mbulon. Autori i shkrimit merr përsipër të shpjegojë pikërisht këtë. Sipas tij *Aftësimi në Informacion* përfshin njohuritë dhe përdorimin e shprehive ose kompetencave që së bashku mundësojnë përdorim efektiv të informacionit. Person i aftë në informacion nënkupton më shumë se gjetje informacioni. Nënkuptohej këtu si përdoret informacioni, si menaxhohet dhe komunikohet ai.

*Aftësimi në Informacion* përfshin informacionin në të gjitha format. Pas disa përkufizimeve të ndryshme autori thekson se aftësimi në informacion është të dish kur dhe pse të duhet informacioni, ku ta gjesht atë, si ta vlerësosh, ta përdorësh dhe ta transmetosh në mënyrë etike atë. Ai jep shpjegim për secilin prej elementeve të përkufizimit.

Blankson-Hemans, Liz

**Enhancing the workflow of information professionals** [*Shtimi i fluksit të punës së punonjësve të informacionit*] / Liz Blankson-Hemans, Kevin Bonsor.

Në: Library and Information Update. - Vol. 4 (2005), nr. 11, f. 27-29.

*Dialog* është një ndër kompanitë më të mëdha që siguron akses në baza të dhënash online. Ajo prej shumë vitesh qëndron në krye në kërkimin e informacionit kryesisht në fushat e biznesit, shkencës dhe teknologjisë. Artikulli e njeh lexuesin me paketën e re software të quajtur *DialogLink 5*, e cila u jep mundësi profesionistëve të informacionit të jenë më efektivë në kërkimin e informacionit dhe më të vlefshëm në institucionet e tyre.

Boserup, Ivan

**The Manuscript and the Internet : digital repatriation of cultural heritage** [*Dorëshkrimet dhe Interneti : riatdhesimi digital i trashëgimisë kulturore*] / Ivan Boserup.

Në: IFLA Journal, Vol. 31 (2005), nr. 2, f. 169-173.

Paraqiten tre projekte ndërshtetërore për digjitalizimin e materialeve të trashëgimisë kulturore të shpërngulura. Argumentohet se bibliotekat dhe arkivat që kanë pronë të tyre materiale unike të trashëgimisë kulturore të kulturave të tjera, duhet t'i paraqesin këto materiale në Internet, duke angazhuar jo vetëm



bibliotekarët dhe arkivistët lokalë, por edhe specialistë jashtë kufijve të vendit. Websitet e ndërtuara do të shërbejnë për qëllime mësimore dhe edukative.

Brindley, Lynne

**The British Library and e-learning** [*Biblioteka Britanike dhe të mësuarit elektronik*] / Lynne Brindley.

Në: IFLA Journal. - Vol. 31 (2005), nr. 1, f. 13-18.

Është një vështrim mbi trajtimin nga Biblioteka Britanike e të mësuarit elektronik dhe që përshkruan si përdoren burimet e bibliotekës për të mësuarit online nga grupe të ndryshme nxënësish. Përmenden gjithashtu disa nga sfidat lidhur me aksesin sa më të gjerë në programet e të mësuarit dhe ngrihen probleme për bibliotekat kombëtare që lidhen me mundësitë që krijojnë të mësuarit elektronik.

Chan, Ben

**24-hour reference service** [*24 orë shërbim referues*] / Ben Chan.

Në: Library and Information Update. - Vol. 4 (2005), nr. 6, f. 24-26.

Shërbimet referuese kanë pësuar ndryshim rrënjësor për shkak të Internetit. Periodikët dhe librat referues sot mund të përdoren në formë virtuale. Gjithashtu, ashtu si koleksionet referuese tradicionale, edhe website-t mbulojnë të gjitha fushat e dijes dhe të interesit. Rezultatet e kërkimit varen shumë nga aftësitë e kërkuesit. Autori prezanton një shërbim online të quajtur *People's Network*, i cili siguron shërbim referues 24 orë.

Chapman, Ann

**Collection descriptions** [*Përshkrimet e koleksioneve*] / Ann Chapman.

Në: Library and Information Update. - Vol. 4 (2005), nr. 4, f. 35-37.

Sot përdoruesit e kanë shumë të lehtë të bëjnë kërkime për koleksione të institucioneve të ndryshme. Kjo realizohet në sajë të një skeme për

metadatat, e cila ndihmon në përshkrimin e koleksioneve sipas një rregulli të përcaktuar. Jepen disa veçori të skemës së metadatave dhe disa baza të dhënash që e përdorin atë.

Ferreiro, Emilia

**Librarians and basic education teachers in the context of "Digital Literacy"** [*Bibliotekarët dhe mësuesit e edukimit bazë në kontekstin e "aftësimi digjital"*] / Emilia Ferreiro.

Në: IFLA Journal. - Vol. 31 (2005), nr. 1, f. 35-44.

Shkrimi e sheh në mënyrë kritike nocionin e "aftësimi digjital". Aftësimi nuk është një nocion statik. Kërkesat e tij ndryshojnë në vartësi të vendit dhe kohës. Sot Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit (TIK) ka pësuar ndryshime të mëdha në mënyrën e prodhimit dhe të shpërndarjes së tekstit. Megjithatë nuk ka ndryshuar natyra konceptuale e procesit të të mësuarit. Shqyrtohet lidhja ndërmjet shkollës fillore dhe njohjes së teknologjive të reja dhe arrihet në përfundimin se është e rrezikshme dhënia pas kompiuterave vetëm për të përmirësuar rezultatet e mësimit. Bëhen sugjerime për rolin e madh që mund të luajnë bibliotekarët në përdorimin më me efektivitet të TIK në arsim.

Forsyth, Ellen

**Public libraries and the millennium development goals** [*Bibliotekat publike dhe objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit*] / Ellen Forsyth.

Në: IFLA Journal. - Vol. 31 (2005), nr. 4, f. 315-324.

Bibliotekat publike mund të japin ndihmesë të madhe për arritjen e tetë objektiveve të Kombeve të Bashkuara për zhvillimin e mijëvjeçarit. Shkrimi analizon përdorimet aktuale të bibliotekave në lidhje me secilin nga objektivat, të cilat janë:

- Zhdukja e varfërisë dhe urisë;
- Arrija e arsimit fillor në shkallë universale;
- Nxitja e barazisë gjinore dhe forcimi i rolit të gruas;

- Reduktimi i vdekshmërisë së fëmijëve dhe përmirësimi i shëndetit të nënës;
- Lufta kundër HIV/AIDS, malaries dhe sëmundjeve të tjera;
- Sigurimi i mbështetjes së mjedisit;
- Krijimi i partneritetit global për zhvillimin.

Si përfundim nënvizohet roli e bibliotekave për zhvillimin e këtyre objektivave.

Hannesdóttir, Sigrún Klara  
**Library development in the electronic environment : Iceland 2005** [Zhvillimi i bibliotekave në mjedisin elektronik : Islanda] / Sigrún Klara Hannesdóttir.  
 Në: IFLA Journal. - Vol. 31, Nr. 2, 2005, f. 151-161.

Kultura islandeze bazohet në gjuhën amtare dhe traditat letrare, të cilat janë shumë të gjalla, ndonëse popullsia është më pak se 300.000 banorë. Botimi i librit për banorë është më i madh se në çdo vend tjetër, niveli i arsimit është i lartë dhe aksesit në Internet është pothuaj universal. Bibliotekat moderne gjithnjë e më shumë ofrojnë shërbime elektronike dhe çdo përdorues i Internetit mund të aksesojë katalogun përmblendhës, i cili përmban koleksionet e të gjitha llojeve të bibliotekave të vendit. Janë firmosur licenca me shitës të informacionit elektronik, që sigurojnë akses të pakufizuar në 34 baza të dhënash dhe 8000 revista shkencore me tekst të plotë. Website-t islandeze depozitohen sipas legjisllacionit të ri për këtë qëllim. Materialet e vjetra në letër dhe dorëshkrimet janë digjitalizuar dhe pasqyruar në Internet. Politika e re qeveritare për informacionin mbështet rolin e bibliotekave në shoqërinë e sotme.

Hyams, Elspeth  
**A fresh approach to online reference products and services** [Afrim i ri në produktet dhe shërbimet referuese online] / Elspeth Hyams  
 Në: Library and Information Update. - Vol. 4 (2005), nr. 6, f. 27-29.

Vitet e fundit ka një rinovim të shërbimit referues, pasi botuesit kanë kaluar në digjitalizimin

dhe botimin në CD të titujve referues. Sot botues si OUP (Oxford University Press) prodhojnë numër të madh librash elektronikë me çmime të arsyeshme për të nxitur akses sa më të gjerë. Shkrimi ka qëllim të njohë lexuesin me produktet dhe shërbimet e këtij botuesi.

Indergaard, Leikny Haga  
**A Voyage through the Norwegian library landscape and some challenges on the horizon** [Vështrim mbi bibliotekat norvegjeze dhe disa sfida të së ardhmes] / Leikny Haga Indregard.  
 Në: IFLA Journal. - Vol. 31 (2005), nr. 2, f. 133-145.

Norvegjia ka një sistem bibliotekar të zhvilluar dhe vitet e fundit vërehet rritje e veprimtarisë. Krahas bibliotekave fizike janë zhvilluar edhe shërbimet bibliotekare virtuale që ndihmojnë në rritjen e përdorimit të burimeve dhe të cilësisë së shërbimeve. Qëllimi është të sigurohen për publikun në të gjithë vendin shërbime bibliotekare me nivel të lartë, pavarësisht nga vendbanimi apo burimet e bibliotekës lokale. Të gjitha bibliotekat janë pjesë e një rrjeti të përbashkët dhe formojnë një strukturë lokale, rajonale dhe kombëtare. Për të siguruar një shërbim bibliotekar unik është i nevojshëm bashkërendimi në të tre nivelet.

Kalra, Harinder P.S.  
**Bioinformatics and the library and information science community** [Bioinformatika dhe komuniteti i bibliotekonomisë dhe shkencës së informacionit] / Harinder P.S. Kalra.  
 Në: IFLA Journal. - Vol. 31 (2005), nr. 4, f. 333-341.

Diskutohet emergjenca e bioinformatikës në tre dekadat e fundit si rezultat i konvergencës së rrjeteve dhe gjenetikës. Ka larmi përkufizimesh dhe përshkrimesh të bioinformatikës. Materiali thekson se veprimtaritë kryesore të bibliotekës dhe të shkencës së informacionit mund të kenë vlerë shumë të madhe në përparimin e bazave teorike të këtij subjekti, si dhe në zhvillimin e mekanizmave dhe mjeteve për informacion biomjekësor cilësor. Krijimi, menaxhimi dhe

shpërndarja e dijeve dhe informacionit biomjekësor për specialistët e të dy palëve është një sfidë dhe mundësi për specialistët e bibliotekave dhe të informacionit, për zgjerimin e horizontit të tyre profesional dhe për gjenerimin e dijeve të reja gjatë procesit.

Mahmood, Khalid  
**Copyright and book piracy in Pakistan** [*E drejta e autorit dhe pirateria e librit në Pakistan*] / Khalid Mahmood, Muhammad Ilyas.  
 Në: IFLA Journal. - Vol. 31 (2005), nr. 4, f. 324-332.

Pakistani gjendet nën një presion të fortë të vendeve perëndimore për shkak të përratisë së përhapur të librit. Materiali është një studim që paraqet rezultatet e tregimit të librit lidhur me të drejtën e autorit dhe piraterinë e librit në vend. Përshkruhen konventat ndërkombëtare që janë firmosur nga Pakistani dhe ligji kombëtar i të drejtës së autorit, si dhe zbatimet e tij. Jepet edhe një përmbledhje e pikëpamjeve amerikane për gjendjen e të drejtës së autorit në Pakistan.

Mouraby, Claire  
**Apprendre à transmettre : un nouvel élément de l'identité du bibliothécaire?** [*Të mësosh të komunikosh : komponent i ri në veçoritë karakteristike të një bibliotekari*] / Claire Mouraby.  
 Në: BBF. - Nr. 6, 2005, f. 80-90.

Në bibliotekat universitare bibliotekari ka edhe rolin e trajnerit për t'u mësuar studentëve se si të gjejnë dhe të përdorin informacionin. Ky rol kërkon aftësi të veçanta, sidomos pedagogjike, për t'u transmetuar përdoruesve disa njohuri profesionale dhe për t'i aftësuar ata në informacion. Ky aspekt i profesionit duhet pranuar nga bibliotekarët dhe duhet vlerësuar si element i rëndësishëm jo vetëm për ata që punojnë në biblioteka akademike, por dhe në llojet të tjera të bibliotekave.

Noël, Élisabeth  
**Enquête sur la formation à la méthodologie documentaire** [*Studim mbi metodologjinë e trajnimit për aftësim në përdorimin e informacionit*] / Élisabeth Noël, Marie-Annick Cazaux.  
 Në: BBF. - Nr. 6, 2005, f. 24-30.

Shoqata e drejtorëve dhe e personelit administrativ të bibliotekave universitare dhe të shërbimeve informuese ka kryer një studim në bibliotekat e universiteteve me synimin për pasur një ide të qartë të trajnimit lidhur me aftësitë e studentëve për përdorimin e informacionit. Shkrimi thekson rëndësinë e trajnimit të studentëve për përdorimin e informacionit, vlerat e tij; metodat e realizimit dhe tregues të arritjeve. Të dhënat statistikore janë krahasuar me ato të një studimi të kryer disa vite më parë.

Panijel-Bonvalot, Claire  
**La formation documentaire des étudiants en France** [*Trajnimi i studentëve në Francë për Aftësimin në Informacion*] / Claire Panijel-Bonvalot.  
 Në: BBF. - Nr. 6, 2005, f. 16-24.

Trajnimi për Aftësim në Informacion duket jo i qartë në universitetet franceze, ndaj qeveria ka miratuar disa direktiva për të shmangur mospërshtetshmësinë e studentëve në vitin e parë në universitet. Vihen në dukje faktorët e dështimit në ciklin e parë universitar dhe angazhimi i qeverisë. Janë kryer disa reforma në kurse të veçanta për mësimdhënien e aftësimin në informacion, si fillim kurse fakultative, dhe në bashkëpunim ose jo me bibliotekën. Në mbështetje të këtij trajnimi janë përgatitur udhëzues dhe burime online.

Pedley, Paul  
**Is digital content treated differently in law?** [*A trajtohet ndryshe në ligj përdorimi i përmbajtjes digjitale?*] / Paul Pedley.  
 Në: Library and Information Update. - Vol. 4 (2005), nr. 10, f. 22-24.



Në Britaninë e Madhe nuk ka ndonjë ligj të posaçëm për të drejtën e autorit për materialet digjitale. Shkrimi komenton disa rregulla dhe udhëzime lidhur me informacionin elektronik, licencat dhe marrëdhëniet kontraktore për përdorimin e këtij informacioni, monitorimin e përdorimit të tij, ruajtjen e website-ve etj.

Roos, J.W.  
**Copyright protection as access barrier for people who read differently : the case for an international approach** [*Mbrojtja e të drejtës së autorit si barrierë për personat me aftësi leximi të kufizuara : çështje për trajtim ndërkombëtar*] / J.W. Roos.

Në: IFLA Journal. – Vol. 31 (2005), nr. 1, f. 52-67.

E drejta e autorit është një barrierë për personat me paaftësi të leximit. Ndonëse këta tradicionalisht kanë përdorur materiale braile dhe audio për të plotësuar nevojat për lexim, ndihen të kufizuar vetëm në këto lloje mediash. Ndryshimet e shpejta të mjedisit teknologjik kërkojnë përshtatje për të shfrytëzuar mundësitë e reja të aksesimit. Problemet që paraqet mbrojtja e të drejtës së autorit si barrierë aksesit po shqyrtohen në një numër vendesh me synimin për ta shmangur këtë pengesë. Shkrimi përqendrohet në pengesat që shkakton e drejta e autorit, rezultatet e përpjekjeve të mëparshme lidhur me këto pengesa, ndryshimet teknologjike që ndikojnë në të drejtën e autorit, punën e disa bibliotekave që u shërbejnë personave me kufizime të të parit dhe së fundi nevoja e bashkëpunimit ndërkombëtar për këto probleme.

Sejersted, Francis  
**Freedom of information in a modern society** [*Liria e informacionit në një shoqëri moderne*] / Francis Sejersted  
 Në: IFLA Journal. – Vol. 31(2005), nr. 4, f. 301-306.

Në vitin 2004 Parlamenti Norvegjez miratoi një nen të ri në kushtetutë për lirinë e shprehjes. Diskutohen probleme të shoqërisë liberale që lidhen me çështjen. Vend të veçantë zënë kushtet për

lirinë e informacionit në një shoqëri moderne. Problemet e politikës së informacionit të autoriteteve publike zënë vend të konsiderueshëm, ashtu si edhe problemet dhe mundësitë që krijohen nga zhvillimet e reja teknologjike. Në shkrim pasqyrohet rëndësia e mbështetjes institucionale dhe nevoja për diversitet.

Serres, Alexandre  
**Evaluation de l'information sur Internet : le défi de la formation** [*Vlerësimi i informacionit në Internet : sfidë për trajnim*] / Alexandre Serres.  
 Në: BBF. – Nr. 6, 2005, f. 38-45.

Të duash të identifikosh dhe të vlerësosh informacionin që gjendet në Internet do të gjendesh përballë vështirësish teorike e metodologjike dhe do të duhet më shumë kompetencë se sa në një mjedis tradicional informacioni. Për studentët është i nevojshëm organizimi sa më shpejt i trajnimit për aftësim në informacion si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik. Kjo kërkon bashkëpunim të ngushtë të personelit akademik me punonjësit e bibliotekës, për të krijuar një "kulturë informacioni" të re.

Streatfield, David  
**Putting school libraries back into the picture** [*Përfshirja e bibliotekave të shkollave në tablonë e treguesve*] / David Streatfield, Sharon Markless.  
 Në: Library and Information Update. – Vol. 4 (2005), nr. 6, f. 36-38.

Pas një kritike të bërë ndaj bibliotekave të shkollave lidhur me hapësirat e pamjaftueshme, mungesën e fondeve të nevojshme, përdorimin e pakët të tyre nga nxënësit, u zhvilluan seminare konsultative për ndryshimin e gjendjes me pjesëmarrjen e bibliotekarëve të shkollave, mësuesve dhe të administratorëve. Nga këto takime lindën disa ide. Ajo që komentohet në këtë shkrim është vetëvlerësimi i treguesve të rezultateve, bazuar në një paketë të përgatitur posaçërisht për këtë qëllim.

Sukiasân, Eduard  
**Tehnologjieskie processy i osnovnye pavilla indeksirovaniâ** [*Proceset teknologjike dhe rregullat bazë të indeksimit*] / Eduard Rubenovië Sukiasân.

Shkola indeksirovania. Zanätie 10-e.  
 Në: Biblioteka. - 2004, Nr. 12, f. 43-45.

Është koment i njëjës nga çështjet e standardit GOST 7.59-2003 dhe pikërisht për proceset teknologjike dhe rregullat bazë të indeksimit. Në këtë numër të revistës autori ndalet në disa procese të indeksimit, si: analiza e përmbajtjes së dokumentit si objekt i indeksimit, nxjerrja në dukje dhe zgjedhja e komponenteve kryesore të përmbajtjes së dokumentit, marrja e vendimit për përbërjen e subjekteve, formulimi i termave të indeksimit në përshatje me sistemin gramatikor dhe redaktimi i termave të indeksimit. Disa çështje të tjera të këtij standardi komentohen në numrat në vijim të revistës.

Sukiasân, Eduard  
**Pravilla sistematizacii i predmetizacii** [*Rregullat e klasifikimit sistematik dhe lëndor*] / Eduard Rubenovië Sukiasân.  
 Shkola indeksirovania. Zanätie 10-e.  
 Në: Biblioteka. - 2005, Nr. 1, f. 38-41.

Artikulli është në vijim të shkrimit të mëparshëm ku komentohet standardi GOST 7.59-2003 dhe ndalet në rregullat e klasifikimit sistematik dhe atij lëndor. Ndonëse në praktikën tradicionale të katalogimit, klasifikimi sistematik dhe ai lëndor kishin një funksion të caktuar lidhur me krijimin e katalogëve me skeda, me automatizimin e sistemit bibliotekar klasifikimi sistematik dhe ai lëndor i dokumenteve nuk kryejnë të njëjtin funksion në katalogun elektronik. Këto janë edhe çështjet që trajtohen në artikull.

Sukiasân, Eduard  
**Koordinatnoe indeksirovanie : vybor terminov indeksirovaniâ i formirovanie poiskovogo obraza dokumenta** [*Indeksi i bashkërenduar : zgjedhja e termave të*

*indeksimit dhe formimi i modelit të kërkimit të dokumentit*] / Eduard Rubenovië Sukiasân.  
 Shkola indeksirovania. Zanätie 13-e.  
 Në: Biblioteka. - 2005, Nr. 3, f. 42-44.

Pas analizës së dokumentit për klasifikimin sistematik dhe lëndor, më tej kalohet në etapën e paraqitjes së përmbajtjes së dokumentit me anën e termave të indeksimit. Autori vë në dukje se për klasifikimin sistematik me anë të termave të indeksimit përdoren indekset e klasifikimit, ndërsa për atë lëndor duhen rubrikatorët lëndorë. Shpjegohen disa veçori të këtyre të fundit bazuar në standardin përkatës.

Sukiasân, Eduard  
**Tablitsy klassifikacii** [*Tabelat e klasifikimit*] / Eduard Rubenovië Sukiasân.  
 Shkola indeksirovania. Zanätie 14-e.  
 Në: Biblioteka. - 2005, Nr. 4, f. 62-65.

Është një përshkrim përmbledhës i disa sistemeve të klasifikimit, si: Klasifikimi Bibliotekar Bibliografik, Klasifikimi Dhjetor i Djujt, Klasifikimi Dhjetor Universal dhe ndonjë sistem tjetër. Autori përqendrohet kryesisht në aspektin historik të zhvillimit të tabelave të klasifikimit.

Sukiasân, Eduard  
**Tablitsy klassifikacii : elementy i sistema oboznaçenij** [*Tabelat e klasifikimit : elementet dhe sistemet e shenjave*] / Eduard Rubenovië Sukiasân.  
 Shkola indeksirovania. Zanätie 15-e.  
 Në: Biblioteka. - 2005, Nr. 5, f. 42-44.

Ndërsa në numrin e mëparshëm të revistës autori trajton zhvillimin historik të tabelave të klasifikimit, në këtë numër ai përqendrohet në simbolet e përdorura, shenjat e pikësimit dhe kombinimet e tyre për të shprehur subjektin e veprës.

Sukjasån, Eduard

**IPA : klùëevyh slov** [*Gjuhët e kërkimit të informacionit : fjalët kyç*] / Eduard Rubenovië Sukjasån.

Shkola indeksirovania. Zanâtie 16-e.

Në: Biblioteka. - 2005, Nr. 6, f. 13-15.

Në gjuhët e kërkimit të informacionit autori përfshin për klasifikimin - indekset e klasifikimit, për lëndorin – rubrikat lëndore, për gjuhët e indeksimit të koordinuar – fjalët kyç ose deskriptorët. Në këtë artikull autori ndalet në këto të fundit.

Trifonova, Ekaterina Evgenevna

**Retrospektivnaâ konversiâ biblioteçnyh katalogov** [*Konvertimi retrospektiv i katalogëve të bibliotekës*] / Ekaterina Evgenevna Trifonova.

Në: Biblioteka. - 2005, Nr. 2, f. 45-50.

Autorja vë në dukje domosdoshmërinë e konvertimit të katalogëve tradicionalë në formë elektronike, mënyrat e konvertimit retrospektiv, etapat e këtij procesi, përpunimin e dokumenteve gjatë procesit të konvertimit retrospektiv dhe së fundi ndalet në shembuj konkretë të konvertimit retrospektiv të katalogëve të bibliotekave.

**Together we shape better libraries : the Swedish Quality Handbook project** [*Së bashku krijojmë biblioteka më të mira*] / Christina Jönsson Adrial etc.

Në: IFLA Journal, Vol. 31 (2005), nr. 2, f. 188-193.

Qëllimi i projektit është të ndihmojë bibliotekat suedeze të sektorit publik në procesin e menaxhimit, duke përdorur treguesit e rezultateve. Projekti synon të shërbejë si pikënisje për bibliotekat që janë të interesuara të angazhohen në rritjen e cilësisë. Bashkëpunimi bazohet në mbledhjen e të dhënave për 12 tregues gjatë një periudhe 3-vjeçare dhe në krahasimin e rezultateve në kohë të ndryshme edhe me ato të bibliotekave të tjera. Në treguesit përfshihen plotësimi i kërkesave të përdoruesve, orët e shërbimit krahasuar me kërkesat, popullsia e shërbyer,

popullsia e shërbyer përmes shërbimit elektronik në distancë, frekuentimi i bibliotekës, numri i kërkesave për informacion, ndjekja e veprimtarive, koha mesatare për pasurim dhe përpunim, raporti i huazimit ndërbibliotekar me huazimin në tërësi, qarkullimi i koleksioneve. Projekti përfshin 50 biblioteka dhe drejtohet nga një grup i menaxhimit cilësor dhe statistikave të Shoqatës Bibliotekare Suedeze, e cila luan rol mjaft aktiv në nxitjen e zhvillimit të bibliotekave në Suedi.

Weber, Jutta

**The Manuscript collections of Europe : a mirror of migration, separation and reunification as seen in the Alexander von Humboldt Collection in Berlin** [*Koleksioni i dorëshkrimeve të Europës : shembull i migrimit, ndarjes dhe ribashkimit siç shihet në koleksionin Alexander von Humboldt në Berlin*] / Jutta Weber.

Në: IFLA Journal. - Vol. 31 (2005), nr. 1, f. 85-89.

Historia e Koleksionit Alexander von Humboldt në Berlin është histori e migrimit të dorëshkrimeve, e ndarjes së pjesëve të koleksionit dhe ribashkimit të tyre. Kjo çon në shtrimin e disa çështjeve, si: ç'ndodh nëse vendi fillestar i një dorëshkrimi nuk është i sigurt? Si mund të garantojmë ruajtje të sigurt të dorëshkrimeve në një vend tjetër? Ka arsye të forta për ndërtimin e aleancave mes institucioneve që janë të gatshme të bashkëpunojnë për këto çështje. Ndonëse nuk mund të kthejmë pas historinë, duhet të veprojme së bashku sot dhe në të ardhmen.



# Website

## për Aftësimin në Informacion

*Aftësimi në Informacion përfshin procesin e arsyelimit se kur të duhet informacioni dhe si të jesh i aftë të gjejsh, të vlerësosh dhe të përdorësh me efektivitet atë. Website-t e mëposhtme përbajnë materiale rreth kësaj tematike.*

Direktori e burimeve online për Aftësimin në Informacion. Ofron lidhje me një numër organizmash, kumtesa, prezantime, programe akademike etj.  
<http://www.cas.usf.edu/lis/il/>.

Home Page për Aftësimin në Informacion. Përmban lidhje me website për programe të Aftësimin në Informacion, si edhe një bibliografi për libra, artikuj revistash dhe botime të tjera për këtë çështje.  
[www.fiu.edu/~library/ili/index.html](http://www.fiu.edu/~library/ili/index.html).

Standarde për Aftësimin në Informacion.  
[www.carl-acrl.org/Reports/rectoWASC.html](http://www.carl-acrl.org/Reports/rectoWASC.html).

Projekti për Aftësimin në Informacion, qëllimi, objektivat, koha e realizimit dhe hollësi të tjera.  
[www.lib.calpoly.edu/infocomp/project/index.html](http://www.lib.calpoly.edu/infocomp/project/index.html).

Raporte për Aftësimin në Informacion.  
hakataj.mcll.djst.maricopa.edu/ocotillo/report94/rep7.html.  
(<http://www.ala.org/acrl/nili/ilit1st.html>).  
[www.ala.org/acrl/nili/nili.html](http://www.ala.org/acrl/nili/nili.html).

Nisma për Aftësimin në Informacion në shkollat e larta.  
[olis.sysadm.suny.edu/projects/ILI/web.html](http://olis.sysadm.suny.edu/projects/ILI/web.html)  
[olis.sysadm.suny.edu/ili/default.htm](http://olis.sysadm.suny.edu/ili/default.htm).  
[facstaff.uww.edu/WAAL/infolit/index.html](http://facstaff.uww.edu/WAAL/infolit/index.html).

Site i Bashkimit Europian për kurse të edukimit në distancë për Aftësimin në Informacion.  
[educate.lib.chalmers.se/DEDICATE/dedindex.html](http://educate.lib.chalmers.se/DEDICATE/dedindex.html).

Projekti i Britanisë së Madhe që ofron disa shërbime, përfshirë kurs online, bibliografi me adnotime të gjata dhe diskutime.  
[netways.shef.ac.uk/index.htm](http://netways.shef.ac.uk/index.htm).

UC Berkeley Teaching Library. Misioni i kësaj biblioteke është të nxisë Aftësimin në Informacion si pjesë e programit të studentëve.  
([library.berkeley.edu/Help/search.html](http://library.berkeley.edu/Help/search.html))  
[www.lib.berkeley.edu/TeachingLib/](http://www.lib.berkeley.edu/TeachingLib/).

## Mësim praktikë

www.bgsu.edu/colleges/library/infosrv/tutorial/tutor1.html.  
 library.jmu.edu/library/gold/modules.htm.  
 www.navigator.utah.edu/  
 gateway.lib.ohio-state.edu/tutor/open/courses.html.  
 nettrail.ucsc.edu/nettrail/master/  
 reach.ucf.edu:8900/public/libtut/

## Revista elektronike

The Chronicle of Higher Education  
<http://chronicle.com/>.

Educom Review  
<http://www.educause.edu/pub/er/erm.html>.

Syllabus Magazine  
[www.syllabus.com/syllmag.html](http://www.syllabus.com/syllmag.html).

## Artikuj

*"Seven Faces of Information Literacy in Higher Education"* /Christine Susan Bruce. [www.fit.qut.edu.au/InfoSys/bruce/inflit/faces/faces1.htm](http://www.fit.qut.edu.au/InfoSys/bruce/inflit/faces/faces1.htm).

*"Integrating Information Literacy Into the Curriculum: How is your library measuring up?"* / Cerise Oberman, Bonnie Gratch Lindauer, Betsy Wilson.  
[www.ala.org/acrl/nili/iqtest.html](http://www.ala.org/acrl/nili/iqtest.html)  
[www.ala.org/acrl/nili/integrtg.html](http://www.ala.org/acrl/nili/integrtg.html).

*"Information Literacy as a Liberal Art"* /Jeremy J. Shapiro, Shelley K. Hughes. [www.educause.edu/pub/er/review/reviewarticles/31231.html](http://www.educause.edu/pub/er/review/reviewarticles/31231.html).

## Organizata dhe shoqata

ALA, ACRL Institute for Information Literacy (IIL)  
[www.ala.org/acrl/nili/nilibp.html](http://www.ala.org/acrl/nili/nilibp.html).

ALA, ACRL Instruction Section (IS)  
[www.bk.psu.edu/academic/library/istm/criteria.html](http://www.bk.psu.edu/academic/library/istm/criteria.html) ([www.cwru.edu/affil/cni/base/acrlcni.html](http://www.cwru.edu/affil/cni/base/acrlcni.html))  
[www.lib.utexas.edu/is/](http://www.lib.utexas.edu/is/).

ALA Library Instruction Round Table (LIRT)  
[diogenes.baylor.edu/Library/LIRT/](http://diogenes.baylor.edu/Library/LIRT/).

CCLI-North Home Page: California Clearinghouse on Library Instruction [www.scu.edu/SCU/Library/Orradre/ccli/ccli.htm](http://www.scu.edu/SCU/Library/Orradre/ccli/ccli.htm).

California Clearinghouse on Library Instruction, South (CCLI, South) [gort.ucsd.edu/atweedy/ccli.html](http://gort.ucsd.edu/atweedy/ccli.html).

LOEX Clearinghouse for Library Instruction  
[www.emich.edu/~lshirato/loex.html](http://www.emich.edu/~lshirato/loex.html).

**Në ndihmë të terminologjisë  
së shpjeguar të  
bibliotekonomisë**



**Adresë e protokollit të Internet-it** [*IP address*]

Adresa fizike e një kompiuteri klient ose server i lidhur me një rrjet që administrohet nga protokollit TCP/IP, në formën e katër grupeve të numrave arabë të ndarë mes tyre me pikë (p.sh. 123.456.78.9). IP është shkurtim i Internet Protocol. Çdo adresë IP lidhet me një adresë Interneti alfanumerike në sistemin e emrave të siteve (të vendeve virtuale në Internet).

**Adresë Interneti** [*Internet address*]

Kod unik i caktuar për një kompiuter të veçantë të lidhur me Internetin për ta identifikuar atë si dërgues ose marrës në transmetimin e të dhënave ose të skedarëve. Përdoren dy kategori adresash: adresa të postës elektronike (e-mail) të individëve të veçantë dhe site URL të FTP, Telnet site dhe Web site. Forma e adresave të Internetit drejtohet nga Sistemi i Emrave të Adresave (DNS).

**Afat favorizues** [*Grace period*]

Periudhë kohe e përcaktuar, në vazhdim të datës së kthimit, gjatë së cilës përdoruesi mund të shtyjë afatin ose të kthejë njësinë e huazuar në bibliotekë pa u ngarkuar me gjobë. Për të nxitur kthimin e materialeve të vonuara, disa biblioteka caktojnë çdo vit një ose disa ditë për kthimin e njërive të vonuara pa gjobë.

**Aftësim në Informacion** [*Information literacy*]

Zotësia për gjetjen e informacionit të nevojshëm, përfshirë njohuritë për organizimin e bibliotekave, familjarizimin me burimet që ato sigurojnë (ku përfshihen dhe formatet e ndryshme të informacionit dhe mjetet e automatizuara të kërkimit) dhe njohuritë për teknikat e kërkimit. Ky koncept përfshin gjithashtu aftësitë e duhura për vlerësim kritik të përmbajtjes së informacionit dhe të kuptuarit e infrastrukturës teknologjike në të cilën bazohet transmetimi i informacionit, përfshirë kuptimin dhe ndikimin social, politik e kulturor të tij.

**Akses i integruar** [*Integrated access*]

Sistem i kërkimit të informacionit që i jep mundësi përdoruesit të kërkojë libra, artikuj periodiku dhe burime elektronike si skedarë kompiuteri dhe Website, duke përdorur një ndërfaqe të vetme dhe jo duke kërkuar veças në katalogët online, në bazat e të dhënave bibliografike dhe në motorët e kërkimit të Web-it.

**Bashkëveprim** [*Interoperability*]

Aftësi e pajisjes (hardware) ose programit (software) të një sistemi kompiuterik për të komunikuar dhe punuar me efektivitet me një sistem tjetër për shkëmbimin e të dhënave, zakonisht sistem i një tipi tjetër, i projektuar dhe prodhuar nga tjetër tregtues.

**Bibla e Gutenbergut** [*Gutenberg Bible*]

Libri i njohur si më i hershëm i prodhuar me shkronja të lëvizshme, i shtypur në vitet 1450-1455 në Mainz të Gjermanisë nga Johann Gutenbergu dhe ndihmësi i tij Peter Schoffer, me ndihmën financiare të tregtarit Johann Fust. Njihet edhe me emrin **Bibla Mazarin** sepse një kopje është gjetur në bibliotekën private të bibliofilit Cardinali Mazarin (1602-1661), njëqind vjet pas vdekjes së tij. Është bibël latine e shtypur me bojë të zezë me shtyp gotik, në dy kolona me nga 42 rreshta për faqe. Nga rreth 180 kopje të shtypura, vetëm 48 prej tyre thuhet se kanë mbijetuar, gjë që i bën ato shumë të rralla dhe me vlerë. 12 janë shtypur në pergamenë dhe 36 në letër. Dy kopje të saj gjenden në Bibliotekën Britanike dhe një kopje në Bibliotekën Kombëtare të Francës. Në SHBA janë gjithsej 13 kopje në biblioteka të ndryshme, një prej të cilave gjendet në Bibliotekën e Kongresit.

**Bibliografi historike** [*Historical bibliography*]

Degë e bibliografisë që merret me studimin e historisë së metodave të prodhimit të librit, përfshirë kopjimin me dorë, ilustrimet, botimin, shtypin, prodhimin e letrës, lidhjen dhe ruajtjen. Bibliografia historike shkrihet me fushën e historisë së librit.

**Bibliotekë filmi** [*Film library*]

Lloj bibliotekë speciale që përmban koleksion filmash 8, 16, 35 ose 70 mm, videoregjistrime, DVD dhe materiale që kanë të bëjnë me prodhimin e filmit, studime etj., të klasifikuara për t'u gjetur dhe përdorur me lehtësi. Huazimi mund të jetë i kufizuar vetëm për anëtarët dhe abonentët falas ose kundrejt një pagese për çdo njësi të huazuar.

**Bibliotekë qeveritare** [*Government library*]

Bibliotekë që mbahet nga njësi të qeverisë në nivel lokal, shtetëror ose federal dhe përmban koleksion për përdorim nga personeli i saj. Disa biblioteka

qeveritare kanë mandat që mund të përdoren edhe nga publiku.

## **Bibliotekë spitali** [*Hospital library*]

Bibliotekë mjekësore që mirëmbahet brenda mjediseve të spitalit dhe që përmban koleksione burimesh për mjekësinë dhe shkencat e përafërta, të shtypura dhe online, në shërbim të kërkesave për informacion dhe studime të mjekëve, infermierëve, pacientëve dhe personelit tjetër. Zakonisht menaxhohet nga një bibliotekar i mjekësisë.

## **Botim i parë** [*First edition*]

Të gjitha kopjet e botimit të një libri të shtypura në të njëjtën kohë, përpara çdo shtypjeje tjetër. Shtypjet e mëpasme nga e njëjta radhitje shtypi konsiderohen shtypje të reja, por bëjnë pjesë përsëri në botimin e parë. Botimi i dytë shtypet nga një radhitje e re shtypi ose ka ndryshime të dukshme të tekstit dhe formatit.

## **Botim i përbashkët** [*Joint publication*]

Botim i të njëjtës vepër (bazuar në një marrëveshje paraprake) nga dy botues të ndryshëm, zakonisht me kapak të trashë nga shtëpi botuese universitare dhe me kapak të hollë nga botues tregtarë.

## **Botim për eksport** [*Export edition*]

Botim i përgatitur nga botuesi posaçërisht për t'u dërguar dhe shitur në një vend tjetër.

## **Botim "si të veprosh"** [*How-to publication*]

Libër, broshurë ose videokasetë që jep informacion dhe këshilla praktike se si të kryhet një punë, si të mësohet një aftësi ose të arrihet një përfundim të dëshiruar, zakonisht në formë të udhëzimeve hap pas hapi, shoqëruar me diagrama (p.sh. manualët për vetëriparim). Këto botime gjenden shpesh në bibliotekat publike.

## **Burim (informacioni) falas** [*Free resource*]

Burim serioz informacioni që mund të përdoret pa pagesë (p.sh. numërorët telefonikë). Sot informacioni është pa pagesë në një numër të madh burimesh përmes World Wide Web-it.

## **Burim në Internet** [*Internet resource*]

Dokument digjital (faqe Web-i, skedar FTP, mesazh e-mail etj.) që mund të shkarkohet nga një

server në distancë përmes Internet-it. Rregullat e katalogimit të burimeve në Internet janë të disponueshme nga OCLC në *Cataloging Internet Resources: A Manual and Practical Guide*.

## **Dalje e parë** [*First appearance*]

Term që përdoret në tregtimin e librit për të treguar: 1) daljen e parë në shtyp të një autori; 2) herën e parë që një vepër e caktuar e një autori del në shtyp, zakonisht vepër e shkurtër (ese, poemë, tregim); 3) trajtimin për herë të parë i një subjekti të botuar në formë libri.

## **Datë e daljes** [*Issue date*]

Datë ose periudhë (pranverë, verë, vjeshtë, dimër) e veçantë me anë të së cilës identifikohet një numër i caktuar i një botimi serial. Zakonisht gjendet e shtypur në kapakun e përparmë dhe në çdo faqe.

## **Datë e mbarimit të afatit** [*Expiration date*]

Data në të cilën ndërpritet dërgimi i një abonimi të periodikut nëse pagesa nuk është marrë nga abonuesi brenda afatit të caktuar. Gjithashtu data pas të cilës një bibliotekë nuk ka të drejtë të fitojë një çmim para botimit, një zbritje të veçantë apo stimuj të tjerë promocionalë për të porositur një njësi. Është dhe data pas të cilës një kartë e anëtarësisë së bibliotekës, një fjalëkalim, licencë programi etj. nuk ka më vlerë.

## **Datë jo e saktë, e gabuar** [*False date*]

Datë, p.sh. e lindjes ose e vdekjes, apo e botimit, e dhënë e pasaktë, me qëllim ose jo. Në katalogim data e saktë vendoset në kllapa katrorë në vijim të datës së gabuar të regjistrimit bibliografik (p.sh. 1950 [1952]).

## **Deshifruer i jashtëm** [*External decoder*]

Pajisje elektronike që lidh një ose më shumë skanera barkodesh me një kompiuter ose sistem kompiuterik me anë të një kablli dhe transferon të dhënat nga skaneri në sinjale digjitale që të mund të përpunohen nga kompiuteri. Disa skanera barkodesh e kanë të integruar deshifruerin.

## **Disketë** [*Floppy disk*]

Disk i jashtëm 3 1/2 inch që përdoret në kompiuter si mjedis ruajtës për të dhëna në format digjital. Disketat më të zakonshme janë me kapacitet 720K dhe 1.44MB. Deri në vitin 1987 përdorshin

disketa 5 1/2 inch. Për të kursyer letrën, përdoruesit e bibliotekave mund t'i ruajnë rezultatet e kërkimit në disketë. Në kompiuter lexuesi i disketës është a./: Sinonim me *discette*.

#### **Dokument i ilustruar** [*Iconic document*]

Botim ose dokument tjetër në të cilin përmbajtja paraqitet kryesisht në formë grafike ose të ilustruar me figura. Shembuj të tillë janë atlasat, librat e fëmijëve me ilustrime, katalogët e ekspozitave, fjalorët vizualë, pllakatet, kartolinat etj.

#### **Dokument për përdorim të brendshëm** [*Internal document*]

Dokument si p.sh. memorandum ose raport, i caktuar për t'u shpërndarë vetëm brenda institucionit dhe jo për publikun e gjerë. Disa nga këto materiale mund të klasifikohen me akses të kufizuar për personel të autorizuar.

#### **Doracak** [*Handbook*]

Libër referues njëvëllimësh që përmban informacion faktik të përmbledhur për një subjekt të caktuar, të organizuar sistematikisht për përdorim të shpejtë dhe të lehtë. Informacioni statistikor zakonisht shtypet në formë doracaku. Ka edhe doracakë që shtypen në seri.

#### **Dhuratë** [*Gift*]

Një ose më shumë libra dhe njësi të tjera të dhuruara bibliotekës, zakonisht nga një person, por edhe nga një organizëm, institucion ose bibliotekë tjetër. Kopjet e dhuruara vlerësohen duke u bazuar në politikën e bibliotekës për zhvillimin e koleksioneve dhe mund t'i shtohen koleksionit të bibliotekës, të përdoren për shkëmbim me bibliotekat e tjera ose të shiten.

#### **E drejtë ndërkombëtare e autorit** [*International copyright*]

Mbrojtje e të drejtës së autorit për veprat e botuara jashtë kufijve të vendit, aktualisht drejtohet nga ligji i të drejtës ndërkombëtare të autorit dhe marrëveshjet ndërkombëtare, kryesisht *Konventa e Bernës* dhe *Konventa Universale e të Drejtës së Autorit*.

#### **Ekran ndihmës** [*Help screen*]

Ekran ose ekrane të njëpasnjëshme në një katalog

online, bazë të dhënash bibliografike ose program tjetër aplikimi, që jep udhëzime për përdoruesit, të cilët kërkojnë ndihmë për të mësuar si të përdorin sistemin.

#### **Eksport** [*Export*]

Dërgim i të dhënave në format digjital nga një aplikim apo sistem kompiuterik te një tjetër, zakonisht nëpërmjet një komande të veçantë. Për shembull regjistrime bibliografike që gjenden në një katalog në rrjet ose bazë të dhënash dërgohen në një adresë elektronike (e-mail) apo mjedis për ruajtje (zakonisht disk). Procesi i eksportit mund të kërkojë konvertim të të dhënave në një format të përshtatshëm me aplikimin apo sistemin që i merr. Shumica e aplikimeve kanë aftësi të konvertojnë formate të ndryshme. Është e kundërta e *import*.

#### **Elemente të dhënash me gjatësi të përcaktuar** [*Fixed length data element*]

Fusha 008 në formatin MARC që përmban 40 karaktere, të cilat përdoren për informacion të koduar në bazë të kriterëve të caktuara për identifikim dhe gjetje, p. sh. materiale me format të madh shtypi, të botuara në një gjuhë të caktuar ose vend të caktuar, apo të destinuara për një kategori të caktuar përdoruesish.

#### **Emër** [*Forename*]

Emri që paraprin mbiemrin e një personi (emrin e familjes) i vënë pas lindjes për të dalluar personin nga persona të tjerë të të njëjtës familje. Në katalogim, në kryetitull emri vendoset pas mbiemrit i ndarë me presje dhe hapësirë.

#### **Emër gjeografik** [*Geographic name*]

Emri i përdorur për të identifikuar një pozicion të caktuar gjeografik, apo zonë, e preferuar nga kataloguesit si element kërkimi, duke vendosur një formë të saktë të tij, jo domosdoshmërisht të njëjtë me emrin politik (p.sh Francë në vend të Republika Franceze).

#### **Emër skedari** [*Filename*]

Emër i shkurtër i dhënë një skedari të dhënash nga programuesi ose përdoruesi i kompiuterit për ta identifikuar dhe gjetur atë kur të kërkohet në të ardhmen. Emrat e skedarëve zakonisht janë çelës i përmbajtjes së skedarit. Tri ose katër shkronjat e



shtuara në fund të emrit tregojnë llojin e skedarit (p.sh. **.txt** ose **.html**. **.txt** është për një skedar në ASCII ose **.html** për një skedar në Hypertext Markup Language).

## **Etika e informacionit** [*Information ethics*]

Degë e etikës që përqendrohet në marrëdhëniet ndërmjet krijimit, organizimit, shpërndarjes dhe përdorimit të informacionit dhe standardeve etike dhe kodeve të moralit që rregullojnë sjelljen e njeriut në shoqëri.

## **Etiketë e fushës** [*Field label*]

Shkurtim, fjalë ose frazë që shfaqet në një regjistrim të një baze të dhënash bibliografike apo katalogo online, zakonisht me shkronja italiane ose në formë tjetër të dallueshme, e vendosur në anën e majtë për të treguar kategorinë e të dhënave që vijojnë. P.sh. fjala *Burimi* e përdorur në bazën e të dhënave të periodikut për të treguar titullin e revistës, numrin e vëllimit, datën e botimit dhe numrin e faqeve të artikullit të indeksuar. Në regjistrimet në formatin MARC përdoret një targë numerike në vend të një etikete me tekst për të treguar një fushë të caktuar të regjistrimit.

## **Faqe e parë** [*Front page*]

Faqja e parë e seksionit të parë të një gazete që përmban titujt e ngjarjeve kryesore të ditës.

## **Faqja e nisjes, e fillimit** [*Homepage*]

Faqja e parë ose kryesore e një vendi virtual (site) në Internet, që shfaqet sa herë që përdoruesi lidhet me një shfletues të Web-it dhe hap një adresë virtuale (URL). Emri i skedarit në fund të adresës së faqes së fillimit shpesh është *home.html*, *index.html*, *main.html* ose diçka e ngjashme. Një faqe fillimi e ndërtuar mirë jep titullin e vendit virtual, emrin e autorit, datën e rifreskimit të fundit, njoftime për të drejtën e autorit, pasqyrën e lëndës dhe lidhjet me faqet pasardhëse që japin informacion më të hollësishëm për site-in; zakonisht është pika më e mirë e nisjes për lundrimin në një site për herë të parë.

## **Fashikull** [*Fascicle*]

Për lehtësi në botim ose shtyp, një libër ose njësi tjetër ndonjëherë del pjesë-pjesë, të numëruara ose jo, çdonjëra prej të cilave është jo e plotë dhe nuk përputhet domosdoshmërisht me ndonjë

ndarje formale të veprës. Fashikujt zakonisht dalin me mbështjellëse letre dhe mund të lidhen bashkë përfundimisht, të renditur në vijimësi për të formuar një vëllim të plotë ose një komplet uniform vëllimesh. Ndryshojnë nga pjesët pasi janë të përkohshëm dhe jo të përhershëm.

## **Faturë** [*Invoice*]

Dokument ose formular i dërguar nga shitësi të blerësi ku tregohet numri i porosisë, lloji, sasia, çmimi, koha e shitjes, mënyra e dërgimit, kosto e transportit dhe shuma e përgjithshme për njësitë e dërguara ose shërbimet e kryera. Bibliotekat e kërkojnë faturën përpara kryerjes së pagesës.

## **Federata Ndërkombëtare e Shoqatave dhe Institucioneve bibliotekare** [*International Federation of Library Associations and Institutions (IFLA)*]

Federatë ndërkombëtare joqeveritare e pavarur e shoqatave bibliotekare, bibliotekave dhe institucioneve që kanë lidhje me to; IFLA është krijuar në vitin 1927 nga 15 vende si Komiteti Ndërkombëtar Bibliotekar dhe Bibliografik për të nxitur bashkëpunimin, komunikimin dhe studimet në bibliotekonomi. IFLA ka një strukturë demokratike, në të cilën organi më i lartë është Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve. Sekretariati i Përgjithshëm është i vendosur me seli në Hagë dhe konferenca vjetore zhvillohet çdo vit në vende të ndryshme anëtare.

## **Fibër optike** [*Fiber optics*]

Transmetues me shpejtësi të madhe i të dhënave të koduara në impulse rrezesh lazer përmes kabllit të prodhuar me fibër optike. Kjo teknologji revolucionarizoi industrinë e telekomunikimit në fund të shekullit XX, duke mundësuar lidhjen në rrjet botëror të kompjuterave të mëdhenj e të vegjël.

## **Filmografi** [*Filmography*]

Listë filmash, zakonisht e kufizuar në vepra të një drejtori ose interpretuesi të caktuar, të një zhanri të caktuar, të një periudhe kohe ose të një vendi, ose për një subjekt të caktuar. Zakonisht renditen alfabetikisht sipas titullit ose kronologjikisht sipas vitit të daljes. Zërat në filmografi përmbajnë disa ose të gjitha elementet e mëposhtme të përshkrimit: prodhuesin, shpërndarësin, drejtorin,

aktorët pjesëmarrës, datën e daljes, kohëzgjatjen e xhirimit, gjuhën, ngjyrat apo bardh-e-zi etj.

#### **Filtër** [*Filter*]

Program kompiuteri i krijuar për të lejuar vetëm disa të dhëna të kalojnë te përdoruesi dhe bllokojnë aksesin në disa të dhëna të tjera. P.sh. fëmijët nuk lejohen të përdorin web site që përbajnë materiale të dhunshme.

#### **Fjalë kyç** [*Keyword*]

Fjalë ose frazë domethënëse në titull, emërtimet lëndore, shënimet e përbajtjes, në abstrakt ose në tekstin e një regjistrimi të katalogut online ose një baze të dhënash bibliografike, e cila mund të përdoret si term kërkimi në kërkimin në tekst për të gjetur të gjitha regjistrimet që e përbajnë atë fjalë. Shumica e katalogëve online dhe e bazave të të dhënave bibliografike i japin mundësi përdoruesit të shtypë fjalë që përshkruajnë tematikën (pavarësisht nga renditja) dhe të gjejë regjistrimet që përbajnë termat e kërkimit në fushat e të dhënave që sistemi i ka përcaktuar për kërkim. Një e metë e kërkimit me fjalë kyç është se nuk merr parasysh kuptimin e fjalëve të përdorura për futje informacioni dhe nëse termi ka më shumë se një kuptim, regjistrimet e gjetura mund të jenë të papërshtatshme (përfundim i gabuar).

#### **Fjalor shpjegues, glosar** [*Glossary*]

Listë alfabetike termash të specializuar për një subjekt të veçantë ose fushë studimi, me përkufizime të shkurtra. Shpesh vendoset në fund të librit ose në fillim të një vepre referuese teknike. Fjalorët shpjegues të gjatë mund të botohen të veçantë. I referohet edhe një liste me sinonime ekuivalente në më shumë se një gjuhë.

#### **Fletë e shtuar** [*Insert*]

Material i shtypur si hartë, ilustrim, fletë abonimi e paplotësuar, shtojcë për reklamë etj., e vendosur në një libër ose periodik, e palidhur dhe jo pjesë përbërëse e botimit. I referohet edhe një fraze a paragrafi që i shtohet tekstit të bocave dhe që përfshihet në bocat e ripunuara përpara se libri të dërgohet për shtyp.

#### **Fletushkë, fletëpalosje, prospekt** [*Handout*]

Fletë e shtypur ose grup fletësh të kapura së bashku në një kënd, që zakonisht përgatiten për

t'u shpërndarë gjatë një prezantimi gojor ose sesioni mësimor, për t'u dhënë dëgjuesve një përmbledhje të materialeve ose informacion plotësues (të dhëna, shembuj, sugjerime për lexime plotësuese etj.).

#### **Forma e elementit hyrës** [*Form of entry*]

Fjalë të përdorura për formulimin e kryetitujve që shërbejnë si pika hyrëse në një katalog ose indeks, të formuar në bazë të rregullave të caktuara lidhur me numrin njëjës apo shumës, kohën e foljes, sintaksën, shenjat e pikësimit etj. Në shumë sisteme katalogimi dhe indeksimi forma e elementit hyrës për emrat (vetjak apo kolektiv), titujt dhe subjektet është subjekti i kontrollit të termave të njësuar.

#### **Forma e kompozimit** [*Form of composition*]

Forma strukturore e kompozimit të një vepre muzikore, e dhënë në zonën e shënimeve të regjistrimit bibliografik kur nuk është shprehur në titull ose në pjesë të tjera të përshkrimit bibliografik (koncert, fantazi, fugë, prelud, sonatë, variacione etj.).

#### **Format Shkëmbimi Grafik** [*Graphics Interchange Format GIF*]

Njëri prej dy formateve më të zakonshme të skedarëve të përdorura për ruajtjen e imazheve grafike të shfaqura në World Wide Web. Algoritmi i zhvilluar nga Unisys, **GIF** është i mbrojtur me anë të patentës përkatëse, por në praktikë kompania nuk u kërkon përdoruesve licencë. Varianti më i ri i **GIF** përmban ngjyra, figura në lëvizje dhe ngjeshje të të dhënave.

#### **Formë** [*Form*].

Term i përdorur në katalogimin bibliotekar për të treguar formën e renditjes së materialit në një libër (fjalor, enciklopedi, direktori, antologji), gjininë e një vepre letrare (roman, poezi, dramë etj.) ose të një kompozimi muzikor (koncert, simfoni, opera etj.).

#### **Furnizues i shërbimeve të Internet-it** [*Internet service provider (ISP)*]

Kompani që siguron akses në Internet për përdoruesit e kompiuterit që nuk kanë lidhje direkte, zakonisht përmes kanaleve të telekomunikimit, kundrejt një pagese të caktuar.

## **Futje e të dhënave** [*Input*]

Transferim ose futje e të dhënave në një sistem kompjuterik për përpunim, në kundërshtim me përfundimin e përpunimit të njohur si nxjerrje e rezultateve të përpunimit (output). Pajisjet më të zakonshme për futjen e të dhënave në kompjuterat personalë janë tastiera dhe mausi. Përdorim të gjerë po gjen dhe skaneri dhe përparime të ndjeshme po bëhen në teknologjinë e përpunimit dhe njohjes së zërit.

## **Gjetje** [*Hit*]

Në kërkimin e informacionit, regjistrim i gjetur në bazën e të dhënave që plotëson nevojën për informacion të shprehur në kërkesë. Termi ndonjëherë përdoret për një regjistrim që plotëson kërkesat sintaksore të pyetjes pa plotësuar kërkesat semantike (përfundim i gabuar), por ky është përdorim jo i saktë i termit. Përqindja e të gjitha regjistrimeve të gjetura në një kërkim që përshtaten me pyetjen quhet nivel i gjetjes.

## **Gjobë** [*Fines*]

Shumë biblioteka i ngarkojnë përdoruesit me një shumë të caktuar parash për çdo ditë vonese në kthimin e materialit të huazuar. Shuma mund të jetë në vartësi të llojit të materialit të huazuar. Gjyba mund të shmangët duke e shtyrë afatin e kthimit përpara mbarimit të tij. Sistemet e automatizuara të qarkullimit janë të programuara për të llogaritur automatikisht gjobën në rast vonese. Ato bëjnë dhe bllokimin e llogarisë së huazuesit kur gjyba e papaguar arrin një shumë të caktuar.

## **Gjuhë indeksimi** [*Indexing language*]

Gjuhë artificiale që përbëhet nga emërtime lëndore ose deskriptorë të përbajtjes, të zgjedhur për të lehtësuar kërkimin e informacionit, duke u përdorur si pika hyrëse në një katalog ose indeks, përfshirë edhe referime dhe rregulla lidhur me formën e elementit hyrës, sintaksën etj.

## **Hartë e skicuar veç** [*Inset map*]

Hartë e vogël e skicuar ose e shtypur brenda kornizës së një harte më të madhe, zakonisht për të treguar me hollësi veçori specifike ose pjesë më të zmadhuara, për shembull një zonë të madhe banimi brenda kufijve të një harte të shtetit ose provincës ku ajo bën pjesë.

## **Hartë ndërvepruese** [*Interactive map*]

Hartë në format digjital, e ndërtuar për t'i dhënë mundësi përdoruesit të përdorë një pjesë të saj në shkallë tjetër ose të ketë akses në informacion tjetër, zakonisht duke zgjedhur një zonë aktive në sipërfaqe të saj me anë të një pajisjeje treguese siç është mausi.

## **Higrometër** [*Hygrometer*]

Një nga instrumentet e shumë meteorologjikë për matjen e lagështisë së atmosferës. Higrometrat përdoren për të mbajtur nën kontroll kushtet e mjedisit në biblioteka dhe muze që mbajnë materiale që dëmtohen me lehtësi nga avujt e ujit (libra të rrallë, dorëshkrime, filma, mostra etj.).

## **Hipermedia** [*Hypermedia*]

Dokument hipertekst në të cilin teksti është i kombinuar me grafikë, zë, lëvizje të figurave dhe video.

## **Hipertekst** [*Hypertext*]

Mënyrë e paraqitjes së informacionit digjital duke mundësuar ndërlidhjen e skedarëve dhe të elementeve të të dhënave dhe jo shikimin në vijimësi lineare. Lidhjet në tekst dhe ikonat e futura në një dokument të shkruar me shkrim HTML japin mundësi që informacioni të shfletohet në mënyrë jolineare, por duke kaluar shpejt nga një pjesë në një tjetër, në mënyrë të ngjashme me funksionimin e trurit të njeriut, duke zgjedhur dhe klikuar me anë të shënjesit të mausit ose përmes tastierës së kompjuterit. Hiperteksti është parimi bazë i organizimit të rrjetit botëror World Wide Web.

## **Holograf, dokument në dorëshkrim** [*Holograph*]

Dokument i shkruar tërësisht me dorë nga personi (ose personat) të cilit i përket. Rishtypje holografike është riprodhim i një dokumenti të tillë me mjete mekanike. I referohet gjithashtu një imazhi tredimensional të një objekti të regjistruar në film me anë të interferencës së rrezeve lazer në një proces që quhet holografi.

## **HTML** [*Hypertext Markup Language (HTML)*]

Gjuhë simbolesh universale. Përdoret për të krijuar dokumente hipertekst të aksesueshme në Web dhe përmes rrjeteve private (intranet). HTML është



një gjuhë prezantimi në sisteme të ndryshme kompjuterash që i mundëson autorit të përfshijë në një faqe Web-i tekst, grafika, audio, video dhe lidhje me dokumente dhe aplikime të tjera. Formatimi kontrollonhet me anë të "tagave" të futura në tekst. Për të parë kodin HTML me të cilin është shkruar një faqe Web, klikoni në "View" ose ekuivalent të kësaj fjale në dritaren e ikonave në shfletuesin tuaj të Web-it dhe më pas zgjidhni "Document source" ose "page source".

**http:// Protokoll i transferimit të tekstit elektronik** [*http:// (Hyper Text Transfer Protocol)*]

Protokoll komunikimi i përdorur në programet e shfletuesve të Web-it për të vendosur lidhjen ndërmjet një kompjuteri klient dhe një serveri të Web-it në distancë, duke mundësuar që skedarët e të dhënave në format HTML të transmetohen përmes Internetit nga serveri te makina kliente ku është instaluar shfletuesi. Shumë shfletues të Web-it janë projektuar me prefiksën http:// të paracaktuar sa herë që përdoruesi hyn në një adresë Web-i (URL) pa këtë prefiks.

**Huazim ndërbibliotekar** [*Interlibrary loan (ILL)*]

Kur një libër ose njësi tjetër bibliotekare kërkohet nga një anëtar i bibliotekës, por është i huazuar nga një përdorues tjetër, nuk është i disponueshëm për arsye të tjera ose biblioteka nuk e ka, përdoruesi mund të kërkojë që të huazohet nga ndonjë bibliotekë tjetër duke plotësuar një formular të posaçëm për këtë shërbim, që përcillet në bibliotekën huadhënëse (me mënyrën tradicionale ose në formë elektronike përmes adresës në Web të bibliotekës tjetër). Ka biblioteka që në raste të veçanta i pranojnë kërkesat për huazim ndërbibliotekar me anë të postës elektronike ose me telefon. Për materialet e huazuara përmes këtij shërbimi, afati i përdorimit, kur është e nevojshme, duhet të shtyhet përpara mbarimit të kohë së caktuar. Huazimi ndërbibliotekar është një formë e ndarjes së burimeve që varet nga mirëmbajtja e katalogut përmbljedhës. Rrjeti më i madh i huazimit ndërbibliotekar në botë mirëmbahet nga OCLC, i cili përdor bazën e të dhënave WorldCat (Katalogu Botëror) si katalogun e tij përmbljedhës.

**Huazim ndërmjet bibliotekave të sistemit**

[*Intralibrary loan*]

Huazim i njësisve nga një bibliotekë te një tjetër brenda të njëjtit sistem bibliotekar, ose drejtpërdrejt te përdoruesi i një bibliotekë tjetër që bën pjesë në të njëjtin sistem, kundrejt kërkesës. Ky shërbim zakonisht është më i shpejtë nga huazimi ndërbibliotekar, nëse sistemi ka shërbimin e vet të dërgimit. Në disa katalogë online përdoruesi mund t'i kryejë vetë veprimet pa ndihmën e punonjësit të bibliotekës.

**Hyrye, portë, kalim** [*Gateway*]

Program kompjuteri që i mundëson përdoruesit të aksesojë përmes rrjetit të dhëna të depozituara në një server. I referohet edhe një pajisjeje hardware që lidh dy rrjete të veçanta, duke krijuar një rrugë kalimi për transferimin e të dhënave që përdorin protokolle të ndryshme, p. sh. lidh dy sisteme të ndryshme të postës elektronike për të mundësuar transferimin e mesazheve nga njëri sistem te tjetri.

**I brejtur** [*Gnawed*]

Libër që ka shenja të brejtjes nga dëmtues në anë ose në kënde, gjendje që e ul në mënyrë të ndjeshme vlerën e librit në tregun e librave të përdorur dhe e bën atë kandidat për ta spastruar nga biblioteka.

**I pakthyeshmë** [*Irreversible*]

Ndryshim në gjendjen kimike ose fizike të një njësie, që nuk mund të zhbëhet, për shembull një shenjë pronësie e stampuar me gdhendje ose biosjpe në një libër. Në proceset e konservimit kthyeshmëria është gjendje e trajtimit dhe materialeve, pasi gjendja origjinale ka vlera dëshmuere ose historike.

**Identifikues** [*Identifier*]

Fjalë kyç ose koncept i indeksueshmë që i vihet një dokumenti për indeksim lëndor më të detajuar. Nuk është e renditur në tezaurin e termave të indeksit sepse ose nuk paraqet një emër tipik (emër gjeografik, emër vetjak, emër programi, pjesë legjislativore etj.) ose koncepti nuk është ende i miratuar si emërtim i njësuar. Zakonisht identifikuesit renditen në një fushë të veçantë të zërave të indeksit ose të regjistrimit bibliografik, menjëherë pas emërtimeve lëndore. Identifikuesit kryesorë mund të shënohen me yllth ose të dallohen me ndonjë mënyrë tjetër. Forma e tij mund të jetë subjekt i kontrollit të termave të njësuar.

Në disa sisteme indeksimi identifikuesit rishikohen në mënyrë të herë pas hershme për t'u përshtatur me emërtimet e reja lëndore. Jo të gjitha sistemet e indeksimit përdorin identifikues.

## **Ideogramë** [*Ideogram*]

Figurë ose simbol që paraqet një objekt ose ide pa e shprehur me zë, p.sh. karakteret e përdorura në sistemet e shkrimit në gjuhën kineze dhe japoneze. I referohet edhe një simboli që paraqet një ide, p.sh. shenja e barazimit = ose shenja e plusit +.

## **Ikonë** [*Icon*]

Element grafik i vogël ose simbol i shfaqur në ekranin e kompiuterit, të cilin përdoruesi e zgjedh me anë të një mjetei shënjes, siç është mausi, për të thirrur një menu me alternativa për zgjedhje, për akses në një skedar të dhënash ose për të filluar një proces ose veprim në një program zbatimi që përdor ndërfaqe grafike për përdoruesin (GUI), p.sh. një imazh i vogël i një koshi plehrash ose për riqarkullim, në të cilin hidhen dokumente që nuk duhen. I referohet edhe një pikturë, imazhi, figurë ose prezantimi.

## **Ilustrim** [*Illustration*]

Pikturë, skicë, plan, hartë, grafik ose imazh tjetër grafik, i shtypur së bashku me tekstin, ose i përfshirë në tekstin e një libri ose botimi tjetër si zbukurim ose për të plotësuar apo sqaruar tekstin. I referohet dhe artit të krijimit të veprave vizuale. Shembujt më të hershëm të teksteve të ilustruara i përkasin mijëvjeçarit të dytë. Dorëshkrimet e Mesjetës janë ilustruar me miniatura. Librat e parë të shtypur janë ilustruar me pllaka druri të gdhendur. Të librat modernë ilustrimet zakonisht janë të numërtuara. Fotot ose portretet mund të shtypen me letër të ndryshme nga ajo e tekstit dhe i shtohen librit në një ose më shumë grupe. Në përshkrimin bibliografik pasqyrohet me shkurtimin *il*.

## **Indeks i fjalëve kyç** [*Keyword index*]

Lloj indeksi lëndor në të cilin janë përdorur si zëra fjalë të rëndësishme (domethënëse) të titujve të veprave të indeksuara.

## **Indeksi i Librave të Ndaluar** [*Index Librorum Prohibitorum*]

I përgatitur në vitin 1558 me kërkesë të Papës

Pavli IV. E botuar në vitin 1559, lista përfshinte vepra të cilat ishin të ndaluara të zotëroheshin ose lexoheshin nga katolikët, sepse autoritetet kishtarë e konsideronin të dëmshëm për besimin dhe moralin, pasi përmbanin mësim të cilësuar heretike. E njohur gjithashtu me emrin Index Expurgatorius, lista nuk u shfuqizua nga Vatikani deri në vitin 1966.

## **Industri e informacionit** [*Information industry*]

Term i gjerë që përfshin kompanitë dhe individët që merren me sigurimin e informacionit dhe aksesin në informacion për qëllime përfitimi, përfshirë masmedian, botuesit komercialë, prodhuesit dhe shitësit e programeve dhe bazave të të dhënave, shërbimet e indeksimit dhe abstrakteve dhe shpërndarësit e pavarur të informacionit. Bibliotekat publike, akademike dhe shumë lloje të bibliotekave speciale funksionojnë jashtë industrisë së informacionit sepse ato punojnë jo mbi bazë të përfitimit.

## **Informacion** [*Information*]

Mesazh i përqeshëm për t'u përdorur në një mjedis komunikimi ose pasqyrimi. Nëse një mesazh i caktuar është informues ose jo, kjo varet pjesërisht nga perceptimi subjektiv i personit që e merr atë. Më konkretisht, të gjitha faktet, konkluzionet, idetë dhe veprat krijuese të mendjes dhe imagjinatës së njeriut, të cilat komunikohen formalisht ose jo, në çdo formë.

## **Informatikë** [*Informatics*]

Studim formal i informacionit, përfshirë strukturën e tij, vetitë, përdorimet dhe funksionet në shoqëri, veçanërisht teknologjinë e përdorur për të regjistruar, organizuar, ruajtur, kërkuar, gjetur dhe shpërndarë atë.

## **Infrastrukturë** [*Infrastructure*]

Term përmbledhës që përfshin të gjithë komponentët që mbështesin një veprimtari të caktuar, veçanërisht sistemet dhe strukturat e përhershme që përbëjnë bazën e saj. Në teknologjinë moderne të informacionit janë të gjitha pajisjet (hardware) dhe programet (software) të zhvilluar dhe mirëmbajtur për të mbajtur sistemin e komunikimit (të madh ose të vogël) në gjendje të mirë pune.

**Inkunabul** [*Incunabula*]

Nga fjala latine *cunae* që do të thotë "djep" ose "fillim". Librat, broshurat, kalendaret etj., të shtypur në Europë që nga shpikja e shtypshkronjës deri në vitin 1500. Shembull i parë është Bibla e Gutenbergut, që mendohet të jetë shtypur në Mainz-Gjermani para vitit 1456 nga Johann Gutenberg, i cili njihet si shpikësi i shtypit me shkronja metalike të lëvizshme.

**Integrim formati** [*Format integration*]

Koncept në katalogimin bibliotekar të kompiuterizuar ku përdoren të njëjtat fusha, nënfusha dhe treguesit e përbajtjes (targa, indikatorë dhe kode nënfushash) në përshkrimin bibliografik, pavarësisht nga formati, për të regjistruar të dhëna të të njëjtit lloj, në vend të përdorimit të kodeve të ndryshme sipas llojit të materialit. Për shembull, në formatin MARC fusha 245 përmban titullin e veprës, pavarësisht nëse është libër, partiturë muzikore, videokasetë etj.

**Internet Kafe** [*Internet Café*]

Biznes i vogël që shet kafe, pije dhe ushqime të lehta dhe ofron pajisje kompiuterike dhe akses në Internet për përdoruesit gjatë ngrënies, pa pagesë ose kundrejt një pagese të arsyeshme. Biblioteka akademike dhe publike instalojnë pajisje të tilla në mjediset e tyre dhe lejojnë përdoruesit të lexojnë postën elektronike pa zënë pajisjet në mjediset të tjera, të nevojshme për kërkime bibliotekare.

**Intranet, rrjet i brendshëm** [*Intranet*]

Website i brendshëm, i krijuar për t'u përdorur vetëm nga punonjësit e organizatës, institucionit apo të ndërmarrjes tregtare. Intranet-et përdorin TCP/IP dhe protokolle Hypertext të njëjta me ato të Internet-it, por aksesit është i lejueshëm vetëm për përdoruesit e autorizuar, ndërsa për përdorues të paautorizuar është i bllokuar me mur mbrojtës.

**Jashtë tekstit** [*Hors texte*]

Frazë franceze me kuptim "outside the text", që u referohet ilustrimeve të shtypura jashtë tekstit. Këto fletë zakonisht numërohen me numra romakë për t'u dalluar nga ilustrimet e shtypura brenda në tekst, të cilat janë të numërtuara me numra arabë ose i referohen numrit të faqes.

**Java** [*Java*]

Gjuhë programimi e nivelit të lartë e përdorur gjerësisht për programe aplikimi klient-server për World Wide Web-in. E prezantuar në vitin 1995 nga kompania Sun Microsystems, Java i mundëson programet të punojnë në shfletues Web-i pavarësisht nga platforma (Windows, Macintosh ose UNIX), duke shmangur nevojën e shkrimit të varianteve për platforma specifike të të njëjtit program.

**Jo i saktë** [*Imperfect*]

Libër që pas kontrollit rezulton me mungesë faqesh ose fashikujsh, me dublime ose lidhje me renditje të çrregullt të faqeve.

**Katalog i ngrirë** [*Frozen catalog*]

Katalog i bibliotekës në të cilin nuk shtohen regjistrime të reja bibliografike dhe nuk hiqen regjistrimet ekzistuese edhe kur bëhen ndryshime ose korrigjime, ose regjistrimet ekzistuese janë konvertuar në format të lexueshëm nga kompiuteri.

**Kërkesat funksionale për Regjistrimet Bibliografike** [*Functional Requirements for Bibliographic Records (FRBR)*]

Një grup elementesh themelore që përbëjnë bazën teorike të regjistrimeve të krijuara nga kataloguesit për të prezantuar njësitë e një koleksioni bibliotekar. FRBR është zhvilluar nga një grup studimi i IFLA-s në përgjigje të rezolutës së miratuar në seminarin e Stokholmit në vitin 1990 për regjistrimet bibliografike, ku bëhej thirrje për një përshkrim të qartë të funksioneve të regjistrimit bibliografik në lidhje me median, zbatimet dhe kërkesat e përdoruesve. FRBR nuk ka të bëjë vetëm me përshkrimin bibliografik, por dhe me pikat hyrëse, elementet e organizimit (klasifikimin) dhe adnotimet. Në vitet pas botimit të *International Bibliographic Description for Monographic Publications* (1971) (Përshkrimi Bibliografik Ndërkombëtar i Botimeve Monografike) kanë ndodhur ndryshime të mëdha në mjedisin ku operojnë parimet dhe standardet e katalogimit, si p. sh. zgjerimi i sistemeve të automatizuara, zhvillimi në një shkallë të lartë i bazave të të dhënave bibliografike nga ana e agjencive bibliografike kombëtare dhe emergjenca e aksesimit në rrjet të informacionit elektronik



dhe formave të reja të botimeve elektronike, të cilat kanë rritur presionin mbi kataloguesit për të ulur koston duke realizuar katalogime të nivelit minimal. Këto ndryshime e bëjnë të nevojshëm riezaminimin tërësor të teorisë së katalogimit. Në studimin e FRBR grupi i studimit ka përdorur analizën e entitetit, një teknikë për ndërtimin e modeleve konceptore të bazave të të dhënave relative, për të krijuar një model të bazuar në tre elementë bazë: entitetet me interes për përdoruesit e regjistrimeve bibliografike, atributet e çdo entiteti dhe lidhjet midis entiteteve.

## **Kërkim dhe gjetje e informacionit** [*Information retrieval (IR)*]

Procesi, mënyrat dhe procedurat që përdoren për të marrë në mënyrë të përzgjedhur informacionin e regjistruar në një skedar të dhënash. Në biblioteka dhe arkiva kërkimet rëndom kryhen për një njësi të njohur ose për informacion rreth një subjekti të caktuar dhe skedari është zakonisht katalog ose indeks i lexueshëm, ose informacionin e ruajtur në kompiuter dhe me sistem kërkimi, si p.sh. katalog online ose bazë të dhënash bibliografike. Në krijimin e këtyre sistemeve duhet mbajtur një barazpeshë ndërmjet shpejtësisë, saktësisë, koston dhe efektivitetit.

## **Kërkim në tekst** [*Full-text search*]

Kërkim në një bazë të dhënash bibliografike në të cilën mund të kërkohet sipas çdo fjale të tekstit të regjistrimit ose dokumentit, nëse termat e përfshirë në shprehjen e kërkimit janë të pranishëm. Shumica e motorëve të kërkimit në Web janë ndërtuar për të realizuar kërkime në tekst. Kjo mund të krijojë problem për përdoruesin kur termi i kërkimit ka më shumë se një kuptim, duke paraqitur informacion që nuk ka lidhje me pyetjen e kërkimit.

## **Kërkim parësor** [*FirstSearch (FS)*]

Shërbim i OCLC që mundëson akses në rreth 50 baza të dhënash bibliografike të shumë disiplinave përmes ndërfaqes së pronësisë, në bazë të abonimit dhe të marrëveshjeve të licencimit. Disa nga bazat e të dhënave në *FirstSearch* janë me tekst të plotë. Katalogu më i madh përmblidhës botëror *WorldCat* mund të përdoret përmes këtij shërbimi.

## **Kërkim për njësi të njohur** [*Known-item search*]

Kërkim në bibliotekë për një vepër të caktuar, në kundërshtim me kërkimin e ndonjë veprë të një autori të njohur, apo kërkim për vepra për një subjekt të caktuar. Kur dihet titulli i veprës, mënyra më e lehtë për ta gjetur është kërkimi me titull në katalogun e bibliotekës ose në bazën e të dhënave bibliografike. Kur përdoruesi nuk është i sigurt për saktësinë e fjalëve të titullit, rruga më e mirë për kërkim mund të jetë kërkimi sipas emrit të autorit. Kur dihen me saktësi 2-3 fjalë të titullit mund të përdoret kërkimi me fjalë kyç.

## **Koleksion për të rinj** [*Juvenile collection*]

Koleksion bibliotekar me libra dhe materiale të tjera i zgjedhur posaçërisht për fëmijë nën moshën 12-13 vjeç dhe të sistemuar veç nga koleksionet bibliotekare për të rritur. Vendosen në sallën e shërbimit të fëmijëve, të organizuar në seksione sipas përmbajtjes dhe veç nga librat për fëmijë të vegjël (si p.sh. librat për alfabetin, për numrat, për veshjen, librat me figura etj.). Koleksionet e fëmijëve zakonisht menaxhohen nga bibliotekarë me trajnim të posaçëm për shërbimet ndaj fëmijëve.

## **Koleksion shumë i rrezikuar** [*High-risk collection*]

Koleksion bibliotekar ose arkivor për të cilin mundësia e vandalizmit ose vjedhjes është e madhe si rezultat i vlerës së veçantë (libra të rrallë) ose të përmbajtjes (koleksione speciale). Merren masa të forta sigurie veçanërisht kur këto njësi vendosen në ekspozita.

## **Kompiuter bartës** [*Host*]

Kompiuter që shërben si burim të dhënash për terminale ose kompiutera të tjerë, për shembull një kompiuter qendror që furnizon me skedarë terminalet që janë të lidhur drejtpërdrejt me të, ose një server i rrjetit që aksesohet nga makinat kliente. I referohet edhe një organizmi ose institucioni që ka server në të cilin është instaluar një Web site (vend virtual në Web), që zakonisht tregohet me adresën e tij të Internetit.

## **Kopje me kushtim, dedikim** [*Inscribed copy*]

Kopje e një libri që mban, si dhuratë me dedikim, emrin e marrësit dhe ndonjëherë edhe koment ose shënim, të shoqëruar me firmën e dhuruesit që mund të jetë autori. Dedikimi zakonisht shkruhet në fletën e bardhë në fillim të librit.

**Kopje në letër** [*Hard copy*]

Kopje e shtypur e një dokumenti ose regjistrimi që ekziston edhe në format të lexueshëm nga kompiuteri (digjital, mikroformë etj.). Përdoret edhe në kuptim më të gjerë për materiale të shtypur në letër, në dallim nga ato të pashtypur.

**Lagështi** [*Humidity*]

Sasia e avujve të ujit në ajër. *Lagështi absolute* është masa e avullit të ujit në një vëllim të caktuar ajri, zakonisht e shprehur me gram ujë për metër kub ajër. *Lagështi relative* është shkalla e sasisë së avullit të ujit të pranishëm në një vëllim të caktuar ajri ndaj sasisë së duhur për të arritur ngopjen në të njëjtën temperaturë, e shprehur si përqindje. Lagështia relative ndryshon në varësi të temperaturës dhe presionit të ajrit – ajri i ngrohtë mund të mbajë më shumë avuj uji se ajri i ftohtë. Lagështia relative 40 % konsiderohet e përkryer për ruajtje afatgjatë të materialeve bibliotekare dhe arkivore prej letre. Myku mund të përbëjë problem serioz kur lagështia relative kalon mbi 70%. Të lagështosh do të thotë të fusësh lagështi në atmosferë me anë të një pajisjeje që quhet lagështues për të shmangur që dokumentet prej letre të bëhen të thyeshëm. Çlagështimi ose tharja heq lagështinë nga atmosfera. Kjo bëhet me anë të agjentëve tharës për të shmangur mykun dhe deformimin. Lagështia kontrollohet rregullisht me anë të një instrumenti të quajtur higrometër, veçanërisht aty ku ruhen materialet arkivore dhe koleksionet speciale.

**Lartësi** [*Height*]

Përmasë e librit, ose e një njësie tjetër të lidhur, nga kreu deri në fund, zakonisht më e madhe nga gjerësia. Në katalogimin bibliotekar, lartësia e njësisë jepet në centimetra në zonën e përshkrimit fizik. Në disa biblioteka librat mbi një lartësi të caktuar quhen me format të madh dhe sistemohen në rafta të veçanta.

**Lexime ndihmëse** (të rekomanduara) [*Further reading*]

Bibliografi burimesh të dhëna nga një autor në dobi të lexuesve me dëshirën për të zgjeruar dijet e tyre lidhur me subjektin që trajtohet në veprën tek e cila bashkangjitet.

**Libër i huaj** [*Foreign book*]

Term që përdoret në pasurim për librat e botuar jashtë shtetit.

**Libër me cilësi të lartë, i shkëlqyer** [*Fine book*]

Libër me cilësi të jashtëzakonshme për sa i përket kompozimit, shtypit, ilustrimeve dhe lidhjes, shpesh kopje e një botimi luksi. Zakonisht këto libra shiten nga shitës të antikuaeve dhe në ankande. Bibliotekat i ruajnë në koleksione speciale.

**Libër me kapak të trashë** [*Hardcover*]

Libër i lidhur me kapak të papërkulshëm, zakonisht të mbuluar me rrobë, letër, material plastik, lëkurë ose material tjetër i qëndrueshëm, në dallim nga një libër i lidhur me kapak prej materiali të përkulshëm. Në shtypin modern, një titull i ri zakonisht del në fillim me kapak të trashë dhe më pas me kapak të hollë, kur bie shitja e kopjeve. Sinonim me *cloth bound*, *hardback* dhe *hardbound*.

**Libër udhërrëfyes** [*Guidebook*]

Doracak që jep informacion të dobishëm aktual për turistët rreth një qyteti, shteti, rajoni ose zone tjetër gjeografike, ose për vizitorët e një muzeu, parku, vendi historik etj.

**Lidhje e riprodhuar, e kopjuar** [*Facsimile binding*]

Lidhje që synon të përsërisë sa më afër që të jetë e mundur lidhjen e një botimi të mëparshëm të të njëjtës vepër, ose një stil të hershëm të lidhjes, tipik për periudhën kur është botuar vepra për herë të parë.

**Lidhje me dorë** [*Hand-binding*]

Arti i libërlidhjes me dorë pa ndihmën e mjeteve të mekanizuara. Dorëshkrimet e Mesjetës dhe librat e parë të shtypur janë lidhur me dorë me kapakë të mbuluar me lëkurë. Sot lidhja me dorë është kufizuar vetëm për libra me cilësi shumë të lartë.

**Legjislacioni i informacionit** [*Information law*]

Rregullimi dhe kontrolli i informacionit nga ana e shtetit, përfshirë ligjet për censurimin, të drejtën e autorit dhe pronësinë intelektuale, falsifikimet,

lirinë e informacionit, lirinë intelektuale, fshtësinë, krimet kompiuterike dhe fondet publike për furnizuesit me informacion siç janë bibliotekat dhe muzetë. I referohet edhe një dege të specializuar të studimeve ligjore që ka të bëjë me rregullimin e informacionit.

## **Liri intelektuale** [*Intellectual freedom*]

E drejta e çdo individi të lexojë dhe të shprehë pikëpamjet e tij.

## **Listë e botimeve të reja** [*Frontlist*]

Listë e përgatitur nga botuesit ku përfshihen të gjithë librat e rinj që janë botuar ose do të botohen në sezonin më të afërt.

## **Listë e gjetjeve, e përfundimeve** [*Finding list*]

Listë e materialeve bibliotekare e përfuar pas një kërkimi, ku çdo njësi paraqitet me përshkrim shumë të shkurtër të informacionit bibliografik (zakonisht emrin e autorit, titullin dhe numrin e vendit në bibliotekë).

## **Literaturë gri** [*Gray literature*]

Vepra të shtypura si raporte, dokumente për përdorim të brendshëm, disertacione, teza për master dhe punime të konferencave, që zakonisht nuk janë të disponueshme përmes kanaleve të zakonshme tregtare, sepse nuk botohen për qëllime komerciale dhe nuk kanë çmim. Për shpërndarjen dhe kontrollin bibliografik të tyre përdoren mënyra të tjera, në përgjigje të kërkesave të bibliotekave për ruajtjen dhe aksesin e këtyre materialeve.

## **Material i përzier** [*Kit*]

Komplet materialesh udhëzuese të më shumë se një lloji, të krijuara për t'u përdorur së bashku dhe ku asnjë nga llojet e materialeve nuk është predominues. Materialet e përziera zakonisht vendosen në kuti apo mbajtës për t'u ruajtur të gjitha pjesët së bashku. Sinonim me *njësi multimedia (multimedia item)*. Në AACR2 në këtë kategori përfshihen edhe njësi që janë paketa me një lloj material në formë teksti, si p.sh. një komplet fletushkash të një veprimtarie.

## **Material grafik** [*Graphic*]

Paraqitje dydimensionale jo në formë teksti. Materialet grafike mund të jenë opakë (ilustrime,

fotografi, diagrama, harta, grafikë etj.) ose të prodhuara për t'u parë ose projektuar me ndihmën e një pajisjeje optike (slajde, shirit filmi etj.). Revistat dhe librat e artit zakonisht përmbajnë sasi të madhe materialesh grafike.

## **Material jetëshkurtër** [*Fugitive material*]

Botime si p.sh. pamflete, pllakate, programe shfaqjesh dhe ekspozitash, të prodhuara në sasi të vogël dhe me interes të momentit, me interes lokal dhe të përkohshëm. Për pasojë janë të vështira për t'u mbledhur dhe kataloguar nga bibliotekat.

## **Mbingarkesë informacioni** [*Information overload*]

Gjendje në të cilën për një subjekt është e disponueshme një sasi shumë e madhe informacioni, dukuri e zakonshme në kërkimin online, veçanërisht kur pyetja shprehet me terma me kuptim të gjerë. Në këto raste janë të nevojshme sistemet që lehtësojnë kërkimin e burimeve me cilësi të lartë, duke mënjeluar informacionin pa vlerë. Ndërkohë, vetë përdoruesit e informacionit duhet të zhvillojnë aftësitë e tyre analizuese dhe kritike.

## **Menaxhim i informacionit** [*Information management*]

Ushtrim profesional i kontrollit rreth pasurimit, organizimit, ruajtjes, sigurimit, kërkimit e gjetjes dhe shpërndarjes së burimeve të informacionit që janë themelore për veprimtari të suksesshme të biznesit, agjencive, organizatave, institucioneve, ku përfshihet dokumentacioni, menaxhimi i regjistrimeve dhe infrastruktura teknike.

## **Komunikim i çastit** [*Instant messaging (IM)*]

Koha reale gjatë të cilës një sistem kompiuterik u jep mundësi dy ose më shumë personave të "bisedojnë" online përmes Internetit. I mundëson përdoruesit të shtojë emrin e një personi tjetër në listën e personave që bashkëbisedojnë dhe ai të marrë menjëherë njoftimin kur futet në rrjet. Sesioni i bisedimit fillohet duke shtypur një mesazh në një dritare të caktuar ose në "dhomën e bisedave" të krijuar nga programi (software) IM. Mesazhi shfaqet pothuaj menjëherë në ekranin e çdo personi të përfshirë në listë dhe marrësi mund të përgjigjet menjëherë duke shkruar një mesazh. Shumica e



sistemeve IM janë projektuar që të japin sinjal dëgjimor sa herë transmetohet ose merret një mesazh. Disa sisteme i japin mundësi përdoruesit të ndryshojë skedarët e të dhënave, të sinkronizojë shfletimin në Web, të dërgojë imazhe dhe video dhe të luajë në kompiuter. Komunikimi i çastit përdoret në biblioteka për të dërguar shërbime referuese elektronike te përdoruesit në largësi dhe te personat që parapëlqejnë shërbimin online.

#### **Mjediset e bibliotekës (në ... )** [*In-house*]

U referohet proceseve që kryhen brenda ndërtesës së bibliotekës, zakonisht nga punonjësit e saj dhe jo jashtë bibliotekës nga ndonjë kontraktues i pavarur, për shembull lidhja e koleksioneve e kryer në bibliotekë dhe jo dërgimi i tyre në një agjenci tregtare për lidhje jashtë institucionit.

#### **Mjet ndihmës kërkimi** [*Finding aid*]

Udhëzues i botuar ose jo, inventar, indeks, regjistër, listë ose sistem tjetër për kërkimin dhe gjetjen e materialeve burimore parësore arkivore. Për çdo njësi përmbajnë përshkrim më të hollësishëm nga ai që kanë zakonisht regjistrimet e një katalogu biblioteke. Mjetet e kërkimit ekzistojnë edhe në formë jo të shtypur (ASCII, HTML, etj.)

#### **Mjet kërkimi** [*Finding tool*]

Term i përgjithshëm për një burim, i hartuar për t'u përdorur në bibliotekë për gjetjen e burimeve të informacionit, zakonisht në kërkimet sipas autorit, titullit, subjektit ose fjalëve kyçe. Në këtë kategori përfshihen katalogët, bibliografitë, indekset, abstraktet, bazat e të dhënave bibliografike etj. Termi korrespondues në arkiva është *finding aid*.

#### **Mur mbrojtës** [*Firewall*]

Kompiuter i posaçëm që funksionon si kufi sigurimi, duke bllokuar trafikun nga njëra anë e një rrjeti tek ana tjetër, zakonisht gjatë transmetimit të të dhënave nga një rrjet më i madh në një rrjet lokal. Muret mbrojtëse instalohen për të kufizuar aksesin në rrjete kompiuterike private ose skedarë në pronësi (të patentuar), duke ekzaminuar trafikun hyrës dhe duke penguar aksesin e përdoruesve të paautorizuar. Ata ndihmojnë gjithashtu për të penguar rrjedhjen e informacionit sekret.

#### **Ndërmjetës** [*Intermediary*]

Person ose program që funksionon ndërmjet përdoruesit dhe sistemit të kërkimit bibliografik online për të ndihmuar në zgjedhjen e bazës së të dhënave, vendosjen e lidhjeve të telekomunikimit, formulimin e pyetjeve të kërkimit me sintaksë të rregullt dhe vlerësimin e përkatësisë së informacionit të gjetur. Kërkimi me ndërmjetës zbatohet sipas kërkesës kryesisht në bibliotekat akademike nga bibliotekari i shërbimit të publikut, i cili është i kualifikuar në shërbimet online.

#### **Ndërprerje** [*Gap*]

Shenjë në një regjistrim të katalogut të serialeve të një biblioteke ose të një katalogu përmbledhës që tregon mungesë të numrave në vijimësinë e koleksionit që ka biblioteka. Kjo ndodh kur abonimi është ndërprerë dhe më pas ka vijuar përsëri, ose kur numra të veçantë kanë humbur ose janë dëmtuar nga përdoruesit. Zakonisht bibliotekat bëjnë përpjekje t'i plotësojnë mungesat e numrave të periodikut me anë të mikrofilmimit, kur teksti i plotë nuk është i disponueshëm online.

#### **Ndërshtënie** [*Interpolation*]

Informacion i shtuar në përshkrimin bibliografik të një njësie nga kataloguesi dhe që nuk duket qartë në vetë njësinë, për shembull numri i faqeve në një libër me faqe të panumërtuara, ose një datë botimi që nuk jepet në njësi, por besohet e saktë bazuar në kërkimet e kryera. Në përshkrimin bibliografik, ndërshtëniet vendosen në kllapa katrore (p.sh. [56] f., ose [1974?]).

#### **Ndërveprues-e** [*Interactive*]

Ndërfaqe kompiuteri e ndërtuar për t'u përgjigjur futjes së të dhënave nga njeriu, zakonisht në formën e komandave ose të dhënave. Sistemet ndërvepruese të nivelit të lartë, siç janë lojërat me kompiuter, janë ndërtuar për të shpejtuar kërkesat e përdoruesit dhe jo për t'u përgjigjur në mënyrë përshkruese. Një program që nuk është ndërveprues, pasi fillon, vijon veprimin pa futje të mëtejshme të të dhënave nga njeriu.

#### **Ndihmë financiare** [*Grant*]

Fonde të marra nga një fondacion privat ose organizëm qeveritar për një person, grup ose institucion, në mbështetje të një projekti ose çështjeje me vlerë. Në shumicën e rasteve marrësi

duhet të konkurojë për këto fonde me anë të paraqitjes së një projekti.

## Në përpunim [In process]

Materiale bibliotekare të reja të porositura për blerje, të dërguara nga shitësi dhe të marra nga biblioteka, por që nuk janë gati për qarkullim, pasi nuk janë përfunduar proceset teknike (inventarizim, katalogim). Në katalogët online fjala “në përpunim” vendoset në regjistrimin e përkohshëm të katalogut për të treguar statusin e qarkullimit të një njësie të rë, që ka ardhur në bibliotekë, por nuk është gati për t'u huazuar nga përdoruesit. Biblioteka shejton procesin e përpunimit kur ka kërkesë në pritje nga përdoruesi.

## Në shtyp [In press]

Libër ose botim tjetër në procesin e shtypit, zakonisht i renditur në listën e librave të ardhshëm.

## Në treg, në shitje [In print]

Libër që aktualisht është i disponueshëm nga botuesi, në listën e botimeve të reja ose të mëparshme, në dallim nga titujt që nuk gjenden më në shitje. Zakonisht në SHBA këta gjenden në botimin vjetor *Books in Print*, *Children's Books in Print* etj.

## Nivel i plotë katalogimi [Full level cataloging]

Forma më e plotë e katalogimit të përgjithshëm, e zbatuar për materialet bibliotekare për prodhimin e një regjistrimi bibliografik me strukturën më të plotë të elementeve të të dhënave, përfshirë përshkrim bibliografik të plotë të njësisë në një regjistrim të strukturuar, për të lehtësuar aksesin përshkruar dhe sipas subjektit.

## Numër i daljes [Issue number]

Numër që i jepet nga botuesi një pjesë të një botimi serial që ka dalë e veçantë për ta dalluar atë nga pjesët e tjera të botuara në kohë të ndryshme. Numrat e daljes shënohen në vijimësi, duke filluar nga numri i parë i çdo periudhe botimi. Kur seriali botohet me vëllime, numrat e daljes rifillojnë nga e para për çdo vëllim. Kur citohet një artikull i një periodiku që ka numrat e daljes, numri zakonisht jepet i pasuar nga dy pika (:) që paraprijnë numrin e vëllimit.

## Numri i parë i një reviste [First issue]

Njësie e parë e një periodiku të ri të botuar (numri

i vëllimit të parë). I referohet edhe njësisë së parë të marrë nga biblioteka të një periodiku të ri, jo domosdoshmërisht numri i parë i botuar.

## Numri Standard Ndërkombëtar i Librit [International Standard Book Number (ISBN)]

Kod unik shifror i botuesit, i vendosur për qëllime identifikimi të një botimi të veçantë të një libri ose veprë tjetër monografike, para se të botohet. Zakonisht shtypet në anën e pasme të faqes së titullit dhe në kapakun e pasmë poshtë. Në ISBD dhe AACR2 vendoset në zonën e numrit standard dhe të kushteve të disponueshmërisë të regjistrimit bibliografik. Numri ISBN përbëhet nga katër pjesë të ndara mes tyre me hapësirë ose vijë, ku pjesa e parë identifikon kombësinë, gjuhën, zonën gjeografike ku është botuar njësia, pjesa e dytë identifikon botuesin, pjesa e tretë identifikon titullin, vëllimin ose botimin e veprës dhe pjesa e fundit është shifra e kontrollit që bën të mundur kapjen e gabimeve në numrat e mëparshëm.

## Numri Standard Ndërkombëtar i Serialit [International Standard Serial Number (ISSN)]

Numër standard unik shifror i caktuar nga Sistemi Ndërkombëtar i të Dhënave për Serialet (ISDS) për të identifikuar një botim serial të caktuar. ISSN-ja zakonisht jepet në krye të çdo numri. Kur seriali ndryshon titullin, merr ISSN tjetër. Në ISBD dhe AACR2 ISSN vendoset në zonën e numrit standard dhe të kushteve të disponueshmërisë të regjistrimit bibliografik.

## Nyje e fillimit [Initial article]

Nyje që gjendet në pozicionin e fjalës së parë të një titulli ose emri organizimi (zakonisht *a*, *an*, *the* në anglisht ose ekuivalentë të tyre në gjuhë të tjera) që nuk merren parasysh në indeksim. Në regjistrimet në formatin MARC indikator i pozicionit të dytë që pason targën (etiketën e fushës) tregon numrin e karaktereve që nuk duhen marrë parasysh kur zgjidhet ose renditet titulli ose emri në fushën përkatëse.

## Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit [International Organization for Standardization (ISO)]

E themeluar në Londër në vitin 1947, me zyrën qendrore në Gjenevë, ISO është federatë

joqeveritare e organizatave kombëtare të standardizimit të vendeve, që i janë kushtuar vendosjes së standardeve ndërkombëtare për të lehtësuar tregtinë dhe bashkëpunimin në shkencë, teknikë dhe ekonomi. ISO punon me komitete teknikë dhe nënkomitete, të cilët rekomandojnë standarde dhe politika standardizimi në vendet anëtare.

### **Organizëm strehues, bartës** [*Host organization*]

Organizëm në të cilin funksionon një bibliotekë speciale, p.sh. një muze që mban bibliotekë në mjediset e tij për përdorim nga restauruesit, studiuesit dhe punonjësit e tjerë, ose një korporatë që mban bibliotekë për t'u përdorur nga punonjësit për nevoja të punës së tyre.

### **Panairi i Librit i Frankfurtit** [*Frankfurt Book Fair*]

Panairi më i madh i tregtimit të librit dhe një nga më të vjetrit në botë, që organizohet çdo vit në Frankfurt, Gjermani. U krijon mundësi botuesve të ekspozojnë botimet e tyre, të diskutojnë rreth të drejtave ndërkombëtare të shpirtit, të bëjnë marrëveshje për botime të përbashkëta etj.

### **Pasuri librare** [*Holdings*]

I gjithë fondi i materialeve, të shtypura ose jo, në zotërimi të një biblioteke ose sistemi bibliotekar, zakonisht i renditur në një katalog. Sinonim në këtë kuptim me koleksion i bibliotekës (*Library collection*). U referohet edhe të gjitha kopjeve, vëllimeve, numrave ose pjesëve të një njësie, pronë e një biblioteke, të treguara me anë të një shënimi në regjistrimin që paraqet njësinë në katalog.

### **Përdorim brenda bibliotekës** [*In-house use*]

Numri i herëve që një njësi është përdorur brenda mureve të bibliotekës gjatë një periudhe kohe të caktuar (zakonisht një muaj ose vit), krahas numrit të herëve që ai është huazuar jashtë institucionit. Përdorimi brenda bibliotekës shënohet duke numëruar sa herë njësi është vënë mbi tryezë nga përdoruesit në mjedisin e shërbimit, publik të bibliotekës dhe është rivendosur në raft nga punonjësi i bibliotekës. Ndonëse kjo mënyrë nuk është krejtësisht e saktë (disa përdoruesi i vendosin vetë në raft materialet pas përdorimit), statistikat e përdorimit mund të ndihmojnë në politikën e

zhvillimit të koleksioneve referuese dhe të periodikut.

### **Përdorim i përbashkët** [*Joint use*]

Marrëveshje e përbashkët mes një biblioteke dhe një institucioni tjetër si p.sh. shkollë, kolegji ose universitet, sipas të cilës të dy institucionet ndajnë të njëjtat mjete e pajisje dhe koleksione. P.sh. një bibliotekë publike dhe një bibliotekë universitare përdorin bashkërisht të njëjtën ndërtesë dhe të njëjtat koleksione.

### **Përfundim i gabuar** [*False drop*]

Regjistrim bibliografik në kërkim të informacionit, i gjetur sipas një kërkimi me fjalë kyçe, i cili nuk ka lidhje me subjektin e kërkimit, zakonisht sepse plotëson kërkesat sintaksore të pyetjes, por jo ato semantike. Përfundimi i gabuar në përgjithësi ndodh kur kuptimi është i ndryshëm me ndryshimin e renditjes së termave të kërkimit (biblotekë + shkollë gjen "shkollë biblioteke" dhe "bibliotekë shkollë") ose kur një term i përdorur në një shprehje kërkimi ka më shumë se një kuptim. Për shembull, një kërkim me fjalën "të ftohtit" do të gjejë regjistrimet për njësi që trajtojnë të ftohtit si sëmundje, por edhe si klimë etj. Për të shmangur këtë problem duhet t'i shtohet një cilësor shprehjes së kërkimit, p.sh. "sëmundje", për ta bërë kërkimin dhe gjetjen më të saktë. Sinonim me kombinim i gabuar (*false combination*).

### **Periodicitet** [*Frequency*]

Intervali i daljes së një periodiku apo i një botimi tjetër në seri (ditor, dy herë në javë, javor, mujor, dymujor, tremujor, vjetor, i parregull etj.). Periodiciteti dhe ndryshimet e tij pasqyrohen në zonën e shënimeve të përshkrimit bibliografik të serialit.

### **Periodicitet i parregull** [*Irregular*]

Denduria e numrave të një botimi periodik që del në intervale kohe jo të njëjta dhe nuk ka rregull të vendosur për periodicitetin.

### **Piktor** [*Illustrator*]

Artist që krijon vizatimet, pikturat, skicat për të ilustruar ose plotësuar tekstin e një libri ose botimi tjetër të shtypur. Piktori i një libri me ilustrime për fëmijë mund të jetë më i vlerësuar se autori i tekstit. Në rregullat e përshkrimit AACR2, kur ka



ilustrime në tekstin e një vepre, përshkrimi bazë bëhet me emrin e autorit të tekstit dhe për piktorin mund të bëhet përshkrim shtesë, nëse është e nevojshme. Kur vepra është rezultat i bashkëpunimit të autorit me piktorin, përshkrimi bazë bëhet sipas emrit të personit që është renditur i pari në burimin kryesor të informacionit.

## **Politikë informacioni** [*Information policy*]

Parim, plan ose drejtim veprimi lidhur me burimet dhe teknologjinë e informacionit, i miratuar nga një kompani, organizatë, institucion ose qeveri.

## **Pronë intelektuale** [*Intellectual property*]

Produkte të prekshme të mendjes dhe intelektit të njeriut, që kanë statusin e pronës personale, veçanërisht veprat e mbrojtura nga e drejta e autorit, shpikje të patentuara dhe marka prodhimi të regjistruara. Një ide konsiderohet pronë intelektuale e krijesit të saj vetëm pasi të jetë regjistruar ose paraqitur në një formë të veçantë.

## **Protokoll për Transferim Skedari** [*FTP (File Transfer Protokol)*]

Protokoll që lejon skedarët e të dhënave të kopjohen nga një kompiuter te një tjetër përmes Internetit pavarësisht nga platforma, pa qenë nevoja të lidhen si në e-mail. Një kompiuter që funksionon si server, që ruan skedarë të disponueshëm për kompiutera të tjerë, quhet site FTP. Kur nuk kërkohet emër përdoruesi ose fjalëkalim për akses, ky kompiuter është një site FTP anonim dhe skedarët e tij mund të transferohen nga kushdo përmes aksesit në Internet. Ndonëse kanë ende përdorim të gjerë, FTP po zëvendësohen nga World Wide Web si mënyra më popullore për përhapjen e informacionit në format digjital.

## **Prozë letrare** [*Fiction*]

Vepër letrare në prozë, ku përshkruhen karaktere dhe ngjarje të krijuara në imagjinatën e shkrimtari, e menduar për të argëtuar dhe zhvilluar tërthorazi përvojën e jetës së lexuesit. Në prozën historike karakteret dhe ngjarjet zakonisht mbartin lidhje me atë që ka ndodhur me të vërtetë, por ndonjë herë dialogu është ndërtuar ose imagjinuar nga autori. E gjithë proza letrare është imagjinare në kuptimin e të qenit e sajuar, por një prozë e mirë mbetet "e vërtetë në jetë". Format tradicionale të

prozës letrare janë romani, novela dhe tregimi.

## **Qendër për detyra shtëpie** [*Homework center*]

Mjedis pranë bibliotekës publike, zakonisht me orar të përcaktuar dhe me personel të kualifikuar, që siguron shërbime për nxënësit, të cilët kërkojnë ndihmë për të kryer detyrat e shtëpisë.

## **Regjistrim i njësisë** [*Item record*]

Në katalogim, regjistrim që i përket regjistrimit bibliografik të një kopjeje të një vepre njëvëllimëshe, ose kopje e një vëllimi të një vepre të botuar në vëllime të veçanta pasi njësia ka hyrë në bibliotekë dhe është përpunuar. Regjistrimi i njësisë zakonisht tregon tipin e njësisë, numrin e vëllimit, numrin e inventarit, barkodin, pozicionin, çmimin, gjendjen, rregullat e huazimit dhe informacion rreth veprimeve të huazimit si numri i identifikimit të përdoruesit, data e kthimit etj. Në katalogimin e serialeve, zakonisht një regjistrim përfaqëson një titull seriali dhe për numrat e veçantë bëhen shënimet përkatëse.

## **Regjistrim i plotë** [*Full record*]

Paraqitja më e plotë e elementeve të të dhënave që përfshihen në një regjistrim bibliografik, të krijuar për të prezantuar një njësi me të gjitha fushat dhe nënfushat e nevojshme, për të identifikuar dhe përshkruar njësinë, ndryshe nga një regjistrim i përbledhur, ku tregohet vetëm një pjesë e përshkrimit bibliografik të disponueshëm. Katalogët në rrjet dhe bazat e të dhënave bibliografike i ofrojnë të dy formatet.

## **Regjistrime joaktive** [*Inactive records*]

Regjistrime që nuk kërkohen më nga agjenci ose individë në punën e përditshme dhe mund të ruhen në një mjedis të ndërmjetëm, të transferohen për ruajtje arkivore, të prishen ose mënjahen në mënyrë që të mos ndikojnë në veprimet normale.

## **Revistë hibride** [*Hybrid journal*]

Periodik që funksionon si gazetë dhe revista duke përfshirë veçori tipike të të dyjave.

## **Revistë me interes të përgjithshëm** [*General interest magazine*]

Revistë me interes për publik të gjerë. Bibliotekat publike zakonisht abonohen në revista me interes sa më të gjerë popullore dhe janë më të kufizuara

në abonimin e revistave me interes të ngushtë.

### **Rezervim kërkese** [*Hold*]

Kur një libër ose njësi tjetër është për momentin e huazuar, shumë biblioteka i japin mundësi një huamarrësi tjetër të rezervojë kërkësen në banakun e qarkullimit. Përdoruesi që e ka huazuar njësinë nuk lejohet të shtyjë afatin e dorëzimit dhe personi që ka rezervuar kërkësen njoftohet ta huazojë materialin kur të kthehet në bibliotekë.

### **Rregullore për renditje** [*Filing rule*]

Udhëzues i krijuar për të përcaktuar mënyrën e renditjes së përshkrimeve në një katalog bibliotekë. Botimi i parë i Shoqatës së Bibliotekarëve Amerikanë *ALA Rules for Filing Catalog Cards*, i vitit 1942, u ripunua në vitin 1967 duke u përshtatur me rregullat e katalogimit AACR. Botimi i ri *ALA Filing Rules*, i vitit 1980, zbatohet për të gjitha formatet bibliografike (të shtypura, mikroforma, digjitale etj.) Sipas këtyre rregullave renditja bëhet shkronjë për shkronjë deri në fund të çdo fjale dhe fjalë për fjalë deri në fund të çdo elementi të renditjes. Numrat paraprijnë shkronjat.

### **Ruajtja dhe gjetja e informacionit** [*Information storage and retrieval (ISAR)*]

Veprime që kryhen nga pajisja kompiuterike (hardware) dhe programi (software) për indeksimin dhe ruajtjen e një skedari regjistrimesh, sa herë që përdoruesi kërkon nga sistemi informacion të përshtatshëm për një subjekt të caktuar. Shprehja e kërkimit për regjistrimet që kërkohen duhet të ndërtohet me sintaksë të ekzekutueshme nga kompiuteri.

### **Shënim në fund të faqes** [*Footnote*]

Shënim i shkurtër në fund të faqes që shpjegon ose zgjeron një çështje të tekstit, ose tregon burimin e një citimi ose ideje që i kushtohet një personi tjetër dhe jo autorit. Shënimet në fund të faqes tregohen në tekst me numra arabë të shkruar sipër, ose me shenja referuese dhe zakonisht janë me madhësi shkronjash më të vogël nga ato të tekstit. Kur janë të numëruara, zakonisht fillojnë me 1 në fillim të çdo kapitulli, por mund të fillojnë nga numri 1 edhe në fillim të çdo faqeje.

### **Shënim për njësitë pronë të bibliotekës** [*Holdings note*]

Shënim që vendoset në regjistrimin në katalog për një njësi të koleksionit të bibliotekës për të treguar sa kopje, vëllime, numra ose pjesë që zotëron biblioteka ose sistemi bibliotekar gjenden në fonde të hapura ose të mbyllura, zakonisht me informacion për vendndodhjen e njësisë.

### **Shënim shpjegues, koment** [*Gloss*]

Në dorëshkrimet e vjetra shpjegim, sqarim ose interpretim i një fjale ose fraze me gjuhë sa më të kuptueshme, i shkruar në hapësirën mbi rreshtin e tekstit të cilit i referohet, ose në një shtojcë të veçantë të quajtur fjalor i fjalëve të vështira, i hartuar nga një person i njohur si hartues i këtyre lloj fjalorësh. Në shtypin modern, shënimin në hapësirën boshe të majtë ose të djathtë quhet shënim anësor dhe zakonisht shtypet me madhësi shkronjash më të vogla nga teksti të cilit i referohet.

### **Shenjë identifikuese** [*Fingerprint*]

Identifikues unik i formuar sipas një formule, i përdorur për të identifikuar kopje të librave të hershëm që i përkasin një botimi të caktuar. Formula zakonisht përbëhet nga dy pjesë: viti i daljes së botimit plus madhësia e librit (p.sh. 157504 për një botim me fashikuj katërsh të botuar në vitin 1575), pasuar nga tre grupe karakteresh të transkriptuara nga rreshti i tekstit që është menjëherë mbi shenjat e sinjaturës të shtypura në fund të faqeve të caktuara, për të ndihmuar libërlihdhësin në mbledhjen e fashikujve në mënyrë të rregullt. Edhe kur teksti është shtypur me saktësi si në botimin e mëparshëm, shenjat e sinjaturës të shtuara pasi është kompozuar teksti, rrallë vendosen në të njëjtin vend, duke krijuar një ndryshim që mund të përdoret për identifikim.

### **Shërbim i informacionit të ri** [*Current awareness service*]

Shërbim ose botim për të njoftuar studentët, studiuesit, lexuesit ose punonjësit për literaturën më të re të botuar për fushat e tyre të interesit sipas specializimeve. Zbatohet zakonisht në bibliotekat speciale që u shërbejnë kompanive, organizatave dhe institucioneve në të cilat aksesit në informacionin aktual është themelor. Këto shërbime kryhen për të plotësuar interesa të profilizuara të individëve të veçantë ose grupeve. Disa katalogë online dhe baza të dhënash bibliografike kanë zgjedhje për "kërkim të

preferuar" që i jep mundësi përdoruesit të bibliotekës të arkivojë rezultatet e kërkimit dhe t'i përdorë ato përsëri sipas nevojave.

### **Shkelje, thyerje** [*Infringement*]

Përdorimi pa leje i materialeve të mbrojtura nga e drejta e autorit ose patenta, duke shkelur ligjin e të drejtave të pronarëve të veprës. Një përdorim i tillë mund të jetë objekt i veprimeve ligjore nga ana e atyre që kanë të drejtën e autorit.

### **Shkenca e informacionit** [*Information science*]

Studim sistematik dhe analizë e burimeve, zhvillimit, mbledhjes, organizimit, shpërndarjes, vlerësimit, përdorimit dhe menaxhimit të informacionit në të gjitha format e tij, përfshirë kanalet (zyrtare dhe jozyrtare) dhe teknologjinë e përdorur në transmetimin e tij.

### **Shkronja e parë** [*Initial letter*]

Shkronjë e madhe në fillim të fjalës së parë të një kapitulli ose paragrafi. Në dorëshkrimet e Mesjetës shkronjat e fillimit zakonisht janë të zbukuruar dhe ilustruara. Tek inkunabulat shkronja e fillimit vendosej në vendin e lënë bosh pasi shtypeshin fletët.

### **Shprehje** [*Expression*]

Sipas përkufizimit në FRBR (*Functional Requirements for Bibliographic Records – Kërkesat Funktionale për Regjistrimet Bibliografike*), forma e realizimit të një vepre krijuese, për shembull një variant i vetëm i tekstit të një vepre letrare (Hamleti i Shekspir) ose partitura e një kompozitori ose një interpretim i caktuar i një vepre muzikore. Çdo modifikim i përbajtjes intelektuale ose artistike të një vepre (shkurtim, përshtatje, ripunim, përkthim etj.) rezultojnë në një shprehje të re. Termi është abstrakt në kuptimin e përjashtimit të aspekteve të formës fizike që nuk janë të rëndësishme për përbajtjen intelektuale/artistike, si p. sh. madhësia e shtypit, madhësia e shkronjave e përdorur për shtypjen e fjalëve dhe fjalive të një vepre të shkruar.

### **Simbol shprehës** [*Expressive notation*]

Në disa sisteme klasifikimi, struktura e shkronjave, numrave dhe/ose e simboleve të përdorura për të shënuar klasat. Janë krijuar për

të treguar pozicionin hierarkik ose veçori të çdo klase dhe nënklase. Për shembull, në Klasifikimin Dhjetor të Djuit nënndarjet e njëpasnjëshme të një klase shënohen me numra arabë dhe nënndarje dhjetore.

### **Sistem shenjash i veçorive** [*Faceted notation*]

Sistem shenjash në të cilin veçoritë e një sistemi klasifikimi tregohen me anë të simboleve, p.sh. dy pikat (:) në *Sistemin e Klasifikimit me Raport të Ranganathanit* ose në Klasifikimin Dhjetor Universal.

### **Sistemi Ndërkombëtar i të Dhënave për Serialet** [*International Serials Data System (ISDS)*]

Rrjet ndërqeveritar i krijuar nën kujdesin e UNESCO-s për të zhvilluar dhe mirëmbajtur një regjistrim ndërkombëtar të botimeve në seri me informacion të nevojshëm për identifikim dhe kontroll bibliografik, përfshirë Numrin Standard Ndërkombëtar të Serialit (ISSN) dhe titullin kyç.

### **Standardi Ndërkombëtar i Përshkrimit Bibliografik** [*International Standard Bibliographic Description (ISBD)*]

Komplet standardesh të miratuara në vitin 1971 nga Federata Ndërkombëtare e Shoqatave dhe Institucioneve Bibliotekare (IFLA) për të përcaktuar përshkrimin bibliografik të njësisë të depozituar në biblioteka. Standardi i përgjithshëm ISBD(G) shërben si udhëzues për përshkrimin e të gjitha llojeve të materialeve. Janë zhvilluar gjithashtu standarde për formate të veçanta si: ISBD(M) për monografitë, ISBD(CM) për materialet hartografike, ISBD(PM) për materialet muzikore të shtypura, ISBD(S) për serialet, ISBD(ER) për burimet elektronike, ISBD(An) për materialet antikuar, ISBD(CP) për pjesët përbërëse etj.

### **Subvencion, ndihmë nga shteti** [*Grant-in-aid*]

Fonde që biblioteka ose sistemi bibliotekar i merr nga shteti për veprimtari të zakonshme ose për një projekt ose program të veçantë, përveç fondeve që merren rregullisht. Në shumicën e rasteve biblioteka paraprakisht duhet të aplikojë në një proces konkurrues duke paraqitur propozimin.



### **Tastierë** [*Keyboard*]

Pajisje periferike që i jep mundësi përdoruesit të kompiuterit të fusë të dhëna me dorë duke shtypur çelësat e shënuar me shkronja, numra dhe karaktere të veçanta. Çelësat mund të jenë të vendosur në një grup të vetëm në radhë paralele ose të ndarë në dy grupe rreshtash. Tastiera e kompiuterit mund të jetë pajisje e veçuar si në kompiuterat personalë ose jo si në kompiuterat portativë (laptop).

### **Të përgjithshme** [*Generalia*]

Vepra që nuk mund të caktohen në një klasë të veçantë bazuar në subjektin, tematikën apo trajtimin, pasi nuk janë të specializuara në fusha të caktuara, por kanë natyrë të larmishme, si p.sh. enciklopeditë e përgjithshme ose almanakët. Në klasifikimin bibliotekar dhe në bibliografi është e përcaktuar një kategori e veçantë për veprat e përgjithshme, zakonisht në krye të skemës së klasifikimit apo listës. Sinonim me *generalities*.

### **Teknologjia e informacionit** [*Information technology (IT)*]

Term shumë i gjerë që përfshin të gjitha aspektet e menaxhimit dhe përpunimit të informacionit me anë të kompiuterit, përfshirë edhe pajisjet (hardware) dhe programin e nevojshëm (software) për aksesimin e tij.

### **Tekst i plotë** [*Full-text*]

Burim elektronik që jep tekstin e plotë të një vepre ose të një baze të dhënash bibliografike, që siguron tekstin e plotë të një pjese të mirë të veprave të indeksuara në të, përveç citimit dhe (në shumë raste) të abstraktit të çdo vepre.

### **Tematikë me interes** [*Interest profile*]

Listë fjalësh kyçe të zgjedhura nga një tezaur lëndor, që paraqesin çështje me interes për përdoruesin e interesuar për informacion të ri. Kërkimet e zakonshme kryhen në bazë të termave. Përdoruesi njoftohet për praninë e botimeve të reja menjëherë sapo ato indeksohen. Informacioni i ri vendoset në krye të tematikës së dëshiruar. Sinonim me *User profile*.

### **Titull i anasjellë, i përkundërt** [*Inverted title*]

Titull i ndarë në dy pjesë nga bibliografi ose indeksuesi dhe që i ndërrohen vendet për të sjellë

fjalën më domethënëse në pozicionin e fjalës së parë, për t'u përdorur si zë ose element hyrës në një bibliografi ose indeks.

### **Titull kyç** [*Key title*]

Emër unik i dhënë një botimi serial, i lidhur me Numrin Standard Ndërkombëtar të Serialit (ISSN) sipas Sistemit Ndërkombëtar të të Dhënave për Serialet (ISDS). Titulli kyç zakonisht (por jo gjithmonë) është i njëjtë me titullin kryesor të serialit. Në katalogimin bibliotekar titulli kyç vendoset pas ISSN në regjistrimin bibliografik. Nëse seriali nuk ka ISSN, titulli kyç nuk vendoset në regjistrim.

### **Titull nderi** [*Honorific title*]

Titull zyrtar i dhënë një personi nga një autoritet i njohur në shenjë nderimi, grade, fisnikërie ose privilegji mbretëror (p.sh. **Cardinal** Richelieu). Në AACR2 titulli i nderit përfshihet në kryetitull të emrit vetjak vetëm kur është shumë i përdorur së bashku me emrin e një personi. Në këto raste titulli pason emrin vetjak dhe paraprin datën e lindjes dhe të vdekjes (p.sh. Newton, Isaac, Sir, 1674-1727).

### **Tregues gjeografik** [*Geographic index*]

Tregues në të cilin zërat janë renditur sipas pozicionit gjeografik (qytet, shtet, vend etj.). I referohet gjithashtu një treguesi që rendit vendet gjeografike të përmendura në një tekst ose dokument. Sinonim me *place index*.

### **Tymosje** [*Fumigation*]

Në konservim, proces i ekspozimit të njësie prej letre dhe materialesh të tjera në avull helmues brenda një konteineri hermetik për të eliminuar insektet, mykun, këpurdhat dhe organizma të tjerë dëmtes të koleksioneve. Kur infeksioni është i madh, mund të jetë e nevojshme tymosja e mjedisit ku janë vendosur njësitë.

### **Udhëzues** [*Guide*]

Informacion i ofruar nga biblioteka, zakonisht në formë të një materiali të shtypur ose broshure që: 1) shpjegon si të përdoren shërbimet e bibliotekës (skedarët, katalogët në rrjet, huazimi ndërbibliotekar etj.); 2) përshkruan burime të rëndësishme për një subjekt, disiplinë, ose formë

të veçantë (artikuj periodiku, dokumente qeveritare, biografi etj.); 3) shpjegon si të kryhet një detyrë (hartimi i një bibliografie të adnotuar, citimi i burimeve sipas një stili të veçantë bibliografik etj.). Në arkiv, mjet ndihmës që siguron përmbledhje ose përshkrim të përgjithshëm të përmbajtjes së një koleksioni arkivor ose që përshkruan materiale arkivore për një subjekt të caktuar, zonë gjeografike, periudhë historike etj. ose të një lloji të caktuar materiali (ditare, letra, fotografi etj.).

#### **Veçori funksionimi [Functionality]**

Veçori e ndërtuar në një ndërfaqe kërkimi që përcakton mënyrën sipas të cilës përdoruesit mund të formulojnë pyetjet dhe të marrin përgjigjet. Software-t e kërkimit të projektuar mirë i japin mundësi përdoruesit:

- të identifikojë bazat e të dhënave më të përshtatshme për subjektin e kërkimit;
- të kërkojë njëkohësisht në më shumë se një bazë të dhënash;
- të spostojë regjistrimet e dubluara nga rezultati i kërkimit kur kërkon në disa baza të dhënash;
- të shohë listën korrente të botimeve të indeksuar në çdo bazë të dhënash;
- të zgjedhë mënyrën e kërkimit bazuar në aftësitë (kërkim bazë ose i përparuar);

- të aksesojë mesazhet e ndihmës të organizuara mirë në çdo hap të procesit të kërkimit;
- të konsultojë tezaurët online ose të përdorë fjalorë termash të kontrolluar për të identifikuar termat e kërkimit të përshtatshëm;
- të kufizojë rezultatin e kërkimit përmes lidhjeve, llojit të materialit, datës së botimit, gjuhës, freskimit më të fundit, tekstit të plotë etj.;
- të zgjedhë rezultatin sipas autorit, titullit, datës së botimit etj.;
- të shohë termat e kërkuar të theksuar;
- të shohë dhe të ruajë historinë e kërkimit;
- të ruajë rezultatet pavarësisht nga shfletuesit e Web-it;
- të printojë, postojë në formë elektronike dhe të transferojë rezultatet në formate të ndryshme.

#### **Zonë aktive [Hot spot]**

Ikone me madhësi të ndryshme ose pjesë e një imazhi më të madh të shfaqur në ekranin e kompiuterit, që funksionon si lidhje aktive me një skedar tjetër ose dokument të disponueshëm në të njëjtin server ose në server tjetër. Kur klikohet me anë të mausit, ekzekutohet një instruksion i koduar për të gjetur dhe shfaqur materialin me të cilin është lidhja.

*Përgatitur nga F. Xhaja*





Mais à quoi servent vraiment  
les bibliothèques municipales ?

# Recherches sur la bibliothèque

Les politiques de lecture  
publique au Brésil

# BBBF





# BIBLIOTHECAE

BIBLIOTEKONOMI PROJEKTE TË REJA DOKUMENTE LEXIME TË REKOMANDUARA HISTORI E LIBRIT DHE E SHTYPIT